With funding from

Austrian Development Cooperation

Sweden Sverige

1.2."Violence against women" - is understood to be a violation of human rights and a form of discrimination against women, and shall mean all acts of gender-based violence that result in or are likely to result in physical, sexual, psychological or economic harm or suffering of women, including threats of such acts, coercion or arbitrary deprivation of liberty, whether in public or private life;

1.3. "Domestic violence" - shall mean all acts of physical, sexual, psychological and economic violence that occur within the family relationship, or the household unit, regardless of the blood connection or family relationship, or from the former or the current intimate partner, regardless of the fact that the perpetrator of the violence shares or has shared the same residence with the victim, with the aim of violating the dignity and keeping under control of another person against whom violence

Zero Tolerancë?

1.4. Gender based violence against women" - means violence directed against a woman because she is a woman or that affects women disproportionately. Gender based violence against women is a manifestation of historically unequal power relationship between women and men as a result of a social problem rather than an individual one;

Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë

1.5. "Political Harassment" - political harassment is one or several acts of pressure, persecution, harassment or threats, carried out by a person or a group of people, directly or through third parties, against women candidates, elected, appointed or in the exercise of the political-public function or against their families, with the aim of curtailing, suspending, preventing or limiting the functions inherent in their position, to induce or compel them to perform, against their will, an action or not to act , in the performance of duties or in the exercise of their rights;

1.6. "Political Violence" - political violence means actions, behaviour and/or physical, psychological, sexual aggression committed by a person or a group of people, directly or through third parties, against women candidates, elected, appointed or in the exercise of the political-public function, or against her family, to curtail, suspend, prevent or limit the exercise of her duty or to induce or compel her to perform, against her will, an act or omission, in the performance of duties or in the exercise of their rights;

1.7."Gender" - means the socially constructed roles, behaviours, activities and attributes that a given society deems appropriate for women and men;

Rrjeti i Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2025

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autorët/et: David JJ Ryan, Besarta Breznica, Nicole Farnsworth, Edita Bllaca, Adelina Berisha, Melisa Kadolli, Era Kadriu, Luigj Uka

Ky publikim është përgatitur me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida). Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e autorëve/eve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e ADA-s apo Sida-s.

Përmbajtja

FALENDERIME 3

AKRONIMET DHE SHKURTESAT 4

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6

HYRJE 8
Pse ky hulumtim? 10
Metodologjia 11
Rreth këtij raporti 13

ANALIZA LIGJORE 14
Çështjet tematike në kuadër të Konventës së Stambollit dhe zbatueshmëria e tyre në legjislacionin e Kosovës 18
E drejta themelore 27
Hetimi, Ndjekja Penale, E Drejta Procedurale dhe Masat Mbrojtëse 46
Masat për Parandalimin e Dhunës 62
Mbledhja e të Dhënave 66
Përfundim 68

Reagimi Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë 69
Gjetjet e Përgjithshme 69
Koordinimi Ndërinstitucional 74
Policia e Kosovës 78
Inspektorati i Policisë 83
Instituti i Mjekësisë Ligjore 83
Prokuroria 84
Këshilli Prokurorial i Kosovës 87
Ndihma Juridike 90
Gjykatat 91
Rehabilitimi i kryesve të veprave dhe përgjigjet institucionale 99
Shërbimet Sociale 101
Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Trajnimeve Profesionale 107
Institucionet Shëndetësore 108
Institucionet Arsimore 109
Institucioni i Avokatit të Popullit 110
Organizatat e Shoqërisë Civile 111
Akterët Ndërkombëtarë 113
Përfundim 113

REKOMANDIME 114
Për Zyrën e Kryeministrit 114
Për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve 114
Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Koordinatoren Kombëtare 115
Për Policinë e Kosovës 119
Për Institutin e Mjekësisë Ligjore 120
Për Prokurorinë dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës 121
Për Zyrat e Ndihmës Juridike 121
Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, AD, dhe Gjyqtarët/et 122
Për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin e Provës 123

Për Shërbimet Sociale 123
Për Strehimoret 125
Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Institucionet Arsimore 125
Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institucionet Shëndetësore 126
Për Komunat 127
Për Institucionin e Avokatit të Popullit 128
Për Këshillin e Evropës 128
Për Koordinimin ndërinstitucional 128
SHTOJCAT 129
Shtojca 1. Të dhënat e institucioneve mbi dhunën me bazë gjinore 129
Shtojca 1. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2022–2026 135

FALENDERIME

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falenderon të gjithë përfaqësuesit/et e institucioneve dhe organizatave që ndanë kohën e tyre për realizimin e këtij monitorimi. RrGK e vlerëson thellësisht bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, veçanërisht me Zyrën e Koordinatores Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, si dhe me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) në Zyrën e Kryeministrit (ZK). Ekipi hulumtues i RrGK-së, i përbërë nga Edita Bllaca, Era Kadriu, Luigj Uka, Fitim Sadiku, Melisa Kadolli, Besarta Breznica dhe Adelina Berisha, punoi me përkushtim për zhvillimin, transkriptimin dhe analizimin e intervistave. Ky raport ndërtohet mbi dhe përfshin hulumtimin e realizuar për raportet e mëhershme të RrGK-së nga Endrita Banjska, Besarta Breznica, Dardan Hoti dhe Biljana Jaredić. Saneea Abboud, Ebba Hellman, Melisë Mustafa dhe Mirjeta Ademi kontribuan vullnetarisht në mbështetjen e finalizimit të raportit, Arthur Cox LLP, dhe në veçanti David JJ Ryan, përgatitën analizën ligjore. Adelina Berisha dhe Nicole Farnsworth ofruan mbështetje në shkrimin dhe redaktimin përfundimtar të raportit, ndërsa Arjeta Murati dhe Loreta Suka dhanë kontributin e tyre në përkthim dhe transkriptim. RrGK falenderon gjithashtu Saneea Abboud për shqyrtimin dhe redaktimin vullnetar të draft-raportit. Ekipi Menaxhues i RrGK-së, përfshirë Igballe Rogovën, Zana Rudin dhe Besa Shehun, ofroi mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Rishikuesit/et e raportit, përfshirë ABGJ, Adile Bashën nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare, eksperten dhe ligjëruesen për barazi gjinore, Ariana Qosja-Mustafa, si dhe Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), dhanë komente të vlefshme për versionin paraprak të raportit. Ky proces monitorimi dhe përgatitja e raportit nuk do të ishin të mundshme pa mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

.

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AD	Akademia e Drejtësisë
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DDV	Direktivë për të Drejtat e Viktimave
DHG	Dhuna ndaj Grave
DHGDHF	Direktivë e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GNDHBGJ	Grupi Ndërministror për Dhunën me Bazë Gjinore
GRETA	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Tregtisë me Qenie Njerëzore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KE	Këshilli i Evropës
KE	Komisioni Evropian
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Koordinatori Kombëtar
KKDHF	Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KS	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ("Konventa e Stambollit")
LGBTQIA+	Persona lezbike, gej, biseksualë, trans, kuir, interseks, aseksualë dhe persona me identitete të tjera gjinore ose seksuale
LMDHF	Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKMDHF	Mekanizmat Komunalë për Koordinim kundër Dhunës në Familje
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MV	Mbrojtësit e Viktimave
NA	Jo e disponueshme
NJHDHF	Njësia për Hetimin e Dhunës në Familje
Nr.	Numër
OIK	Institucioni i Avokatit të Popullit

OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPDAT	Zyra për Zhvillim, Ndihmë dhe Trajnim të Prokurorisë Jashtë Shtetit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PK	Policia e Kosovës
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional
QKSH	Qendra për Kështillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime
QPS	Qendra për Punë Sociale
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi i Provës së Kosovës
Sida	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SKMDHF	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave
SMIR	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve për Rastet
TFGBV	Dhuna me Bazë Gjinore e Lehtësuar nga Teknologjia
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UEM	Urdhri Emergjent për Mbrojtje
UM	Urdhri Mbrojtës
UN Women	Agjencia e OKB-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UP	Universiteti i Prishtinës
UPMM	Urdhri i Përkohshëm i Menjëhershëm për Mbrojtje
ZMNV	Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave
ZNJ	Zyrtarë të Ndihmës Juridike
ZP	Zyra e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) e ka realizuar këtë hulumtim me qëllim të identifikimit të boshllëqeve ende ekzistuese në kuadrin ligjor të Kosovës për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të njohur si Konventa e Stambollit (KS). Po ashtu, synimi ka qenë të kontribuojë në proceset e vazhdueshme përmes vlerësimit të njohurive, qëndrimeve dhe performancës së institucioneve përgjegjëse në zbatimin e këtij kuadri ligjor. Gjetjet bazohen në literaturën ekzistuese, të dhënat relevante, 128 intervista me institucione përgjegjëse, si dhe monitorimin e gjykatave. Ky raport, që mbulon periudhën 2021–2024, ndërtohet mbi monitorimet e rregullta që RrGK ka bërë mbi performancën institucionale që nga viti 2008.

Kosova ka përmirësuar ndjeshëm kuadrin e saj ligjor për trajtimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ). Në vitin 2020, Kosova e ndryshoi Kushtetutën e saj duke përfshirë Konventën e Stambollit (KS). Dhuna në familje dhe ngacmimi seksual janë përfshirë në Kodin Penal të Kosovës (KPK), ndërsa disa ligje të tjera janë rishikuar për t'u përafruar me standardet e KS-së. Në vitin 2022, Ministria e Drejtësisë (MD) miratoi Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje 2022–2026 (SKMDHF) dhe Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Më pas, në vitin 2023, u miratua Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF). Megjithë këto përparime, qasja gjinore në adresimin e dhunës ndaj grave ende nuk është integruar plotësisht në kuadrin ligjor të Kosovës, dhe disa politika shtesë për përafrimin e plotë me KS-në janë ende në shqyrtim. Dhuna kibernetike dhe dhuna seksuale vazhdojnë të jenë të nënvlerësuara në legjislacion, ndërsa zbatimi mbetet sfidues. Përafërsisht 54% e SKMDHF-së u zbatua plotësisht, 42% pjesërisht, ndërsa 5.5% nuk ishte zbatuar, deri në dhjetor 2024. Që nga viti 2020, njohuritë dhe qëndrimet e institucioneve që merren me trajtimin e dhunës me bazë gjinore janë përmirësuar. Megjithatë, kuptimi i dobët për natyrën e DHBGJ-së, veçanërisht dhunës seksuale, dhe fajësimi i viktimave ende mbeten të pranishme. Besimi se dhuna duhet të zgjidhet brenda familjes apo në rrethin shoqëror, në vend që të raportohet, është ende i përhapur dhe ndikon negativisht në raportim. Përpjekjet për "pajtim të çifteve" me arsyetimin e "ruajtjes së familjes" vazhdojnë përmes institucioneve. Zyrtarët përgjegjës shpesh shkelin konfidencialitetin. Policia e Kosovës (PK) ende ka mungesë të trajnimeve adekuate dhe shpesh e minimizon rëndësinë e veprave penale. Mbrojtësve të Viktimave (MV) u mungon stafi i mjaftueshëm, ndaj shpesh mungojnë në stacionet policore kur raportohen rastet e dhunës, pavarësisht detyrimeve ligjore për praninë e tyre. Prokurorët ende e ngatërrojnë ngacmimin seksual me sulmin seksual, mbështeten shumë në dëshmitë e viktimave pa mbledhur prova të tjera të mjaftueshme dhe përballen me probleme me infrastrukturën; provat e pamjaftueshme kontribuojnë në dënime të ulëta. Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) trajton shumë raste të dhunës në familje dhe dhunës seksuale, por shpesh përballet me raporte të paplota mjekësore nga institucione të tjera për shkak të mungesës së trajnimit dhe sfidave logjistike. Mungesat në dokumentimin e traumës psikologjike ndikojnë në rezultatet ligjore dhe në dënimet.

Gjyqtarët civil dhe penal në përgjithësi kanë njohuri mbi veprat që lidhen me dhunën me bazë gjinore, por pak prej tyre i kuptojnë plotësisht ose i trajtojnë në mënyrë të përshtatshme veprat penale siç janë nxitja për të ekspozuar pjesët intime të trupit dhe gjymtimi gjenital femëror (GJGJF). Sistemi gjyqësor ende përballet me sfida të mëdha në zbatimin e Konventës së Stambollit (KS), veçanërisht në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Edhe pse janë vërejtur disa përmirësime të vogla, ndjekja penale mbetet e ngadalshme dhe jo e qëndrueshme.

Një zhvillim thelbësor ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese (2023), i cili për herë të parë iu referua drejtpërdrejt KS-së dhe detyrimeve të autoriteteve të drejtësisë, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt njohjes dhe zbatimit të saj në praktikë. Ndërkohë, drejtorët komunal të arsimit shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi ligjet që rregullojnë DHBGJ-në. Mungesa e psikologëve në shkolla dhe shkeljet e konfidencialitetit mbeten sfida të vazhdueshme.

Stafi i Zyrave të Punësimit (ZP) dhe Qendrave të Aftësimit Profesional (QAP) shpesh nuk kanë njohuri mbi ligjet që lidhen me DHBGJ-në dhe shpesh manifestojnë qëndrime patriarkale përmes fajësimit të viktimave. Institucionet shëndetësore (MSH) shpesh nuk e trajtojnë dhunën seksuale apo gjymtimin gjenital femëror si çështje serioze. Punëtorët/e socialë/e kanë nivele të ndryshme të njohurive për DHBGJ-në, duke ngatërruar shpesh ngacmimin seksual me sulmin seksual. Sfidat e vazhdueshme përfshijnë mungesën e kuptimit të plotë të qasjes së bazuar në viktimë dhe mënyrës së menaxhimit të duhur të rasteve, mungesën e stafit të mjaftueshëm, si dhe mungesën e strehimit afatgjatë. Edhe pse gjendja financiare e strehimoreve është përmirësuar, ato ende nuk disponojnë fonde të mjaftueshme për zbatimin e plotë të Konventës së Stambollit (KS), veçanërisht në aspektin e mbështetjes për riintegrim, si dhe përballen me bashkëpunim të paqëndrueshëm me institucionet. Disa komuna vazhdojnë të mos i përmbushin detyrimet e tyre ligjore për financimin e strehimoreve dhe punëtorëve social. Boshllëqet ligjore të mbetura, vlerësimet e dobëta të rrezikut për sigurinë e viktimave, mungesa e trajnimeve adekuate, kufizimet në burime, bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional dhe qëndrimet e dëmshme shoqërore vazhdojnë të minojnë mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e të mbijetuarave/ve të dhunës.

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore nënkupton çdo formë dhune ndaj një personi për shkak të gjinisë së saj apo të tij. Megjithatë, kjo dhunë prek më së shumti gratë, si pasojë e normave ekzistuese gjinore dhe pabarazive të fuqisë[1]. Ajo përfshin dhunën në familje, dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike. Ndër krimet më të përhapura që ndodhin, dhuna me bazë gjinore mbetet një nga çështjet më serioze të të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit.[2] Sipas një ankete të vitit 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), 54% e grave në Kosovë kanë raportuar se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri intim që nga mosha 15 vjeçare, ndërsa gati 30% kanë përjetuar ngacmim seksual.[3] Edhe më shqetësuese është se vetëm 2% e grave kanë raportuar rastet e rënda të dhunës në polici, gjë që tregon për një mosbesim të thellë ndaj institucioneve dhe frikë nga stigmatizimi shoqëror. Edhe pse anketa e OSBE-së nuk përfshiu burrat, një hulumtim i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) nga viti 2015 gjeti se 56% e burrave dhe 68% e grave kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre.[4] Këto shifra, megjithatë, nuk pasqyrojnë përmasën e vërtetë të problemit, pasi shumë raste mbeten të paraportuara. Pothuajse gjysma e grave në Kosovë (48%) e konsiderojnë dhunën, sidomos dhunën në familje, si çështje private.[5] OSBE-ja ka gjetur se ekziston lidhje e qartë mes grave që kanë përjetuar dhunë dhe atyre që besojnë se dhuna në familje është "çështje e brendshme", apo se "gruaja duhet të jetë e bindur dhe nënshtruese". Gratë që kanë këto bindje janë më të prira të përjetojnë dhunë në familje dhe rrjedhimisht hezitojnë ta raportojnë. Mosraportimi pengon aftësinë e institucioneve për ta adresuar dhe trajtuar në mënyrë efektive dhunën. Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) e njeh dhunën ndaj grave, si në jetën private ashtu edhe në atë publike, si shkelje të të drejtave të njeriut.[6] Ndërsa në vitin 2014, Konventa e Stambollit (KS) vendosi një kornizë të plotë ligjore për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore, duke u bërë instrumenti i parë ndërkombëtar ligjërisht i

Kutia 1. "Zero Tolerancë"

Qasja e "tolerancës zero" nënkupton ndëshkimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, pavarësisht ashpërsisë së tyre apo rrethanave lehtësuese. Kjo qasje eliminon hapësirën për interpretim nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke siguruar ndëshkim të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm për çdo rast dhune.

[1] Këshilli i Evropës, Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, [Në anglisht], 2011.
[2] Pas vjedhjes (16,287 raste), dhuna në familje ishte krimi i dytë më i raportuar në Kosovë gjatë katër viteve të fundit (10,220 raste) (të dhëna të RrGK-së nga Policia e Kosovës), 2024.
[3] OSBE, *Survey on violence against women: Well-being and Safety of Women*, [Në anglisht], 2019.
[4] Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Banjska, I., Berisha, A., dhe Morina, D., për RrGK, *Mjaft më me arsyetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, 2015.
[5] OSBE, *Survey on violence against women: Well-being and Safety of Women*, OSBE, [Në anglisht], 2019. Kjo përkon me gjetjet e anketës së RrGK-së të vitit 2015, e cila tregoi se 31% e kosovarëve e shihnin dhunën në familje si çështje private, duke besuar se fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici (Farnsworth et al. për RrGK, Mjaft më me arsyetime, 2015).
[6] Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW General Recommendation No. 19: Violence against women, [Në anglisht], 1992. General Recommendation No. 35. Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 ka njohur më tej se ndalimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave është shndërruar në një parim detyrues të së drejtës zakonore ndërkombëtare.

detyrueshëm në këtë fushë.[7] Konventa e Stambollit njeh se dhuna ndaj grave është pjesë e një sistemi më të gjerë shtypës. Gratë përjetojnë dhunë strukturore të bazuar në gjini, e cila dallon nga dhuna incidentale e kryer ndaj burrave.[8] Për shembull, në Kosovë, ky sistem më i gjerë shtypës shfaqet përmes shkallës më të ulët të punësimit të grave, diskriminimit me bazë gjinore në tregun e punës, përfaqësimit të pamjaftueshëm të grave në pozita vendimmarrëse dhe pronësisë minimale të pasurive nga gratë. Analizat e fundit e konfirmojnë këtë model, duke treguar se gratë vazhdojnë të përballen me pengesa të tilla sistemike.[9] Të gjithë këta faktorë e vendosin gruan në një pozitë të pabarabartë në shoqëri dhe, si pasojë, e ekspozojnë ndaj një rreziku më të lartë për të përjetuar dhunë. Konventa e Stambollit kërkon një qasje të "tolerancës zero" ndaj dhunës me bazë gjinore (shih Kutia 1). Kosova është zotuar për zbatimin e CEDAW-it dhe, që nga viti 2020, e ka përfshirë Konventën e Stambollit në Kushtetutë, duke e bërë atë të zbatueshme në praktikë.[10] Është e rëndësishme të theksohet se KS njeh natyrën gjinore të dhunës, pabarazisë dhe diskriminimit dhe se "dhuna kryhet kundër grave sepse ato janë gra".Sipas Konventës së Stambollit, institucionet që merren me rastet e dhunës me bazë gjinore duhet të sigurojnë një qasje të koordinuar dhe të përqendruar tek viktima (shih Kutinë 1), e cila garanton mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim efektiv.

Në kuadër të aspiratave të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), Komisioni Evropian (KE), në raportet e tij të progresit, ka theksuar në mënyrë të përsëritur nevojën që institucionet e Kosovës ta trajtojnë dhunën me bazë gjinore si çështje të të drejtave të njeriut dhe, më së fundi, edhe si çështje të sundimit të ligjit.[11] Për më tepër, parandalimi i dhunës me bazë gjinore mund të ndihmojë në uljen e shpenzimeve shtetërore për polici, drejtësi, shërbime sociale dhe papunësi, ndër të tjera.[12] Në Kosovë, vlerësimet e mëhershme tregojnë se vetëm dhuna në familje i ka kushtuar shtetit mbi 3.1 milionë euro në kosto direkte gjatë viteve 2011 dhe 2012, ndërsa kostoja reale ka qenë shumë më e lartë duke marrë parasysh ditët e humbura në punë, ndikimin në shëndet, si dhe pasojat në arsim dhe mundësitë afatgjata të punësimit për fëmijët, ndër të tjera.[13] Prandaj, adresimi dhe parandalimi i dhunës, veçanërisht parandalimi i përsëritjes së saj, është edhe në interesin ekonomik të shtetit. Për më tepër, është thelbësore për të parandaluar lëndimet fizike dhe vdekjen, përkatësisht femicidin.

[7] Këshilli i Evropës, *Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence* (Konventa e Stambollit), [Në anglisht] 2011.
[8] Berisha et al. për RrGK, *Nga fjalët në vepra*, 2017.
[9] UN Women, Kosovo Gender Country Profile, [Në anglisht], 2024.
[10] KS tani është e zbatueshme sipas Nenit 22 [Direct Applicability of International Agreements and Instruments], [Në anglisht].
[11] KE, Commission Staff Working Document, Kosovo* 2024 Report, [Në anglisht], 2024.
[12] Për shembull, një studim rasti në Mbretërinë e Bashkuar, i realizuar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), vlerësoi se dhuna me bazë gjinore i kushton vendit mbi 32.5 miliardë euro në vit (*Estimating the costs of gender-based violence in the European Union: Report*, 2014). [Në anglisht].
[13] Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Ekonomi, M., Shima, A., dhe Dauti-Kadriu, D. për RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, 2012.

Kutia 2. "Qasja e përqendruar tek viktima"

Zbatimi i një "qasjeje të përqendruar tek viktima" nënkupton që institucionet duhet gjithmonë t'i vendosin në qendër prioritetet dhe nevojat e personave që kanë përjetuar dhunë. Si parim themelor, institucionet duhet të minimizojnë dëmin dhe të rrisin sigurinë e personave që kanë përjetuar dhunë. Empatia dhe konfidencialiteti duhet të sigurohen, ndërsa informacionet ndahen me institucione të tjera vetëm pas pëlqimit të personit të prekur. Personat që kanë përjetuar dhunë duhet të informohen plotësisht për të drejtat e tyre ligjore dhe për shërbimet mbështetëse që u janë në dispozicion. Pasi të jenë të sigurt dhe të gatshëm, institucionet duhet t'i përfshijnë ata/ato në hartimin e një plani që garanton sigurinë e tyre dhe t'i mbështesin me shërbime rehabilituese të përshtatura me nevojat individuale. Gjithashtu, viktimat duhet të kenë të drejtën të japin mendim dhe vlerësim për mënyrën se si janë trajtuar nga institucionet, përfshirë edhe procesin e referimit, dhe institucionet duhet ta përdorin këtë feedback për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve. Të gjithë ofruesit/et e shërbimeve duhet të trajnohen në mënyrë të veçantë për zbatimin e kësaj qasjeje dhe të sigurojnë që të zbatohet në praktikë në çdo rast.

Pse ky hulumtim?

Misioni i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) është të mbështesë, mbrojë dhe promovojë të drejtat e grave dhe vajzave. Një nga synimet afatgjata strategjike të RrGK-së është që gratë dhe vajzat të jetojnë jetë të lira nga dhuna me bazë gjinore.[14] Për të ecur drejt këtij vizioni, RrGK monitoron rregullisht performancën e institucioneve për të vlerësuar përparimin e tyre në zbatimin e kuadrit ligjor. Përmes këtij monitorimi, RrGK synon të sigurojë prova që mund të përdoren në komunikim dhe avokim me institucionet, me qëllim përmirësimin e reagimit institucional. Kështu, RrGK synon të ofrojë informata të dobishme dhe kritika konstruktive që do të kontribuojnë në përmirësimin e jetës së personave të prekur nga dhuna, veçanërisht grave.

Në vitet 2008,[15] 2009,[16] 2015,[17] 2017,[18] and 2021,[19] RrGK zhvilloi hulumtimet në të gjithë Kosovën që shqyrtuan përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, duke u përqendruar në dhunën në familje dhe, që nga viti 2015, edhe në ngacmimin seksual. Të zhvilluara në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM), Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe institucione të tjera relevante, këto hulumtimet kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në hartimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF),[20] strategjive kombëtare pasuese për adresimin e dhunës me bazë gjinore, si

[14] RrGK, *Strategjia 2019-2022*, 2018.
[15] Farnsworth, N. dhe Qosaj-Mustafa, A. për RrGK në bashkëpunim të ngushtë me ABGJ-në, *Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje*, ABGJ: 2008.
[16] Qosaj-Mustafa, A. dhe Farnsworth, N. për RrGK, *Më shumë se "Vetëm fjalë"? Përgjigja e organeve të drejtësisë ndaj dhunës në familje në Kosovë*, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), 2009.
[17] Farnsworth et al. për RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, 2015.
[18] Berisha et al. për RrGK, *Nga fjalët në vepra*, 2017.
[19] Banjska, E., Breznica, B., Ryan, D., dhe Farnsworth, N. për RrGK, *Nga Ligjet në Vepra*, 2021.
[20] Vlerësohet se rreth 70% e rekomandimeve të RrGK-së, që dolën nga raporti "Mjaft më me arsyetime", u përfshinë në Strategjinë për periudhën 2022–2026.

dhe Procedurave Standarde të Operimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë (PSV). Më së fundi, raporti i RrGK i vitit 2021, *Nga Ligjet në Vepra*, përdori gjetjet nga monitorimi i reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje për të formuluar rekomandime specifike për secilin institucion.[21] Që nga ajo kohë, RrGK ka zhvilluar takime me përfaqësues/e institucionalë/e për të diskutuar këto rekomandime dhe për të mbështetur zbatimin e tyre. Për më tepër, RrGK ka dërguar 105 letra avokuese, ka dhënë kontribut në 23 ligje dhe politika, ka marrë pjesë në grupe punuese qeveritare, ka nisur fushata ndërgjegjësuese, është angazhuar në protesta dhe ka qenë e pranishme rregullisht në media për të avokuar për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e mëhershme hulumtuese.

Ky hulumtim, pra, ka synuar të vlerësojë nëse institucionet kanë zbatuar rekomandimet e mëhershme të RrGK-së dhe në çfarë mase është përmirësuar performanca e tyre që nga monitorimi i vitit 2021. Hulumtimi ka pasur për qëllim matjen e ndryshimeve në qëndrimet, vetëdijen dhe mënyrën e trajtimit të dhunës me bazë gjinore nga ana e institucioneve, si dhe monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor përkatës.

Që nga viti 2021, kanë ndodhur disa ndryshime në kuadrin ligjor. Ky raport analizon shkallën në të cilën janë zbatuar këto reforma ligjore dhe hapat që mbeten për t'u ndërmarrë në mënyrë që kuadri ligjor i Kosovës të harmonizohet plotësisht me Konventën e Stambollit (KS). Përveç kësaj, ky proces monitorimi ka pasur për qëllim të vlerësojë në mënyrë të pavarur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (SKMDHF) për periudhën 2022–2024.

Metodologjia

Në përputhje me qëllimet e përmendura më lart, ky hulumtim ka synuar t'u përgjigjet tre pyetjeve kërkimore të ndërlidhura dhe nënpytjeve përkatëse:

- Në çfarë mase kuadri ligjor i Kosovës që lidhet me dhunën me bazë gjinore është i harmonizuar me Konventën e Stambollit (KS); dhe në çfarë mase ky kuadër po zbatohet në praktikë?
  - Cilat pjesë kanë nevojë për rishikim të mëtejshëm; dhe si ka ndryshuar kjo që nga viti 2021, nëse ka pasur përmirësime?
  - Në çfarë mase është zbatuar Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (SKMDHF) 2022–2026?
  - Në çfarë mase po zbatohen dispozitat e reja të Kodit Penal të Kosovës (KPK) që lidhen me dhunën me bazë gjinore?

- Në çfarë mase përfaqësuesit/et e institucioneve publike përgjegjëse janë të vetëdijshëm/me për detyrimet e tyre në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, dhe si ka ndryshuar kjo vetëdije që nga viti 2021, nëse ka pasur përmirësime?
  - Sa të vetëdijshëm janë ata/ato për format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore?
  - Sa njohuri kanë për detyrimet e tyre ligjore në lidhje me dhunën në familje?

- Në çfarë mase institucionet përkatëse po i zbatojnë përgjegjësitë e tyre?
  - Në çfarë mase po funksionojnë mekanizmat e koordinimit?
  - Cilat janë sfidat që pengojnë funksionimin e tyre të qëndrueshëm dhe efektiv?

[21] Banjska et al. për RrGK, *Nga Ligjet në Vepra*, 2021.

Në kuadër të këtij hulumtimi, dhuna me bazë gjinore është operacionalizuar (pra, është përcaktuar) për të përfshirë: dhunën në familje, dhunën fizike, dhunën psikologjike, martesën e detyruar, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar, dhunën e ndihmuar nga teknologjia, ngacmimin seksual, përdhunimin, sulmin seksual, gjymtimin gjenital femëror (GJGJF), përndjekjen dhe vrasjen. Ekipi hulumtues e njeh faktin se ekzistojnë edhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore — më e rëndësishmja ndër to, trafikimi me qenie njerëzore — por këto nuk janë përfshirë në hulumtim për shkak të kufizimeve kohore dhe burimeve të disponueshme.

RrGK përdor termin "viktimë" në këtë raport, pasi ky term përdoret në Konventën e Stambollit, në legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në kuadrin ligjor të Kosovës. Megjithatë, RrGK njeh dhe respekton aftësinë, autonominë dhe fuqinë vepruese të personave që kanë përjetuar dhunë.[22]

Ky hulumtim ka ndjekur të njëjtën metodologji si hulumtimet e mëhershme të RrGK për dhunën me bazë gjinore, në mënyrë që të mundësohet krahasimi i rezultateve me kalimin e kohës. Hulumtimi është zhvilluar duke përdorur metoda të kombinuara, që përfshijnë: rishikimin e kuadrit ligjor përkatës, vëzhgimin e reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore, kërkimin në dokumente (desk research), realizimin e intervistave dhe analizën e të dhënave statistikore.

Së pari, RrGK ka shqyrtuar kornizën ligjore dhe politike të Kosovës në raport me Konventën e Stambollit (KS) dhe me aspektet përkatëse të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian. Qëllimi i këtij procesi ka qenë identifikimi i ndryshimeve që ende nevojiten në kuadrin ligjor. Ky rishikim ligjor ka shërbyer gjithashtu si bazë për hartimin e pyetjeve të intervistës.

Së dyti, RrGK ka monitoruar punën e institucioneve përgjegjëse në trajtimin e 292 rasteve të dhunës me bazë gjinore gjatë periudhës 2021–2024 në pesë komuna ku funksionojnë gjykatat: Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan (shih Grafikun 1). Një numër dukshëm më i madh rastesh është monitoruar në Prishtinë, ku gjenden më shumë gjykata dhe ku raportohen më shumë raste. Ky proces ka përfshirë edhe monitorimin e rasteve kur personat i janë drejtuar RrGK-së dhe kanë kërkuar ndihmë. Një protokoll monitorimi është përdorur për të vëzhguar rastet, i cili ka përfshirë vlerësimin e punës së të gjitha institucioneve të përfshira në çdo seancë gjyqësore. RrGK ka marrë pjesë gjithashtu në seanca në Qendrat për Punë Sociale (QPS), kur kjo ka qenë e nevojshme.

Grafiku 1. Numri i rasteve të monitoruara sipas komunës



Së treti, ekipi hulumtues pesëanëtarësh i RrGK-së ka zhvilluar 128 intervista gjysmë të strukturuara me institucione dhe akterë përgjegjës për zbatimin e kuadrit ligjor që lidhet me dhunën me bazë gjinore (64% gra, 36% burra). Duke përdorur metodën e përzgjedhjes së larmishme (variation sampling), të intervistuarit/at janë përzgjedhur në bazë të përgjegjësive të tyre ligjore nga institucionet e mëposhtme: Policia e Kosovës, Mbrojtësit e Viktimave (MV), Qendrat për Punë Sociale (QPS), gjykatat civile, gjykatat penale, prokuroritë, Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP), shërbimet korrektuese, shërbimet e provës, institucionet arsimore, institucionet shëndetësore, Zyrat e Punësimit (ZP), Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP), Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) dhe strehimoret për persona që kanë përjetuar dhunë.

[22] IEBGJ, "Definition of Victim", [Në anglisht], 2012.

Gjykatat, policia dhe prokuroritë zakonisht kanë caktuar vetë pjesëmarrësit/et për intervista. Përqindja më e lartë e grave pjesëmarrëse mund të pasqyrojë përbërjen gjinore të vetë institucioneve apo vendimin institucional se kush do të marrë pjesë. RrGK ka zhvilluar gjithashtu intervista me organizata të ndryshme të shoqërisë civile (OSHC) që punojnë për adresimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe strehimoret.

Intervistat janë realizuar në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicën e Jugut, Prishtinë dhe Ferizaj, duke u bazuar në udhëzues intervistash të përshtatur për secilin institucion. Pyetjet janë fokusuar në detyrimet e tyre ligjore, njohuritë rreth këtyre detyrimeve, qëndrimet dhe përvojat e tyre në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, si dhe ndryshimet institucionale që kanë ndodhur prej vitit 2021 e deri më sot.

Për të siguruar triangulim në hulumtim dhe vlefshmëri më të lartë të të dhënave, në shumicën e intervistave kanë marrë pjesë dy hulumtues/e.[23] Hulumtuesit/et kanë përdorur gjithashtu metodën e refleksivitetit, duke shqyrtuar pas çdo interviste se si pozicioni i tyre mund të ketë ndikuar në përgjigjet e të intervistuarve. Për të zvogëluar ndikimin e mundshëm të dinamikave gjinore dhe të pushtetit, ekipi është përpjekur të sigurojë që intervistat të zhvillohen ndërmjet personave të së njëjtës gjini. Megjithatë, kjo nuk ka qenë gjithmonë e mundur për shkak të kufizimeve në orare. Përgjigjet e pjesëmarrësve mund të kenë ndryshuar varësisht nga gjinia e intervistuesit/es, gjë që mund të ketë ndikuar në rezultatet e hulumtimit. Për shembull, ekipi hulumtues ka vërejtur se pjesëmarrësit meshkuj kanë qenë më të hapur dhe më të sinqertë gjatë intervistave me hulumtues meshkuj sesa me hulumtuese femra.

Së katërti, RrGK ka kërkuar dhe ka shqyrtuar të gjitha të dhënat statistikore të disponueshme që lidhen me dhunën me bazë gjinore, të cilat janë ofruar nga institucionet përkatëse, përfshirë policinë, prokurorinë, gjykatat dhe strehimoret.[24] RrGK ka marrë gjithashtu të dhëna nga baza e re e centralizuar për rastet e dhunës në familje: Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve për Rastet (CMIS). Analiza e të dhënave ka pasur për qëllim të shqyrtojë trendet me kalimin e kohës lidhur me raportimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore nga institucionet përgjegjëse.

Ekipi hulumtues i ka koduar gjetjet e studimit në një bazë të dhënash të ndërtuar në përputhje me pyetjet kërkimore. Për të siguruar vlefshmëri dhe saktësi më të madhe gjatë procesit të kodimit, secila intervistë është analizuar nga të paktën dy anëtarë/e të ekipit. Autorët/et e raportit kanë dërguar draftin përfundimtar për rishikim te pjesëmarrësit/et dhe kolegët/et, ndërsa para publikimit janë bërë ndryshimet e nevojshme bazuar në komentet dhe sugjerimet e marra.

Rreth këtij raporti

Kapitulli i parë analizon kuadrin aktual ligjor të Kosovës në raport me Konventën e Stambollit (KS), me qëllim që të identifikohen ndryshimet që ende nevojiten për ta adresuar në mënyrë të plotë dhunën me bazë gjinore në legjislacion, si pjesë e proceseve të vazhdueshme të rishikimit dhe amendimeve ligjore. Kapitulli i dytë analizon reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë pjesë të ndara për secilin institucion përgjegjës, si edhe për bashkëpunimin ndërinstitucional. Kapitulli i tretë paraqet rekomandimet e drejtuara për secilin institucion përkatës. Shtojcat përfshijnë (1) të dhëna mbi trajtimin nga institucionet të formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore; dhe (2) një përmbledhje të vlerësimit të pavarur të RrGK-së mbi zbatimin e SKMDHF-së.

[23] Në disa raste, për shkak të vështirësive në planifikim, shënuesi/ja nuk ka mundur të marrë pjesë. Këto intervista janë regjistruar, transkriptuar dhe analizuar nga disa hulumtues/e.

[24] Për të gjitha të dhënat e pranuara, shih Shtojcën 2.

ANALIZA LIGJORE

Ky kapitull analizon kornizën ligjore dhe të politikave në lidhje me dhunën me bazë gjinore në Kosovë.[1] Së pari përshkruan kornizën përkatëse ligjore ndërkombëtare dhe më pas shqyrton çështje tematike që ndërlidhen me Konventën e Stambollit (KS). Më tej, shqyrton shkallën në të cilën legjislacioni i Kosovës është harmonizuar me dispozitat thelbësore të KS-së, duke përfshirë veprat që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe kompensimin e viktimave. Në vijim, kapitulli analizon se në çfarë mase korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit (KS) që kanë të bëjnë me hetimin, ndjekjen penale, procedurat gjyqësore dhe masat mbrojtëse. Në fund, paraqiten masat që KS-ja përcakton për parandalimin e dhunës dhe mbledhjen e të dhënave, si edhe vlerësohet zbatueshmëria e tyre në Kosovë.

Kuadri Ndërkombëtar Ligjor

Kjo pjesë paraqet një përmbledhje të kornizës ndërkombëtare ligjore që lidhet me adresimin e dhunës me bazë gjinore, si edhe të shkallës në të cilën instrumentet ndërkombëtare janë të zbatueshme në Kosovë.

Konventa e Stambollit

Konventa e KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si "Konventa e Stambollit" (KS), ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2014. KS synon të vendosë një sërë detyrimesh gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave brenda kuadrit ligjor të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, duke u bërë instrumenti i parë ligjërisht detyrues i këtij lloji në Evropë.[2] Duke u mbështetur në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Konventa e Stambollit (KS) e njeh dhunën ndaj grave si një shprehje të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis gjinive, të cilat kanë çuar në nënshtrimin dhe diskriminimin e grave, si edhe në pengimin e pjesëmarrjes së tyre të plotë në jetën shoqërore.[3]

Konventa e Stambollit përcakton dhe kriminalizon format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe kërkon nga shtetet nënshkruese që të bëjnë ndryshime ligjore në legjislacionin civil dhe penal kombëtar, nëse është e nevojshme. Krimet e përcaktuara në të përfshijnë dhunën psikologjike, përndjekjen, dhunën fizike dhe dhunën seksuale, përfshirë përdhunimin, martesën e detyruar, gjymtimin gjenital femëror (GJGJF), abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar dhe ngacmimin seksual. Konventa ndjek një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e dhunës me bazë gjinore përmes katër shtyllave: parandalimit, mbrojtjes dhe shërbimeve mbështetëse, ndjekjes

[1] Ky kapitull është një version i përditësuar dhe i rishikuar i një kapitulli të ngjashëm të botuar në raportin e mëparshëm të RrGK-së, "Nga Ligjet në Vepra" (2021). Kapitulli është shkruar fillimisht nga David JJ Ryan dhe është përditësuar nga Arthur Cox LLP, përfshirë edhe David JJ Ryan, si një kontribut pro bono për RrGK-në.
[2] Nousiainen, K. dhe Chinkin, C., "Legal Implications of EU Accession to the Istanbul Convention", Komisioni Evropian, 2015, f. 39, [Në anglisht].
[3] Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Preambula, [Në anglisht].

penale dhe politikave të koordinuara. Ajo parasheh një gamë të gjerë masash për zbatimin e politikave të koordinuara dhe gjithëpërfshirëse ndërmjet institucioneve.[4]

Më 25 shtator 2020, Kosova e ndryshoi Kushtetutën e saj për të përfshirë Konventën e Stambollit (KS) si ligj të zbatueshëm drejtpërdrejt.[5] KS u kërkon shteteve të sigurojnë ose të nxisin ndërmarrjen e masave të caktuara përmes ndryshimeve në kuadrin e tyre ligjor dhe politik kombëtar. Prandaj, që dispozitat e KS-së të kenë efekt praktik, Kosova duhet të ndërmarrë veprime shtesë ligjvënëse, të shoqëruara me llogaridhënie të rreptë, monitorim të vazhdueshëm dhe zbatim rigoroz të ligjit.

Ky raport analizon shkallën në të cilën kuadri ligjor i Kosovës është në përputhje me standardet e përcaktuara nga KS dhe identifikon ndryshimet shtesë që janë të nevojshme.

Aktualisht, Kosova është në proces të aplikimit për anëtarësim në KE. Nëse ky anëtarësim arrihet, Kosova do të ketë të drejtën të ratifikojë KS-në dhe kështu të bëhet "Palë" e Konventës. Ratifikimi i KS-së nga Kosova do të sillte me vete disa obligime juridiksionale dhe raportuese, të cilat aktualisht nuk zbatohen për Kosovën, siç shpjegohet më poshtë.

Bashkëpunimi kombëtar

Kapitulli VIII i Konventës së Stambollit (KS) lidhet me bashkëpunimin ndërmjet palëve për qëllimet e mëposhtme

- parandalimin, luftimin dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga fusha e veprimit të KS-së;
- mbrojtjen dhe ofrimin e ndihmës për viktimat;
- sigurimin e zhvillimit të hetimeve apo procedurave lidhur me veprat e parashikuara në KS; dhe
- zbatimin e aktgjykimeve civile dhe penale përkatëse, përfshirë urdhrat mbrojtës.[6]

Më konkretisht:

- Kosova do të jetë e obliguar të sigurojë që banorët e saj të kenë të drejtën të paraqesin ankesa ndërkufitare brenda vendit për vepra të kryera në territorin e një Pale tjetër të Konventës.[7]
- Nëse autoritetet kosovare kanë arsye të bazuara për të besuar se një person është në rrezik të menjëhershëm për t'u ekspozuar ndaj veprimeve të dhunës të përmendura në nenet 36 (dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin), 37 (martesat e detyruara), 38 (gjymtimi gjenital femëror) dhe 39 (aborti dhe sterilizimi i detyruar) në territorin e një Pale tjetër, ato do të inkurajohen të përcjellin këtë informacion menjëherë tek pala përkatëse, për të siguruar marrjen e masave të duhura mbrojtëse.[8]
- Kur autoritetet e Kosovës, gjatë hetimeve të tyre, hasin në informacione që mund t'i ndihmojnë një Pale tjetër në parandalimin e veprave penale, në fillimin apo

[4] Jürviste, Ü., Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian, "The Istanbul Convention: a tool to tackle violence against women and girls", 2015, f. 1, [Në anglisht].
[5] Këshilli i Evropës, "The National Kuvendi i Kosovës* decides to apply the Istanbul Convention", [Në anglisht], 2020.
[6] KS, Neni 62.
[7] Neni 62.2.
[8] Neni 63.

zhvillimin e hetimeve, ose që mund të çojnë në kërkesa për bashkëpunim në bazë të Kapitullit VIII, Kosova ka të drejtë t'ia përcjellë këto informacione palës tjetër, nëse një veprim i tillë është në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm.[9] Pala që i pranon këto informacione është e obliguar t'i përcjellë ato tek autoritetet e saj kompetente.[10]

Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO)

Mekanizmi i monitorimit të Konventës së Stambollit (KS), i njohur si GREVIO, është themeluar sipas Kapitullit IX të saj. GREVIO përbëhet nga një trup i pavarur monitorues me 10 deri në 15 anëtarë/e, përfshirë përfaqësues/e nga secila Palë nënshkruese e Konventës, të cilët/at zgjidhen nga Komiteti i Palëve. Nëse Kosova do ta ratifikonte KS-në, ajo do të bëhej anëtare e këtij Komiteti dhe do të kishte detyrimin t'i nënshtrohej procesit të monitorimit dhe vlerësimit nga GREVIO.

Palët janë të obliguara t'i dorëzojnë Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së një raport mbi masat ligjore dhe të tjera që synojnë zbatimin e Konventës së Stambollit (KS), i cili më pas shqyrtohet nga GREVIO.[11] GREVIO përgatit një raport paraprak që përmban analizën e tij nga procesi i vlerësimit, si dhe sugjerime e propozime për adresimin e problemeve të identifikuara.[12] Organizatat joqeveritare (OJQ-të), shoqëria civile, institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe disa trupa të KE-së ose të themeluara sipas instrumenteve të tjera ndërkombëtare mund t'i paraqesin informacione GREVIO-s gjatë përgatitjes së raportit të tij paraprak.[13] Raporti paraprak i përcillet Palës për komente, të cilat GREVIO i shqyrton gjatë miratimit të raportit përfundimtar.[14]

Komiteti i Palëve mund të miratojë gjithashtu rekomandime drejtuar një Pale, bazuar në raportin e GREVIO-s.[15] Në raste kur GREVIO merr informacione të besueshme që tregojnë një situatë që kërkon vëmendje të menjëhershme, ai mund t'i kërkojë një Pale të dorëzojë me urgjencë një raport të veçantë lidhur me masat që duhet ndërmarrë për të parandaluar një model të rëndë, masiv ose të vazhdueshëm të dhunës ndaj grave.[16] GREVIO ka gjithashtu kompetencë të miratojë rekomandime të përgjithshme, jo specifike për shtetet, lidhur me zbatimin e Konventës së Stambollit.[17] Edhe pse këto rekomandime nuk janë ligjërisht detyruese, ato përbëjnë pjesë të rëndësishme të procesit të ardhshëm të monitorimit.[18]

Përfshirja e Parlamentit

Parlamentet kombëtare duhet të ftohen të marrin pjesë në monitorimin e masave që ndërmerren për zbatimin e Konventës së Stambollit (KS).[19] Palët gjithashtu janë të obliguara t'i dërgojnë raportet e GREVIO-s parlamenteve të tyre kombëtare për shqyrtim. Përveç kësaj,

[9] Neni 64(2).
[10] Neni 64(3).
[11] Neni 68(1).
[12] Neni 68(10).
[13] Neni 68(5) dhe Neni 68(8).
[14] Neni 68(10).
[15] Neni 68(12).
[16] Neni 68(13).
[17] Neni 69.
[18] Këshilli i Evropës, Explanatory Report – CETS 210 – Violence against women and domestic violence, Article 69, [Në anglisht], 2011.
[19] KS, Neni 70(1).

Asambleja Parlamentare e KE-së (e përbërë nga parlamentarë të secilit shtet anëtar) do të "ftohet të vlerësojë rregullisht progresin në zbatimin" e KS-së.[20]

Direktiva e BE-së 2024/1385 për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje

Bashkimi Evropian miratoi Direktivën për Dhunën ndaj Grave (DHGDHF) më 14 maj 2024. Kjo direktivë ndjek në masë të madhe strukturën e Konventës së Stambollit, por përfshin disa shtesa të rëndësishme. Për shembull, DHGDHF përfshin vepra penale që lidhen me krimin e ndihmuar nga teknologjia ose krimin kibernetik, të cilat nuk janë pjesë e KS-së, si dhe saktëson mënyrën se si duhet të funksionojnë masat mbrojtëse dhe shërbimet mbështetëse. Shtetet Anëtare të BE-së duhet ta transpozojnë Direktivën në legjislacionin e tyre kombëtar deri më 14 qershor 2027.

Për shkak të kompetencave të kufizuara të BE-së në fushën e të drejtës penale, jo të gjitha veprat e përfshira në KS trajtohen nga DHGDHF. Ndërsa Direktiva kriminalizon vetëm disa forma të dhunës me bazë gjinore (gjymtimin gjenital femëror, martesën e detyruar dhe veprat e ndihmuara nga teknologjia), dispozitat që lidhen me mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave, si dhe me parandalimin e dhunës, vlejnë për spektrin më të gjerë të dhunës me bazë gjinore të përshkruar në KS dhe nuk duhet të kufizohen vetëm në veprat e kriminalizuara nga DHGDHF.

Legjislacioni tjetër i BE-së që lidhet me dhunën me bazë gjinore

Përveç Direktivës për Dhunën ndaj Grave (DHGDHF), acquis i Bashkimit Evropian në këtë fushë përfshin kryesisht përfundimet e Këshillit, rezolutat e Parlamentit Evropian dhe strategjitë e Komisionit Evropian. Ndryshe nga vetë DHGDHF-ja, këto dokumente nuk kanë fuqi detyruese juridike për shtetet anëtare.[21] Për më tepër, direktivat përkatëse nuk i referohen posaçërisht dhunës me bazë gjinore, por vetëm dhunës ndaj grave.

Megjithatë, disa akte ligjore të BE-së kanë rëndësi edhe për Kosovën, e cila, si vend që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, është e obliguar ta harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.[22] Instrumentet përkatëse përfshijnë: Direktivën për të Drejtat e Viktimave (DV);[23] Direktivën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;[24] Direktivën e Rishikuar për Trajtimin e Barabartë[25] dhe Direktivën për

[20] Nenet 70(2) dhe 70(3).
[21] Bonewit, A. (Drejtoria e Përgjithshme për Politika të Brendshme e Parlamentit Evropian), "Study on the Issue of Violence Against Women in the European Union", f. 44, [Në anglisht], 2016.
[22] Stabilisation and Association Agreement between the European Union and Kosovo, [Në anglisht] (OJ L 71, 16.3.2016).
[23] Direktiva 2012/29/BE on common minimum standards on the rights, support and protection of victims, [Në anglisht].
[24] Direktiva 2011/36/BE on preventing and combatting trafficking in human beings and protecting its victims, [Në anglisht].
[25] Direktiva 2006/54/KE on the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation (recast), [Në anglisht].

Mallrat dhe Shërbimet me Bazë Gjinore,[26] ku të dyja e përkufizojnë dhe e ndalojnë ngacmimin[27] dhe ngacmimin seksual;[28] si dhe Direktivën për Luftimin e Abuzimit Seksual ndaj Fëmijëve.[29]

Çështjet tematike në kuadër të Konventës së Stambollit dhe zbatueshmëria e tyre në legjislacionin e Kosovës

Kjo pjesë shqyrton temat që trajtohen në Konventën e Stambollit dhe shkallën në të cilën ato pasqyrohen në kuadrin ligjor dhe politik të Kosovës, përfshirë integrimin e një perspektive të duhur gjinore, një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale të përqendruar tek viktima dhe mekanizmave të mjaftueshëm të monitorimit.

Zbatimi i perspektivës gjinore të Konventës së Stambollit

Termi "gjini", si ndërtim shoqëror, është thelbësor për të përshkruar shtypjen strukturore ndaj grave dhe për të kuptuar pabarazitë historike, sistemike dhe institucionale të fuqisë që çojnë në pabarazi gjinore dhe dhunë me bazë gjinore.[30] Edhe pse ky term ishte tashmë në përdorim në kuadrin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut para Konventës së Stambollit (shih Kutinë 3),[31] Konventa e Stambollit ishte traktati i parë ndërkombëtar ligjërisht detyrues që e përkufizoi "gjininë" në terma të ndërtimit shoqëror.

Kutia 3. Terminologjia e KS

Seksi

I referohet "dallimeve biologjike ndërmjet grave dhe burrave."

- CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 28

Gjinia

I referohet "identiteteve, atributeve dhe roleve të ndërtuara shoqërisht për gratë dhe burrat, si dhe kuptimit shoqëror e kulturor që shoqëria i jep dallimeve biologjike, duke rezultuar në marrëdhënie hierarkike ndërmjet grave dhe burrave dhe në shpërndarjen e fuqisë dhe të drejtave në favor të burrave dhe në dëm të grave. Pozita shoqërore e grave dhe burrave ndikohet nga faktorë politikë, ekonomikë, kulturorë, shoqërorë, fetarë, ideologjikë dhe mjedisorë, të cilët mund të ndryshohen nga kultura, shoqëria dhe komuniteti."

- CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 28

Dhuna me bazë gjinore

Nënkupton dhunën që ushtrohet ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij apo të saj, ose që ndikon në mënyrë disproporcionale ndaj personave të një gjinie të caktuar.

---

[26] Direktiva 2004/113/KE on implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services, [Në anglisht].

[27] "Kur ndodh një sjellje e padëshiruar që lidhet me gjininë e një personi dhe që ka për qëllim ose si pasojë cenimin e dinjitetit të tij/saj, duke krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, poshtërues apo fyes."

[28] "Kur ndodh çfarëdo forme e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale apo fizike me natyrë seksuale, që ka për qëllim ose si pasojë cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijon një mjedis frikësues, armiqësor, poshtërues apo fyes."

[29] Direktiva 2011/93/BE për luftimin e abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë.Mbrojtja parashihet gjithashtu edhe në Direktivën 2011/99/BE për urdhrin evropian të mbrojtjes dhe në Rregulloren (BE) Nr. 606/2013 për njohjen e ndërsjellë të masave mbrojtëse në çështjet civile. Megjithatë, zbatimi i këtyre instrumenteve është i vlefshëm vetëm brenda Bashkimit Evropian, [Në anglisht].

[30] Antić, M. dhe Radačić, I., "Evoluimi i kuptimit të gjinisë në të drejtën ndërkombëtare dhe reagimi kundër 'ideologjisë gjinore' 25 vjet pas Konferencës së Pekinit për Gratë", Forumi Ndërkombëtar i Studimeve për Gratë, 2020, f. 83.

[31] Shih, për shembull, Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 28 të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (2010, neni 5).

Konventa njeh natyrën shoqërore të ndërtuar të gjinisë, duke e përkufizuar si "rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat". Kjo qasje progresive ndaj konceptit të gjinisë e dallon Konventën nga traktatet e mëhershme ndërkombëtare. Ajo kërkon që politikat të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe që gjatë zbatimit e vlerësimit të ndikimit të dispozitave të saj të përdoret një perspektivë gjinore. Të gjitha detyrimet që lidhen me mbrojtjen, mbështetjen,[32] dhe ndjekjen penale duhet të bazohen në një kuptim gjinor të dhunës ndaj grave.[33] Palët duhet të marrin masa, kur është e përshtatshme, për të përfshirë materiale mësimore mbi çështjet e barazisë gjinore, respektit të ndërsjellë dhe roleve gjinore jo-stereotipike.[34] Konventa e Stambollit kërkon që Palët të mbrojnë të drejtat e viktimave pa asnjë formë diskriminimi, përfshirë — për herë të parë në një traktat ndërkombëtar — bazuar në identitetin gjinor ose orientimin seksual.[35]

Konventa e Stambollit është pjesërisht e përcaktuar sipas gjinisë, pasi fokusohet në dhunën me bazë gjinore ndaj grave, e cila përkufizohet si "dhunë e ushtruar ndaj një gruaje për shkak të gjinisë së saj, apo dhunë që ndikon në mënyrë joproporcionale tek gratë."[36] Ndërsa Konventa synon të mbrojë të gjitha viktimat e dhunës në familje, ajo i kushton vëmendje të veçantë grave si gjinia më e prekur në mënyrë disproporcionale (Neni 2). Edhe pse kjo zgjidhje është përshkruar si inovative, rastet e dhunës në familje ndaj burrave nuk e kanë rrënjën në diskriminimin apo nënshtrimin strukturor.[37] Ish-Raportuesja e Posaçme e Kombeve të Bashkuara për Dhunën ndaj Grave, Rashida Manjoo, ka theksuar se përdorimi i neutralitetit gjinor në këtë kontekst "nxit një kuptim më pragmatik dhe politikisht të pranueshëm të gjinisë, duke e reduktuar atë thjesht në një eufemizëm për "burra dhe gra", në vend që të shihet si një sistem dominimi i burrave ndaj grave."[38] Ajo argumenton se një qasje e tillë nënkupton se viktimat meshkuj të dhunës "kërkojnë dhe meritojnë burime të ngjashme me ato që u ofrohen viktimave femra, duke injoruar faktin se dhuna ndaj burrave nuk është rezultat i pabarazisë dhe diskriminimit të përhapur, dhe se ajo nuk është as sistemike, as e përhapur në shkallë të gjerë — siç është, pa dyshim, dhuna ndaj grave." Ajo shton se:

> Dhuna ndaj grave nuk mund të analizohet rast pas rasti, e ndarë nga faktorët individualë, institucionalë dhe strukturorë që ndikojnë dhe formësojnë jetën e grave. Këta faktorë kërkojnë qasje specifike gjinore për të siguruar barazi në rezultatet për gratë. Përpjekjet për t'i bashkuar apo për t'i trajtuar të gjitha format e dhunës brenda një kuadri "gjinor neutral" zakonisht çojnë në një diskurs të depolitizuar ose të zbutur, i cili e braktis agjendën transformuese.

Në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore e njeh dhunën me bazë gjinore si një formë diskriminimi që "pengon seriozisht aftësinë e grave dhe burrave për të gëzuar të drejtat dhe liritë në bazë të barazisë".[39] Akti kryesor ligjor në fushën e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDhF),[40] u zëvendësua në vitin 2023 me Ligjin për

[32] Nenet18 dhe 49.
[33] Neni 6.
[34] Neni 14.
[35] Neni 4.3; shih më poshtë pjesën "Mosdiskriminimi dhe Qasja Ndërsektoriale për Trajtimin e Dhunës me Bazë Gjinore".
[36] Neni 3(d).
[37] Po aty.
[38] Manjoo, R., "Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences", (A/HRC/26/38), f. 17, [Në anglisht].
[39] Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Neni 4.2, 2015.
[40] Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, 2010.

Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF).[41] Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDhF) ishte kritikuar për mungesën e njohjes së mjaftueshme se dhuna ndaj grave përbën një formë diskriminimi dhe shkelje të të drejtave të njeriut të grave.[42] Tani, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore është më i harmonizuar me Konventën e Stambollit dhe e njeh në mënyrë të qartë se "dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe përbën diskriminim që i pengon ato të gëzojnë të drejtat dhe liritë në mënyrë të barabartë me burrat."[43]

Gjinia në të drejtën penale

Dispozitat penale të Konventës së Stambollit janë përgjithësisht gjinore neutrale, pasi gjinia e viktimës apo e kryesit të veprës, në parim, nuk duhet të jetë element përbërës i një krimi. Kjo nuk synon të pengojë shtetet që të përfshijnë dispozita specifike gjinore,[44] dhe ka përjashtime nga ky rregull.

Në Kosovë, një kuptim i efekteve gjinore të dhunës që lidhen me veprat penale është disi i identifikueshëm. Sipas nenit 173 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), vrasja e motivuar nga gjinia, identiteti gjinor dhe/ose orientimi seksual konsiderohet vrasje e rënduar, e dënueshme me të paktën 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) kërkon "marrjen e konsideratës së duhur" për "palën e dëmtuar ose viktimën që është viktimë e … trafikimit me njerëz, dhunës me bazë gjinore, dhunës në marrëdhënie familjare, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose diskriminimit, si dhe viktimat që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të ashpërsisë së veprës penale".[45] Në KPPK nuk ekziston ndonjë përkufizim për termin "gjini".

Kodi Penal i Kosovës (KPK) e trajton dimensionin gjinor të dhunës kryesisht në kontekstin familjar. Ai e përkufizon "viktimën e cenueshme" si: "një viktimë e një krimi që është … një grua shtatzënë, … ose një person që, për shkak të marrëdhënies dhe varësisë ndaj kryesit, bëhet veçanërisht i cenueshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit ose hakmarrjes".[46] "Viktimat e cenueshme" trajtohen posaçërisht në disa vepra që lidhen me dhunën me bazë gjinore,[47] por çdo vepër penale e kryer ndaj një viktime që është "veçanërisht e cenueshme" duhet të trajtohet si rrethanë rënduese gjatë shqiptimit të dënimit.[48] Udhëzimet për Shqiptimin e Dënimeve të Gjykatës Supreme sqarojnë se faktori kryesor që merret parasysh gjatë dënimit, kur zbatohen këto dispozita, është niveli i cenueshmërisë së viktimës dhe shkalla në të cilën kryesi e ka perceptuar këtë cenueshmëri.[49] Në lidhje me dhunën në familje, Udhëzimet theksojnë se "një

[41] Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2023.
[42] OSBE, *Adjudication of petitions for protection orders in domestic violence cases in Kosovo*, [Në anglisht], 2012, f. 23.
[43] LDHBGJ, Neni 4.1.
[44] "Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011, para. 153.
[45] Nr. 06/L-151Kodi i Procedurës Penale, Neni 63.1.4.
[46] Kodi Nr. 06/L-074 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Neni 113.39.
[47] Shih në veçanti: Lëndim i lehtë trupor (Neni 185), lëndim i rëndë trupor (Neni 186), gjymtim i organeve gjenitale femërore (Neni 180), sulm (Neni 184), rrëmbim (Neni 191) dhe privim i paligjshëm nga liria (Neni 193).
[48] Neni 70.2.6.
[49] Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzimet për Shqyrtimin e Dënimeve, Botimi i Parë, 2018, f. 79. Ekziston një botim i dytë (2024), por faqja zyrtare nuk funksionon në kohën e botimit për të përfshirë citimin dhe lidhje.

periudhë e zgjatur e abuzimit mendor dhe fizik rrit pafuqinë e viktimës dhe mundësinë e konstatuar të rrethanave rënduese serioze."[50]

Disa vepra të tjera penale konsiderohen si të rënduara kur kryesi është në një marrëdhënie familjare me viktimën.[51] Parimi i "rrethanave rënduese" zbatohet gjithashtu në mënyrë të përgjithshme në një gamë të gjerë veprash penale.[52] Përkufizimi i termit "gjini" në Kodin Penal të Kosovës (KPK) ende nuk është harmonizuar me përkufizimin më të gjerë të dhënë nga Konventa e Stambollit; aktualisht ai përmban përkufizimin e paqartë të përdorur në Statutin e Romës: "Gjini – i referohet dy sekseve, mashkull dhe femër, në kontekstin e shoqërisë".[53] Megjithatë, disa vepra penale trajtohen si të rënduara nëse kryhen mbi baza gjinore,[54] dhe ekziston një rrethanë rënduese e përgjithshme që bazohet në të njëjtin parim.[55]

Koordinimi i një reagimi institucional gjithëpërfshirës

Konventa e Stambollit kërkon zbatimin e politikave të integruara, efektive, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara, të cilat përfshijnë të gjitha masat e nevojshme për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e dhunës, si dhe për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat.[56] Palët nënshkruese duhet të zhvillojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt viktimës në reagimin ndaj dhunës ndaj grave.[57] Konventa kërkon ndarjen e duhur të burimeve financiare dhe njerëzore për zbatimin efektiv të politikave, masave dhe programeve të integruara, përfshirë ato që realizohen nga organizatat joqeveritare.[58] Konventa e njeh rolin thelbësor të shoqërisë civile, veçanërisht të organizatave për të drejtat e grave, dhe u kërkon shteteve t'i inkurajojnë dhe t'i mbështesin në punën e tyre.[59] Shtetet duhet të caktojnë trupa zyrtare qendrore që janë përgjegjëse për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës, siç parashihet në Konventë.[60]

Në mënyrë të ngjashme, Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave (DHGDHF) kërkon koordinim dhe bashkëpunim në politikat dhe reagimin institucional ndaj dhunës ndaj grave. Shtetet Anëtare janë të detyruara të miratojnë dhe zbatojnë politika efektive, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara në nivel kombëtar për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Këto politika duhet të mbikëqyren nga një ose më shumë institucione zyrtare të caktuara enkas për këtë qëllim.[61] DHGDHF njeh gjithashtu rolin e rëndësishëm të organizatave joqeveritare dhe kërkon që Shtetet Anëtare të bashkëpunojnë dhe të konsultohen rregullisht me to në ofrimin e shërbimeve mbështetëse, në hartimin e politikave, në fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit, në programet e kërkimit dhe edukimit, në trajnimet profesionale,

---

[50] Po aty.

[51] Shih në veçanti: përdhunim (Neni 227), sulm seksual (Neni 229), cenim i integritetit seksual (Neni 230) dhe skllavëri, kushte të ngjashme me skllavërinë dhe punë e detyruar (Neni 163).

[52] Neni 70.2.14.

[53] Neni 143.1.10. Disa argumentojnë se përdorimi i frazës "në kontekstin e shoqërisë" përfshin në mënyrë të qartë ndërtimin shoqëror të gjinisë (Copelon, R., "Krimet gjinore si krime lufte: Integrimi i krimeve kundër grave në të drejtën penale ndërkombëtare", McGill Law Journal, 46, 2000, f. 237), ndërsa vlerësimet konservatore të kësaj përkufizimi zakonisht përfundojnë se ajo e vendos gjininë brenda kufijve të seksit biologjik (Singson, S., "Konventa e re evropiane e përkufizon 'gjininë' si konstrukt shoqëror", *Instituti Katolik për Familjen dhe të Drejtat e Njeriut* [C-FAM], 7 prill 2000, f. 1).

[54] Shih, për shembull: vrasje e rënduar (Neni 173), sulm (Neni 184) dhe lëndim i rëndë trupor (Neni 186).

[55] Neni 70.2.12.

[56] Përkatësisht nenet 7.1 dhe 18.2.

[57] Neni 7.2.

[58] Neni 8.

[59] Neni 9.

[60] Neni 10.

[61] Neni 38.

si edhe në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të masave për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave.[62]

Direktiva për Dhunën ndaj Grave (DHGDHF) shkon më tej se Konventa e Stambollit, duke kërkuar miratimin e planeve kombëtare të veprimit për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore, të hartuara në bashkëpunim me shërbimet mbështetëse specializuese. Këto plane mund të përfshijnë prioritetet dhe veprimet për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, mekanizmat e monitorimit, hollësitë mbi burimet e nevojshme dhe mënyrën se si duhet të ndahen ato. Planet kombëtare të veprimit duhet të rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme.[63] Gjithashtu, përtej kërkesave të Konventës së Stambollit, Shtetet Anëtare janë të detyruara të vendosin mekanizma të përshtatshëm për të siguruar koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet autoriteteve dhe institucioneve përkatëse, përfshirë Avokatin e Popullit, autoritetet lokale dhe rajonale, organet e zbatimit të ligjit, sistemin gjyqësor, shërbimet mbështetëse, organizatat joqeveritare, shërbimet sociale, si dhe ofruesit e arsimit dhe kujdesit shëndetësor.[64]

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (DHGDHF) ndërtohet mbi Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF), duke adresuar boshllëqet e mëparshme përmes përcaktimit të qartë të përgjegjësive të akterëve të përfshirë në koordinimin e reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore. Ndërkohë që përgjegjësitë dhe koordinimi ndërinstitucional për rastet e dhunës në familje[65] dhe trafikimit[66] më parë ishin të përcaktuara në Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), masa të ngjashme për format e tjera të dhunës me bazë gjinore kanë munguar. Si pasojë, përgjegjësitë nuk njiheshin me ligj, gjë që çoi në buxhete të kufizuara dhe mbështetje të pamjaftueshme financiare për mekanizmat e koordinimit. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore e korrigjon në masë të madhe këtë situatë, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e akterëve të mëposhtëm.

Koordinatori Kombëtar për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore është autoriteti më i lartë për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës, në përputhje me Konventën e Stambollit, Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, si dhe Strategjinë Kombëtare.[67] Këtë pozitë e mban **Ministri/ja e Drejtësisë, i/**e cili/a ka për detyrë të raportojë para Kuvendit të Kosovës të paktën një herë në vit. Koordinatori Kombëtar:

- udhëheq hartimin, monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit;
- koordinon, zbaton, monitoron dhe vlerëson politikat dhe masat për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga DHGDHF dhe Konventa e Stambollit (KS);
- kryeson dhe përfaqëson Grupin Ndërministror Koordinues (GKN) për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave;

[62] Neni 41.
[63] Neni 39.
[64] Neni 40.
[65] Zyra e Kryeministrit, Procedurat Standarde të Operimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë.
[66] Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit të Njerëzve, Procedurat Standarde të Operimit për Personat e Trafikuar në Kosovë.
[67] Nenet 13 dhe 25.4.

- udhëheq procesin e forcimit të kapaciteteve të mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ); dhe
- monitoron rregullisht punën e mekanizmave lokalë koordinues (me mbështetjen e GKN-së).

Një **Sekretariat** është themeluar brenda Ministrisë së Drejtësisë për të mbështetur Koordinatorin Kombëtar dhe Grupin Ndërministror Koordinues. Sekretariati është përgjegjës për mbledhjen e informacionit, përgatitjen e raporteve të monitorimit dhe kryerjen e veprimeve të tjera sipas kërkesës së Koordinatorit Kombëtar.

Agjencia për Barazi Gjinore është Zëvendëskoordinatore Kombëtare, e cila mund të marrë përsipër përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar me kërkesë të tij dhe me miratimin e GKN-së. [68] Agjencia për Barazi Gjinore është përgjegjëse për të siguruar "përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe legjislacionet publike, sistemet dhe proceset", përfshirë udhëheqjen e procesit të rishikimit dhe vlerësimit të Procedurave Standarde të Operimit, koordinimin e procesit të ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe ndërsektoriale për zbatimin e PSV-ve, si dhe koordinimin e ngritjes së kapaciteteve të mediave për eliminimin e stereotipeve gjinore dhe gjuhës seksiste — të gjitha këto në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe ministritë përgjegjëse.

Grupi Koordinues Ndërministror kryesohet nga Koordinatori Kombëtar. [69] Zëvendëskryesuese e Grupit Ndërministror Koordinues është Agjencia për Barazi Gjinore. Në përbërjen e GKN-së përfshihet një anëtar nga ministritë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe përfaqësues/e nga Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Akademia e Drejtësisë, Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave dhe Qendrat për Punë Sociale. Çdo ministri duhet të përfaqësohet nga një zëvendësministër/re, megjithëse anëtarësimi mund t'i delegohet një zyrtari/eje të kabinetit "në rast pamundësie". Kjo dispozitë mbetet e paqartë sa i përket shpeshtësisë me të cilën mund të delegohen këto përgjegjësi, prandaj do të ishte e dobishme që kjo të sqarohet më qartë. Koordinatori Kombëtar mund të ftojë përfaqësues/e të ministrive apo institucioneve të tjera, varësisht nga detyrimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare. Përfaqësues/e të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë mund të ftohen nga Koordinatori Kombëtar në cilësinë e vëzhguesve. Grupi Ndërministror Koordinues është përgjegjës për zbatimin, rishikimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare; për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës; si edhe për sigurimin e bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërsektorial — përfshirë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, sigurimin e buxhetit dhe burimeve njerëzore për zbatimin e Strategjisë. Të gjitha institucionet, në të gjitha nivelet, janë të obliguara t'u përgjigjen kërkesave të GKN-së.

Mekanizmat Lokalë Koordinues duhet të krijohen nga të gjitha komunat dhe t'u caktohen burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të koordinuar zbatimin e dispozitave të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore dhe të Strategjisë Kombëtare.[70] Përgjegjësitë e tyre të detyrueshme, ndonëse jo

[68] Nenet 13.5 dhe 14.
[69] Neni 15.
[70] Neni 25.

shteruese, përfshijnë koordinimin ndërinstitucional në nivel të qeverisjes lokale për zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore dhe të Strategjisë Kombëtare; raportimin ndaj Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për zbatimin; si dhe hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare. Edicioni i mëparshëm i këtij raporti kishte konstatuar se Kosova kishte nevojë urgjente të zhvillonte një strategji gjithëpërfshirëse që adreson të gjitha format e dhunës ndaj grave, duke përfshirë një kuptim gjinor të dhunës dhe një reagim gjithëpërfshirës ndaj saj, që përfshin të gjitha masat e përcaktuara nga Konventa e Stambollit.[71] Strategjia aktuale në fuqi (Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje – SKMDHF) është hartuar mirë dhe shoqërohet me objektiva konkrete, të matshme dhe të zbatueshme, duke përfshirë edhe koston dhe burimet e financimit për secilën masë.[72] Megjithatë, ajo është përqendruar kryesisht në dhunën në familje dhe nuk ka adresuar format e tjera të dhunës me bazë gjinore.[73] KE ka vërejtur se shumë forma të dhunës të përfshira në Konventën e Stambollit — si dhuna seksuale, martesa e detyruar, përndjekja, sterilizimi dhe aborti i detyruar, dhuna psikologjike dhe gjymtimi gjenital femëror — mungonin plotësisht në politikat dhe ndërhyrjet e synuara, si edhe në shërbimet mbështetëse të specializuara dhe ato të përgjithshme.[74] KE rekomandoi që strategjia e Kosovës ta trajtojë në mënyrë koherente dhe të qëndrueshme lidhjen ndërmjet të gjitha formave të dhunës ndaj grave, si edhe ta adresojë dhunën me bazë gjinore si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi.[75] Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore kërkon që Strategjia Kombëtare të hartohet nga Koordinatori Kombëtar dhe të miratohet nga Qeveria.[76] Strategjia duhet të "përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e politikave që synojnë parandalimin, mbrojtjen, koordinimin, trajtimin, risocializimin dhe riintegrimin". Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore përcakton se "të gjitha institucionet kanë obligim të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga plani i veprimit i strategjisë." Edhe pse neni përkatës i referohet "Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje", ai kërkon që strategjia të hartohet në përputhje me kërkesat e DHGDHF-së dhe të Konventës së Stambollit (KS), që do të thotë se në të duhet të adresohen të gjitha format e dhunës ndaj grave.

DHGDHF-ja gjithashtu përcakton disa "obligime të përgjithshme" për institucionet, të cilat përfshijnë:

- vendosjen e të drejtave të viktimave në qendër gjatë hartimit të të gjitha politikave, dokumenteve dhe legjislacionit;
- ndërmarrjen e masave për të promovuar ndryshime shoqërore dhe kulturore në sjelljen e grave dhe burrave, me synimin e eliminimit të paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet stereotipike gjinore;
- ndarjen e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte dhe iniciativa që parandalojnë dhunën në familje, ofrojnë përgjigje

[71] Rrjeti i Grave të Kosovës, *Nga Ligjet në Vepra*, 2020, f. 24.
[72] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, 2022.
[73] Shtojca 3 e Strategjisë përfshinte përkufizime të formave të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit. Megjithatë, kjo nuk pati ndikim të rëndësishëm në masat e parashikuara në Strategji, pasi të gjitha objektivat specifike i referoheshin vetëm dhunës në familje.
[74] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në anglisht] 2017, f. 45.
[75] Po aty, f. 79.
[76] LDHBGJ, Neni 12.

gjithëpërfshirëse ndaj dhunës ndaj grave, fuqizojnë dhe riintegrojnë viktimat, duke siguruar që nevojat specifike të viktimave të cenueshme të merren parasysh dhe të adresohen siç duhet;

- bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe shoqatat profesionale të gazetarëve dhe punëtorëve/eve të mediave, për të forcuar kapacitetet e mediave për raportim profesional mbi çështjet që lidhen me dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore;
- njohjen, inkurajimin dhe mbështetjen, në të gjitha nivelet, të punës së organizatave joqeveritare përkatëse dhe të shoqërisë civile që veprojnë në luftën kundër dhunës ndaj grave, si dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata;
- ngritjen e kapaciteteve të personave përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, me qëllim parandalimin dhe identifikimin e dhunës, të nevojave dhe të drejtave të viktimave, si dhe parandalimin e riviktimizimit të tyre;
- organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit për dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe barazinë gjinore, në bashkëpunim me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare — veçanërisht organizatat e grave — mekanizmat e të drejtave të njeriut dhe mediat;
- mbledhjen dhe raportimin e rregullt të të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë për të gjitha format e dhunës të rregulluara me këtë ligj; dhe
- përgatitjen dhe mbështetjen e hulumtimeve që lidhen me shkaqet, pasojat dhe shkallën e rasteve të dhunës, si dhe me mënyrën e ndështkimit të tyre.[77]

Këto obligime të përgjithshme duhet të adresohen dhe të pasqyrohen në Strategjinë Kombëtare dhe në të gjitha masat ligjore e të tjera që synojnë parandalimin dhe eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Strategjia Kombëtare 2022–2026 e njeh rëndësinë e reagimeve të koordinuara institucionale. Strategjia e përcakton koordinimin si një parim ndërsektorial, duke kërkuar forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të drejtësisë, shëndetësisë, arsimit dhe mirëqenies sociale. Strategjia thekson më tej rolin e Koordinatorit Kombëtar në mbikëqyrjen e zbatimit të veprimeve dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara për të mbijetuarat/it. Edhe pse çështja e koordinimit është adresuar, disa përgjegjësi — veçanërisht ato që lidhen me mekanizmat e llogaridhënies dhe koordinimin në nivel lokal — mund të përfitonin nga sqarime shtesë dhe udhëzime më të qarta për zbatim praktik.

Përparimi në vitin 2025

Edhe pse ky hulumtim mbulon periudhën 2020–2024, gjatë vitit 2025 janë miratuar disa politika të rëndësishme që lidhen me trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Këto përfshijnë:

- Udhëzimin Administrativ (Qeveria e Republikës së Kosovës) Nr. 01/2025 për Linjën Emergjente Telefonike për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore, i cili përcakton përgjegjësinë e shtetit për themelimin e një linje emergjente telefonike 24/7 që ofron mbështetje të menjëhershme, konfidenciale dhe falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Linja duhet të shërbejë

[77] LDHBGJ, Neni 10.

si pikë qendrore kontakti, duke ofruar informim, këshillim, udhëzim në situata krize dhe referim drejt shërbimeve të specializuara, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes dhe fuqizimit të viktimave.

- Rregulloren (Qeveria e Republikës së Kosovës) Nr. 01/2025 për Mekanizmin Lokal Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, e cila përcakton përgjegjësitë dhe rolin koordinues të Mekanizmit Lokal në ofrimin e mbrojtjes, mbështetjes dhe ndihmës për viktimat. Rregullorja kërkon qasje të përqendruar tek viktima, pa diskriminim, me ruajtje të konfidencialitetit dhe në përputhje me standardet ligjore kombëtare dhe evropiane.
- Rregulloren (Qeveria e Republikës së Kosovës) Nr. 37/2024 për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore dhe Funksionimin e Grupit Ndërministror të Punës, e cila përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar dhe Grupit Ndërministror të Punës, përfshirë zhvillimin e politikave, koordinimin, mbledhjen e të dhënave, fushatat e ndërgjegjësimit dhe raportimin, me qëllim sigurimin e parandalimit efektiv dhe mbrojtjes së viktimave.

Monitorimi

GREVIO ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Konventës së Stambollit.[78] Palët e Konventës dorëzojnë raporte te GREVIO, por ky organ nuk trajton ankesa individuale për shkelje.[79] Trupi i vetëm që merret me ankesa individuale në kuadër të KS-së është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNj). Meqenëse Kosova ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe nuk mund ta ratifikojë formalisht Konventën, qytetarët aktualisht nuk kanë qasje në GJEDNj. Kësisoj, këto mekanizma monitorimi për momentin mbeten të paqasshëm. Kjo mund të ndryshojë në të ardhmen, nëse Kosova arrin anëtarësimin në KE. Ndërkohë, në vitin 2022, GREVIO ka monitoruar Kosovën për të vlerësuar shkallën e harmonizimit të legjislacionit, politikave dhe masave kombëtare me KS-në.[80] Raporti evidenton përparime, përfshirë reformat ligjore dhe themelimin e institucioneve të specializuara, si njësi policore, prokurorë/e dhe gjyqtarë/e të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Megjithatë, raporti identifikon mangësi të theksuara: dhuna në familje shpesh nuk merret parasysh në mënyrë të duhur në vendimet për kujdestari dhe vizita; varësia ekonomike e grave vazhdon për shkak të mbështetjes së dobët sociale dhe qasjes së kufizuar në pronë dhe punësim; si dhe ekzistojnë boshllëqe në mbledhjen sistematike të të dhënave dhe në trajnimin profesional. Gjetjet nënvizojnë nevojën për reforma më të thelluara, financim të qëndrueshëm për shërbimet mbështetëse si strehimoret, dhe politika gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat e grupeve të cenueshme, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, komunitetet Rome, Ashkalie dhe Egjiptiane, si dhe personat LBTI.

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të caktojnë trupa zyrtarë për të monitoruar dhe vlerësuar politikat dhe masat për parandalimin dhe adresimin e të gjitha formave të dhunës.[81] Në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, Koordinatori Kombëtar është përgjegjës për zbatimin,

[78] KS, Neni 66.
[79] Megjithatë, GREVIO mund të iniciojë një procedurë hetimore në rastet kur ekzistojnë informacione të besueshme që tregojnë se është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve për të parandaluar një model serioz, të përhapur ose të vazhdueshëm të çdo forme dhune të mbuluar nga Konventa e Stambollit (Neni 68).
[80] GREVIO, Assessment of the alignment of Kosovo's laws, policies and other measures with the standards of the Istanbul Convention, 2022., [Në anglisht], 2022.
[81] Neni 10.

monitorimin dhe vlerësimin. Ndërkohë, mungesa e qasjes së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit e bën edhe më të rëndësishëm rolin e shoqërisë civile, përfshirë OSHC-të, akademinë, sindikatat dhe odat profesionale të avokatëve, në monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor.[82] Ekziston një mundësi për të themeluar një trup të pavarur ndërinstitucional, me përfaqësim të shoqërisë civile, për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e KS-së, duke lehtësuar kështu ndërtimin e një sistemi më të fortë kombëtar të monitorimit.

E drejta themelore

Kjo pjesë shqyrton Kapitullin V të Konventës së Stambollit (KS) që trajton të drejtën themelore materiale, përfshirë format e dhunës me bazë gjinore që janë të kriminalizuara dhe dispozitat që lidhen me kompensimin e viktimave. Fokusohet në masën në të cilën dispozitat themelore të KS-së pasqyrohen në legjislacionin e Kosovës. Që nga viti 2021, janë futur disa vepra të reja penale, përfshirë dhunën ndaj grave në jetën publike dhe testimin e virgjërisë.[83]

Dhuna në familje

Konventa e Stambollit e përkufizon dhunën në familje si "çdo akt dhune fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes apo njësisë familjare, ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve aktualë ose të mëparshëm, pavarësisht nëse autori dhe viktima jetojnë apo kanë jetuar së bashku".[84] Në Kosovë, dhuna në familje trajtohet nga Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore dhe nga Kodi Penal i Kosovës.

KS nuk kërkon që dhuna në familje të klasifikohet si një vepër penale e veçantë. Çdo vepër e parashikuar nga Konventa mund të trajtohet si e rënduar në rastet kur ndodh në një kontekst familjar — pra, kur kryhet kundër një bashkëshorti/eje aktual/e ose të mëparshëm/me, nga një anëtar familjeje, një person që bashkëjeton me viktimën ose ka keqpërdorur autoritetin ndaj saj/tij.[85] Kosova ka miratuar një qasje të shumëanshme në trajtimin e dhunës në familje në KPK, duke përfshirë si një vepër penale të veçantë, ashtu edhe si rrethanë rënduese për vepra të tjera.[86] Vepra e veçantë përmban dy formulime të dhunës në familje:

- Kushdo që ushtron dhunë fizike, psikologjike ose ekonomike apo keqtrajtim me qëllim të cenimit të dinjitetit të një personi tjetër brenda një marrëdhënieje familjare (Neni 248.1),
- Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike apo keqtrajtim ndaj një anëtari tjetër të familjes së tij/saj (Neni 248.3).[87]

Edhe pse të dyja dispozitat parashohin të njëjtin dënim, kjo përsëritje krijon paqartësi të panevojshme, veçanërisht për shkak të mospërfshirjes së dhunës seksuale në formulimin e parë. Ligji do të ishte shumë më i qartë po të unifikohej në një formulim të vetëm, që do të përfshinte dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, apo çdo formë keqtrajtimi brenda një

[82] Neni 9.
[83] Kodi Penal i Kosovës (KPK), nenet 236/A dhe 248/A, të ndryshuara me Ligjin nr. 08/L-188, 2023.
[84] DHGDHF përmban një përkufizim të ngjashëm (Neni 2(b)).
[85] Neni 46a.
[86] Neni 70.2.14. Një dënim shtesë u shqiptohet zyrtarëve publikë që shpallen fajtorë për dhunë në familje sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK); atyre u ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratën apo shërbimin publik për një periudhë prej një deri në pesë vjetësh (Neni 62.4).
[87] Neni 248.

"marrëdhënieje familjare". Përkufizimi i "marrëdhënies familjare" në formulimin e parë përfshin persona që janë:

- të fejuar ose kanë qenë të fejuar, janë të martuar ose kanë qenë të martuar, janë në bashkësi jashtëmartesore ose kanë qenë në një të tillë, ose bashkëjetojnë apo kanë bashkëjetuar në një ekonomi të përbashkët;
- që përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë të lidhur me gjak, martesë, birësim, krushqi ose kujdestari, përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipërit, mbesat, vëllezërit, motrat, hallat, xhaxhallarët, kushërinjtë; ose
- që janë prindër të një fëmije të përbashkët.[88]

Njohja e bashkëjetesës brenda një "ekonomie të përbashkët" është e përshtatshme për realitetin kosovar, ku shpesh disa breza apo familje të zgjeruara jetojnë së bashku. Megjithatë, Konventa e Stambollit thekson se nuk ka rëndësi nëse autori/ja ka ndarë apo jo banesën me viktimën. Lidhja e përkufizimit me kushtin e banimit të përbashkët mund të jetë problematike, pasi kufizon zbatimin e ligjit. Prandaj, përkufizimi duhet të jetë më i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë *të gjithë* anëtarët e familjes, pavarësisht nëse ndajnë apo jo të njëjtën banesë, si edhe çdo person që jeton në një formë bashkëjetese, pavarësisht natyrës së marrëdhënies. Një qartësim i tillë do të ndikonte pozitivisht edhe në rrethanat rënduese për vepra të tjera që lidhen me marrëdhënie familjare. Përkufizimi i dhunës në familje në DHGDHF është në përputhje të gjerë me atë të KS-së.[89] Megjithatë, ligji në Kosovë shton një element specifik — që autori/ja të ketë "qëllim cenimin e dinjitetit dhe mbajtjen nën kontroll apo varësi të vazhdueshme të personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna". Ky element mendor shtesë nuk kërkohet nga Konventa e Stambollit. DHGDHF e përkufizon "marrëdhënien familjare" si marrëdhënie ndërmjet personave që janë ose kanë qenë të fejuar, të martuar, në bashkëjetesë jashtëmartesore, që ndajnë ekonomi të përbashkët, kanë fëmijë të përbashkët, apo janë të lidhur "me gjak, krushqi, birësim ose kujdestari". Ashtu si në Kodin Penal të Kosovës (KPK), mungon përfshirja e anëtarëve të familjes që nuk ndajnë të njëjtin vendbanim — një element që kërkohet nga Konventa e Stambollit.

Dhuna Psikologjike

Konventa e Stambollit e kriminalizon cenimin serioz të qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi përmes detyrimit ose kërcënimeve.[90] KS nuk përcakton saktësisht se çfarë konsiderohet "serioze", por dispozita i referohet një sjelljeje të vazhdueshme e jo një akti të vetëm.[91] Dhuna psikologjike përfshihet në përkufizimin e dhunës në familje sipas legjislacionit të Kosovës, si në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, ashtu edhe në Kodinin Penal të Kosovës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh se disa studime kanë treguar se dhuna psikologjike mund të jetë forma më e përhapur e dhunës në ambientin familjar, duke përfshirë kufizimin e burimeve

[88] Neni 113.25.

[89] Neni 3.1.3: "të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda marrëdhënies familjare ose njësisë familjare, pavarësisht lidhjes së gjakut apo marrëdhënies familjare, ose nga ish apo aktuali partner intim, pavarësisht faktit nëse kryesi i dhunës ka jetuar apo jeton në të njëjtën banesë me viktimën, me qëllim të cenimit të dinjitetit dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm dhe pozitë varësie të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna."

[90] Neni 33.

[91] "Raport Shpjegues i Këshillit të Evropës për Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11 maj 2011, paragrafi 181.

financiare, të arsimit apo të kujdesit shëndetësor, si dhe izolimin, poshtërimin dhe kërcënimet.[92] Kjo formë dhune shpesh shoqëron abuzimin fizik ose seksual.[93] Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave ka theksuar rëndësinë e njohjes së dhunës psikologjike në kontekstin familjar në rastin V.K. kundër *Bullgarisë,*[94] duke përfunduar se:

> "Dhuna me bazë gjinore, në kuptimin e [CEDAW] dhe të Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 19, nuk kërkon domosdoshmërisht një kërcënim të drejtpërdrejtë apo të menjëhershëm ndaj jetës ose shëndetit të viktimës. Ajo nuk kufizohet vetëm në akte që shkaktojnë dëm fizik, por përfshin edhe veprime që shkaktojnë dëm mendor ose seksual, vuajtje, kërcënime për kryerjen e akteve të tilla, detyrim apo forma të tjera të privimit nga liria."

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka arritur në përfundime të ngjashme. Për shembull, në rastin *Hajduová* kundër *Sllovakisë*,[95] gjykata konstatoi se, edhe pse kërcënimet e përsëritura të ish-bashkëshortit të viktimës nuk u materializuan, ato mjaftonin për të ndikuar negativisht në integritetin psikologjik dhe mirëqenien emocionale të saj.[96] Kushtetuta e Kosovës përcakton që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duhet të interpretohen në përputhje me vendimet e GJEDNj,[97] prandaj kjo praktikë gjyqësore mund të shërbejë si udhërrëfyes për gjykatat kosovare në trajtimin e rasteve të dhunës psikologjike.

Megjithatë, dhuna psikologjike mund të ndodhë edhe jashtë sferës familjare, dhe KS nuk e kufizon aplikimin e këtij neni vetëm në ambientin familjar. Raporti Shpjegues i KS-së vë në dukje se dhuna psikologjike mund të ndodhë edhe në vendin e punës apo në mjediset shkollore.[98] Kriminalizimi i dhunës psikologjike vetëm brenda marrëdhënieve familjare mund të mos e përfshijë plotësisht gamën e sjelljeve të përshkruara nga Konventa e Stambollit. Edhe pse dhuna psikologjike ndodh edhe në ambiente shkollore, monitorimi i RrGK-së tregon se ajo mbetet kryesisht e paraportuar, pasi gjatë periudhës së vëzhguar nuk është evidentuar asnjë rast i dokumentuar i këtij lloji dhune në institucionet arsimore. Neni për dhunën në familje kërkon ekzistencën e një marrëdhënieje të caktuar për të ndodhur dhuna psikologjike, çka nuk vlen në kontekste si puna apo shkolla. Në Kosovë, veprat penale që lidhen me këtë formë sjelljeje përfshijnë kërcënimet, shantazhin,[99] dhe ngacmimin.[100] Megjithatë, një dispozitë e dedikuar për dhunën psikologjike në KPK mund ta adresojë më mirë dhunën psikologjike nga një perspektivë gjinore duke e përcaktuar atë më qartë për një zbatim më të mirë.

Që nga botimi i mëparshëm i këtij raporti, LMDHF ka futur një përkufizim të posaçëm dhe të detajuar të "dhunës psikologjike", i cili përfshin:

---

[92] Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., "Praktikat dhe Standardet e Mira Ndërkombëtare për Dhunën Kundër Grave dhe Dhunën në Familje", Këshilli i Evropës, 2015, ff. 24–25.

[93] Krug, E., Dahlberg, L., Mercy, J., Zwi A., dhe Lozano, R. (red.) për Organizatën Botërore të Shëndetësisë, *World Report on Violence and Health: Chapter 4 - Violence by Intimate Partners*, [Në anglisht] 2002, f. 89.

[94] Komiteti CEDAW, *VK* kundër Bullgarisë (CEDAW/C/49/D/20/2008).

[95] Shih, për shembull: Opuz kundër Turqisë (Aplikimi nr. 33401/02); A kundër Kroacisë (Aplikimi nr. 55164/08); dhe X dhe Y kundër Holandës (Aplikimi nr. 8978/80).

[96] *Hajduovà kundër Sllovakisë* (Aplikimi nr. 2660/03).

[97] Neni 53.

[98] Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 181.

[99] KPK nenet 181 dhe 329, përkatësisht.

[100] Shih më poshtë: Ndjekja.

kontroll të vazhdueshëm, abuzim verbal, izolim, poshtërim ose abuzim emocional përmes fyerjeve, shantazhit, frikësimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme, mbajtjes së informacionit, keqinformimit dhe sjelljeve kërcënuese, trajtimit degradues, kërcënimeve ose formave të ngjashme të kontrollit apo presionit psikologjik, vendosjes së një personi nën frikë të arsyeshme nga përdorimi i dhunës ndaj tij/saj apo personave në marrëdhënie familjare, kërcënimit për dëmtim të pasurisë ose mbajtjes së tij/saj nën stres të vazhdueshëm emocional.[101]

Dhuna Fizike

Konventa e Stambollit e kriminalizon çdo akt të qëllimshëm të dhunës fizike ndaj një personi tjetër, pavarësisht nga konteksti në të cilin ndodh një veprim i tillë.[102] Kjo i referohet dëmtimit trupor të shkaktuar si pasojë e përdorimit të forcës fizike.[103] Dhuna fizike përfshihet në përkufizimin e dhunës në familje në Kodit Penal të Kosovës (KPK), si dhe në përkufizimet e "dhunës ndaj grave" dhe "dhunës në familje" në Ligjin për Dhunën me Bazë Gjinore.

Brenda KPK-së, tre vepra penale zakonisht e kriminalizojnë këtë sjellje: sulmi, lëndimi i lehtë trupor dhe lëndimi i rëndë trupor. [104] Këto vepra ndëshkohen me dënime më të rënda nëse kryhen me përdorim arme, ndaj një viktime të cenueshme,[105] dhe/ose janë të motivuara nga një sërë bazash të mbrojtura, përfshirë gjininë.

Femicidi dhe Detyrimi për Kujdes të Duhur

Femicidi i referohet vrasjeve të grave dhe vajzave për shkak të gjinisë së tyre. Aktualisht nuk ekziston një përkufizim i unifikuar për këtë term. Sipas Kombeve të Bashkuara, femicidi përfshin vrasjet e grave dhe vajzave që lidhen me dhunën nga partneri intim, dhunën në familje, çështjet e "nderit" apo të prikës, si edhe ato të ndërlidhura me punën seksuale.[106] Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) përfshin gjithashtu raste të abortit selektiv ndaj vajzave (female foeticide), vdekjeve të ndërlidhura me abortet jo të sigurta dhe vdekjeve të shkaktuara nga gjymtimi i organeve gjenitale femërore (GJGJF).[107]

Në legjislacionin e Kosovës, vepra e vrasjes sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK) dënohet me minimum pesë vjet burgim.[108] Vepra rëndohet nga disa rrethana, duke e ngritur dënimin minimal në dhjetë vjet ose burgim të përjetshëm, nëse viktima është fëmijë, grua shtatzënë, anëtar/e familjeje, ose nëse motivi bazohet në gjini, identitet gjinor apo orientim seksual.[109] Përkufizimi i "anëtarit/es të familjes" përfshin bashkëshortët dhe personat që "jetojnë në bashkësi jashtëmartesore".[110] Kjo vepër e rënduar mund të zgjerohet për të përfshirë edhe partnerët apo ish-partnerët që nuk bashkëjetojnë me viktimën. Po ashtu, disa vepra të tjera të ndërlidhura me dhunën me bazë gjinore parashohin dënime më të rënda nëse rezultojnë me

---

[101] Neni 3, 1.8.
[102] Neni 35. Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 187.
[103] Po aty., paragrafi 188.
[104] Nenet 184, 185, dhe 186, respektivisht.
[105] Shih seksionin "Gjinia në të Drejtën Penale" më sipër.
[106] Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim, *Global Study on Homicide: Gender-related killing of women and girls*, [Në anglisht], 2018, ff. 29-37.
[107] EIGE, *Terminology and Indicators for Data Collection: Rape, femicide and intimate partner violence*, [Në anglisht], 2017, ff. 34-35.
[108] Neni 172.
[109] Neni 173.
[110] Neni 113.26.

vdekjen e viktimës — si përdhunimi, sulmi seksual, aborti i detyruar, sterilizimi i detyruar dhe gjymtimi i organeve gjenitale femërore, përfshirë nxitjen apo ndihmën në realizimin e tyre.[111]

Konventa e Stambollit nuk e përdor termin "femicide", por krimi i dhunës fizike synon të përfshijë edhe rastet kur dhuna përfundon me vdekjen e viktimës.[112] Edhe më i rëndësishëm është detyrimi për kujdes të duhur (due diligence) që u vendoset shteteve, për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe ofruar kompensim për aktet e dhunës të kryera nga akterë jo-shtetërorë.[113] Ky detyrim zbatohet në raste rreziku ekstrem, kur autoritetet shtetërore kanë ditur ose është dashur të dinin për rrezikun, por nuk kanë reaguar.

Ky parim është i dukshëm në rastet e dhunës nga partneri intim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ),[114] e cila është mbështetur në opinionet e Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe në jurisprudencën e Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut lidhur me kujdesin e duhur. Në rastin Branko Tomashiq kundër Kroacisë, GJEDNJ ka vlerësuar se:

> Një detyrim pozitiv lind në rastet kur konstatohet se autoritetet kanë ditur, ose është dashur të dinin në kohën përkatëse, për ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm ndaj jetës së një personi të caktuar, si pasojë e veprimeve kriminale të një pale të tretë, por kanë dështuar të ndërmarrin masa brenda kompetencave të tyre që, në mënyrë të arsyeshme, do të pritej ta parandalonin atë rrezik.[115]

Në Kosovë, vitet e fundit është kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje fenomenit të femicidit në kontekstin e dhunës në familje dhe mungesës së reagimit të duhur institucional ndaj këtyre krimeve — përfshirë veprimet e policisë dhe ndëshkimet gjyqësore.

Gjatë 15 viteve të fundit, të paktën 59 gra janë vrarë nga bashkëshortët e tyre, ish-bashkëshortët, baballarët ose anëtarë të tjerë meshkuj të familjes.[116] Detyrimi për kujdes të duhur, sipas Konventës së Stambollit, nënkupton që pas krimeve të tilla duhet të zhvillohet një hetim për të vlerësuar nëse autoritetet shtetërore kanë pasur dijeni paraprake për ekspozimin e një gruaje ndaj dhunës, nëse institucionet kanë ditur apo është dashur të dinin se jeta e saj ishte në rrezik, dhe nëse janë ndërmarrë masa të përshtatshme për ta parandaluar atë rrezik.[117] Në një rast, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se institucionet shtetërore kishin dështuar të mbronin një viktimë të dhunës në familje, në një aktvendim historik të vitit 2023.[118] Duhet të shqyrtohet mundësia e krijimit të një "vëzhguesi të femicidit" (femicide watch), i cili do të fokusohej në parandalim përmes identifikimit të mangësive në legjislacion, politika apo zbatim.[119]

---

[111] Nenet 227.5, 229.4, 178.3, 179.2, dhe 180.4, respektivisht.
[112] Neni 35. Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 188.
[113] Neni 5.
[114] *Opuz kundër Turqisë* (Aplikimi nr. 33401/02).
[115] *Branko Tomasic kundër Kroacisë* (Aplikimi nr. 46598/06).
[116] Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), "The last 15 years, at least 59 women have been killed", [Në anglisht], 25 mars 2025.
[117] Duhaček, D., Branković, B. dhe Miražić, M. për Komisionin e Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, *Women's Rights in Western Balkans*, [Në anglisht], janar 2019, f. 41.
[118] KE Raporti për Kosovën 2023, f. 19.
[119] Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, "Femicide Watch Call 2020" [Në anglisht],.

Mjetet juridike të parashikuara nga Konventa e Stambollit duhet të jenë të qasshme edhe për pasardhësit e viktimës në rast vdekjeje të saj apo të tij.[120]

Kutia 4. Zbatimi i Detyrimit për Kujdes të Duhur në Kosovë

Detyrimet që burojnë nga parimi i kujdesit të duhur kërkojnë zhvillimin e hetimeve pas krimeve si femicidi, me qëllim të vlerësimit nëse autoritetet shtetërore kishin dijeni paraprake për ekspozimin e një gruaje ndaj dhunës dhe nëse kishin ditur ose duhej të kishin ditur se jeta e saj ishte në rrezik, duke ndërmarrë masa të përshtatshme aty ku është e nevojshme.

Në rastin e Sebahate Morinës (2021), pavarësisht raportimeve të mëparshme për dhunë në familje, urdhrit mbrojtës dhe dënimit penal ndaj bashkëshortit të saj, autoritetet nuk vepruan me shpejtësinë e kërkuar, nuk kryen vlerësim të duhur të rrezikut dhe dështuan të bashkëpunonin me shërbimet sociale. Dhjetë ditë pas raportimit të një rasti të ri dhune, Morina u vra nga bashkëshorti i saj. Në këtë rast, institucionet shtetërore dështuan të mbrojnë viktimat e dhunës në familje.

Në një aktvendim historik, Gjykata Kushtetuese e Kosovës përfundoi se këto mosveprime përbënin shkelje të së drejtës për jetën, në përputhje me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të GJEDNJ-së, si dhe me detyrimet e Kosovës sipas Konventës së Stambollit dhe CEDAW-it. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Opuz kundër Turqisë, Kurt kundër Austrisë), Gjykata theksoi se detyrimet pozitive kërkojnë veprim shtetëror të menjëhershëm, proaktiv dhe gjithëpërfshirës për t'u përballur me rreziqet e dhunës me bazë gjinore.[121]

Rasti i Hamide Magashit paraqet një shembull tragjik të dështimit të institucioneve shtetërore për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Edhe pse ajo kishte një urdhër aktiv mbrojtjeje, autoritetet nuk ndërmorën masa të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e saj. Ajo u vra nga ish-bashkëshorti i saj në nëntor 2022, vetëm një ditë para se të lindte. Edhe pse disa zyrtarë policorë u pezulluan pas ngjarjes, nuk u zhvillua ndonjë hetim i mëtejshëm, dhe rasti nuk u referua në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e mundshëm të mosveprimit institucional. Ky rast tregon mangësi serioze në mekanizmat e mbrojtjes dhe të llogaridhënies për viktimat e dhunës në Kosovë.

Martesa e detyruar

Konventa e Stambollit dhe Ligji për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje kërkojnë që shtetet të ndërmarrin masa për të siguruar që martesa e detyruar, si ndaj të rriturve ashtu edhe ndaj fëmijëve, të jetë e kriminalizuar.[122] Sipas DHGDHF-së, kjo vepër duhet të jetë e dënueshme me dënim maksimal prej të paktën tre vjetësh burgim.[123] Kodi Penal i Kosovës e parasheh këtë në mënyrë të përshtatshme. Detyrimi i një personi për t'u martuar ose hyrja në martesë duke ditur se pala tjetër është detyruar, dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet.[124] Dënimi rritet nëse vepra kryhet:

---

[120] "Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 164.

[121] Judgment in case no. KI129 / 21 Applicant Velerda Sopi, [Në anglisht], Rishikim kushtetues i "veprimeve dhe mosveprimeve" të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit të Policisë në Gra-çanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

[122] KS Neni 37.1 dhe DHGDHF Neni 4.1. Tërheqja e një të riu ose fëmije në një territor tjetër përveç atij ku ata jetojnë, me qëllim të martesës me forcë, është kriminalizuar gjithashtu (KS Neni 37.2 dhe DHGDHF Neni 4.2).

[123] DHGDHF, Neni 10.3.

[124] KPK, Neni 239.

- kundër një fëmije nën moshën 18 vjeçare – dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet;
- nga një prind i një fëmije të moshës ndërmjet 14 dhe 18 vjeç – dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet;
- nga një prind i një fëmije të moshës ndërmjet 14 dhe 16 vjeç – dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet;
- nga një prind i një fëmije nën moshën 14 vjeçare – dënohet me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë vjetësh;
- me qëllim përfitimi material – dënohet me gjobë dhe burgim prej së paku pesë vjetësh; nëse vepra kryhet nga prindi, dënohet me gjobë dhe burgim prej së paku pesëmbëdhjetë vjetësh.

Kodi Penal i Kosovës gjithashtu parashikon dënimin e çdo zyrtari/e publik/e që me vetëdije lejon një martesë të paligjshme, me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

Ligji për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje shton se, meqë viktimat janë shpesh të mitura, afati i parashkrimit për këtë vepër penale duhet të nisë vetëm kur viktima mbush moshën 18 vjeçare.[125] KPK është në përputhje me këtë dispozitë të DHGDHF-së.[126]

E drejta civile luan një rol thelbësor në trajtimin e martesave të detyruara. Kjo reflektohet edhe në Konventën e Stambollit, e cila kërkon që martesat e tilla të shpallen të pavlefshme ose të shpërbëhen pa barrë të tepruar financiare apo administrative për viktimën.[127] Ligji i Kosovës për Familjen përcakton se martesa nuk është e vlefshme nëse është lidhur nën detyrim, kërcënim, mashtrim apo mungesë të vullnetit të lirë, dhe duhet të shfuqizohet nëse njëri prej bashkëshortëve ka dhënë pëlqimin nën frikë, dhunë ose kërcënim serioz.[128]

Sipas komenteve të ekspertëve, shpesh është e vështirë të provohet se një martesë ka qenë "e detyruar". Edhe pse gjykatat mund të pranojnë kërcënimet fizike apo presionin emocional si prova, është vërejtur se gjyqtarët/et shpesh hezitojnë t'i konsiderojnë si "detyrim" faktorë të tjerë, si frika nga përjashtimi shoqëror apo ndjenja e turpit — elemente që mund të kenë ndikim të madh, veçanërisht te gratë në disa komunitete.[129] Në Kosovë, martesat e hershme dhe martesat e fëmijëve ndodhin më shpesh në komunitetet Rome, Ashkali, Egjiptiane, në zonat rurale dhe në diasporë.[130] Prandaj, trajnimi i gjyqtarëve/eve mbi martesat e detyruara duhet të përfshijë njohjen e kontekstit kulturor dhe gjinor[131] duke marrë parasysh mënyrën se si këta faktorë ndikojnë në kuptimin e termave "detyrim", "kërcënim" dhe "dëshirë e lirë" sipas Ligjit për Familjen.

Ndërkohë, trajnimi duhet të theksojë qartë se asnjë kulturë, zakon, fe, traditë apo koncept i "nderit" nuk mund të justifikojë martesat e detyruara në asnjë rrethanë, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit.[132]

---

[125] DHGDHF, Neni 13.2 dhe hyrja sqaruese 16.
[126] KPK, Neni 100.2.
[127] Neni 32.
[128] Nr. 2004/32, Nenet 18 dhe 63, respektivisht.
[129] Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore "Addressing forced marriage in the EU: legal provisions and promising practices",[Në Anglisht], 2014, f. 19.
[130] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në Anglisht], 2017, f. 4.
[131] Anitha, S. dhe Gill, A., "Detyrimi, pëlqimi dhe debati mbi martesën e detyruar në MB", Feminist Legal Studies, 17(2), 2009, 165-184, f. 175.
[132] Neni 42.

Përndjekja

Konventa e Stambollit e përkufizon përndjekjen si "sjellje të qëllimshme dhe të përsëritura kërcënuese ndaj një personi tjetër, që i shkaktojnë atij ose asaj frikë për sigurinë personale".[133] Edhe pse Kodi Penal i Republikës së Kosovës nuk përdor fjalën "përndjekje", vepra penale e ngacmimit e mbulon këtë formë sjelljeje.[134] Sipas KPK-së, ngacmimi është "model sjelljeje i përsëritur dhe i padëshiruar i vëmendjes ose komunikimit me qëllim për të ngacmuar, frikësuar, lënduar, dëmtuar pasurinë ose vrarë një person, fëmijët, familjarët, të afërmit apo kafshët shtëpiake të tij/saj", si dhe vendosja e një personi nën mbikëqyrje me të njëjtin qëllim.

Disa ekspertë kanë kritikuar formulimin e Konventës së Stambollit, duke theksuar se përqendrimi te pasojat e sjelljes ndaj viktimës mund të vendosë një prag tepër të lartë për provat, gjë që rrezikon të lërë shumë viktima pa mbrojtje.[135] Sipas tyre, vetë ndërhyrja e vazhdueshme në hapësirën psikologjike dhe privatësinë mendore të një personi duhet të jetë e mjaftueshme për ta konsideruar veprën të dënueshme, pa qenë e nevojshme të vërtetohet një pasojë konkrete.[136] Edhe legjislacioni kosovar përballet me të njëjtën sfidë, pasi kërkon që viktima të jetë "vendosur në frikë të arsyeshme për vdekje, lëndim të rëndë trupor, dëmtim të rëndë të pasurisë apo stres të theksuar emocional".[137] Në të ardhmen, reformat ligjore duhet të shqyrtojnë heqjen e këtij kushti, në mënyrë që mbrojtja e viktimave të jetë më efektive dhe reale.

Dënimet janë më të rënda kur krimi kryhet ndaj një partneri/e aktual/e ose të mëparshëm, ose ndaj një anëtari të familjes. Një rrethanë rënduese shtesë është përdorimi i armës, mjetit apo ndonjë objekti tjetër gjatë kryerjes së veprës.

Ndërkohë, Ligji për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje ka sjellë vepra të reja penale që lidhen me përndjekjen dhe ngacmimin në internet (përndjekja kibernetike dhe ngacmimi kibernetik), të cilat trajtohen në seksionin vijues "Krimet e lehtësuara nga teknologjia".

Ngacmimi Seksual

Konventa e Stambollit ndalon ngacmimin seksual, i cili përkufizohet si:
"çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e natyrës seksuale me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues".[138] Kodi Penal i Republikës së Kosovës tani përmban një vepër të ngjashme penale[139] e cila mbron të gjithë personat nga ngacmimi seksual, por në mënyrë të veçantë adreson rastet që përfshijnë persona të cenueshëm për shkak të moshës, sëmundjes, aftësisë së kufizuar, varësisë, shtatzënisë apo paaftësisë së rëndë fizike ose mendore, por jo bazuar në gjini.

Dënimet rriten nëse autori/ja i/e veprës ndodhet në pozitë autoriteti ndaj viktimës ose nëse gjatë kryerjes së veprës është përdorur armë, mjet apo objekt tjetër.

---

[133] Neni 34.
[134] Neni 182. Disa komentues kritikojnë këtë qasje, duke argumentuar se megjithëse ndjekja dhe ngacmimi janë të lidhura, ato janë fenomene të ndryshme dhe meritojnë kriminalizim të veçantë (Van der Aa, S., "Tendencat e Reja në Kriminalizimin e Ndjekjes në Shtetet Anëtare të BE-së", European Journal of Criminal Policy and Research, 24, 2018, 315-333, f. 326).
[135] Po aty., f. 325.
[136] Guelke, J. dhe Sorel, T., "Shkelja e privatësisë dhe ligjit: rasti i ndjekjes", Law, Ethics and Philosophy, 4, 2016, 32-60.
[137] Neni 182.
[138] Neni 40.
[139] Neni 183.

Një ndryshim i fundit në Kodin Penal ka ashpërsuar dënimet dhe ka shtuar rrethana të reja rënduese, përfshirë rastet kur vepra kryhet ndaj një fëmije nën moshën 10 vjeç apo ndaj një personi të cenueshëm nën moshën 15 vjeç.[140] Dispozita e re parashikon gjithashtu që personi i dënuar për ngacmim seksual ndaj një fëmije ndalohet të ushtrojë çdo profesion apo veprimtari që lidhet me punën me fëmijë.

Përveç sferës penale, ligjet e Kosovës ofrojnë mbrojtje nga ngacmimi seksual edhe përmes Ligjit për Barazinë Gjinore dhe Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.[141]

Dhuna Seksuale

Konventa e Stambollit (KS) ndalon një sërë veprash që lidhen me dhunën seksuale, përfshirë:

A. kryerjen e penetrimit vaginal, anal ose oral me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër, me çdo pjesë të trupit ose me ndonjë objekt, pa pëlqimin e tij/saj;
B. kryerjen e veprimeve të tjera me natyrë seksuale ndaj një personi, pa pëlqimin e tij/saj;
- detyrimin e një personi që të kryejë veprime me natyrë seksuale ndaj një personi të tretë, pa pëlqimin e tij/saj.[142]

Kodi Penal i Kosovës përfshin veprat penale të dhunimit dhe sulmit seksual, të cilat në mënyrë të përgjithshme përputhen me pikat A dhe B të mësipërme.[143] Përkufizimi i dhunimit është: detyrimi i një personi për të kryer një akt seksual pa pëlqimin e tij/saj.[144] Ndërsa sulmi seksual nënkupton se kur një person prek një tjetër për qëllime seksuale, ose e bind atë që ta prekë vetë apo një person tjetër për qëllime seksuale, pa pëlqimin e tij/saj.[145] KPK përmban një gamë të gjerë rrethanash rënduese. Një prej tyre është specifike për dhunimin — në rastet kur akti shoqërohet me kërcënim për zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e viktimës apo të një personi të afërt me të.

Dënimet për dhunim dhe sulm seksual rriten ndjeshëm kur akti shoqërohet me kërcënim me dhunë, rrezik të menjëhershëm, shfrytëzim, përdorim të armës, torturë, lëndim trupor, dehje, njohuri të autorit për cenueshmërinë e viktimës, ose kur ekziston një marrëdhënie familjare ndërmjet autorit dhe viktimës.

Pëlqimi

Konventa e Stambollit ndjek qasjen e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, duke e vendosur autonominë personale në qendër të përkufizimit të dhunimit. Ajo përcakton se "Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht, si rezultat i vullnetit të lirë të personit, i vlerësuar në kontekstin e rrethanave përreth." KE ofron udhëzimet e mëposhtme në lidhje me këtë parim:

---

[140] KPK Neni 183, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-188.
[141] Neni 3.1.12; dhe Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga diskriminimi, Neni 4.1.3. Shih Banjska et al. për RrGK, *Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi në Kosovë.*, Edicioni i dytë, 2022, ff. 18-28
[142] Neni 36.
[143] Vepra penale e Cënimit të Integritetit Seksual (Neni 230) në përgjithësi ndjek të njëjtën strukturë të këtyre veprave penale, megjithëse me dënime të ndryshme. Kjo vepër penale ndodh kur një person nxitet të ekspozojë pjesët private të trupit të tij, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër që cënon integritetin e tij/saj seksual, pa pëlqimin e tij/saj.
[144] Neni 227. Neni 225.4 përkufizon "aktin seksual"
[145] Neni 229.

> Ndjekja penale e kësaj vepre do të kërkojë një vlerësim të ndjeshëm në kontekst të provave në mënyrë që të përcaktohet rast pas rasti nëse viktima është pajtuar lirisht për veprën seksuale të kryer. Një vlerësim i tillë duhet të njohë gamën e gjerë të përgjigjeve të sjelljes ndaj dhunës seksuale dhe përdhunimit që shfaqin viktimat dhe nuk do të bazohet në supozime të sjelljes tipike në situata të tilla. Është po aq e rëndësishme të sigurohet që interpretimet e legjislacionit të përdhunimit dhe ndjekja penale e rasteve të përdhunimit nuk ndikohen nga stereotipet gjinorë dhe mitet për seksualitetin mashkullor dhe femëror.[146]

Në Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit, KE i referohet gjithashtu rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNj) *M.C. kundër Bullgarisë*, duke theksuar se:

> Gjykata vlerëson se një qasje e ngurtë ndaj ndjekjes penale të veprave seksuale — si, për shembull, kërkimi i domosdoshëm i provave për rezistencë fizike në çdo rast — rrezikon të lërë të pandëshkuara disa forma të dhunimit dhe, si rezultat, të cënojë mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individit. … [Shtetet anëtare duhet të sigurojnë] ndëshkimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual pa pëlqim, përfshirë edhe rastet kur viktima nuk ka ofruar rezistencë fizike.[147]

Sipas Kodit Penal të Kosovës, "pëlqimi" nënkupton marrëveshjen vullnetare të një personi mbi moshën 16 vjeçare për të kryer një akt seksual.[148] Pëlqimi mund të nënkuptojë gjithashtu marrëveshjen vullnetare ndërmjet dy personave mbi moshën 14 vjeçare, nëse diferenca e moshës mes tyre nuk tejkalon dy vjet. KPK parasheh një mbrojtje ligjore në rastet kur një person gabimisht beson, për "arsye të justifikueshme"[149], se viktima është mbi moshën 16 vjeçare. Në rrethana të tilla, personi mund të mos mbahet penalisht përgjegjës për kryerjen e një akti seksual me pëlqim me një person nën moshën e lejuar. Megjithatë, neglizhenca e të akuzuarit/ës nuk mjafton për ta përjashtuar përgjegjësinë — autori/ja duhet të dënohet nëse ka pasur arsye të ishte i/e vetëdijshëm/me se viktima ishte nën moshën e pëlqimit, ose nëse ka vepruar në mënyrë të pakujdesshme. Kodi Penal i Kosovës përcakton disa rrethana jo shteruese në të cilat pëlqimi nuk konsiderohet i vlefshëm. Këto përfshijnë rastet kur viktima, me fjalë apo me sjellje, shpreh qartë se nuk dëshiron të përfshihet në një akt seksual; kur pëlqimi jepet nga një person tjetër dhe jo nga vetë viktima; kur pëlqimi merret përmes mashtrimit, frikës apo kërcënimit; ose kur personi nuk është në gjendje të japë pëlqim për shkak të kapaciteteve të kufizuara mendore apo fizike, ose për shkak të dehjes.

Provat e papranueshme

Ndërsa Rregulloret e Procedurës së *Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë* (TPNJ) dhe *Gjykatës Penale Ndërkombëtare* (GJPN) përcaktojnë se sjellja e mëparshme seksuale e viktimës nuk mund të pranohet si provë, Konventa e Stambollit (KS) e lejon këtë "vetëm kur është e rëndësishme dhe e domosdoshme",[150] duke lënë kështu një hapësirë të

[146] Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi192.
[147] Aplikimi nr. 39272/98.
[148] Neni 225.1 – 225.2.
[149] Nenet 25 dhe 226.
[150] Neni 54.

konsiderueshme për diskrecion.[151] Direktiva e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave tani parashikon se provat që lidhen me "sjelljen e kaluar seksuale të viktimës apo aspekte të tjera të jetës së saj private që kanë lidhje me të" mund të lejohen në procedura penale vetëm nëse janë të rëndësishme dhe të domosdoshme.[152] Në Kosovë, Kodi i Procedurës Penale (KPP) përcakton se:

> Çdo provë që ka të bëjë me sjelljen e kaluar seksuale të dëshmitarit/ës, viktimës ose palës së dëmtuar do të vendoset të jetë e papranueshme në procedurat penale të veprave penale të natyrës seksuale, përveç nëse është e rëndësishme dhe rreptësisht e nevojshme dhe jo degraduese pa nevojë për dëshmitarin/en, viktimën ose palën e dëmtuar.[153]

Rrethanat e vetme kur një provë e tillë mund të paraqitet janë: për të dëshmuar se provat fizike i përkasin një personi tjetër, e jo të pandehurit/es, ose për të vërtetuar ekzistencën e pëlqimit bazuar në kontaktet e mëparshme seksuale ndërmjet të pandehurit/es dhe viktimës, dëshmitarit/es apo personit të dëmtuar. Megjithatë, sjellja e mëparshme seksuale nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare për të dëshmuar se ka pasur pëlqim. Udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës për dënimet sqarojnë qartë se: "E kaluara seksuale e viktimës nuk ka asnjë rëndësi në vlerësimin e besueshmërisë së saj dhe nuk duhet të shërbejë si arsye për të zbutur dënimin e kryesit të veprës."[154]

Dhunë Seksuale brenda Marrëdhënieve, përfshirë Dhunën Seksuale Bashkëshortore

KS kërkon që ligji të njeh që veprat e mësipërme penale seksuale zbatohen për veprimet e kryera kundër ish-bashkëshortëve ose partnerëve aktualë.[155] Kjo dispozitë njeh faktin se dhuna seksuale dhe dhunimi janë forma të zakonshme të ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit në marrëdhënie abuzive dhe ka gjasa të ndodhin si gjatë lidhjeve, ashtu edhe pas ndarjes së çifteve.[156] Prandaj, duhet të mos ekzistojnë përjashtime nga kriminalizimi dhe ndjekja penale e akteve të tilla kur ato kryhen ndaj bashkëshortit/es apo partnerit/ës aktual/e ose të mëparshëm/me.[157] Si për veprën e dhunimit, ashtu edhe për sulmin seksual, Kodi Penal i Kosovës njeh kryerjen e tyre brenda një marrëdhënieje familjare si rrethanë rënduese.[158] Megjithatë, pavarësisht këtyre dispozitave, është ngritur shqetësimi për zbatim të pamjaftueshëm dhe për probleme të gjera që lidhen me dhunimin bashkëshortor në Kosovë.[159] Në veçanti, KPK i mëparshëm e kufizonte rrethanën rënduese për marrëdhëniet familjare vetëm në rastet kur viktima ishte ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeç, duke përjashtuar në mënyrë të pajustifikueshme shumë viktima të mundshme të dhunës seksuale brenda martesës.[160] Kështu, qartësia në KPK-në e re përbën një zhvillim pozitiv, por kërkon monitorim të vazhdueshëm për

---

[151] Nousiainen, K. dhe Chinkin, C., "Legal Implications of EU Accession to the Istanbul Convention",[Në Anglisht] Komisioni Evropian, 2015, f. 44.
[152] DHGDHF, Neni 20.
[153] Neni 257.
[154] Gjykata Supreme e Kosovës, *Udhëzimet për Dënimet*, Edicioni i Parë, 2018, f. 135-136.
[155] Neni 36.3.
[156] Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 194.
[157] Po aty.
[158] Nenet 227.4.9 dhe 229.3.9, respektivisht
[159] Shih, për shembull, Gjocaj, S., për Kosovo 2.0, "Përdhunimi martesor, 'legjitim' dhe i mirëqenë në Kosovë", 2019.
[160] Kodi Nr. 06/I-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës (i shfuqizuar), Neni 230.4.9.

të siguruar zbatimin e duhur, duke pasur parasysh këtë histori. Problemet me zbatimin e ligjeve kundër dhunimit, përfshirë dhunimin bashkëshortor, vazhdojnë të jenë të pranishme; gjykatat shpesh shqiptojnë dënime më të lehta se minimumi ligjor.[161]

Gjymtimi Gjenital Femëror

Konventa e Stambollit dhe Direktiva e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave ndalojnë çdo formë të gjymtimit të organeve gjenitale të grave ose detyrimin e grave dhe vajzave për t'iu nënshtruar një akti të tillë.[162] DHGDHF shton se "çdo gjymtim" duhet të kuptohet si çdo ndryshim fizik i organeve gjenitale femërore.[163] Kodi Penal i Kosovës përcakton se kushdo që, "për arsye jo mjekësore, heq pjesërisht ose plotësisht apo ndryshon në mënyrë të përhershme organet e jashtme gjenitale të femrës", dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet. Dënimi rritet në rastet kur viktima konsiderohet "e cenueshme" ose nëse viktima vdes si pasojë e gjymtimit.[164] Këto dënime janë në përputhje me kërkesat e DHGDHF, e cila përcakton një maksimum dënimi prej të paktën pesë vjetësh burgim.[165] Në Kosovë, nxitja apo ndihma për kryerjen e veprës janë gjithashtu të dënueshme. Përcaktimi i "arsyeve jo mjekësore" në KPK është në përputhje me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, megjithatë që në vitin 2014 është ngritur shqetësimi për një trend në rritje të personelit mjekësor që kryente GJGJF, duke maskuar praktikën si ndërhyrje "mjekësore".[166]

Përtej ndëshkimit, masat e mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimat janë gjithashtu të nevojshme, të cilat duhet të përfshijnë trajnime për profesionistë të vijës së frontit.[167] Një praktikë e mirë ndërkombëtare në legjislacionin kundër gjymtimit gjenital femëror është mbrojtja e vajzave nga kryerja e gjymtimit jashtë vendit[168] si edhe kriminalizimi i mosveprimit për t'i mbrojtur ato.[169] Kjo nënkupton se, nëse prindërit apo kujdestarët e një vajze e ekspozojnë atë ndaj një rreziku të tillë, ata mund të ndiqen penalisht. Zbatimi i këtij modeli duhet të merret në konsideratë edhe në Kosovë.

Aborti i Detyruar dhe Sterilizimi i Detyruar

Konventa e Stambollit trajton abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar në të njëjtin nen[170], ndërsa në KPK këto trajtohen veçmas.[171] KS ndalon kryerjen e qëllimshme të një aborti ndaj një gruaje pa pëlqimin paraprak dhe të informuar të saj.[172] Ligji i Kosovës për abortin e detyruar ndalon ndërprerjen e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas shtatzënë. Ai ndalon gjithashtu ndërprerjen e shtatzënisë *me pëlqim*, në rastet kur procedura bëhet në kundërshtim me Ligjin për Ndërprerjen e Shtatzënisë.[173] Situata të tilla, ose ndihma për të tilla, dënohen me burgim.

---

[161] Departamenti i Shtetëror i SHBA-së Human Rights Report on Kosovo, [Në Anglisht], 2023.
[162] KS Neni 38 dhe DHGDHF Neni 3.
[163] DHGDHF, Hyrja sqaruese 15.
[164] Neni 180.
[165] DHGDHF, Neni 10.
[166] Organizata Botërore e Shëndetësisë, "Female Genital Mutilation; Fact Sheet", [Në Anglisht].
[167] Gardner-Rhys, R., "Zhvillimet e Fundit në Ligjin që lidhet me Gjymtimin Gjenital Femëror", Child and Family Law Quarterly, 28(1), 2016, 87-98, f. 96 – 97.
[168] Për shembull, shih Ligjin e Mbretërisë së Bashkuar për Gjymtimin Gjenital të Femrave (United Kingdom Female Genital Mutilation Act 2003), neni 3 (me ndryshime).
[169] Po aty, s.3A (me ndryshime).
[170] Neni 39.
[171] Nenet 178 dhe 179.
[172] Neni 39a.
[173] Nr. 03/L-110.

Abortet e detyruara sjellin rritje dënimi nëse ato rezultojnë me lëndime të rënda trupore, dëmtime serioze të shëndetit ose vdekje të gruas shtatzënë.

Sa i përket sterilizimit të detyruar, Konventa e Stambollit ndalon kryerjen e çdo ndërhyrjeje kirurgjikale që synon ose rezulton në ndërprerjen e aftësisë natyrore riprodhuese të një gruaje, pa pëlqimin e saj të informuar paraprakisht ose pa e kuptuar plotësisht procedurën.[174] Në Kosovë, kjo vepër është formuluar në mënyrë gjinore neutrale. Sterilizimi i detyruar dënohet më rëndë nëse si pasojë shkaktohet lëndim i rëndë trupor, dëmtim serioz i shëndetit apo vdekja e gruas. Dispozita kosovare bazohet vetëm në mungesën e pëlqimit, ndërsa Konventa e Stambollit shkon më tej, duke e ndaluar sterilizimin edhe në rastet kur viktima nuk e kupton plotësisht procedurën.

Krimi i Mundësuar nga Teknologjia

Disa forma të reja të dhunës me bazë gjinore nxiten ose lehtësohen përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Këto përfshijnë ngacmimin online, përndjekjen, ngacmimin kibernetik, bullizmin dhe abuzimin seksual në internet.[175] Konventa e Stambollit nuk e trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë krimin e mundësuar nga teknologjia, por Direktiva e BE-së për Luftimin e Dhunës ndaj Grave përfshin vepra të tilla si ndarja pa pëlqim e materialeve intime ose të manipuluara, përndjekja kibernetike, ngacmimi kibernetik dhe nxitja kibernetike për dhunë apo urrejtje.

Ndarja pa pëlqim e materialeve intime ose të manipuluara

Një formë e abuzimit seksual online është ajo që njihet si "pornografi hakmarrëse" (revenge porn), e cila nënkupton shpërndarjen e imazheve ose videove me përmbajtje seksuale pa pëlqimin e personit të paraqitur në to dhe pa ndonjë qëllim të ligjshëm (p.sh. brenda një procedure gjyqësore). Autorët/et e këtyre veprimeve janë shpesh, por jo gjithmonë, ish-partnerë që e kanë siguruar materialin në mënyrë konsensuale, ndërsa motivi nuk është gjithmonë hakmarrja.[176] Megjithëse mungojnë studime të thelluara empirike për abuzimin seksual online, gratë dhe vajzat duken të prekura në mënyrë disproporcionale.[177]

Direktiva DHGDHF përcakton se veprimet e mëposhtme të qëllimshme duhet të konsiderohen vepra penale:

- publikimi i imazheve, videove ose materialeve të ngjashme që paraqesin aktivitete me përmbajtje seksuale ose pjesë intime të trupit të një personi, përmes TIK, pa pëlqimin e tij/saj, kur një veprim i tillë ka gjasë të shkaktojë dëm serioz ndaj personit;
- prodhimi, manipulimi ose ndryshimi i imazheve, videove apo materialeve të ngjashme për t'i bërë të duken sikur një person është përfshirë në aktivitete me përmbajtje seksuale, dhe më pas publikimi i këtyre materialeve përmes TIK pa pëlqimin e tij/saj, kur veprimi ka gjasë të shkaktojë dëm serioz ndaj personit; dhe

[174] Neni 39b.
[175] Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian, "Parandalimi dhe luftimi i të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave, përfshirë gjymtimin gjenital femëror", Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme, Luksemburg, 5-6 qershor 2014, f. 2.
[176] EIGE, "Cyber violence against women and girls",[Në Anglisht], f. 2.
[177] Shih për shembull: Drouin, D., Ross, J., dhe Tobin, E., "Sexting: një mjet i ri digjital për agresionin ndaj partnerit intim?", Computers in Human Behaviour, 50, 2015, 197, dhe Franks, M.A. dhe Citron, D., "Kriminalizimi i Pornografisë Hakmarrëse", Wake Forest Law Review, 49, 2014, 345.

- kërcënimi për të kryer ndonjërin nga veprimet e mësipërme, me qëllim detyrimin e një personi që të bëjë, të pranojë apo të heqë dorë nga një veprim i caktuar.[178]

DHGDHF është e qartë se vepra e ndarjes pa pëlqim të materialeve intime ndodh pavarësisht nëse viktima ka dhënë pëlqimin për krijimin e materialit ose e ka ndarë atë me një person të caktuar.[179] Sjellja kriminale konsiston në *shpërndarjen* pa pëlqim të materialit në publik. Preambulat e Direktivës theksojnë se termi "i qasshëm për publikun" nënkupton aftësinë për të arritur një numër të konsiderueshëm personash.[180] Preambulat sqarojnë gjithashtu se kërkesa për "mundësi shkaktimi të dëmit serioz" është përfshirë për të vendosur standarde minimale për rastet më të rënda të dhunës kibernetike. Në secilin rast, duhet të merren parasysh rrethanat specifike, ndërsa vlerësimi i "mundësisë për dëm" duhet të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave objektive. Preambulat gjithashtu theksojnë se shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë dispozita penale më të rrepta se ato që parashikon kjo direktivë.

Përndjekja dhe Ngacmimi Kibernetik

Përndjekja kibernetike Sipas Direktivës për Luftimin e Dhunës ndaj Grave, përkufizohet si veprim i qëllimshëm që konsiston në vendosjen e përsëritur ose të vazhdueshme të një personi nën mbikëqyrje, me qëllim të ndjekjes ose monitorimit të lëvizjeve dhe aktiviteteve pa pëlqimin apo autorizimin ligjor të tij/saj.[181] jo vepër dënohet me burgim të paktën një (1) vit. Në preambulat e Direktivës theksohet se mbikëqyrja mund të realizohet përmes përpunimit të të dhënave personale të viktimës — për shembull: vjedhja e identitetit, vjedhja e fjalëkalimeve, ndërhyrja në pajisjet e viktimës, aktivizimi i fshehtë i softuerëve për regjistrimin e shtypjeve të tastierës (keylogging), instalimi i aplikacioneve për lokalizim/ndjekje (përfshirë stalkerware), ose vjedhja e pajisjeve të viktimës".[182] Termi "gjurmim (tracking)" duhet të kuptohet si ndjekja e vendndodhjes së një personi, ndërsa "monitorim" nënkupton vëzhgimin e përgjithshëm të veprimtarive të tij/saj.[183] Në DHGDHF, **ngacmimi kibernetik** përfshin:

> (a) përfshirjen e vazhdueshme ose e përsëritur në sjellje kërcënuese ndaj një personi përmes mjeteve të TIK-ut — veçanërisht kur këto sjellje përfshijnë kërcënime për kryerje të veprave penale dhe kur kanë gjasë të shkaktojnë frikë serioze për sigurinë personale të viktimës ose të personave që varen prej saj — konsiderohet e ngjashme me veprën e përndjekjes sipas Konventës së Stambollit, por në kontekstin online;
> (b) pjesëmarrjen bashkë me persona të tjerë përmes mjeteve të TIK-ut në sjellje publike kërcënuese ose fyese ndaj një personi, kur kjo sjellje ka gjasë të shkaktojë dëm serioz psikologjik viktimës (kjo përfshin sulmet e koordinuara online, të cilat shpesh synojnë gra politikane, gazetare, aktiviste për të drejtat e njeriut dhe gra të njohura në publik[184]);
> (c) dërgimin e padëshiruar, përmes mjeteve të TIK-ut, të imazheve, videove ose materialeve të ngjashme që paraqesin organet gjenitale të një personi, kur kjo sjellje ka gjasë të shkaktojë dëm serioz psikologjik (e njohur si "cyberflashing"[185]);

[178] DHGDHF, Neni 5.
[179] DHGDHF, Hyrja sqaruese 19.
[180] DHGDHF, Hyrja sqaruese 18.
[181] DHGDHF, Neni 6.
[182] DHGDHF, Hyrja sqaruese 21.
[183] DHGDHF, Hyrja sqaruese 22.
[184] DHGDHF, Hyrja sqaruese 24.
[185] DHGDHF, Hyrja sqaruese 24.

(d) bërjen publike të materialeve që përmbajnë të dhënat personale të një personi, pa pëlqimin e tij/saj, me qëllim nxitjen e të tjerëve për t'i shkaktuar dëm fizik ose psikologjik të rëndë (e njohur ndryshe si "doxing").[186]

Të gjitha këto vepra duhet të jenë të dënueshme me burgim deri në të paktën një (1) vit, përveç rastit (c) më sipër, për të cilin Direktiva nuk përcakton një periudhë të veçantë dënimi.

Nxitja Kibernetike për Dhunë ose Urrejtje

Direktiva për Luftimin e Dhunës ndaj Grave vëren një rritje të ndjeshme të nxitjes publike për dhunë dhe urrejtje gjatë viteve të fundit, përfshirë edhe atë të bazuar në gjini:

> Shpërndarja e shpejtë, e lehtë dhe masive e gjuhës së urrejtjes në hapësirën digjitale përforcohet nga i ashtuquajturi "efekt i çlirimit online", pasi ndjenja e anonimitetit dhe mungesa e frikës nga ndëshkimi i nxisin njerëzit të përfshihen më lehtë në këtë formë komunikimi. Gratë shpesh bëhen objektiv i gjuhës seksiste dhe mizogjiniste të urrejtjes në internet, e cila mund të përshkallëzohet dhe të shndërrohet në krime urrejtjeje edhe jashtë hapësirës virtuale.[187]

Për ta luftuar këtë dukuri, Direktiva ka paraparë një vepër të re penale që ndalon nxitjen e qëllimshme të dhunës ose urrejtjes ndaj një grupi personash, apo ndaj një anëtari/je të atij grupi të përcaktuar sipas gjinisë, përmes shpërndarjes publike të materialeve që përmbajnë një nxitje të tillë përmes mjeteve të TIK-ut.[188] Shtetet anëtare mund të vendosin ta kufizojnë këtë vepër vetëm në rastet kur sjellja ka gjasa të prishë rendin publik, ose kur është kërcënuese, fyese apo poshtëruese ndaj personit të prekur.

Mjetet e mbrojtjes

Veprat kibernetike paraqesin një rrezik të shtuar për viktimizim të përsëritur, të zgjatur apo edhe të vazhdueshëm, për shkak të lehtësisë dhe shpejtësisë me të cilat materialet mund të shpërndahen në masë, si edhe për shkak të vështirësive që shpesh paraqiten në largimin e tyre nga hapësirat digjitale.[189] Për këtë arsye, Direktiva u bën thirrje Shteteve Anëtare të ndërmarrin "masa të përshtatshme që synojnë heqjen e menjëhershme të materialit në fjalë". Megjithatë, pasi heqja e materialit nga burimi mund të mos jetë gjithmonë e mundur (p.sh. për shkak të vështirësive ligjore apo praktike që lidhen me zbatimin ose ekzekutimin e urdhrit për heqje), Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësi të parashohin masa për çaktivizimin e menjëhershëm të qasjes në materialet e tilla.[190] Kjo arrihet përmes instrumenteve në vijim:

(a) Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që materialet e publikuara në internet dhe të qasshme publikisht, që lidhen me veprat penale të (1) shpërndarjes jokonsensuale të materialeve intime ose të manipuluara, (2) ngacmimit kibernetik dhe (3) nxitjes kibernetike për dhunë ose urrejtje, të hiqen menjëherë ose që qasja në to të çaktivizohet.

---

[186] DHGDHF, Neni 7.
[187] DHGDHF, Hyrja sqaruese 25.
[188] DHGDHF, Neni 8.
[189] DHGDHF, Hyrja sqaruese 51.
[190] DHGDHF, Hyrja sqaruese 51.

(b) Kjo mund të përfshijë lëshimin e urdhrave ligjorë detyrues për heqjen ose çaktivizimin e qasjes në materialet e tilla, me kusht që këta urdhra të përmbushin kriteret e përcaktuara.[191] Urdhrat duhet t'u drejtohen ofruesve të shërbimeve në internet.[192] Në rastet kur heqja e materialit nuk është e mundur, urdhrat mund t'u drejtohen ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse për të çaktivizuar qasjen.[193] Nëse procedurat penale përfundojnë pa konstatimin e kryerjes së një vepre penale, urdhrat duhet të shfuqizohen dhe palët e përfshira të njoftohen. Të gjitha urdhrat dhe masat e tjera duhet të kenë siguri të mjaftueshme ligjore dhe të kufizohen vetëm në atë që është e domosdoshme dhe proporcionale. Ofruesit e shërbimeve të pritjeve, shërbimeve ndërmjetësuese dhe përmbajtjeve duhet të kenë të drejtë për mjet juridik pranë gjykatës.

- Heqja ose çaktivizimi i qasjes në materiale sipas një urdhri apo mase tjetër nuk duhet të pengojë autoritetet kompetente që të sigurojnë ose ruajnë provat e nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave, pa vonesa të panevojshme.

Meqenëse këto masa tashmë janë pjesë e acquis-it të BE-së, Kosova duhet të miratojë dispozita të posaçme penale në Kodin Penal të Kosovës, si dhe t'i integrojë masat e sipërpërmendura në ligjin përkatës (p.sh. Ligjin nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike).[194] Policia e Kosovës tashmë ka një Njësi për Hetimin e Krimeve Kibernetike; prandaj, duhet të merret në konsideratë ofrimi i trajnimeve të përshtatshme për reagim ndaj rasteve të tilla.

Rrethanat Rënduese

Konventa e Stambollit dhe Direktiva e BE-së 2024/1385 për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje parashohin që disa faktorë duhet të merren parasysh si rrethana rënduese gjatë caktimit të dënimit.[195] Lista e faktorëve në DHGDHF është më e gjerë se ajo në Konventën e Stambollit, por zbatohet për një grup më të kufizuar veprash penale — si gjymtimi gjenital femëror (GJGJF), martesa e detyruar, shpërndarja pa pëlqim e materialeve intime ose të manipuluara, ndjekja kibernetike, ngacmimi kibernetik dhe nxitja kibernetike e dhunës ose e urrejtjes.

Rregullat e përcaktuara nga Direktiva përbëjnë standarde minimale, ndaj Kosova mund të zbatojë rrethana rënduese edhe për vepra të tjera penale, përfshirë ato që mbulohen nga Konventa e Stambollit. Siç u theksua, disa vepra penale përfshijnë rrethana rënduese në legjislacionin e Kosovës. Kodi Penal i Kosovës (KPK) gjithashtu përmban rregulla të përgjithshme për rëndimin (dhe lehtësimin) e dënimit që zbatohen për të gjitha veprat penale. Tabela në vijim

---

[191] Këto kritere përcaktohen nga Neni 9(2) i Rregullores 2022/2065 për një Treg të Vetëm për Shërbimet Digjitale (p.sh., referenca e bazës ligjore për urdhrin, dhënia e një deklarate të arsyeve, identifikimi i autoritetit lëshues, etj.).

[192] "Ofruesi i shërbimit të pritjes" do të thotë një ofrues i një shërbimi pritës, i cili është një shërbim që konsiston në ruajtjen e informacionit të ofruar nga dhe me kërkesë të një marrësi të shërbimit (DHGDHF, Neni 2(d)).

[193] "Ofruesi i shërbimit ndërmjetës" do të thotë një ofrues i një shërbimi ndërmjetës, i cili është ndonjë nga shërbimet e mëposhtme të shoqërisë së informacionit: (i) një shërbim "vetëm kanal transmetimi", që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose sigurimin e qasjes në një rrjet komunikimi; (ii) një shërbim "ruajtjeje të përkohshme" (caching), që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, duke përfshirë ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të atij informacioni, të kryer vetëm për qëllimin e bërjes më efikase të transmetimit të mëtejshëm të informacionit te marrës të tjerë sipas kërkesës së tyre; (iii) një shërbim "pritjeje" (hosting), siç përkufizohet Po aty. (DHGDHF, Neni 2(e)).

[194] Nr. 03/L –166.

[195] KS, Neni 46 dhe DHGDHF Neni 11.

krahason rrethanat rënduese në Konventën e Stambollit (KS) dhe Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) me rregullat e përgjithshme të KPK-së. KPK është në përgjithësi në përputhje me DHGDHF-në dhe KS-në. Megjithatë, ekzistojnë mangësi të dukshme, si pragu i lartë që kërkohet për ta konsideruar recidivizmin si rrethanë rënduese, mungesa e një rrethane rënduese kur vepra kryhet në prani të një fëmije, dhe përfshirja e rrethanës rënduese vetëm për rastet kur vepra kryhet brenda një marrëdhënieje familjare, në vend të formulimit më të gjerë "kundër një partneri/eje actual/e ose ish-partneri/eje", i cili nuk e kushtëzon bashkëjetesën. Siç është theksuar, disa vepra përfshijnë rrethana rënduese në legjislacionin e Kosovës. Kodi Penal i Kosovës përmban gjithashtu rregulla të përgjithshme mbi rëndimin (dhe lehtësimin) e dënimit, të cilat zbatohen për të gjitha veprat penale. Tabela në vijim krahason faktorët rëndues të përcaktuar në Konventën e Stambollit dhe në Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje me rregullat e përgjithshme të KPK-së. KPK-ja është në përputhje të gjerë me DHGDHF-në dhe KS-në. Megjithatë, boshllëqet e dukshme përfshijnë pragun e lartë që duhet përmbushur që recidivizmi të konsiderohet si faktor rëndues, mungesën e një faktori rëndues kur vepra kryhet në prani të një fëmije, si dhe kufizimin e faktorit rëndues vetëm për rastet kur vepra kryhet brenda një marrëdhënieje familjare (dhe jo më gjerë, pra "kundër një partneri/eje aktual/e ose ish-partneri/je", që nuk kërkon bashkëjetesë

DHGDHF, Neni 11	KS, Neni 46	KPK
(a) vepra penale, ose ndonjë vepër tjetër penale e dhunës ndaj grave apo dhunës në familje, është kryer në mënyrë **të përsëritur**;	(b) vepra penale, ose veprat e tjera të ndërlidhura, janë kryer në mënyrë të përsëritur;	75. autori i veprës penale është dënuar më parë dy ose më shumë herë me burgim prej të paktën një viti për vepra penale tëkryera me dashje, dhe kanë kaluar më pak se pesë vjet;
(b) Vepra penale është kryer ndaj një personi që është bërë i/e **cenueshëm/me** për shkak të rrethanave të veçanta, si një situatë varësie apo një gjendje paaftësie fizike, mendore, intelektuale ose shqisore;	(c) vepra penale është kryer ndaj një personi të cenueshëm për shkak të rrethanave të veçanta;	70.2.6 nëse viktima e veprës penale ka qenë veçanërisht e pambrojtur ose e cenueshme
(c) vepra penale është kryer **ndaj një fëmije**;		70.2.7 mosha e viktimës, qoftë e re apo e shtyrë në moshë
(d) vepra penale është kryer në **praninë e një fëmije**;	(d) vepra penale është kryer ndaj ose në praninë e një fëmije;	
(e) vepra penale është kryer nga **dy ose më shumë persona** që kanë vepruar së bashku;	(e) vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona që kanë vepruar së bashku;	
(f) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele **ekstreme** të dhunës;	(f) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar me nivele të larta ekstreme të dhunës;	70.2.3 prania e dhunës reale ose e kërcënimit me dhunë gjatë kryerjes së veprës penale 70.2.4 nëse vepra penale është kryer me mizori të veçantë;
(g) vepra penale është kryer me përdorimin e një **arme** ose me kërcënimin për përdorimin e saj;	vepra penale është kryer me përdorim ose kërcënim me armë;	

DHGDHF, Neni 11	KS, Neni 46	KPK
(h) vepra penale është kryer me përdorimin e **forcës** ose kërcënimin për përdorimin e forcës, **apo përmes detyrimit**;		
(i) sjellja ka shkaktuar **vdekjen** e viktimës ose dëmtim të rëndë fizik apo psikologjik ndaj saj/tij;	(h) vepra penale ka rezultuar me dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik për viktimën;	70.2.8 shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, duke përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e një sëmundjeje te viktima, si dhe çdo dëm tjetër të shkaktuar viktimës dhe familjes së saj
(j) autori i veprës penale **është dënuar më parë** për vepra të së njëjtës natyrë;	autori i veprës penale është dënuar më parë për vepra të ngjashme	70.2.13 çdo dënim i mëparshëm penal i rëndësishëm i personit të dënuar
(k) vepra penale është kryer ndaj një **bashkëshorti/eje ose partneri/eje të mëparshëm apo aktual/e**;	(a) vepra penale është kryer ndaj një bashkëshorti/eje ose partneri/eje të mëparshëm apo aktual/e, siç njihet nga legjislacioni i brendshëm, nga një anëtar i familjes, një person që bashkëjeton me viktimën, ose një person që ka keqpërdorur autoritetin e tij apo të saj	
(l) vepra penale është kryer nga një **anëtar i familjes** së viktimës ose nga një person që **bashkëjeton** me të;		70.2.14 nëse vepra penale është kryer brenda një marrëdhënieje familjare.
(m) vepra penale është kryer duke **keqpërdorur një pozitë** të njohur besimi, autoriteti apo ndikimi;		70.2.9 çdo keqpërdorim i pushtetit ose i pozitës zyrtare nga ana e personit të dënuar gjatë kryerjes së veprës penale 70.2.10 prova që tregon shkelje të besimit nga ana e personit të dënuar
(n) vepra penale është kryer ndaj një personi për shkak se ai ose ajo ishte **përfaqësues/e publik/e, gazetar/e ose mbrojtës/e i të drejtave të njeriut**;		
(o) qëllimi i veprës penale ka qenë ruajtja ose rikthimi i të ashtuquajturit "**nder**" të një personi, familjeje, komuniteti apo grupi tjetër të ngjashëm;		
(p) qëllimi i veprës penale ka qenë ndëshkimi i viktimës për shkak të orientimit të saj seksual, gjinisë, ngjyrës, fesë, prejardhjes shoqërore apo bindjeve politike		70.2.12 nëse vepra penale përbën akt urrejtjeje (duke përfshirë racën, ngjyrën, gjininë, identitetin gjinor, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, lidhjen me ndonjë komunitet, orientimin seksual apo ndonjë status tjetër personal), përveç rasteve kur një nga këto karakteristika të përmendura përbën element të vetë veprës penale.

DHGDHF, Neni 11	KS, Neni 46	KPK
		70.2.1. **përfshirje në shkallë të lartë** të personit të dënuar në kryerjen e veprës penale; 70.2.2. **shkalla e lartë e qëllimit** nga ana e personit të dënuar; 70.2.5. nëse vepra penale ka përfshirë **më shumë se një viktimë**; 70.2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e aktiviteteve të një **grupi të organizuar criminal**

Kompensimi i Viktimave

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të sigurojnë që viktimat të kenë të drejtën të kërkojnë kompensim nga autorët e krimit për çdo vepër të mbuluar nga Konventa.[196] Kompensimi shtetëror duhet të jepet brenda një afati të arsyeshëm nëse personat kanë pësuar lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit, në atë masë që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera, si autori i veprës, sigurimi apo programet shtetërore të shëndetit dhe mbrojtjes sociale.[197] Direktiva e BE-së për Kompensimin e Viktimave të Krimeve parashikon gjithashtu procedura të detajuara për mënyrën se si duhet të jepet kompensimi për viktimat.[198] Direktiva për të Drejtat e Viktimave (DV) gjithashtu kërkon krijimin e mekanizmave për rikuperimin e kompensimit nga kryesit e veprës penale.[199] Ndërkohë, Direktiva për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) përcakton se viktimat kanë të drejtë të kërkojnë kompensim të plotë nga kryesit e veprës për dëmet që rezultojnë nga veprat e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje, dhe se viktimat duhet të kenë mundësi të marrin një vendim për kompensim gjatë procedurës penale.[200]

Në Kosovë, Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit është në përputhje të gjerë me Direktivën e BE-së për Kompensimin e Viktimave të Krimeve.[201] Ky ligj përcakton se kompensimi u takon viktimave të të gjitha veprave që kanë rezultuar me vdekje, lëndim të rëndë ose dëmtim të shëndetit fizik apo mendor. Në rastet që përfshijnë fëmijë, trafikim njerëzor, përdhunim dhe dhunë në familje, parashihet kompensim i menjëhershëm. Ligji njeh gjithashtu të drejtën për kompensim për vuajtje mendore, ndërsa zbatimin e tij e garanton Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si organ kompetent.[202] Megjithatë, është shprehur shqetësim për mungesë të alokimeve të mjaftueshme buxhetore për kompensimin e viktimave, si dhe për mungesë të ndihmës adekuate për viktimat gjatë paraqitjes së kërkesave për

[196] Neni 30.1.
[197] Neni 30.2.
[198] Direktiva e Këshillit 2004/80/EC e datës 29 prill 2004 në lidhje me kompensimin për viktimat e krimit.
[199] Shih poashtu: Milquet, J. për Presidentin e Komisionit Evropian, "Strengthening Victims' Rights: From compensation to reparation – for a new EU Victims' rights strategy 2020-2025", [Në Anglisht], 2019.
[200] Direktiva e Këshillit 2024/1385 e datës 14 maj 2024 për luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Neni 24.
[201] Nr. 08/L-109. Komisioni Evropian, *Kosovo 2022 Report*, [Në Anglisht], 2022, f. 39.
[202] Shih Kapitullin III të Ligjit.

kompensim.[203] DHGDHF obligon mbrojtësit e viktimave që t'i informojnë viktimat për të drejtën e tyre për kompensim dhe t'i udhëzojnë gjatë procesit të paraqitjes së kërkesave.[204]

Dispozita të Tjera Thelbësore

Veprat penale të parashikuara në Konventën e Stambolli zbatohen pavarësisht marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe autorit/es të veprës penale.[205] Konventa kërkon që kultura, zakoni, feja, tradita apo i ashtuquajturi "nder" të mos përdoren kurrë si justifikim për kryerjen e veprave penale.[206] Meqenëse këto nuk janë parashikuar si rrethana lehtësuese në KPK, korniza penale e Kosovës nuk parashikon që ato mund të përdoren në argumentet e mbrojtjes që lidhen me aktet e dhunës me bazë gjinore. Për më tepër, Udhëzuesi për Dënime i Gjykatës Supreme u kërkon gjyqtarëve të mos e marrin parasysh asnjë rrethanë lehtësuese në rastet kur autori/ja pretendon se ka vepruar për "nder", duke theksuar se Konventa kërkon dënime më të rënda kur një anëtar/e i/e familjes është autor/e i një krimi të tillë.[207] Proceset e zgjidhjes alternative të detyrueshme të mosmarrëveshjeve janë të ndaluara nga Konventa e Stambollit për të gjitha format e dhunës që përfshihen në fushëveprimin e saj.[208] Në përputhje me këtë, Ligji për Dhunën me Bazë Gjinore përcakton se procedurat alternative — përfshirë, por pa u kufizuar në ndërmjetësim dhe pajtim — janë të ndaluara në procedurat penale dhe administrative për rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.[209] Në mënyrë të ngjashme, Kodi i Procedurës Penale parashikon që krimet e dhunës në familje dhe krimet kundër integritetit seksual nuk mund të referohen për ndërmjetësim, siç përcaktohet edhe në Ligjin për Ndërmjetësim.[210] Kodi i Etikës për Ndërmjetësit përcakton që ndërmjetësi duhet ta ndërpresë menjëherë procesin e ndërmjetësimit nëse vëren elemente të dhunës në familje, t'i njoftojë palët për arsyen e ndërprerjes dhe t'i udhëzojë ato të ndjekin procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.[211] Këto parime janë veçanërisht të rëndësishme edhe në procedurat civile, siç janë ato për kujdestarinë e fëmijëve, ushqimin (alimentacionin) apo divorcin, ku ekziston rreziku që ndërmjetësimi të shkaktojë ri-traumatizim të viktimave apo të shfrytëzojë pozitën e tyre të cenueshme. Megjithatë, Ligji për Familjen ende përmban një dispozitë që inkurajon bashkëshortët të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm, përfshirë edhe masat e pajtimit, për ruajtjen e martesës — një dispozitë që disa zyrtarë/e e kanë interpretuar si bazë për të nxitur "pajtimin" e çifteve.[212] Sidoqoftë, i njëjti nen përcakton qartë se duhet shmangur çdo rrezik nga dëmi ose dhuna ndaj bashkëshortëve apo fëmijëve, në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit.

Hetimi, Ndjekja Penale, E Drejta Procedurale dhe Masat Mbrojtëse

Nënkapitujt vijues fokusohen në mbrojtjen e viktimave — fillimisht gjatë procesit ligjor, e më pas në aspektin e shërbimeve mbështetëse dhe mbrojtjes nga dhuna e përsëritur. Shumë nga masat përkatëse të Konventës së Stambollit mbivendosen me dispozitat e Direktivës për

[203] Shih Mbrojtësit e Viktimave më poshtë.
[204] LMDHF, Neni 16.3.
[205] Neni 43.
[206] Neni 42, i përsëritur në Nenin 12.5.
[207] Gjykata Supreme e Kosovës, *Sentencing Guidelines*, [Në Anglisht] Edicioni i Parë, 2018, f. 135.
[208] Neni 48.
[209] LMDHF, Neni 55.
[210] KPK, Neni 229.2; dhe igji Nr. 06/L–009, 2022, Neni 2.3.
[211] Kodi Nr. 12/2019 I Sjelljes së Ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, Neni 7.8.
[212] Neni 59. Shih gjetjet në seksionin e Gjykatave më poshtë.

Viktimat dhe të Ligjit të ri për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje. Miratimi i Kodit të ri të Procedurës Penale ka përmirësuar ndjeshëm harmonizimin e kornizës ligjore të Kosovës me KS-në dhe DV-në.

Megjithatë, kërkohen ende disa përshtatje për të siguruar harmonizim të plotë me këto instrumente. DHGDHF përmban gjithashtu dispozita të reja, të cilat duhet të transpozohen në legjislacionin e Kosovës për zbatim të plotë.

Të Drejtat e Viktimave – Përmbledhje

Kodi i Procedurës Penale përmban detaje të rëndësishme dhe të domosdoshme në lidhje me të drejtat e viktimave.[213] Së pari, KPP zgjeroi përkufizimin e palës së dëmtuar apo viktimës, duke përfshirë personat që kanë pësuar dëm fizik, mendor, emocional ose humbje ekonomike.[214] Edhe pse KPP-ja zbatohet për të gjitha viktimat, një dispozitë e re trajton posaçërisht viktimat e cenueshme, duke përcaktuar se:

> Pala e dëmtuar ose viktima që ka përjetuar trafikim me njerëz, dhunë me bazë gjinore, dhunë në familje, dhunë seksuale, shfrytëzim apo diskriminim — si edhe viktimat që kanë pësuar dëm të konsiderueshëm për shkak të rëndësisë së veprës penale, viktimat me aftësi të kufizuara dhe ato që janë veçanërisht të cenueshme — duhet të trajtohen dhe të merren parasysh në mënyrë të duhur.[215] [sic]

Që nga miratimi i KPP-së, korniza ligjore e Kosovës përmbush shumicën e kërkesave të përcaktuara nga Konventa e Stambollit dhe Direktiva për Viktimat.

Parimet Udhëzuese të Mbrojtjes Procedurale

Kapitulli VI i Konventës së Stambollit trajton hetimin, ndjekjen penale, të drejtën procedurale dhe masat mbrojtëse. Parimet udhëzuese përfshijnë:

- Hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve pa vonesa të panevojshme;
- Mbrojtje dhe mbështetje të menjëhershme dhe të përshtatshme për viktimat;
- Marrjen në konsideratë të plotë të të drejtave të viktimave, duke përfshirë një kuptim gjinor të dhunës; dhe
- Sigurimin që organizatat qeveritare dhe joqeveritare, si dhe këshilluesit/et për dhunën në familje, të kenë mundësinë të ndihmojnë dhe/ose të mbështesin viktimat, me kërkesën e tyre, gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore.[216]

Kapitulli 3 i Ligjit të ri për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje përmban një sërë dispozitash që mbështesin dhe plotësojnë parimet e Konventës së Stambollit. Ndërkohë, Ligji për Dhunën me Bazë Gjinore parashikon që institucionet shtetërore duhet të: "ndërmarrin me përparësi të gjitha masat e duhura ligjore, administrative, gjyqësore dhe të tjera për të parandaluar, mbrojtur, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar kompensim të drejtë për viktimat".[217] Një ndryshim i bërë në nëntor të vitit 2023 në Kodin e Procedurës Penale përcakton që hetimet që lidhen me rastet e përdhunimit dhe dhunës në familje duhet të përfundojnë brenda një

[213] Kodi i Procedurës Penale nr. 08/L-032.
[214] Neni 19.1.7.
[215] Neni 63.1.4.
[216] Nenet 49, 50, dhe 55.2.
[217] LMDHF, Neni 5.

periudhe prej një viti, me mundësi zgjatjeje deri në gjashtë muaj të tjerë në rastet kur ekzistojnë "rrethana të ndërlikuara".[218] Ky afat është dy herë më i shkurtër se ai standard për veprat e tjera penale, duke reflektuar rëndësinë e trajtimit të përshpejtuar të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në familje.[219]

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e masave mbrojtëse për viktimat, të parashikuara në Konventën e Stambollit, në Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje, si edhe në Direktivën për Viktimat, si dhe mënyra se si këto masa janë transpozuar në legjislacionin e Kosovës.

Vlerësimi i Rrezikut

Një nga konceptet qendrore në mbrojtjen e viktimave sipas Konventës së Stambollit është vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut. Të gjitha autoritetet përkatëse duhet të vlerësojnë rrezikun për jetën (lethality risk), ashpërsinë e situatës, posedimin ose qasjen në armë zjarri, si dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, duke e bërë këtë rast pas rasti, me qëllim që të menaxhojnë rreziqet dhe të përcaktojnë nevojën për masa të koordinuara të sigurisë dhe mbështetjes.[220] Një detyrim i ngjashëm ekziston edhe sipas Direktivës për Viktimat.[221] Edhe pse kjo direktivë zbatohet për të gjitha viktimat, ajo kërkon vëmendje të veçantë ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në marrëdhënie të afërta dhe dhunës seksuale, ndër të tjera. E njëjta qasje është e përfshirë edhe në Kodin e Procedurës Penale.

Direktiva për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje ka prezantuar konceptin e "vlerësimit individual të mbrojtjes", me qëllim identifikimin e nevojave specifike të çdo viktime për mbrojtje. Ky vlerësim duhet të bëhet të paktën në rastet e dhunës seksuale ose dhunës në familje dhe paraqet një kërkesë shtesë ndaj dispozitave të Direktivës për Viktimat.[222] Vlerësimi duhet të kryhet "në fazën më të hershme të mundshme", për shembull gjatë kontaktit të parë të autoritetit kompetent me viktimën. Autoritetet përkatëse duhet të bashkëpunojnë, kur është e përshtatshme, me shërbimet mbështetëse, profesionistët shëndetësorë dhe shërbimet sociale. Vlerësimi duhet të përqendrohet në rrezikun që paraqet autori/ja ose i/e dyshuari/a, dhe mund të përfshijë, ashtu siç kërkohet nga Konventa e Stambollit: (a) rrezikun e përsëritjes së dhunës; (b) përdorimin e mundshëm ose qasjen në armë; (c) rrezikun e dëmtimit fizik ose psikologjik; (d) faktin nëse autori ose i dyshuari bashkëjeton me viktimën; (e) përdorimin e substancave narkotike apo alkoolit nga autori/ja ose i dyshuari/a; (f) abuzimin ndaj fëmijëve; (g) problemet e shëndetit mendor; (h) sjelljen përndjekëse. Në bazë të këtij vlerësimi, duhet të merren masa të përshtatshme mbrojtëse, të cilat duhet të rishikohen rregullisht. Një rishikim i vlerësimit duhet të bëhet sa herë që shkelet urdhri mbrojtës.[223] DHGDHF-ja përcakton se personat në varësi duhet të supozohen si persona me nevoja specifike mbrojtjeje, pa pasur nevojë për një vlerësim individual, përveç nëse ka indikacione të kundërta.

Ligji për Dhunën me Bazë Gjinore tani përcakton që institucionet publike duhet të përshtatin masat, aktivitetet dhe shërbimet me nevojat specifike të viktimave të cenueshme, në të cilat përfshihen (gratë dhe fëmijët).[224] Viktimat (dhe/ose përfaqësuesit/et e tyre ligjorë/e) kanë të drejtë të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave të tyre, të njoftohen për masat, aktivitetet dhe shërbimet e disponueshme për mbrojtjen e tyre, si dhe të përfshihen në përzgjedhjen e

[218] KPK, Neni 157.5 – 157.6 (siç është futur me Nenin 2 të Ligjit Nr. 08/L-87).
[219] KPK, Neni 310.4 (siç është futur me Nenin 3 të Ligjit Nr. 08/L-87).
[220] KS, Neni 51.
[221] Neni 22.
[222] DHGDHF, Neni 16.
[223] DHGDHF, Neni 19.5.
[224] LMDHF, Neni 7.1.

masave të mbështetjes dhe mbrojtjes.[225] Policia është e detyruar të vlerësojë menjëherë nivelin e rrezikut në rastet e raportuara dhe të marrë masa sigurie për viktimat dhe familjet e tyre.[226] Kodi i Procedurës Penale përcakton se viktimat kanë të drejtë të marrin informacion mbi llojet e mbështetjes që mund të përfitojnë pas vlerësimit individual.[227] Procedurat Standarde të Veprimittë Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV) kërkojnë që të bëhet një vlerësim i nevojave të viktimës kur një mbrojtës i viktimës (MV) caktohet për një rast.[228] Më pas, duhet të ndërmerren veprime të përshtatshme për të përmbushur nevojat e identifikuara. [229]

PSV-të për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përshkruajnë procedurën e vlerësimit të rrezikut që duhet ta ndjekë policia në rastet e dhunës në familje.[230] Në këtë proces duhet të jetë i pranishëm mbrojtësi i viktimës (MV). Nëse viktima kontakton një institucion tjetër përveç policisë, duhet të përdoret i njëjti formular bazë.

Mbrojtjet në procesin ligjor

Kapitulli VI i Konventës së Stambollit përcakton disa masa procedurale mbrojtëse për të mbrojtur dhe fuqizuar viktimat në të gjitha fazat e procedurës, përfshirë gjatë hetimit dhe gjykimit. Këto masa janë treguese, dhe palët mund të miratojnë dispozita edhe më të favorshme. Në tabelat e mëposhtme, "DV" i referohet Direktivës për të Drejtat e Viktimave, ndërsa "DHGDHF" i referohet Direktivës së BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje.

Masat e përgjithshme	
KS, DV, and DHGDHF	Kosova
*Të sigurohet **mbrojtja** e viktimave, familjeve të tyre dhe dëshmitarëve nga frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur* (KS Neni 56a; DV Neni 18).	Viktimat do të kenë të drejtë të kërkojnë mbrojtje (KPP, neni 63.1.17). Procedurat e vlerësimit të rrezikut, të përshkruara më sipër, duhet të zhvillohen për të përcaktuar nevojat urgjente, shëndetësore dhe të sigurisë që janë të rëndësishme për viktimën. Ndalimi i viktimizimit në Ligjin për Dhunën me Bazë Gjinore është shumë i gjerë, duke përfshirë, për shembull, edhe mosveprimet që pa qëllim e vendosin viktimën në një pozitë më të pafavorshme (Neni 6). Ky "ndalim" duket kryesisht aspirues, pasi nuk parashihen sanksione për shkeljen e tij. Dispozita e Konventës së Stambollit nuk kërkon domosdoshmërisht ndalim ose sanksione për viktimizimin, por kërkon që shtetet të sigurojnë mbrojtje efektive për viktimat nga frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur. Mënyrat përmes të cilave mund të arrihet kjo nuk janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar. Për shembull, Direktiva për të Drejtat e Viktimave parashikon masa për mbrojtjen fizike të viktimave dhe anëtarëve të familjes së tyre, përfshirë strehimin dhe akomodimin e përkohshëm, si dhe krijimin e sistemeve të drejtësisë restauruese të sigurta dhe profesionale për të parandaluar viktimizimin e dytë apo të përsëritur.

[225] LMDHF, Neni 7.2.
[226] LMDHF, Neni 19.2.
[227] Neni 63.1.3.1.
[228] PSV-të i referohen Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, prandaj ky term përdoret këtu. Vlen të përmendet se emri i saj ka ndryshuar dhe tani quhet Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV)).
[229] Neni 8.
[230] PSV-të për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, f. 29. Shih gjithashtu Shtojcën 8 (Lista e Kontrollit për Vlerësimin e Rrezikut),2013.

Masat e përgjithshme	
KS, DV, and DHGDHF	Kosova
*T'u sigurohen viktimave **shërbime mbështetëse të përshtatshme** në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedurave gjyqësore, në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten dhe të merren parasysh siç duhet* (KS, Neni 56e).	Të gjitha viktimat e veprave penale kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet mbështetëse për viktimat (KPP, neni 63.1.18) dhe mund të kërkojnë ndihmë nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV) (Procedurat Standarde të Veprimit– PSV-të).

Raportimi	
KS, DV, dhe DHGDHF	Kosova
*Të sigurohet që viktimat të mund të **raportojnë** aktet e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje përmes kanaleve të qasshme, të lehta për t'u përdorur, të sigurta dhe lehtësisht të disponueshme (DHGDHF, Neni 14.1).*	Raportimet mund të bëhen personalisht; me telefon përmes numrit emergjent (192) ose numrit jo emergjent (038 550 999); dhe me email (info@kosovopolice.com).
*Të paktën për krimet kibernetike që përfshihen në fushëveprimin e Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF), duhet të mundësohet **raportimi online** (DHGDHF, Neni 14.1).*	Raportimi i vetëm online aktualisht është përmes emailit. Ndërsa ka ekzistuar një aplikacion, Lajmëro Policinë [Inform Police], ai nuk ishte funksional që nga gushti 2025.[231]
*Të sigurohet që raportimi online të përfshijë mundësinë për **paraqitjen e provave** (DHGDHF, Neni 14.1).*	Dëshmitë mund të dorëzohen me email.
*Të merren masat e nevojshme për të nxitur çdo person që është **dëshmitar** i kryerjes së akteve të dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i Konventës së Stambollit (KS), ose që ka arsye të bazuara për të besuar se një akt i tillë mund të kryhet apo se priten akte të tjera dhune, që ta **raportojë** këtë pranë organizatave ose autoriteteve kompetente, pa frikë nga pasojat negative (KS, Neni 27; DHGDHF, Neni 14.3).*	Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPK) sanksionon penalisht personin që ka dijeni, por nuk raporton përgatitjen e një vepre penale (nëse ajo vepër kryhet ose tentohet të kryhet) (Neni 377.1) dhe mosraportimin e veprave penale (Neni 378). Parashikohen dënime më të rënda për mosraportimin e disa veprave të caktuara (Neni 377.2). Ekziston një përjashtim, por ai nuk zbatohet për veprat që përfshijnë abuzim ndaj fëmijëve dhe dhunë në familje (Nenet 377.3 dhe 378.3). Prandaj, ekziston një detyrim ligjor për raportim nëse një person ka dijeni për dhunë në familje, pavarësisht marrëdhënies. Gjithashtu, ekzistojnë detyrime specifike shtesë për të raportuar çdo formë dhune fizike ose mendore, keqtrajtim, braktisje, abuzim, neglizhencë dhe shfrytëzim të fëmijëve, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (Neni 26).
*Të sigurohet që **rregullat e konfidencialitetit** për profesionistët të mos përbëjnë pengesë për mundësinë e raportimit, nëse ata kanë arsye të bazuara për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune dhe se priten akte të tjera serioze dhune (KS, Neni 28), ose nëse ekziston rrezik i menjëhershëm për dëmtim fizik (DHGDHF, Neni 14.4), apo nëse një fëmijë ka pësuar dëmtim të rëndë fizik (DHGDHF, Neni 14.5).*	Nuk ekziston asnjë përjashtim nga kërkesat e mësipërme për profesionistët që janë subjekt i rregullave të konfidencialitetit. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës kërkon në mënyrë të qartë që profesionistët, si mjekët, psikologët, punëtorët socialë dhe mësimdhënësit, të raportojnë çdo dyshim për dhunë ose abuzim ndaj fëmijëve (Neni 26.3).
*Kur fëmijët **raportojnë dhunë**, të sigurohet që procedurat e raportimit të jenë të sigurta, konfidenciale, të dizajnuara dhe të qasshme në një mënyrë miqësore për fëmijët. Nëse personi që ushtron përgjegjësinë prindërore është i*	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës parasheh "drejtësi miqësore për fëmijët" (që nënkupton drejtësi të përshtatshme për moshën, të shpejtë, të kujdesshme, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijës) në procedurat penale, civile ose administrative dhe përcakton të drejtën për

[231] RrGK ka kërkuar informata lidhur me këtë rast nga Policia e Kosovës gjatë korrikut dhe gushtit 2025, respektivisht, por nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

Raportimi	
KS, DV, dhe DHGDHF	Kosova
përfshirë në aktin e dhunës, duhet të sigurohet që raportimi të mos varet nga pëlqimi i tij/saj dhe që masat mbrojtëse të ndërmerren përpara se ai/ajo të njoftohet (DHGDHF, Neni 14.6).	ndihmë juridike falas për fëmijët (që përfshin këshillim dhe përfaqësim ligjor) (Nenet 55 dhe 56). Ligji përcakton se, kur prindi, anëtari i familjes apo kujdestari nuk e mbron fëmijën ose e vë atë në rrezik nga ndonjë formë dhune apo shfrytëzimi, institucioni komunal kompetent është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës (Neni 35.3). Ligji mund të harmonizohet më mirë me DHGDHF-në duke përcaktuar procedura specifike për mbrojtjen e fëmijëve përpara se prindi apo kujdestari i përfshirë në aktin e dhunës të njoftohet për raportimin e fëmijës.

Intervistimi	
KS dhe DV	Kosova
Të mbrohen viktimat gjatë hetimit penal, duke zhvilluar intervistat me viktimën ***pa vonesa të pajustifikuara*** *pas paraqitjes së ankesës, duke e kufizuar* ***numrin e intervistave në minimum****, duke lejuar që viktima të* ***shoqërohet*** *nga një përfaqësues/e ligjor/e ose person i zgjedhur prej saj,* ***dhe duke kryer ekzaminime mjekësore vetëm kur janë rreptësisht të nevojshme*** *(DV, Neni 20).*	KPP-ja i transpozon këto kërkesa (Nenet 127.6, 127.7 dhe 142.4).
Kur vlerësimi individual e konsideron të nevojshme, intervistat me viktimën duhet të zhvillohen në ***hapësira të dizajnuara ose të përshtatura për nevojat e viktimave****, të realizohen nga ose përmes profesionistëve të trajnuar për këtë qëllim, dhe të kryhen nga i njejti* ***personel,*** *përveç në rastet kur kjo është në kundërshtim me administrimin e drejtë të drejtësisë (DV, Nenet 23.2(a) – 23.2(c)*	Kjo kërkesë është e parashikuar në Ligjin për Dhunën me Bazë Gjinore (Neni 19.10). Vëzhgimet e RrGK sugjerojnë se aktualisht të gjitha stacionet policore kanë të paktën një dhomë në secilin stacion policor.
Të gjitha intervistat me viktimat e dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore apo dhunës në marrëdhënie të afërta, përveç nëse zhvillohen nga prokurori ose gjyqtari, duhet të zhvillohen nga një ***person i gjinisë së njëjtë me viktimën****, nëse viktima e kërkon këtë, me kusht që procesi penal të mos paragjykohet (DV, Neni 2(d))*	KPP-ja e transpozon këtë kërkesë (Neni 127.8).
Të mundësohet që viktimat, në përputhje me rregullat procedurale të legjislacionit të brendshëm, ***të dëgjohen****, të paraqesin prova dhe që pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre të paraqiten, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi, dhe të merren parasysh (KS, Neni 56(d); DV, Neni 10)*	KPP-ja i transpozon këto kërkesa (Neni 63.1.8).

Informacioni	
KS dhe DV	Kosova
Të informohen viktimat në kontaktin e parë për (DV, Neni 4): ○ *procedurat e paraqitjes së ankesave;* ○ *qasjen në këshillim ligjor, ndihmë juridike dhe çdo lloj këshillimi tjetër, përfshirë përkthimin dhe interpretimin;* ○ *mënyrën dhe kushtet në të cilat mund të përfitojnë kompensim;* ○ *procedurat e ankesave në rastet kur të drejtat e tyre nuk respektohen nga autoritetet kompetente që veprojnë në kuadër të procedurave penale;* ○ *të dhënat kontaktuese për komunikim në lidhje me rastin e tyre;* ○ *shërbimet e drejtësisë restauruese që janë në dispozicion;* ○ *mënyrën dhe kushtet në të cilat shpenzimet e bëra si rezultat i pjesëmarrjes në procedurat penale mund të rimbursohen.;* ○ *si dhe në ç'mënyrë dhe në çfarë kushte mund të rimbursohen shpenzimet që janë shkaktuar si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në procedurat penale.*	KPP-ja i transpozon këto kërkesa (Neni 63.1.3). Gjithashtu, sipas Ligjit për Dhunën me Bazë Gjinore, mbrojtësit e viktimave (AV), policia dhe shërbimet mbështetëse janë të detyruara të informojnë viktimat për të drejtat e tyre (Nenet 16.1.2; 19.4; 22.1.1).

Informacioni	
KS dhe DV	Kosova
Të informohen viktimat për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion, si dhe për v**eprimet pasuese lidhur me ankesën e tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimeve** ose procedurave dhe roli i tyre në to, si dhe për **rezultatin** e rastit (KS, Neni 56(c)), përfshirë (DV, Neni 6): ○ *vendimin për të mos vazhduar apo për të përfunduar hetimin, ose për të mos ndjekur penalisht të dyshuarin;* ○ *kohën dhe vendin e gjykimit dhe natyrën e akuzave;* ○ *çdo aktgjykim përfundimtar;* ○ *gjendjen e procedurave penale.*	Dispozita të ndryshme të KPP-së i transpozojnë pjesërisht këto kërkesa (Nenet 63.1.3.1, 63.1.9 dhe 371.6). Viktimat nuk e kanë të përcaktuar shprehimisht të drejtën për të marrë informata mbi ecurinë e përgjithshme të hetimeve apo procedurave në KPP. Megjithatë, ekziston e drejta për të inspektuar dosjen e rastit (Neni 212). Po ashtu, policia tani është e detyruar të "sigurojë kontakt zyrtar" me viktimën (LMDHF, Neni 19.4.9) dhe, nëse ekziston një dyshim i bazuar mirë për dhunë në familje, policia duhet ta njoftojë rregullisht viktimën për ecurinë e hetimeve (LMDHF, Neni 19.7).
*Për të ndihmuar në sigurimin vullnetar të provave, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale, **viktimat duhet të drejtohen** pa vonesë të panevojshme te profesionistët përkatës shëndetësorë ose shërbimet mbështetëse që janë të specializuara në ndihmën për sigurimin e provave, dhe të informohen për rëndësinë e mbledhjes së këtyre provave sa më herët që të jetë e mundur (DHGDHF, Neni 15.4).*	Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale parasheh që, nëse jemi brenda afateve kohore për mbledhjen e provave përmes ekzaminimit fizik, policia duhet t'ia shpjegojë viktimës rëndësinë e mbledhjes së provave dhe, pas marrjes së pëlqimit të informuar, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta shoqërojë viktimën (faqe 48)
*Të sigurohet që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktimat dhe familjet e tyre mund të jenë në rrezik, **kur autori i veprës penale arratiset ose lirohet përkohësisht apo përfundimisht** (KS Neni 56(b); DV, Neni 6.5).*	KPP-ja i transpozon këto kërkesa (Neni 63.1.9)

Të drejtat procedurale	
KS dhe DV	Kosova
*Të sigurohet që viktimat të kenë të drejtën për **të kërkuar rishikimin e një vendimi për mos-ndjekje penale** (DV, Neni 11)*	KPP-ja e transpozon këtë kërkesë (Neni 82.8).
*Të sigurohet që të mund të ndërmerren masa për **mbrojtjen e privatësisë** dhe imazhit të viktimës (KS, Neni 56(f); DV, Neni 21).*	KPP-ja parashikon këtë mbrojtje (Neni 217). Kërkesat për anonimitet mund të parashtrohen në çdo fazë, kur ekziston rrezik serioz për palën e dëmtuar, dëshmitarin apo anëtarët e familjes.
*Të sigurohen viktimat me **përkthyes të pavarur** dhe kompetentë kur ato janë palë në procedura ose kur po ofrojnë prova (KS, Neni 56(h); DV, Neni 7), dhe të sigurohet që viktimat të mund të paraqesin ankesën në një gjuhë që e kuptojnë ose të marrin ndihmën gjuhësore të nevojshme (DV, Neni 5.2)*	KPP-ja përmban të drejtën për interpretim "në një cilësi të mjaftueshme për të garantuar drejtësinë e procedurës" (Neni 14.2). Ajo përfshin një të drejtë të re për viktimat për interpretim gjatë intervistimit dhe marrjes në pyetje (Neni 63.1.12), për paraqitjen e një kërkese apo ankese në një gjuhë që e kuptojnë ose me ndihmë gjuhësore (Neni 63.1.13), si dhe për përkthimin e informacionit thelbësor për ushtrimin e të drejtave të tyre në procesin penal (Neni 63.1.14).
*Të sigurohet që **kontakti** midis viktimave dhe autorëve brenda ndërtesave të gjykatave dhe institucioneve të zbatimit të ligjit të **shmanget** sa herë që është e mundur*	KPP-ja ka parashikuar mundësinë që viktima ose dëshmitari/ja të dëshmojnë në një seancë të mbyllur për publikun, ose nga një vend tjetër përmes mjeteve teknologjike (Neni 337).

Të drejtat procedurale	
KS dhe DV	Kosova
*(KS, Neni 56(g); DV, Neni 19), dhe të mundësohet që viktimat të **dëshmojnë,** sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishme fizikisht ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit (KS, Neni 56(i); DV, Neni 23.3).*	
*Të sigurohet e **drejta për asistencë** ligjore dhe **ndihmë juridike falas** për viktimat, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm (KS, Neni 57; DV, Neni 13).*	KPP-ja e transpozon këtë dispozitë saktësisht, pa ndonjë kufizim si vlerësim individual bazuar në nevoja apo burime (Neni 63.1.15). Megjithatë, përpjekja për transpozimin e DV-së duket se nuk ka marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme aspektet praktike të zbatimit të këtyre të drejtave. BE-ja e ka kritikuar këtë dispozitë për ndihmë juridike në KPP, duke e cilësuar si "të pamjaftueshme në praktikë për të përmbushur detyrimet e legjislacionit përkatës të Kosovës dhe kërkesat e acquis të BE-së dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencës së saj".[232] LMDHF-ja tani parashikon gjithashtu që institucionet duhet të ofrojnë ndihmë dhe përfaqësim ligjor falas gjatë procedurave civile dhe penale (Neni 22.1.4). E drejta sipas KS-së dhe Direktivës nuk nënkupton ndihmë automatike ligjore falas, pasi shtetet duhet të sigurojnë kushte për qasje në të. Ligji për Ndihmë Juridike Falas (Nr. 04/L-017) ofron më shumë detaje mbi kriteret për aplikim për ndihmë. Sipas Nenit 64 të KPP-së, viktimat kanë të drejtë të përfaqësohen nga një anëtar i Odës së Avokatëve ose nga një Mbrojtës i Viktimave (MV).
*Të sigurohet që **afati parashkrues** për fillimin e procedurave për veprat penale të dhunës seksuale (Neni 36), martesës së detyruar (Neni 37), gjymtimit gjenital të femrave (Neni 38) dhe abortit apo sterilizimit të detyruar (Neni 39) të vazhdojë për një periudhë kohe të mjaftueshme dhe proporcionale me rëndësinë e veprës penale përkatëse, në mënyrë që të mundësohet nisja efektive e procedurave pas arritjes së moshës madhore nga viktima (KS, Neni 58)*	Ligji i Kosovës përcakton që, kur një vepër penale kryhet ndaj një personi nën moshën 18 vjeçare, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë vetëm nga dita kur viktima mbush 18 vjet (KPK, Neni 100.2). Afatet e parashkrimit të ndjekjeve penale në Kosovë përcaktohen në varësi të dënimit maksimal të paraparë për veprën, duke filluar nga katër vjet (për veprat që dënohen me burgim deri në një vit ose me gjobë) deri në 30 vjet (për veprat që dënohen me burgim të përjetshëm) (KPK, Neni 99).

Kompensimet	
KS dhe DV	Kosova
*Të mbrohet viktima nga viktimizimi sekondar dhe i përsëritur, frikësimi dhe hakmarrja gjatë ofrimit të **çdo shërbimi të drejtësisë riparuese** (Neni 12 i Direktivës për Viktimat – DV). Këto shërbime mund të përdoren vetëm me pëlqimin e lirë dhe të informuar të viktimës, i cili mund të tërhiqet në çdo kohë.*	Ndërsa këto shërbime ofrohen në mënyrë joformale, dhe në disa raste nga strehimoret apo punëtorët/et socialë/e, ato nuk janë të përcaktuara në mënyrë të mjaftueshme brenda kuadrit ligjor përkatës.
*Të sigurohet që viktimat të kenë të drejtë të marrin një vendim për **kompensim** nga kryesi i veprës penale*	Kodi i Procedurës Penale (KPP) parasheh të drejtën e viktimave për kompensim të arsyeshëm me vendim

[232] Komisioni Evropian, *Kosovo 2019 Report*, [Në Anglisht], 2019, f. 30.

(Neni 16 i Direktivës për Viktimat – DV) gjatë procedurës penale (sipas Nenit 24 të Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – DHGDHF).	gjykate nga i pandehuri (Neni 63.1.19). Nëse një kompensim i tillë nuk është i mundur, viktima ka të drejtë të kërkojë kompensim nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Neni 63.1.20).

Mbrojtja dhe Mbështetja e Viktimave

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të mbrojnë viktimat nga çdo akt të dhunës.[233] Shumë nga dispozitat e KS në këtë fushë mbivendosen me ato të Direktivës për Viktimat.[234] Sipas parimeve udhëzuese të KS, masat duhet të:

- bazohen në një kuptim gjinor të dhunës ndaj grave, duke vënë në qendër të drejtat e njeriut dhe sigurinë e viktimës;
- përdorin një qasje të integruar që merr parasysh marrëdhënien ndërmjet viktimave, kryerësve të dhunës, fëmijëve dhe mjedisit më të gjerë shoqëror; të shmangin viktimizimin sekondar; të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave viktima të dhunës; dhe
- adresojnë nevojat specifike të personave të cenueshëm.

Theksi i këtij kapitulli të KS është te bashkëpunimi ndërmjet akterëve. Edhe pse policia mund të ketë kontaktin e parë me viktimën, ajo duhet të jetë në gjendje ta referojë viktimën te shërbimet e specializuara mbështetëse, si qendrat për referimin e dhunës seksuale, qendrat e krizës për përdhunim, strehimoret, shërbimet për mbledhjen e provave mjeko-ligjore, mbështetjen psikologjike dhe/ose këshillimin ligjor.[235] Këto hapa shpesh i vënë viktimat në kontakt me avokatë, Mbrojtësit e Viktimave (MV) apo me gjykatat.

Ashtu si në rastin e vlerësimit individual të rrezikut, autoritetet duhet të bashkëpunojnë, kur është e përshtatshme, për të ofruar shërbime mbështetëse, ndërsa vlerësimi duhet të rishikohet rregullisht. Duhet të sigurohet që shërbimet mbështetëse të kontaktojnë viktimat për t'u ofruar ndihmë dhe mbështetje, nëse nevojat janë identifikuar ose kërkuar nga vetë viktima, duke respektuar sigurinë dhe me pëlqimin e saj/tij.[236]

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore kërkon që zyrtarët/et në institucionet e mbrojtjes sociale, punëve të brendshme, shëndetësisë, mbrojtjes së fëmijëve dhe arsimit, si dhe gjykatat, "të veprojnë me urgjencë, duke i dhënë përparësi të avancuar interesave dhe nevojave të viktimës."[237] Qendrat për Punë Sociale (QPS) duhet të caktojnë një menaxher/e rasti për secilën viktimë për identifikimin, koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Pas vlerësimit të situatës në aspektin e mbrojtjes sociale dhe integrimit, QPS-të kanë një sërë detyrimesh që përfshijnë referimin e viktimës në një program rehabilitimi dhe punësimi, ofrimin e strehimit të përkohshëm, referimin ose ofrimin e këshillimit psikosocial për viktimat dhe personat në varësi të tyre, koordinimin e aktiviteteve për riintegrim dhe referimin e viktimave në skemat e asistencës sociale nëse ato nuk kanë të ardhura.[238]

[233] Neni 18.
[234] Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 25 tetor 2012, për vendosjen e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/220/GBS (JHA).
[235] Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi114.
[236] DHGDHF, Neni 18.1
[237] LMDHF, Neni 5.3.
[238] LMDHF, Neni 21.1.

Urdhërat Mbrojtës

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të bëjnë të disponueshme **urdhërat mbrojtëse** për viktimat e të **gjitha** formave të dhunës të mbuluara nga Konventa.[239] Këta urdhëra duhet të jenë të vlefshëm pavarësisht nga ndonjë procedurë tjetër ligjore. Shtetet duhet të sigurojnë që autoritetet përkatëse të kenë kompetencë ligjore për të lëshuar **urdhëra të menjëhershëm ndalimi** në raste të rrezikut të menjëhershëm që rrjedh nga **dhuna në familje**.[240] Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje po ashtu parasheh lëshimin e urdhërave të menjëhershëm të ndalimit, urdhërave të ndalimit dhe urdhërave mbrojtës për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Direktiva.[241]

Më parë, korniza ligjore e Kosovës e kufizonte mundësinë e lëshimit të urdhërave mbrojtës vetëm për viktimat e dhunës në familje. Kjo është adresuar me miratimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, i cili parashikon që urdhërat mbrojtës mund të kërkohen për raste të "dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore". Megjithatë, urdhërat e përkohshëm, të cilët lëshohen kur gjykatat janë të mbyllura, vazhdojnë të kufizohen vetëm për rastet e dhunës në familje — ndonëse kjo është në përputhje me Konventën e Stambollit. Direktiva për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje kërkon që viktimat të informohen për mundësinë e lëshimit të urdhërave mbrojtës, si dhe për mundësinë e njohjes ndërkufitare të këtyre urdhërave.[242] Kodi i Procedurës Penale parashikon që viktimat të informohen se si dhe në çfarë kushtesh mund të sigurojnë mbrojtje, përfshirë masat mbrojtëse."[243] Lëshimi i një urdhri nuk pengon fillimin e procedurës penale.[244] Përfshen tri forma të urdhërave mbrojtës:

- Urdhërat e Rregullt Mbrojtës (UM-të), lëshohen me vendim gjykate për të ofruar masa mbrojtjeje për viktimën. Urdhrat mund të lëshohen deri në 12 muaj dhe mund të zgjaten deri në 24 muaj, pas së cilës aplikuesi/ja mund të parashtrojë një kërkesë të re.
- Urdhërat e Menjëhershëm Mbrojtës (UMM-të), lëshohen nga gjykata përmes një procedure të përshpejtuar për të ofruar mbrojtje të menjëhershme.
- Urdhërat e Përkohshëm të Menjëhershëm Mbrojtës (UPMM-të), lëshohen nga policia jashtë orarit të punës së gjykatave dhe vlejnë deri në ditën e parë të punës së gjykatës.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kishte shprehur shqetësim për mungesën e dallimit ndërmjet UM-së dhe UMM-së në ligjin e mëparshëm, gjë që shkaktonte konfuzion për viktimat dhe gjykatat.[245] LMDHF e ka sqaruar këtë:

- **UM-të** Lëshohen nga gjykata themelore lokale me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe për mbrojtjen e sigurisë dhe mirëqenies së palës së mbrojtur dhe personave në marrëdhënie

[239] Neni 53.
[240] Neni 52.
[241] DHGDHF, Neni 19.
[242] DHGDHF, Neni 19.4.
[243] KPK, Neni 63.1.3.3.
[244] LMDHF, Neni 26.2.
[245] OSBE, "Adjudication of petitions for protection orders in domestic violence cases in Kosovo", [Në Anglisht], 2012, f. 23.

familjare me të [sic]".[246] Përmes urdhrit, gjykata "synon të shmangë pasojat dhe ... rrethanat që ndikojnë ose mund të ndikojnë në përsëritjen e dhunës".[247] Vendimet duhet të merren brenda 15 ditëve nga kërkesa. Personat përgjegjës duhet të thirren në seancë, por ajo mund të mbahet në mungesë të tyre nëse janë thirrur në mënyrë të rregullt dhe kërkesa bazohet në prova të mjaftueshme. Vendimet mund të apelohen në Gjykatën e Apelit brenda tetë ditëve, dhe urdhri mbetet në fuqi gjatë shqyrtimit të ankesës.

- UMM-të lëshohen nga gjykata themelore lokale kur gjykata "dyshon se në mungesë të kësaj mase, pala përgjegjëse paraqet një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur".[248] Vendimet duhet të merren brenda 24 orëve nga kërkesa. Vendimi jepet pa seancë, vetëm mbi bazën e materialit dhe provave të dorëzuara. Çdo palë mund të kundërshtojë vendimin brenda tre ditëve. Nëse nuk ka kundërshtime, ai bëhet UM. Nëse paraqitet kundërshtim, duhet të mbahet një seancë brenda shtatë ditëve. Seanca duhet të përfundojë me lëshimin e një UM-je ose me anulimin e UMM-së; të dyja vendimet mund të apelohen.

- Për UPMM-të, Supervizori Rajonal për Dhunë në Familje ose Shefi/ja i/e Hetimeve në një stacion policor duhet të konfirmojnë se (1) ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer ose kërcënuar dhuna në familje; (2) pala përgjegjëse paraqet "rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose një personi me të cilin pala e mbrojtur ka marrëdhënie familjare"; dhe (3) UPMM është e nevojshme për të siguruar shëndetin apo mirëqenien e palës së mbrojtur ose personit me të cilin ka marrëdhënie familjare.[249]

Për dallim nga KS, DHGDHF liston masat që duhet të jenë të përfshira në urdhërat mbrojtës. Këto përfshijnë: largimin e dhunuesit/ës nga banesa e viktimës apo varësve të saj; ndalimin e hyrjes në banesë; ndalimin e afrimit brenda një distance të caktuar; ndalimin e hyrjes në vendin e punës së viktimës; ose kontakti me viktimën apo personat në varësi të saj.[250] LMDHF parasheh që këto masa, ndër të tjera, mund të jepen në UM-të dhe UMM-të:

- Ndalimi i ushtrimit të dhunës detyron palën përgjegjëse të ndalojë dhe të mos përsërisë asnjë veprim të dhunshëm.
- Mbrojtja nga shqetësimi ndalon palën përgjegjëse të "ngacmojë, shqetësojë, manipulojë, fyejë, kërcënojë, përgjojë ose monitorojë palën e mbrojtur dhe personat në marrëdhënie familjare me të, drejtpërdrejt, përmes palëve të treta apo çdo mjeti tjetër komunikimi".
- Ndalimi i afrimit me palën e mbrojtur, personat në marrëdhënie familjare me të dhe vendet që ata frekuentojnë (kur ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës). Monitorimi elektronik kryhet nga policia.

[246] LMDHF, Neni 45.1.
[247] LMDHF, Neni 45.2.
[248] LMDHF, Neni 46.1.
[249] LMDHF, Neni 52.3.
[250] DHGDHF, Neni 19.1.

- **Largimi nga hapësira e banimit**, kur viktima është anëtare e familjes që jeton me personin përgjegjës.
- **Shoqërimi** i palës së mbrojtur (nga një officer/e policie dhe punëtor/e social/e) ër ta ndihmuar në marrjen e gjërave personale kur ajo vendos të largohet nga vendbanimi.
- **Konfiskimi** i sendeve të përdorura për kryerjen e veprës, ose që mund të përdoren për përsëritjen e dhunës, përfshirë ndalimin ose revokimin e lejes për armë.
- **Caktimi i përkohshëm i kujdestarisë** në rastet e dhunës në familje, me kusht që të respektohet interesi më i lartë i fëmijës. Diskrecioni është i kufizuar kur dhuna është ushtruar ndaj fëmijës.
- **Mbajtja financiare**, që mund të përfshijë ushqimin e fëmijës, qiranë dhe shpenzime të tjera të arsyeshme jetese.
- **Trajtimi psikosocial ose mjekësor** për varësitë nga substancat për personat përgjegjës.
- **Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik** për personat përgjegjës, kur dhuna është kryer "në gjendje të paaftësisë mendore ose me aftësi ndjeshëm të reduktuara mendore", dhe kur ekziston rrezik që dhuna të përsëritet.
- **Ndalimi i transaksioneve me pronë**, përfshirë transferimet, ngarkesat apo çdo transaksion tjetër për pronën e specifikuar.
- **Masa të tjera të nevojshme, të cilat mund të përfshijnë urdhërimin e palës përgjegjëse** që t'i lejojë palës së mbrojtur përdorimin e pasurisë ku palët jetojnë bashkë, ose që është në pronësi të përbashkët apo të ndarë, si edhe mundësinë që pala e mbrojtur të kthehet në shtëpi.[251]

Këta shembuj nuk janë gjithëpërfshirës. Masat që mund të vendosen në kuadër të Urdhrave të Përkohshëm dhe të Menjëhershëm Mbrojtës kufizohen në pikat 1–6 të përmendura më sipër. Këto masa janë, në përgjithësi, të ngjashme me ato që ishin paraparë në Ligjin e mëparshëm për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF). Bazuar në monitorimin e rasteve të urdhërave mbrojtës gjatë periudhës 2021–2024, janë vërejtur përmirësime në praktikë, me zbatim më të qëndrueshëm të masave mbrojtëse. Në veçanti, gjykatat kanë urdhëruar largimin e kryesve të dhunës nga shtëpia, pagesën e qirasë dhe ushqimit për viktimat, si edhe përfshirjen e tyre në trajtim psikosocial, ndër masa të tjera mbështetëse.[252] Udhëzimet administrative për rregullimin e zbatimit të trajtimit psikosocial dhe trajtimit mjekësor për varësinë nga substancat u prezantuan në kuadër të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF), por u kritikuan për mospërkushtim të mjaftueshëm ndaj personave të mbrojtur, mungesë detajimi në vlerësimin e trajtimit, theksim të tepruar të pajtimit, dhe për mundësinë e konfliktit me qëllimet e LMDHF-së.[253] Trajtimi i detyrueshëm rehabilitues për personat që kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogave mund të imponohet gjithashtu edhe për vepra të tjera penale sipas Kodit të Procedurës Penale.[254] Megjithatë, Kosova historikisht ka mungesë të infrastrukturës së financuar nga shteti dhe programeve të veçanta të ndërhyrjes për kryesit e dhunës në familje dhe kryesit e veprave seksuale, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit, gjë që ka penguar

[251] LMDHF, Nenet 29 – 41.
[252] Bazuar në monitorimin e rasteve gjyqësore dhe referimet e rasteve që janë paraqitur në zyrën e RrGK-së.
[253] Farnsworth et al. për RrGK Mjaft më me Arsyetime, f. 12.
[254] Kapitulli XXXII.

zbatimin e këtyre masave.[255] Ministria e Drejtësisë themeloi një program në vitin 2023 për kryesit e dhunës, por ai ende nuk ofron shërbime në të gjithë territorin e Kosovës.[256] Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, një program pilot është iniciuar në Qendrën Korrektuese të Dubravës, i cili përfshin të burgosur që, ndër të tjera, kanë kryer vepra të dhunës në familje. Programi po mbështetet nga KE dhe është zhvilluar në dy faza pilotuese: e para me një grup prej 12 të burgosurish dhe e dyta me 10 të burgosur.[257] Në vitin 2025, Ministria ka planifikuar ta zgjerojë programin pilot për të përfshirë edhe Shërbimin e Provës dhe strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje, stafi i të cilave do të trajnohet për zbatimin e programit për kryesit e dhunës. Një nga sfidat e identifikuara gjatë zbatimit të programit në institucionet korrektuese është dënimi relativisht i shkurtër i kryesve të dhunës me bazë gjinore, pasi shumë prej tyre marrin dënime me burgim më pak se gjashtë muaj, ndërkohë që programi i plotë është projektuar të zgjasë gjashtë muaj, duke e bërë të vështirë pjesëmarrjen e plotë nën praktikat aktuale të dënimit. Policia duhet t'i monitorojë rregullisht urdhërat mbrojtës, pasi shkelja e tyre përbën vepër penale për të cilën kryesi duhet të ndiqet menjëherë penalisht, pa qenë e nevojshme paraqitja e ndonjë ankese nga viktima.[258] Përsëritja e shkeljeve konsiderohet si rrethanë rënduese që ndikon në ashpërsimin e dënimit.[259] Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) përcakton që çdo shkelje e një urdhri mbrojtës duhet të sanksionohet me masa ndëshkuese efektive, proporcionale dhe dekurajuese, qofshin ato penale apo jo-penale.[260] Viktimat duhet të njoftohen kur ndodh një shkelje e urdhrit të menjëhershëm të ndalimit, urdhrit kufizues apo urdhrit mbrojtës, nëse ajo mund të ndikojë në sigurinë e tyre,[261] dhe në rast të një shkeljeje, duhet të rishikohet vlerësimi individual i rrezikut të viktimës.[262] Kjo ende nuk është trajtuar në mënyrë të mjaftueshme në Procedurat Standarde të Operimit. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore parasheh që një urdhër mbrojtës i lëshuar nga një shtet tjetër mund të regjistrohet në gjykatë dhe më pas të zbatohet sikur të ishte lëshuar sipas këtij ligji.[263]

Shërbimet Mbështetëse

Tabela në vijim përmbledh shërbimet mbështetëse të parashikuara nga Konventa e Stambollit, Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje, si edhe nga Direktiva për Viktimat, si dhe nivelin në të cilin këto shërbime janë të zbatueshme në Kosovë.

Shërbimet Mbështetëse	
KS, DV, dhe DHGDHF	**Kosova**
Të sigurohet që viktimat të marrin **informata** të mjaftueshme dhe në kohë lidhur me shërbimet mbështetëse dhe masat ligjore, të komunikuara në gjuhë	Kjo e drejtë është e transpozuar në Kodinin e Procedurës Penale (nenet 63.1.3.1 dhe 63.1.10). Kërkesat e veçanta të Direktivës së BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) pasqyrohen pjesërisht në Protokollin

[255] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në Anglisht], 2017, ff. 76-77.
[256] RrGK dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) janë duke monitoruar zbatimin e programit (raporti pritet të publikohet).
[257] Numrat nga MD (koment mbi draft-raportin gjatë procesit të rishikimit nga kolegët).
[258] LMDHF, Neni 54.
[259] LMDHF, Neni 542.
[260] DHGDHF, Neni 19.5.
[261] DHGDHF, Neni 19.6.
[262] DHGDHF, Neni 19.2.
[263] LMDHF, Neni 56. Gjykatat mund të refuzojnë njohjen e urdhërave mbrojtës të huaj në rrethana të caktuara (neni 57).

Shërbimet Mbështetëse	
KS, DV, dhe DHGDHF	**Kosova**
të qartë dhe të kuptueshme [264] (KS Neni 19, DV Neni 3 dhe 4). Shërbimet mbështetëse të specializuara duhet të përfshijnë (sipas Nenit 25.1 të Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – DHGDHF)): • Informata dhe mbështetje për **çështje praktike**, duke përfshirë qasjen në strehim, arsim, kujdes për fëmijët, trajnime, mbështetje financiare, këshillim ligjor, ndihmë juridike dhe punësim; • Informata dhe **referim në shërbime që ofrojnë ekzaminime mjekësore dhe mjeko-ligjore**, të cilat mund të përfshijnë shërbime të plota të kujdesit shëndetësor dhe këshillim psikosocial, përfshirë kujdesin ndaj traumës; • Informata dhe referim në **shërbime mbështetëse për gratë**, qendra për viktimat e përdhunimit, strehimore dhe qendra referimi për dhunë seksuale; si dhe mbështetje për mënyrën se **si të dokumentohen** krimet kibernetike dhe informata mbi mjetet juridike për heqjen e përmbajtjeve online; • Informata dhe **referim në shërbime mbështetëse të specializuara** për viktimat në rrezik të shtuar nga dhuna, që mund të përfshijnë shërbime për rehabilitim dhe integrim socio-ekonomik pas shfrytëzimit seksual.	Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
Përveç nëse është në kundërshtim me interesat e viktimës ose nëse rrjedha e procedurës do të paragjykohej, të **lejohet që viktimat të shoqërohen nga një person i zgjedhur** prej tyre gjatë kontaktit të parë me autoritetin kompetent, kur, për shkak të ndikimit të krimit, viktima ka nevojë për ndihmë për të kuptuar ose për t'u kuptuar (Neni 3.3 i Direktivës për Viktimat – DV).	Kjo e drejtë është e transpozuar në Kodinin e Procedurës Penale (neni 63.1.6).
Të sigurohet që viktimat të kenë **qasjen në shërbime që lehtësojnë rikuperimin e tyre nga dhuna**, përfshirë këshillimin ligjor dhe psikologjik, ndihmën financiare, strehimin, arsimin, trajnimin dhe ndihmën në gjetjen e punës (Neni 20.1 i Konventës së Stambollit – KS; Nenet 8 dhe 9 të Direktivës për Viktimat – DV)	Programet e rehabilitimit dhe riintegrimit për viktimat e dhunës me bazë gjinore mbeten të dobëta në Kosovë.[265] Bashkimi Evropian ka vërejtur nevojën për masa që sigurojnë riintegrim efektiv të viktimave.[266]
Të sigurohet që viktimat të kenë **qasjen në shërbime shëndetësore** dhe sociale që janë të pajisura me burime të mjaftueshme dhe ku profesionistët janë të trajnuar për të ndihmuar viktimat dhe për t'i referuar ato në shërbimet përkatëse (Neni 20.2 i KS). Të sigurohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ofrimin e shërbimeve mbështetëse të	KE raporton për mungesë të trajnimeve dhe kuptimit të mjaftueshëm mbi dhunën me bazë gjinore dhe atë ndërsektoriale ndër profesionistët që punojnë me viktimat, mungesë të procedurave të standardizuara, protokolleve, udhëzuesve apo një kuadri të përbashkët, si dhe mungesë të financimit të mjaftueshëm apo të qëndrueshëm

[264] Viktimat duhet të kenë gjithashtu qasje në mekanizmat përkatës rajonalë dhe ndërkombëtarë për paraqitjen e ankesave individuale ose kolektive (neni 21). Megjithatë, këta mekanizma mund të jenë të kufizuar për qytetarët e Kosovës.

[265] Gavrić, S. për Lobin Evropian të Grave, "Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën kundër Grave dhe Konventën e Stambollit në Kosovë", 2018, f. 18; monitorimi I RrGK.

[266] KE, *Kosovo 2019 Report*, 2019, f. 28; KE, Assessment of the Aligment of Kosovo*'s laws, policies, and other measures with the standards of the Istanbul Convention, [Në Anglisht], 2022.

Shërbimet Mbështetëse	
KS, DV, dhe DHGDHF	**Kosova**
specializuara dhe të sigurohet financim adekuat për OJQ-të që ofrojnë shërbime të tilla të specializuara (Neni 25.3 i Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – DHGDHF).	nga buxhetet qeveritare.[267] Edhe pse është vërejtur përmirësim, monitorimi i RrGK-së tregon se OJQ-të kanë ende nevojë për financim shtesë për të ofruar shërbime të specializuara me cilësi të lartë.[268]
Të sigurohet **shpërndarje e përshtatshme gjeografike**, si dhe shërbime mbështetëse të specializuara afatshkurtra dhe afatgjata, për çdo viktimë që ka përjetuar ndonjë nga aktet e dhunës të mbuluara nga fusha e Konventës së Stambollit, të cilat duhet të përfshijnë shërbime të specializuara për gratë viktima dhe fëmijët e tyre (Neni 22 i KS). Direktiva për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje parashikon sigurimin e shërbimeve për viktimat e dhunës seksuale me kapacitet dhe shpërndarje të mjaftueshme gjeografike (Neni 26.4).	KE raporton se ky standard ende nuk është arritur në Kosovë. Aty ku ekzistojnë shërbime të specializuara, është e rëndësishme që këto shërbime dhe stafi i tyre të jenë të aftë të trajtojnë forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, përfshirë ato që ndodhin jashtë marrëdhënieve familjare.[269]
Të sigurohet që **strehimoret** të jenë lehtësisht të qasshme dhe në numër të mjaftueshëm për të ofruar strehim të sigurt dhe për të ndërvepruar në mënyrë proaktive me viktimat, veçanërisht me gratë dhe fëmijët e tyre (Neni 23 i KS). Raporti Shpjegues i Konventës përcakton që situata e sigurisë e secilës viktimë duhet të vlerësohet dhe të hartohet një plan individual sigurie. Bashkëpunimi efektiv me policinë për çështjet e sigurisë është i domosdoshëm.[270] Strehimoret dhe akomodimet e tjera të përkohshme përkatëse duhet të jenë të pajisura për të plotësuar nevojat specifike të grave (p.sh. strehimore vetëm për gra me hapësirë për fëmijë), duhet të jenë të qasshme për viktimat dhe personat në varësi nën moshën 18 vjeç, pa dallim kombësie, dhe duhet të ndihmojnë viktimat në procesin e rimëkëmbjes duke ofruar kushte të sigurta, të përshtatshme dhe të lehta për t'u arritur për një jetesë të pavarur, si dhe informata për shërbimet mbështetëse dhe referime, përfshirë edhe kujdesin e mëtejshëm mjekësor (Neni 30 i DHGDHF).	KE raporton se ofrimi i strehëzave në Kosovë nuk i përmbush standardet evropiane, sipas të cilave duhet të ketë një vendstrehim familjar për çdo 10,000 banorë. Mungesa e strehimit afatgjatë ose mundësive ekonomike rrezikon që viktimat të detyrohen të kthehen tek dhunuesit.[271] Ekzistojnë mundësi të kufizuara për akomodim të sigurt për gratë me djem mbi moshën 12 vjeçare.[272] LMDHF-ja parashikon financim të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm të strehëzave nga buxheti i Kosovës; kontraktimin e shërbimeve sociale nga OJQ-të e licencuara; si dhe kërkesën që organizimi i strehëzave të përmbushë standardin e KE-së prej një strehëze për çdo 10,000 banorë (Neni 24).
Të sigurohen **qendra urgjente për përdhunim ose qendra referimi** për dhunë seksuale për viktimat, të cilat të jenë lehtësisht të qasshme dhe në numër të mjaftueshëm për të ofruar ekzaminime mjekësore dhe mjeko-ligjore, mbështetje për traumën dhe këshillim për viktimat (Neni 25 i Konventës së Stambollit – KS, Neni 26 i Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – DHGDHF). Këto shërbime duhet të jenë falas dhe të qasshme çdo ditë të javës (Neni 26 i DHGDHF).	Kosova nuk ka shërbime të specializuara për viktimat e dhunës seksuale (si qendra për krizë nga përdhunimi apo qendra referuese për dhunë seksuale); ofruesit e tjerë të shërbimeve i kushtojnë vetëm një pjesë të vogël të punës së tyre çështjeve që lidhen me dhunën seksuale.[273] Qasja në ekzaminime mjeko-ligjore është e kufizuar vetëm në një institucion. Disa shërbime kërkojnë që viktima të paraqesë kallëzim ose të nënshtrohet ekzaminimit mjeko-ligjor për të pasur qasje në shërbime mbështetëse, gjë që mund të

[267] Po aty., p. 37.
[268] Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), në botim, 2025.
[269] Po aty.; dhe Krol, et al., f. 38.
[270] Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Stamboll, 11.V.2011, paragrafi134.
[271] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në Anglisht], f. 76.
[272] Po aty.
[273] Po aty.

Shërbimet Mbështetëse	
KS, DV, dhe DHGDHF	**Kosova**
	pengojë qasjen e viktimave në mbrojtje dhe ndihmë.[274]
Të sigurohen linja telefonike shtetërore 24-orëshe, falas për thirrësit, për të ofruar këshilla dhe mbështetje në mënyrë konfidenciale ose me respektim të anonimitetit të tyre, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga fusha e Konventës së Stambollit (Neni 24 i KS). Këto linja ndihmëse mund të menaxhohen nga shërbime mbështetëse të specializuara (Neni 29 i Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje – DHGDHF). Përveç kësaj, DHGDHF: • nxit shtetet që të ofrojnë linja ndihmëse përmes teknologjive të sigurta dhe të qasshme të komunikimit elektronik (TIK), përfshirë aplikacione online; • kërkon marrjen e masave të duhura për të siguruar që linjat ndihmëse të jenë të qasshme për përdoruesit me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes në gjuhë të lehtë për t'u kuptuar dhe në përputhje me kërkesat e qasshmërisë për shërbimet e komunikimit elektronik të përcaktuara në Aneksin I të Direktivës 2019/882; • kërkon që shtetet të synojnë që këto shërbime të ofrohen në gjuhën që viktimat e kuptojnë, përfshirë përmes përkthimit telefonik; • kërkon që të sigurohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve. Nëse ofrohen nga OJQ-të, shtetet duhet t'u sigurojnë financim të përshtatshëm, duke marrë parasysh përqindjen e shërbimeve të specializuara që tashmë ofrohen nga autoritetet publike; • kërkon që shtetet të synojnë që këto shërbime të mbeten plotësisht funksionale në kohë krize, si gjatë krizave shëndetësore apo gjendjeve të tjera emergjente; dhe • kërkon që shtetet të sigurojnë që përdoruesit të jenë të informuar në mënyrë të përshtatshme për ekzistencën dhe numrin e linjave ndihmëse, përfshirë përmes fushatave të rregullta të ndërgjegjësimit.	Ligji i Kosovës është i harmonizuar me Konventën e Stambollit (KS), por kërkohen masa shtesë për t'u përputhur me Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore parasheh që policia të sigurojë një linjë të veçantë telefonike për raportimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (Neni 19.4.1). Thirrjet duhet të regjistrohen. Një linjë telefonike emergjente duhet të ofrojë informata të sakta, të menjëhershme dhe konfidenciale për mbrojtjen e viktimave, shërbimet në dispozicion për viktimat dhe këshillim telefonik për viktimat e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave, në çdo kohë të ditës dhe në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës (Neni 23). Është miratuar një akt nënligjor, por ky shërbim ende nuk ishte funksional deri në gusht 2025. Zyra për Avokim dhe Ndihmë për Viktima (ZANV) menaxhon një linjë telefonike falas (0800 11 112), e cila është e qasshme 24 orë në ditë.[275] Mbulesa e specializuar e linjës telefonike për forma të dhunës përtej dhunës në familje është e kufizuar.[276] Ajo nuk është në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit, e cila kërkon një linjë të dedikuar për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, të menaxhuar nga operatorë të trajnuar profesionalisht. Gjithashtu, linjat telefonike për Avokim për Viktima dhe ndihmën juridike falas raportohen të jenë të paqëndrueshme dhe në disa raste jashtë funksionit.
Të sigurohet që ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes të marrë parasysh të **drejtat dhe nevojat e fëmijëve dëshmitarë**, duke përfshirë këshillim psikosocial të përshtatshëm për moshën (Neni 26 i Konventës së Stambollit). Mbështetja për fëmijët duhet të jetë e specializuar dhe e përshtatur me moshën, nevojat zhvillimore dhe situatën individuale të fëmijës, duke respektuar gjithmonë interesin më të mirë të fëmijës	Kodi i Procedurës Penale (KPP) parasheh që gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve fëmijë të ndihmojë një psikolog/e apo këshilltar/e fëmijësh (Neni 127.5). Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës po ashtu parashikon trajtim të specializuar mjekësor, duke përfshirë ndihmën psikologjike. Megjithatë, raportohet se pak shërbime mbështetëse ofrojnë

[274] Po aty.
[275] SKMDHF 2016-2020, f. 18.
[276] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në Anglisht], f. 76; Monitorimi i RrGK-së.

Shërbimet Mbështetëse	
KS, DV, dhe DHGDHF	Kosova
(Neni 31 i Direktivës për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje).	mbështetje psikosociale të specializuar dhe të përshtatur për moshën.[277]
Të synohet që shërbimet e specializuara të mbështetjes të mbeten **plotësisht funksionale në kohë krize**, si gjatë krizave shëndetësore apo gjendjeve të jashtëzakonshme.	Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale thekson "rëndësinë e trajtimit me prioritet dhe në mënyrë të koordinuar ndërsektoriale të rasteve të dhunës seksuale, edhe në situata të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, pandemive, etj." dhe përmban rekomandime të përgjithshme për skenarë të tillë, të bazuara në përvojën gjatë pandemisë Covid-19.

Siç ilustron tabela, vazhdon të ketë probleme në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Një çështje kyçe mbetet mungesa e financimit adekuat të shërbimeve mbështetëse.[278] Mungesa e fondeve të mjaftueshme shtetërore paraqet pengesë për rehabilitimin, riintegrimin dhe fuqizimin afatgjatë të viktimave.[279] Për të zbatuar Konventën e Stambollit, Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje dhe Direktivën për të Drejtat e Viktimave, kuadri ligjor i Kosovës duhet të përfshijë në mënyrë më të plotë këto shërbime, duke mundësuar përcaktim më të qartë të përgjegjësive për financimin e tyre.

Masat për Parandalimin e Dhunës

Në përgjithësi, të gjitha reagimet e hershme ligjore ndaj dhunës ndaj grave u përqendruan kryesisht në sferën penale, pa adresuar shkaqet rrënjësore të dhunës. Rëndësia e masave parandaluese ka marrë gjithnjë e më shumë theks, siç reflektohet në Kapitullin III të Konventës së Stambollit. Në vazhdimësi shqyrtohen këto masa në kontekstin e Kosovës.

Ndryshimi i Modeleve Shoqërore dhe Angazhimi i Burrave

Duke u mbështetur në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),[280] KS u bën thirrje shteteve të ndryshojnë modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes për të zhdukur "paragjykimet, zakonet, traditat dhe të gjitha praktikat e tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave apo në stereotipet për gratë dhe burrat."[281] Përdorimi i stereotipeve të dëmshme është gjithnjë e më shumë i njohur si një formë diskriminimi ndaj grave që kontribuon në dhunën me bazë gjinore.[282] Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje gjithashtu u vendos shteteve anëtare detyrimin që

[277] Po aty, duke përfshirë monitorimin e RrGK-së.
[278] BE-ja ka pranuar mungesën e sigurimit të financimit të qëndrueshëm për strehimoret në raportin e saj më të fundit për Kosovën (Komisioni Evropian, *Kosovo 2019 Report*, [Në Anglisht], 2019, f. 28).
[279] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo*, [Në Anglisht], f. 82; Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), në botim, 2025.
[280] Edhe pse Konventa CEDAW nuk e ndalon në mënyrë të qartë dhunën ndaj grave, ajo ofron "një kuadër të posaçëm gjinor për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, i cili përfshin dhunën ndaj grave", që i mundëson Komitetit CEDAW ta interpretojë dhunën ndaj grave si një formë të diskriminimit ndaj tyre dhe ta zbatojë këtë në punën e vet (Šimonović, D., "Global and Regional Standards on Violence Against Women: The Evolution and Synergy of the CEDAW and Istanbul Conventions" [Në anglisht], Human Rights Quarterly, 36, 2014, f. 590).
[281] Neni 12.
[282] Cook, R. dhe Cusack, S., Stereotipet Gjinore: Perspektiva Ligjore Transnacionale, Shtëpia Botuese e Universitetit të Pensilvanisë, 2010

të promovojnë ndryshime në modelet e sjelljes që burojnë nga marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit ndërmjet burrave dhe grave, të cilat bazohen në stereotipe gjinore — veçanërisht në kontekstin e marrëdhënieve seksuale, seksit dhe pëlqimit.[283] Masat parandaluese duhet të miratohen "për të sfiduar stereotipet e dëmshme gjinore, për të promovuar barazinë gjinore, respektin e ndërsjellë dhe të drejtën për integritet personal, si dhe për të inkurajuar të gjithë personat – veçanërisht burrat dhe djemtë – që të shërbejnë si shembuj pozitivë për të mbështetur ndryshime të sjelljes në mbarë shoqërinë".[284] Konventa e Stambollit po ashtu kërkon që shtetet të ndërmarrin masa për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë – veçanërisht burrat dhe djemtë – të kontribuojnë në mënyrë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës.[285] Angazhimi i burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore është bërë një komponent gjithnjë e më i institucionalizuar i punës për barazi gjinore në mbarë botën. Përfshirja efektive e burrave mund të forcohet përmes një qasjeje ndërsektoriale, e cila merr parasysh mënyrën se si ata mund të përjetojnë margjinalizim në bazë të racës, klasës shoqërore, seksualitetit apo faktorëve të tjerë shoqërorë.[286] Megjithatë, përhapja dhe ndikimi joproporcional i dhunës me bazë gjinore ndaj grave, si dhe adresimi i pabarazive gjinore, duhet të trajtohen si përparësi.[287] Angazhimi i burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës ndaj grave duhet të mbështetet në parime feministe dhe të udhëhiqet nga organizatat për të drejtat e grave, me qëllim avancimin e këtyre përpjekjeve.

Konventa e Stambollit kërkon themelimin e programeve që synojnë t'u mësojnë autorëve të dhunës në familje të "adoptojnë sjellje jotëdhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme."[288] Programet e trajtimit duhet të synojnë parandalimin e përsëritjes së dhunës nga autorët/et, veçanërisht nga ata/ato që kanë kryer dhunë seksuale. Megjithatë, gjatë zbatimit të këtyre masave, shtetet duhet të sigurojnë që "siguria, mbështetja dhe të drejtat e njeriut të viktimave të jenë në qendër të vëmendjes dhe që, kur është e përshtatshme, këto programe të hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e specializuara mbështetëse për viktimat."

Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) përmban një detyrim të ngjashëm, por shton se programet duhet të jenë të qasshme për persona që kanë kryer ndonjë vepër të dhunës ndaj grave dhe/ose "vlerësohen si në rrezik për të kryer vepra të tilla." Kjo përfshin edhe persona që ndjejnë nevojën të marrin pjesë, sepse kanë frikë se mund të ushtrojnë dhunë ndaj grave.[289] Bazuar në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore, duhet të nxirren udhëzime administrative që rregullojnë trajtimin psikosocial dhe mjekësor për autorët me varësi nga substancat, të ngjashme me masat që kanë qenë në fuqi më herët nën LMDHF-në e mëparshme.

[283] DHGDHF, Neni 35(1).
[284] DHGDHF, Neni 34(5).
[285] Neni 12.4.
[286] Casey, E., Leek, E., Tolman, R., Allen, C., dhe Carlson, J., "Të sjellësh burrat në dhomë: perceptimet e strategjive efektive për të nisur përfshirjen e burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në një mostër globale", Culture, Health and Sexuality, 19(9), 2017, 979-995, f. 993.
[287] Po aty. Ekzistojnë shqetësime se përfshirja e burrave riprodhon modelet e fuqisë dhe privilegjit të burrave dhe kërcënon udhëheqjen e grave në lëvizje (shih: MenEngage për UNW dhe UNFPA, "Burrat, Maskulinitetet dhe Ndryshimi i Fuqisë: Një dokument diskutimi mbi përfshirjen e burrave në barazinë gjinore nga Pekini 1995 deri në 2015", f. 43)
[288] KS, Neni 16.
[289] DHGDHF, Neni 37(2).

Ndërgjegjësimi, Arsimi dhe Trajnimi i Profesionistëve

Konventa e Stambollit dhe Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje përfshijnë ndërgjegjësimin publik, edukimin dhe trajnimin e profesionistëve në kapitujt e tyre përkatës mbi parandalimin.[290] Po ashtu, edhe Direktiva për të Drejtat e Viktimave thekson disa nga këto aspekte.[291] Ndërgjegjësimi publik duhet të përfshijë fushata të rregullta që adresojnë format e ndryshme të dhunës, të drejtat e grave, barazinë gjinore, të drejtën e grave për të jetuar të lira nga dhuna, qasjet e "tolerancës zero" dhe nisma të tjera përkatëse. Fushatat e veçanta duhet të synojnë përmirësimin e njohurive rreth ligjeve që adresojnë dhunën ndaj grave dhe mjeteve ligjore që janë në dispozicion.[292] Në Kosovë, masat për ngritjen e ndërgjegjësimit duhet të koordinohen nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe të përfshijnë akterë të ndryshëm.[293] Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe të gjitha format e dhunës me bazë gjinore thekson rëndësinë e zhvillimit të fushatave sensibilizuese mbi një gamë të gjerë temash përtej dhunës me bazë gjinore, përfshirë çështje si të drejtat pronësore dhe parandalimi i martesave të hershme. Këto fushata kryesisht bien nën përgjegjësinë e ABGJ-së, Drejtorive të Arsimit, Policisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile. Shumica e tyre planifikohen të zhvillohen gjatë fushatës vjetore "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës ndaj Grave".

Sipas Konventës së Stambollit, arsimi duhet të përfshijë kurrikulat në "të gjitha nivelet" që trajtojnë "barazinë ndërmjet grave dhe burrave, rolet gjinore jo-stereotipike, respektin e ndërsjellë, zgjidhjen paqësore të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale, dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe të drejtën për integritet personal". "Të gjitha nivelet" përfshijnë institucionet joformale arsimore, sportin, kulturën dhe mediat. Arsimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj perspektivës gjinore dhe të përfshijë informacione mbi ligjet që promovojnë të drejtat e grave dhe adresojnë dhunën ndaj tyre.[294] Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) kërkon përdorimin e gjuhës dhe materialeve mësimore që janë miqësore për fëmijët, kur është e përshtatshme, si dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.[295] Materialet arsimore duhet të jenë "të përshtatura me kapacitetet zhvillimore të personave për të cilët janë të destinuara."[296] Një praktikë e mirë është vendosja e një detyrimi ligjor për autoritetet arsimore që të kryejnë "auditime gjinore" të materialeve shkollore, me qëllim sigurimin e heqjes së stereotipeve seksiste dhe diskriminuese.[297] Në Kosovë, kjo masë është e përfshirë në Ligjin për Barazi Gjinore, ndërsa një udhëzues metodologjik mbi "Parandalimin e stereotipeve gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore" është publikuar nga Agjencia për Barazi Gjinore.[298] Megjithatë, Programi për Barazi Gjinore ka theksuar se është bërë pak progres në auditimet gjinore të teksteve shkollore dhe kurrikulave.[299] Në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar nga Ligji për Barazi Gjinore për integrimin e perspektivës gjinore në programet e studimit, Programi për Barazi Gjinore synonte që të paktën

[290] Nenet 13-15.
[291] Neni 26.
[292] Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., "Praktikat dhe Standardet e Mira Ndërkombëtare për Dhunën Kundër Grave dhe Dhunën në Familje", Këshilli i Evropës, 2015, f. 12.
[293] Ligji për Barazinë Gjinore, Neni 8.1.10
[294] Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., f. 12.
[295] DHGDHF, Neni 34(4).
[296] DHGDHF, Neni 35(3).
[297] Përshtatur nga Kapitulli I i Aktit Organik Spanjoll për Masat e Integruara të Mbrojtjes kundër Dhunës Gjinore, 2004.
[298] Neni 21. Gjuha e kësaj dispozite është aspirative dhe duhet të forcohet; ABGJ, "Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore".
[299] ABGJ, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, f. 32.

15 programe të arsimit të lartë ta përfshinin këtë perspektivë në kurrikulat e tyre. Sipas të dhënave të ofruara nga Universiteti i Prishtinës, gjatë vitit akademik 2023/24 janë ofruar gjithsej 16 lëndë me perspektivë gjinore në katër fakultete.[300] Përmirësimi i kësaj gjendjeje përbën një objektiv strategjik të Programit. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore (LMDHF) kërkon që Ministria e Arsimit të përfshijë në kurrikulat parauniversitare tema që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen paqësore të konflikteve, respektimin e diversitetit, njohuritë mbi identitetin gjinor, të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual, përfshirë respektin e ndërsjellë dhe të drejtën për integritet personal.[301] Ministria duhet të organizojë "trajnime bazike dhe profesionale" për stafin arsimor në lidhje me këto tema.[302] LMDHF gjithashtu kërkon që institucionet e arsimit të lartë t'i përfshijnë këto tema në kurrikulat e tyre.[303]

KS kërkon trajnime për profesionistët/et që punojnë me viktima ose autorë/e dhune, mbi parandalimin dhe identifikimin e dhunës, barazinë gjinore, nevojat dhe të drejtat e viktimave dhe të grave të margjinalizuara, vlerësimin e rrezikut, dinamikën gjinore dhe mënyrat për të parandaluar viktimizimin e përsëritur. Kjo duhet të përfshijë bashkëpunim të koordinuar ndërinstitucional për trajtimin e duhur të referimeve. Edhe DV dhe DHGDHF kërkojnë trajnime të tilla.[304] DHGDHF specifikon që trajnimi duhet t'u ofrohet policisë, stafit të gjykatave, gjyqtarëve, avokatëve, profesionistëve të kujdesit shëndetësor (përfshirë pediatër, gjinekologë, obstetër, mami dhe stafin që ofron mbështetje psikologjike), stafit të shërbimeve sociale dhe arsimore, si dhe personave me funksione mbikëqyrëse në vendin e punës.[305]

Procedurat Standarde të Veprimitqë rregullojnë detyrat e profesionistëve në adresimin e dhunës në familje në Kosovë vetëm pjesërisht përputhen me kërkesat e KS-së, pasi nuk trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme format e tjera të dhunës ndaj grave.[306] Historikisht, Agjencia për Barazi Gjinore ka vërejtur se mungesa e trajnimeve adekuate ka penguar zbatimin e duhur të Procedurave Standarde të Operimit për dhunën në familje.[307] Idealja do të ishte të hartoheshin protokolle dhe udhëzime specifike për profesionistët/et që merren me viktimat e të gjitha formave të dhunës të përshkruara në KS, dhe këto masa të mbështeteshin nga trajnime të specializuara, të qëndrueshme dhe sistematike.[308] DHGDHF kërkon që të nxirren udhëzime dhe protokolle për profesionistët/et e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale për identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes së përshtatshme për viktimat, përfshirë referimin te shërbimet përkatëse të mbështetjes dhe shmangien e viktimizimit të dytë.[309] Këto udhëzime dhe protokolle duhet të përcaktojnë mënyrën se si të trajtohen nevojat specifike të viktimave "që janë në rrezik të shtuar për shkak të diskriminimit të përjetuar në bazë të gjinisë apo ndonjë arsyeje tjetër diskriminimi." Udhëzimet duhet të zhvillohen në aspekt të ndjeshëm gjinor, ndaj traumës dhe ndaj fëmijëve, në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve të specializuara, dhe duhet të rishikohen dhe nëse është e nevojshme, të përditësohen për të reflektuar ndryshimet

[300] ABGJ, Raporti i Vlerësimit të Programit për Barazi Gjinore 2020-2024.
[301] LMDHF, Neni 17.1.1.
[302] LMDHF, Neni 17.1.2.
[303] LMDHF, Neni 17.2.
[304] Neni 25.
[305] Nëse trajnimi është i detyrueshëm apo i rekomanduar, si dhe përmbajtja e saktë që duhet të përfshijë trajnimi, përcaktohet në nenin 36 të DHGDHF-së.
[306] Duhaček, D., Branković, B., dhe Miražić, M. për Komitetin FEMM, "Të drejtat e grave në Ballkanin Perendimor", 2019, g. 54.
[307] ABGJ, "Vlerësimi i Niveli të Zbatimit të Procedurave Standarde Operative për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë", 2019, f. 150.
[308] Krol, et al., *Mapping support services for victims of violence against women in Kosovo**, [Në Anglisht], f. 79.
[309] DHGDHF, Neni 25(5) dhe (6).

ligjore dhe praktike. Udhëzime dhe protokolle për identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes së përshtatshme për viktimat kërkohen gjithashtu për ofruesit e kujdesit shëndetësor që ofrojnë kujdes të drejtpërdrejtë mjekësor dhe duhet të mbulojnë "ruajtjen dhe dokumentimin e provave, si dhe dërgimin e mëtejshëm të tyre në qendrat kompetente mjeko-ligjore."

Duke respektuar lirinë e shprehjes dhe pavarësinë, Konventa e Stambollit inkurajon sektorin privat dhe mediat të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave, udhëzimeve dhe standardeve vetërregulluese për të parandaluar dhunën ndaj grave.[310] Pa cenuar lirinë dhe pluralizmin mediatik, DHGDHF kërkon që shtetet të inkurajojnë dhe mbështesin trajnimin e organizatave mediatike dhe institucioneve të tjera përkatëse për të luftuar stereotipet gjinore, paraqitjet seksiste të grave dhe fajësimin e viktimave. KE ka komentuar rëndësinë e mediave në Kosovë për raportimin mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje nga aspekti i ndjeshëm gjinor dhe jo-stereotipik.[311] Mediat mund të kenë një ndikim të fuqishëm në formësimin e opinionit publik; prandaj, rritja e ndërgjegjësimit dhe qasjet më të ndjeshme gjinore në raportim mund të kontribuojnë në krijimin e mbështetjes shoqërore për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave.[312] OSBE në Kosovë ka përgatitur një dokument udhëzues për gazetarët/et në raportimin mbi rastet e dhunës në familje.[313] LMDHF tani kërkon që mediat të "krijojnë dhe zbatojnë programe informuese dhe edukative për ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore", dhe të "promovojnë barazinë gjinore, eliminimin e stereotipeve gjinore dhe të gjuhës seksiste në programet dhe produktet mediatike".[314] Komisioni i Pavarur i Mediave është i obliguar të monitorojë përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Edhe pse kjo nuk përcaktohet në mënyrë të qartë në Konventën e Stambollit, Direktiva e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje tani përfshin masa parandaluese që adresojnë krimet kibernetike, si zhvillimi i aftësive të shkrim-leximit digjital, përfshirë angazhimin kritik me "botën digjitale" dhe mendimin kritik për të ndihmuar njerëzit të identifikojnë dhe adresojnë rastet e dhunës kibernetike, si dhe mënyrat për të kërkuar ndihmë dhe për ta parandaluar atë. Direktiva gjithashtu përfshin masa për parandalimin e përdhunimeve dhe promovimin e pëlqimit në marrëdhëniet seksuale. Këto masa përfshijnë materiale arsimore mbi pëlqimin, me qëllim "promovimin e kuptimit se pëlqimi duhet të jepet në mënyrë vullnetare, si rezultat i vullnetit të lirë të personit, respektit të ndërsjellë dhe të drejtës për integritet seksual dhe autonomi trupore." Direktiva kërkon që këto informacione të "përhapen gjerësisht, me qëllim informimin e publikut mbi masat ekzistuese për parandalimin e përdhunimeve, përfshirë disponueshmërinë e programeve ndërhyrëse."

Mbledhja e të Dhënave

Konventa e Stambollit (KS) u kërkon shteteve që të mbledhin rregullisht të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë dhe të mbështesin kërkime mbi të gjitha format e dhunës të mbuluara nga KS-ja, për të studiuar shkaqet, pasojat, përhapjen, shkallën e dënimeve dhe efektivitetin e masave të zbatimit.[315] Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje i obligon shtetet anëtare të "kenë në funksion një sistem për mbledhjen, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi dhunën ndaj grave apo dhunën në familje".[316] Të dhënat duhet të përmbushin

[310] Neni 17.
[311] Këshilli i Evropës, "Raising awareness on violence against women and domestic violence: working with media in Kosovo", [Në Anglisht], 2019.
[312] Po aty.
[313] OSBE Kosovë, "Reporting on Domestic Violence: Guidelines for journalists", [Në Anglisht],2018.
[314] LMDHF, Neni 26.
[315] Neni 11.
[316] DHGDHF, Neni 44.

standardet minimale të përcaktuara në nen, të jenë të disponueshme në nivel qendror dhe të ndahen sipas kategorive. Shtetet anëtare duhet të përpiqen që të mbledhin të dhëna administrative në përputhje me standardet e zhvilluara nga EIGE. Statistikat e mbledhura duhet të jenë të qasshme për publikun në mënyrë të lehtë dhe transparente.

Në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore i obligon të gjitha institucionet publike të mbledhin të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë dhe t'i dërgojnë ato në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK).[317] Moszbatimi i kësaj detyre sanksionohet me gjobë.[318] Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF) parasheh që Ministria e Drejtësisë të krijojë dhe mirëmbajë një sistem elektronik për menaxhimin e informacionit mbi rastet e dhunës ndaj grave, i cili mbikëqyret dhe administrohet nga Koordinatorja Kombëtare.[319] Ministria e Drejtësisë (MD) ka krijuar Sistemin e Integruar të të Dhënave / Bazën Kombëtare të të Dhënave, që shërben si platformë e unifikuar për menaxhimin e koordinuar të rasteve të dhunës në familje. Në vitin 2024, në sistem janë shtuar tre module të reja, duke rritur numrin e institucioneve pjesëmarrëse në nëntë. Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime në rastet e dhunës në familje janë të detyrueshme të regjistrojnë të dhënat në sistem brenda 24 orëve. Ky sistem mundëson identifikimin e mangësive në menaxhimin e rasteve, përcaktimin e qartë të përgjegjësive institucionale dhe analizën e trendeve, me qëllim përmirësimin e parandalimit dhe hartimin e politikave publike efektive.

Baza përfshin të dhëna mbi informacionin e përgjithshëm të rastit, shërbimet e ofruara për viktimat dhe masat e ndërmarra ndaj kryerësve, me mundësi kategorizimi sipas gjinisë, moshës, marrëdhënies me kryerësin, statusit të aftësisë së kufizuar, llojit të ndihmës së ofruar dhe llojit të dhunës. Megjithëse disa institucione, përfshirë institucionet shëndetësore, ende nuk janë plotësisht të integruara, sistemi është projektuar për t'u zgjeruar më tej.

Ndërkohë, sistemi i drejtësisë po punon për të bërë plotësisht funksional Sistemin e Informimit për Menaxhimin e Lëndëve (SIML) dhe ka miratuar një manual për përdorimin e tij. Ky sistem duhet të përfshijë të gjitha të dhënat elektronike të rasteve dhe vendimeve të trajtuara nga policia, prokuroria dhe gjykatat. Institucionet e drejtësisë shpesh i regjistrojnë këto të dhëna, por nuk i fusin gjithmonë të njëjtat të dhëna në bazën e të dhënave të Koordinatorit Kombëtar, pasi të dy sistemet nuk janë të ndërlidhura (nuk kanë interoperabilitet).

Në të ardhmen, krijimi i një sistemi të përbashkët do të mundësonte përpunimin e të dhënave institucionale për qëllime statistikore dhe hartimin e politikave publike, si dhe lehtësimin e komunikimit të Qeverisë me Bashkimin Evropian në kuadër të kapitullit 23 të acquis communautaire, që lidhet me gjyqësorin dhe të drejtat themelore. Edhe pse disa aktgjykime gjyqësore janë të publikuara online, gjetja e praktikës përkatëse gjyqësore mbetet shumë e vështirë, pasi vendimet janë të renditura kronologjikisht dhe jo sipas temës, duke e bërë të vështirë analizën e trajtimit gjyqësor të rasteve të dhunës në familje.

Për më tepër, të dhënat e ndara sipas gjinisë ende nuk janë lehtësisht të qasshme online. Një mangësi thelbësore e këtyre bazave të të dhënave është se ato fokusohet vetëm në rastet e dhunës në familje, ndërsa përjashtojnë format tjera të dhunës me bazë gjinore. Ekziston gjithashtu shqetësim për efikasitetin e përdorimit të kohës së zyrtarëve, të cilët duhet të regjistrojnë të dhëna në dy sisteme të ndara. Fakti që Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) është përballur me vështirësi në sigurimin e të dhënave nga institucionet përkatëse për përgatitjen e këtij raporti, tregon se menaxhimi i të dhënave ende nuk funksionon siç është paraparë. Shumica

[317] Neni 5.1.8.
[318] Neni 23.5.
[319] LMDHF, Neni 61.

e institucioneve nuk po e përmbushin detyrimin e tyre ligjor për t'ia dorëzuar të dhënat Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

Përfundim

Raporti paraprak i RrGK-së kishte konstatuar se korniza ligjore dhe politike mungonte në kuptimin gjinor të dhunës ndaj grave dhe shpesh kufizohej gabimisht vetëm në dhunën në familje. Miratimi i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF) e ka përafruar dukshëm kornizën ligjore të Kosovës me Konventën e Stambollit dhe, më e rëndësishmja, ka zgjeruar fokusin nga dhuna në familje në dhunën me bazë gjinore. LMDHF-ja gjithashtu është ndërtuar mbi Ligjin e mëparshëm për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LPMDF), duke adresuar boshllëqet ekzistuese përmes përcaktimit të qartë të përgjegjësive të akterëve që koordinojnë reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore. Miratimi i Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) e ka përmirësuar ndjeshëm harmonizimin e kornizës ligjore me KS-në dhe Direktivën e Viktimave në kontekstin e mbrojtjes procedurale të viktimave në proceset ligjore. Megjithëse ka ende hapësirë për përmirësim, ky progres drejt përputhjes ligjore me Konventën e Stambollit është i rëndësishëm. Zbatimi praktik i ligjit mbetet sfidë, dhe nevojiten alokime më të përshtatshme buxhetore, veçanërisht për shërbimet mbështetëse.

Edhe pse është bërë përparim i konsiderueshëm drejt përafrimit me Konventën e Stambollit, korniza ligjore e Bashkimit Evropian është zhvilluar më tej pas miratimit të Direktivës së BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDF). Kjo direktivë sjell më shumë detaje për mënyrën se si duhet të funksionojnë masat mbrojtëse dhe shërbimet mbështetëse, dhe prezanton një numër veprash të reja që lidhen me krimin e lehtësuar nga teknologjia. Për këtë arsye, Kosova do të duhet të ndërmarrë reforma të tjera për të transpozuar këto masa në kornizën e saj ligjore.

REAGIMI INSTITUCIONAL NDAJ DHUNËS ME BAZË GJINORE NË KOSOVË

Ky kapitull shqyrton reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kapitulli identifikon mangësitë që duhet adresuar për të mundësuar zbatimin e plotë të Konventës së Stambollit (KS), Direktivës për Viktimat (DV) dhe Direktivës së BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDF). Së pari, kapitulli përmbledh gjetjet kryesore. Së dyti, diskuton koordinimin ndërinstitucional në trajtimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore në nivelet kombëtare dhe lokale. Më pas, kapitulli përfshin seksione për secilën institucion përgjegjës për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Çdo seksion analizon njohuritë, qëndrimet dhe performancën e tyre në trajtimin e dhunës me bazë gjinore në përputhje me kornizën ligjore.[1] Kapitulli bazohet në kërkime ekzistuese, të dhëna zyrtare si dhe në intervistat dhe monitorimet e zhvilluara nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK). Edhe pse hulumtuesit/et kanë përdorur triangulimin për të rritur vlefshmërinë e gjetjeve, nivele të tjera njohurish dhe qëndrime të ndryshme mund të ekzistojnë, duke pasur parasysh metodologjinë e përzgjedhjes së mostrës. Megjithatë, përsëritja e temave të njëjta në përgjigjet e të anketuarve tregon prirje të qarta në ndërgjegjësim dhe qëndrime. Në rastet kur janë identifikuar dallime në gjetje, autorët/et i kanë evidentuar ato në mënyrë përkatëse.

Gjetjet e Përgjithshme

Duke u bazuar në dëshmitë e paraqitura në seksionet e mëvonshme të raportit, ky seksion përmbledh gjetjet kryesore që lidhen me njohuritë e përgjithshme të institucioneve mbi kornizën ligjore, qëndrimet e tyre ndaj dhunës me bazë gjinore, qasjen ndërsektoriale në trajtimin e kësaj dhune, si dhe financimin e dedikuar për adresimin e saj.

[1] Vlen të theksohet se njohuria për Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHGDHF) nuk është vlerësuar, pasi ajo është miratuar në maj të vitit 2024 dhe ishte ende herët për një vlerësim të tillë; megjithatë, janë shqyrtuar njohuritë e përgjithshme që lidhen me të.

Njohuritë dhe Qëndrimet ndaj Dhunës me Bazë Gjinore

Në përgjithësi, vetëdijësimi institucional lidhur me dhunën me bazë gjinore duket se është përmirësuar që nga raporti i fundit monitorues i RrGK në vitin 2020. Ndër faktorët kontribues të identifikuar janë rritja e raportimit të rasteve, bashkëpunimi më i mirë ndërmjet institucioneve dhe shtimi i mundësive për trajnim. Megjithatë, disa përgjigje treguan se boshllëqet në kuptim dhe në reagim ende vazhdojnë.

> “
>
> Po, dhuna n’baza gjinore do të thot një dhunë që ushtrohet ndaj një femre, ekskluzivisht vetëm ndaj saj.
>
> - Burrë, Mbrojtës i Viktimës

Pjesëmarrësit/et në hulumtim nga institucionet kishin njohuri të përgjithshme mbi përkufizimet kyçe të përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës (KPK), përfshirë ngacmimin seksual, sulmin seksual, dhunën në familje, nxitjen për ekspozim të pjesëve intime të trupit, gjymtimet gjenitale femërore (GJGJF), dhunimin dhe përndjekjen. Megjithatë, niveli i kuptimit ndryshonte varësisht nga forma e dhunës me bazë gjinore. Shumica e pjesëmarrësve treguan një kuptim të qartë të dhunës me bazë gjinore, duke identifikuar dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike si format kryesore. Megjithatë, ngacmimi seksual, sulmi seksual dhe dhuna në familje nuk kuptoheshin në mënyrë të qëndrueshme nga të gjithë. Ekzistonte vetëdija e qartë se dhuna me bazë gjinore përfshin dhunën ndaj çdo personi, pavarësisht gjinisë, por perceptimi i gabuar se kjo dhunë nënkupton vetëm dhunën ndaj grave vazhdon të mbetet i pranishëm te disa zyrtarë/e.

> “
>
> Po nëse janë dy t’ri përafërsisht të gjeneratës dhe shkëmbejnë ndonjë fjalë nuk e shoh që është ngacmim seksual... duhet pak edhe gjinia femërore me pasë kujdes n’veshje për mua atë mendim e kam - që pak ta ketë nji etikë veshjës, a po kupton?
>
> - Zyrtar, Drejtoria e Financave

Zyrtarët/et përgjithësisht i përkufizuan në mënyrë të saktë rastet e dhunimit dhe të sulmit seksual, duke i lidhur me prekjen pa pëlqim. Edhe përndjekja ishte e kuptuar gjerësisht. Megjithatë, ngacmimi seksual shpesh kuptohej vetëm si ngacmim verbal, dhe kishte ngatërresa midis ngacmimit seksual dhe sulmit seksual. Disa zyrtarë/e ende besojnë se mënyra se si vishet një grua mund të kontribuojë në ngacmim seksual. Kur u pyetën drejtpërdrejt nëse veshja është faktor në ngacmim seksual, disa përgjigje sugjeruan se ky mendim ende ekziston. Kjo ideologji e fajësimit të viktimës mund të ndikojë në trajtimin jo të duhur të këtyre veprave penale.

Fajësimi i Viktimës

Termi "fajësimi i viktimës" u përdor për herë të parë nga William Ryan, si një ideologji për të justifikuar dhe arsyetuar krimet e kryera ndaj personave me ngjyrë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.[2] Që nga ajo kohë, ky term është zgjeruar dhe përdoret edhe në diskutimet që lidhen me dhunën seksuale, ku gratë shpesh fajësohen për mënyrën si janë veshur, vendin ku kanë shkuar apo veprimet që kanë bërë — në vend që përgjegjësia të vihet mbi kryesit e krimit. Suarez dhe Gadalla kanë argumentuar se një kulturë e fajësimit të viktimës mund të kontribuojë në përhapjen e dhunës seksuale.[3]

Nxitja për ekspozim të pjesëve intime të trupit u perceptua ndryshe ndërmjet pjesëmarrësve në hulumtim. Detyrimi i dikujt që të zhvishet, shantazhi apo ushtrimi i presionit për të zbuluar detaje intime u identifikuan si forma të nxitjes. Megjithatë, disa përgjigje sugjeruan se mënyra e veshjes së grave, si ekspozimi i pjesëve intime të trupit, mund të shihej si provokim, që potencialisht çon në sulm apo ngacmim seksual. Kjo tregon më tej për përhapjen e vazhdueshme të mentalitetit të fajësimit të viktimës, megjithëse veshja e viktimës nuk duhet të ketë asnjë relevancë në akuzat penale.

> "
>
> E shoh [veshjen] pak si provokim, që mund të çojë në […] sulm seksual apo ngacmim seksual. Besoj se kjo ka ndikim, dhe gjithashtu varet nga mënyra e veshjes apo teprimet e zhveshjeve të gjinisë së kundërt.
>
> - Zyrtar, Drejtoria për Punë Komunale

Gjatë intervistave, zyrtarët/et e institucioneve në mënyrë të qëndrueshme dhe të saktë e kuptuan dhunën në familje, duke vërejtur me të drejtë se ajo është forma më e përhapur e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Është vërejtur përmirësim në njohuritë se dhuna seksuale mund të ndodhë edhe brenda martesës. Zyrtarët/et kishin kuptim të qartë për dhunën fizike, por format e tjera të dhunës brenda marrëdhënieve familjare — si dhuna psikologjike apo ekonomike — nuk kuptoheshin gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme.

Ndërkohë, njohuritë lidhur me gjymtimet gjenitale femërore (GJGJF) ishin të kufizuara. Disa përgjigje pohonin se GJGJF nuk ndodh në Kosovë, ndërsa të tjera tregonin mungesë vetëdijeje për praktikën.

Pjesëmarrësit/et në hulumtim përmendën se kishin marrë pjesë në trajnime të ndryshme për dhunën me bazë gjinore, përfshirë ato të organizuara nga OSBE-ja, Akademia e Drejtësisë dhe OJQ-të e ndryshme. Trajnimet u vlerësuan si të vlefshme dhe ndihmuese. Megjithatë, fakti që këto trajnime nuk janë të detyrueshme u identifikua si kufizim, ndërsa u shpreh qartë dëshira për më shumë trajnime të shpeshta dhe të detyrueshme.

[2] William Ryan, *Fajësimi i viktimës*, New York: 1971.
[3] "Ndalo fajësimin e viktimës: Një meta-analizë mbi mitet rreth përdhunimit", *Revista e Dhunës Ndërpersonale 25(11)* 2010–2035, SAGE, 2010.

Mospërjashtimi dhe qasja ndërseksionale në trajtimin e dhunës me bazë gjinore

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të marrin masa për të mbrojtur të drejtat e viktimave pa diskriminim në asnjë bazë, përfshirë gjininë, seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, bindjet politike apo të tjera, prejardhjen kombëtare apo shoqërore, përkatësinë ndaj një pakice kombëtare, pasurinë, lindjen, orientimin seksual, identitetin gjinor, moshën, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar, statusin martesor, si dhe statusin e migrimit apo refugjatit.[4] Një qasje ndërseksionale në ofrimin e shërbimeve do të nënkuptonte marrjen parasysh të mënyrave në të cilat pabarazitë dhe/ose cenueshmëritë ndikojnë në qasjen e grave të ndryshme ndaj shërbimeve. Për shembull, gratë që jetojnë në zona rurale, gratë me aftësi të kufizuara, ato të izoluara apo që nuk flasin gjuhën shqipe, mund të përballen me vështirësi shtesë për të pasur qasje në shërbime.

Pjesëmarrësit/et në hulumtim nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë me gra të ndryshme shprehën mendime të ndryshme lidhur me reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore. Për shembull, intervistat sugjerojnë se gratë me aftësi të kufizuara shpesh nuk ndihen të sigurta ta raportojnë dhunën, gjë që pasqyron një dështim sistematik në krijimin e rrugëve të qasshme dhe të besueshme drejt drejtësisë. Gratë rome, ashkalike dhe egjiptiane përballen me neglizhencë institucionale, mbrojtje dhe ndjekje të pamjaftueshme të rasteve, si dhe mungesë mbështetjeje familjare, që shpesh i detyron të kthehen në mjedise abuzuese.

Ndërkohë, personat lesbike, gej, biseksualë, transgjinorë, kuir, interseks, aseksualë dhe të tjerë që identifikohen si LGBTQIA+ përballen me stigmatizim, ku dhuna nga anëtarët/et e familjes zakonisht trajtohet si dhunë në familje, pa u marrë parasysh orientimi seksual apo identiteti gjinor si faktorë nënshtrues. Kjo, e kombinuar me shkeljen e konfidencialitetit dhe trajtimin diskriminues, ka minuar besimin e komunitetit LGBTQIA+ ndaj institucioneve. Gjetjet sugjerojnë se qasjet institucionale jo vetëm që dështojnë të adresojnë nevojat specifike të këtyre grupeve, por madje mund t'i dekurajojnë ato të kërkojnë ndihmë, duke kontribuar kështu në vazhdimësinë e dhunës.

Financimi për trajtimin e dhunës me bazë gjinore

Konventa e Stambollit kërkon ndarjen e duhur të burimeve financiare dhe njerëzore për zbatimin efektiv të politikave, masave dhe programeve të integruara, përfshirë ato që zbatohen nga organizatat e shoqërisë civile.[5] Në Kosovë, çdo organizatë buxhetore ka përgjegjësi të planifikojë buxhetin për zbatimin e detyrimeve të saj.[6] Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) përcakton kufijtë e shpenzimeve, jep udhëzime përmes qarkoreve buxhetore dhe përgatit buxhetin e Kosovës para se ta dërgojë në Kuvend për debat dhe miratim. Ndërkohë që komunat dhe ministritë përkatëse propozojnë ndarjet buxhetore, MFPT finalizon buxhetin e Kosovës dhe mund t'u kërkojë këtyre organizatave të ndajnë mjete të mjaftueshme për zbatimin e detyrimeve të tyre, përfshirë ato që lidhen me trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

Një analizë e shpejtë e ligjeve buxhetore të Kosovës për periudhën 2021–2024 tregoi shumë pak linja specifike buxhetore të lidhura drejtpërdrejt me trajtimin e dhunës me bazë

[4] Neni 4.3.

[5] Neni 8.

[6] Korniza ligjore i referohet çdo organi përgjegjës për buxhetimin, përfshirë ministritë dhe komunat, ndër të tjera, si "organizata buxhetore".
Sipas Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin dhe Përgjegjësinë Financiare Publike, Neni 1, "Organizatat Buxhetore" janë "çdo autoritet publik ose ndërmarrje publike që merr drejtpërdrejt, sipas Ligjit të Ndarjeve Buxhetore, një ndarje buxhetore që nuk është përbërës i një ndarjeje më të gjerë të siguruar për një autoritet publik ose ndërmarrje publike tjetër."

gjinore. Përdorimi i sistemit të buxhetimit sipas zërave, në vend të buxhetimit programor apo të bazuar në rezultate, e bën të vështirë vlerësimin e ndarjeve konkrete për këtë fushë. Disa linja buxhetore kontribuojnë në mënyrë të tërthortë, përmes shpenzimeve të rregullta të institucioneve përgjegjëse si policia, prokuroria dhe qendrat për punë sociale (QPS)+.

Plani Strategjik Kombëtar për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) kishte paraparë një buxhet gjithsej prej 4,932,195 euro për vitet 2022–2024 nga fondet shtetërore dhe 1,631,535 euro shtesë nga donatorët.[7] Edhe pse fondet ishin shpërndarë relativisht në mënyrë të barabartë ndërmjet shtyllave të strategjisë, pjesa më e vogël ishte ndarë për shërbimet e përgjithshme dhe të specializuara për viktimat. Deri në tetor 2025, nuk është publikuar ndonjë e dhënë zyrtare mbi shpenzimet faktike për zbatimin e strategjisë.

Sipas ligjit të Kosovës, strehimoret e licencuara nga shteti duhet të marrin financim shtetëror.[8] Linja e veçantë buxhetore për strehimoret u krijua pas viteve të tëra të avokimit intensiv nga strehimoret, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore. Në vitet 2021 dhe 2022, MFPT mbështeti strehimoret me nga 1,000,000 euro në vit.[9] Pas lobimit të mëtejmë, Qeveria e rriti financimin në 1,500,000 euro në vitin 2023, e po aq u ndanë edhe në vitin 2024.[10] Historikisht, vonesat në shpërndarjen e fondeve kanë shkaktuar mbyllje të strehimoreve, duke rrezikuar gratë dhe fëmijët.[11] Edhe pse situata është përmirësuar, nevoja për të aplikuar çdo vit dhe për të pritur disbursimin e fondeve krijon ngarkesë administrative për institucionet dhe strehimoret, si dhe vështirësi financiare, veçanërisht në fillim të vitit. Intervistat tregojnë se financimi i paqëndrueshëm, për shkak të pritjes për fonde, kontribuoi në mbylljen e strehimores së vetme në Kosovë të specializuar për kujdesin e fëmijëve që kishin përjetuar dhunë me bazë gjinore — "Hope and Homes for Children", e cila u mbyll në vitin 2023. Kjo ka dëmtuar rëndë reagimin institucional ndaj trajtimit të fëmijëve që kanë përjetuar dhunë. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë nuk ka ende një metodologji të standardizuar për koston e shërbimeve të strehimoreve, gjë që mund të çojë në financim të pamjaftueshëm në raport me kërkesat e Konventës së Stambollit.[12]

Në ligjet buxhetore për periudhën 2021–2024, komunat nuk kanë pasur linja specifike buxhetore të dedikuara për dhunën me bazë gjinore. Ekziston një linjë e quajtur "Shërbime Rezidenciale", të cilën komunat e përdorin për sigurimin e strehimit social, por ajo i referohet përfituesve të ndryshëm dhe nuk përfshin ndarje specifike për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Një analizë e shpejtë e ndarjeve buxhetore komunale për QPS-të sugjeron se ato nuk i kanë rritur shpenzimet për të punësuar së paku dy punonjës/e socialë/e shtesë të specializuar/a në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, siç parashihet me Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Një shembull i mirë është Komuna e Prishtinës, e

[7] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, 2022.
[8] Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, Neni 24.
[9] RrGK, Ligji për ndarjet buxhetore të buxhetit të republikës së kosovës 2023 nga pikëpamja gjinore , 2023.
[10] RrGK, Drejt një Buxheti për Qytetarët: Rishikim Gjinor i Buxhetit të Kosovës, 2024. Për informata më të tut-jeshme shih, "Avokimi shtyn Qeverinë që të krijojë Linjën Buxhetore për Strehimoret ", 28 maj 2020. ABGJ, Raporti i vlerësimit të programit të kosovës për barazi gjinore , 2024. Shih poashtu, KOMF, Letër e hapur drejt Kryeministrit, Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministres së Drejtësisë, 2024.
[11] Shih RrGK, "Ministria do të nxjerrë fondin e shumëpritur për strehimoret të aprovuar nga Kuvendi ", 1 mars 2019.
[12] ABGJ ka realizuar një ushtrim të kostimit në vitin 2019 (Buxhetimi operacional i strehimoreve në kosovë dhe udhëzuesi i projektimit), por ai nuk është përdorur rregullisht për vlerësimin e kostove. RrGK ka zhvilluar një metodologji gjithëpërfshirëse, të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, e cila po testohet në vitin 2025 dhe mund të adoptohet, përshtatet dhe përdoret nga Ministria e Drejtësisë ose ministria përgjegjëse në të ardhmen (në përgatitje).

cila ofron ndihmë financiare prej 500 euro në muaj për viktimat e dhunës në familje që kanë urdhër mbrojtjeje, për qira dhe shpenzime thelbësore, nga buxheti i Komunës së Prishtinës, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale. Ndërkohë, disa, por jo të gjitha komunat, kanë zhvilluar strategji dhe plane lokale për barazi gjinore, që shpesh përfshijnë masa për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Disa prej tyre parashikojnë ndarje buxhetore, të cilat në të ardhmen mund të shërbejnë për të analizuar më saktë shpenzimet faktike, nëse monitorohen në mënyrë të qartë. Shumica e këtyre planeve janë hartuar me mbështetje ndërkombëtare, dhe ende mbetet për t'u parë se në çfarë mase do të jenë të zbatueshme dhe të financuara në nivel lokal. Në dhjetor 2023, Qeveria prezantoi një masë për mbështetjen e punësimit për të mbijetuarat e dhunës në familje, me synim promovimin e pavarësisë së tyre ekonomike. Kjo nismë subvencionon 70% të pagës bruto (deri në 300 €) për gjashtë muaj për të mbijetuarat që punësohen.[13] Të mbijetuarat aplikojnë duke telefonuar në një numër falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, pas së cilës ato referohen për t'u regjistruar si kërkuese të punës në Zyrat Komunale të Punësimit. Ministria verifikon statusin e tyre si të mbijetuara dhe bashkëpunon me Agjencinë e Punësimit për t'i lidhur me punëdhënës potencialë. Deri në vitin 2025, 14 gra kishin përfituar nga kjo masë. Kërkesa për të telefonuar MD-në mund të pengojë disa viktima ta përdorin këtë program, prandaj ofrimi i këtyre shërbimeve mund të lehtësohej përmes menaxherëve/eve të rasteve në Qendrat për Punë Sociale, të cilët/at koordinojnë rastet dhe janë më të pajisur/a për të ofruar mbështetje në nivel lokal.

Në përgjithësi, shteti nuk ka ndarë fonde të mjaftueshme për të përmbushur zotimet e veta për mbrojtjen e personave të ndryshëm që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit.[14]

Koordinimi Ndërinstitucional

Kjo pjesë trajton çështjen e koordinimit ndërinstitucional. Sipas Konventës së Stambollit, shtetet duhet të caktojnë trupa zyrtarë përgjegjës për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore.[15] Kosova ka themeluar mekanizma koordinues në nivel kombëtar, si dhe në disa komuna, të cilët fokusohen kryesisht në dhunën në familje dhe në trafikimin e qenieve njerëzore.[16] Nënseksionet në vijim trajtojnë trupat e ndryshëm koordinues, përfshirë: Grupin Ndërministror për Koordinim; Koordinatorin Kombëtar; Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ); dhe mekanizmat koordinues komunalë.

Grupi Ndërministror për Koordinim kundër Dhunës në Familje

Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës themeloi Grupin Ndërministror për Koordinim kundër Dhunës në Familje me Vendimin Nr. 04/83.[17] Ky grup udhëhiqet nga Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje (KKDHF) brenda Ministrisë së Drejtësisë dhe bashkëkryesohet nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ). Anëtarët/et zyrtarë/e përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI),

[13] Kallxo.com, *Lansohet masa për punësimin e viktimave të dhunës në familje*, 7 dhjetor 2023.
[14] Për më shumë informacion, shihni hulumtimin e ardhshëm të RrGK-së që do të trajtojë koston e shërbimeve të specializuara.
[15] Neni 10.
[16] Trupat koordinues për adresimin e trafikimit kanë qenë përtej qëllimit të këtij hulumtimi dhe, rrjedhimisht, nuk janë shqyrtuar këtu. Po ashtu, ekziston bashkëpunim në njohjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, por kjo temë ka qenë përtej fokusit të këtij raporti.
[17] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, 2022, ff. 23-24.

Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Policinë e Kosovës (PK), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Koalicionin e Strehimoreve. Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe partnerët/et ndërkombëtarë/e marrin pjesë si vëzhgues/e dhe ekspertë/e.

Grupi është mbledhur rregullisht sa herë që posti i Koordinatorit Kombëtar ka qenë i plotësuar, por gjatë ndryshimeve të qeverive, takimet janë mbajtur më rrallë. Gjatë takimeve janë diskutuar zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF), rastet me profil të lartë që kërkojnë qasje të përbashkët, sfidat me mbledhjen e të dhënave nga institucione të ndryshme dhe koordinimi i aktiviteteve gjatë fushatës "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave". Gjyqtarët/et dhe prokurorët/et kanë marrë pjesë rrallë në këto takime, gjë që ka vështirësuar koordinimin efektiv. Megjithatë, sipas vëzhgimeve, rregullsia dhe performanca e Grupit janë përmirësuar gradualisht me kalimin e kohës.

Koordinatorja Kombëtare

Historikisht, Zëvendësministri/ja i/e Drejtësisë ka shërbyer si Koordinator/e Kombëtar/e kundër Dhunës në Familje, me përgjegjësi për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë kombëtare, koordinimin e institucioneve, menaxhimin e bazës së të dhënave për dhunën në familje dhe sigurimin e llogaridhënies.[18] Pas miratimit të Ligjit të ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore në vitin 2023, këto përgjegjësi i ka marrë Ministri/ja i/e Drejtësisë.[19]

Koordinatorja Kombëtare ka punuar për të avancuar politikat shtetërore në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke kontribuar në përmirësimin e koordinimit dhe dokumentimit të përpjekjeve institucionale. Megjithatë, mbeten sfida në sigurimin e llogaridhënies së institucioneve të tjera për zbatimin e detyrimeve të tyre në këtë fushë. Në përputhje me përgjegjësitë ligjore, Koordinatorja Kombëtare ka monitoruar rregullisht përparimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare. Një tregues i rëndësishëm i performancës së saj është niveli i zbatimit të strategjive kombëtare. Raportohet se nuk ekziston ndonjë evidencë e arkivuar për zbatimin e strategjisë së mëparshme deri në vitin 2022, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e progresit për shkak të ndryshimeve në koordinatorë/e dhe mungesës së kujtesës institucionale.[20] Megjithatë, është vërejtur përparim i matshëm në zbatimin e strategjisë aktuale,[21] siç tregohet në tabelën më poshtë. Përmirësimet më të mëdha janë bërë në avancimin e politikave dhe forcimin e institucioneve, ndërsa sfidat vazhdojnë në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme për viktimat.

[18] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, f. 24.
[19] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2023, Neni 13.
[20] Intervistë e RrGK-së.
[21] KE, Raporti për Kosovën 2024, [Në Anglisht],2024, f. 36.

Objektivi	Rezultatet 2022[22]	Rezultatet 2023[23]
1. Parandalimi dhe Identifikimi i Dhunës	10% plotësisht i zbatuar, 26% pjesërisht 64% i pazbatuar	49% plotësisht i zbatuar 37% pjesërisht 13% i pazbatuar
2. Avancimi dhe Harmonizimi i Politikave Publike	45% plotësisht i zbatuar 38% pjesërisht 17% i pazbatuar	73% plotësisht i zbatuar 20% pjesërisht 6% i pazbatuar
3. Forcimi Institucional për Mbrojtje dhe Trajtim të Viktimave	14% plotësisht i zbatuar 51% pjesërisht 34% i pazbatuar	53% plotësisht i zbatuar 38% pjesërisht 8.8% i pazbatuar
4. Ofrimi i Shërbimeve të Përgjithshme dhe të Specializuara	0% plotësisht i zbatuar 59% pjesërisht 41% i pazbatuar	25% plotësisht i zbatuar 49% pjesërisht 25% i pazbatuar

Agjencia për Barazi Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore u themelua në vitin 2005 në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore dhe funksionon në kuadër të ZKM.[24] Ajo promovon barazinë gjinore, monitoron zbatimin e ligjeve përkatëse dhe mbështet Zyrtarët/et për Barazi Gjinore në komuna dhe ministri. ABGJ bashkëpunon ngushtë me organizatat e grave dhe strehimoret për reforma ligjore dhe fushata vetëdijësimi. Nën LMDHF-në, ABGJ mbante rolin e zëvendës Koordinatores Kombëtare.

ABGJ luan rol kyç normativ dhe koordinues: ka hartuar ligjin e parë për dhunën në familje, strategjitë e para dhe pasuese, Procedurat Standarde të Veprimit(PSV), si dhe aktet nënligjore. Ajo fokusohet në ngritjen e kapaciteteve, parandalimin dhe fushatat e vetëdijesimit, shpesh në bashkëpunim me OShC-të. ABGJ raporton rregullisht në Grupin Ndërministror për Koordinim mbi punën e saj, përfshirë hartimin e PSV-ve të reja.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, Agjencia për Barazi Gjinore është përgjegjëse për forcimin e kapaciteteve të anëtarëve të Mekanizmave Komunalë të Koordinimit përmes trajnimeve mbi trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave me një qasje të koordinuar dhe shumësektoriale.[25]

Komunat dhe Mekanizmat Komunalë të Koordinimit

Në kuadër të procesit të decentralizimit, komunat kanë një rol kyç në koordinimin e reagimit ndërinstitucional ndaj dhunës me bazë gjinore.[26] Komunat janë përgjegjëse për hartimin e planeve të veprimit për trajtimin e dhunës me bazë gjinore në nivel komunal, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF), si dhe për menaxhimin e shërbimeve në fushat e shëndetësisë, arsimit, trajnimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, të cilat financohen kryesisht përmes transferimeve nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës.

Komunat kanë për detyrë të krijojnë partneritete rajonale dhe ndërkomunale, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të identifikimit, referimit, strehimit, rehabilitimit dhe fuqizimit të viktimave.[27] Komunat mbajnë gjithashtu përgjegjësi për parandalimin e dhunës dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, përfshirë përmes fushatave lokale, iniciativave arsimore dhe

[22] Ministria e Drejtësisë, *Reporti Vjetor i Zbatimit të Strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026*, 2023.
[23] Ministria e Drejtësisë, *Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026*, 2024.
[24] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, f. 24.
[25] MD, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, 3.2.4, ff. 89-90.
[26] Po aty., f. 24.
[27] Po aty.

programeve që adresojnë normat e dëmshme gjinore. Përveç kësaj, ato kanë për detyrë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në nivel lokal. Komunat duhet gjithashtu të zhvillojnë kapacitetet e ofruesve lokalë të shërbimeve, veçanërisht të personelit shëndetësor, të mirëqenies sociale dhe arsimor.[28]

LMDHF dhe SKMDHF i rendisin komunat si aktorë kyç në zbatimin lokal të mekanizmave të mbrojtjes, parandalimit dhe reagimit.[29] Komunat kanë një rol shumëdimensional që përfshin koordinimin, ofrimin e shërbimeve, parandalimin, monitorimin dhe ndarjen e burimeve. Komunat janë të mandatuara për të krijuar dhe udhëhequr Mekanizmat Koordinues Komunalë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (MKK), të cilët mundësojnë bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet akterëve relevantë.[30] Përmes këtyre mekanizmave, komunat pritet të sigurojnë një përgjigje koherente dhe të përqendruar te viktima ndaj rasteve të dhunës, përfshirë referimin efektiv, monitorimin e urdhrave mbrojtës dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve. Për më tepër, autoritetet komunale janë përgjegjëse për sigurimin e qasjes në shërbime thelbësore, si këshillimi psikosocial, ndihma juridike, strehimi dhe asistenca emergjente, duke mbështetur njëkohësisht QPS-të në kryerjen e vlerësimeve të rrezikut dhe hartimin e planeve të sigurisë dhe rehabilitimit për të mbijetuarat/it. MKK-të duhet të mblidhen rregullisht për të diskutuar raste specifike dhe mënyrat se si të mbështetet rehabilitimi dhe riintegrimi i individëve. Në përgjithësi, zyrtaret/ët për barazi gjinore kanë marrë përsipër përgjegjësinë për koordinimin e MKK-ve, krahas roleve të tyre të tjera, megjithëse kjo nuk ka qenë pjesë e përshkrimit të tyre zyrtar të punës. Për pasojë, mungesa e kohës dhe e burimeve të mjaftueshme shpesh ka penguar aftësinë e tyre dhe të vetë mekanizmave për të menaxhuar rastet në përputhje me Konventën e Stambollit. Historikisht, ka munguar një bazë e qartë ligjore që do të udhëhiqte funksionimin e MKK-ve, gjë që ka ndikuar në paqartësi lidhur me përgjegjësitë institucionale. LMDHF ka sqaruar tashmë këto përgjegjësi, por zbatimi i tyre kërkon më shumë kohë. Deri në maj 2024, të gjitha 38 komunat në Kosovë kishin themeluar MKK-të.[31] Megjithatë, funksionaliteti i tyre ndryshonte. Intervistat sugjerojnë se MKK-ja në Gjakovë dallohet, pasi ka qenë aktive që nga viti 2012. MKK-ja në Pejë gjithashtu shfaq koordinim të mirë, me takime të rregullta që përfshijnë edhe disa komuna të tjera. Në të kundërt, në Mitrovicë mekanizmi nuk ka funksionuar deri në momentin kur është riaktivizuar nga përpjekjet e shoqërisë civile, ndërsa në Ferizaj takimet janë të rralla dhe me pjesëmarrje të ulët.

> “
>
> Nuk mund të themi që funksionon siç duhet… Thonë se nuk kanë kohë.
>
> - Përfaqësuesi/ja e Strehimores

Anëtarët e MKK-ve kanë raportuar në mënyrë të përsëritur se gjyqtarët/et, prokurorët/et dhe Mbrojtësit e Viktimave zakonisht marrin pjesë në takime vetëm kur bëhet fjalë për ndonjë rast të madh të dhunës me bazë gjinore. Punëtorët socialë kanë theksuar se Mbrojtësve të Viktimave shpesh nuk marrin pjesë në takime, madje as kur diskutohen rastet, duke përmendur mungesën e automjeteve, numrin e kufizuar të mbrojtësve dhe përplasjet me seanca gjyqësore. Mospjesëmarrja e disa institucioneve kyçe pengon menaxhimin e plotë dhe efektiv të rasteve. Vëzhgimet tregojnë se kur në këto mekanizma janë

[28] Procedurat Standarde të Operimit për mbrojtje nga Dhuna në familje në kosovë.
[29] Po aty.
[30] Republika e Kosovës, Rregullore (QRK) – NR. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në familje, Dhuna ndaj grave dhe Dhuna në baza gjinore.
[31] OSBE, OSBE përfundon themelimin e Mekanizmave Komunalë të Koordinimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, [Në anglisht], 2024.

përfshirë organizata të grave, veçanërisht përfaqësuese të strehimoreve, MKK-të kanë qenë dukshëm më aktive.

MKK-të nuk mbajnë gjithmonë takime të rregullta dhe disa anëtar/e nuk marrin pjesë në mënyrë aktive. Sfidat e tjera përfshijnë menaxhimin e rasteve me qasje të bazuar në viktimë, që përfshin vlerësime të plota të rrezikut, bashkëpunim ndërinstitucional — veçanërisht me institucionet e drejtësisë — riintegrimin e viktimave dhe sigurimin e buxheteve të mjaftueshme për të mbështetur menaxhimin adekuat të rasteve. Për më tepër, historikisht këto mekanizma janë përqendruar kryesisht në rastet e dhunës në familje, ndërsa kapacitetet e tyre për të trajtuar forma të tjera të dhunës me bazë gjinore kërkojnë forcim të mëtejshëm, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale dhe dhunës digjitale.

Evidenca tregon se zbatimi në nivel komunal mbetet i pakoordinuar dhe i fragmentuar nëpër Kosovë. Ndërsa disa komuna kanë krijuar MKK funksionale dhe kanë bërë ndarje buxhetore për ndërhyrje kundër dhunës me bazë gjinore, të tjerat ende mbështeten kryesisht në nisma të financuara nga donatorët ose të udhëhequra nga OJQ-të. Mungesa e financimit të qëndrueshëm komunal, funksionimi jo i rregullt i MKK-ve dhe komunikimi i kufizuar ndërinstitucional e minojnë koherencën dhe qëndrueshmërinë e përgjigjes lokale. Gjithashtu, mungesa e trajnimeve adekuate për stafin komunal dhe sistemet e dobëta të monitorimit pengojnë zbatimin e qëndrueshëm të masave mbrojtëse dhe qasjen e viktimave në shërbime gjithëpërfshirëse të mbështetjes.

Si rrjedhojë, edhe pse kuadrot normative dhe strategjike parashikojnë një qasje të fortë dhe të decentralizuar për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, zbatimi i këtyre detyrimeve në praktikë, në nivel komunal, mbetet i kufizuar. Kapacitetet e pabarabarta institucionale, ndarja e pamjaftueshme e burimeve dhe mungesa e mekanizmave të llogaridhënies në nivel lokal vazhdojnë të kufizojnë efektivitetin e përgjithshëm të sistemit të reagimit në Kosovë, duke theksuar nevojën për përmirësimin e koordinimit institucional, forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e modeleve të qëndrueshme të financimit për të siguruar mbrojtje të vazhdueshme dhe të bazuar në të drejta për viktimat në të gjitha komunat.

Policia e Kosovës

Kjo pjesë analizon rolin dhe performancën e Policisë së Kosovës (PK) në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke u mbështetur në vëzhgimet e RrGK dhe në intervistat me përfaqësues/e të institucioneve të ndryshme, shtatë zyrtarë/e policorë/e nga rajone të ndryshme, si dhe me Inspektoratin Policor. Në përgjithësi, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) duhet të sigurojë që PK të jetë e trajnuar dhe e pajisur për të mbështetur të gjitha viktimat e dhunës me bazë gjinore. PK është përgjegjëse për hetimin e veprave penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore, reagimin ndaj rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e rrezikut për viktimën dhe zbatimin e urdhrave mbrojtës. Policia e Kosovës e ka detyrim ligjor të mbrojë viktimat dhe t'i informojë ato për të drejtat e tyre, përfshirë qasjen në ndihmë psikologjike, mbështetje ligjore dhe planifikim të sigurisë.[32] PK ka themeluar Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje (NJHDHF), të përbëra nga zyrtarë policorë burra dhe gra të trajnuar/a posaçërisht për hetimin e rasteve të dhunës në familje.[33]

Gjithashtu, PK ka njësi të veçantë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, por kjo njësi është angazhuar pak në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia.

[32] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2023.
[33] Amnesty International, Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë premtimet e saj ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje, [Në anglisht], 2023.

Duke pasur parasysh përvojën e grumbulluar të NJHDHF-ve në trajtimin e dhunës në familje, do të ishte e dobishme që forma të tjera të dhunës me bazë gjinore të trajtoheshin nga këto njësi, në përputhje me përkufizimet më të gjera të Konventës së Stambollit, në mënyrë që të shfrytëzohej njohuria ekzistuese mbi marrëdhëniet gjinore në këto raste. Gjithashtu, ekziston mundësi për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet këtyre njësive në hetime.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) kishte paraparë krijimin e Drejtorisë për Parandalimin dhe Hetimin e Dhunës në Familje brenda Policisë së Kosovës,[34] e cila u themelua në vitin 2023. Kjo Drejtori përbëhet nga katër sektorë: Njësia për Kontroll dhe Cilësi të Hetimit të Rasteve; Njësia e Hetimit (që më parë fokusohej vetëm në parandalim); Njësia për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Keqtrajtimit të Fëmijëve; dhe Njësia për Parandalimin e Dhunës Seksuale. Në nivel komunal, çdo stacion policor përfshin një Njësi për Hetimin e Dhunës në Familje. Këto ndryshime strukturore janë bërë si përgjigje ndaj numrit të lartë të rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici dhe ilustrojnë përkushtimin në rritje të institucionit për ta trajtuar dhunën me bazë gjinore me seriozitet dhe efikasitet më të madh. Siç është paraparë në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF), disa stacione policore komunale kanë themeluar "Dhoma Miqësore", të cilat synojnë të krijojnë një ambient të sigurt dhe mbështetës për viktimat dhe fëmijët e tyre gjatë dhënies së deklaratave. Aktualisht, nëpër komuna ekzistojnë gjithsej 28 dhoma të tilla[35]. Në lokacionet ku mungojnë hapësira të dedikuara, Policia e Kosovës (PK) ka përshtatur ambiente përreth për të shërbyer me funksion të ngjashëm derisa të krijohen hapësirat e duhura. Megjithatë, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka vërejtur raste kur zyrtarët/e policorë/e nuk i kanë përdorur këto dhoma, përfshirë edhe situatat kur kanë qenë të pranishëm fëmijët. Në disa raste, intervistat janë zhvilluar në hapësira të papërshtatshme për trajtimin e rasteve të tilla serioze dhe emocionalisht të ndjeshme, pa privatësinë dhe mbështetjen e nevojshme për viktimat.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) përmend nevojën që PK të krijojë një "Fond Emergjent (në formë të arkës së vogël)" për të mbuluar nevojat urgjente të viktimave gjatë qëndrimit të tyre në stacionet policore. Bazuar në vëzhgimet e RrGK-së, ky fond ende nuk është themeluar. Shpeshherë, vetë zyrtarët/e policorë/e mbulojnë këto shpenzime kur viktimave u nevojiten artikuj bazikë si qumështi, uji apo ushqimi, përfshirë rastet kur janë të përfshirë fëmijët. SKMDHF gjithashtu parasheh përfshirjen e PK-së në fushata vetëdijësuese, të cilat janë organizuar çdo vit, veçanërisht gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave. Brenda shtyllës së parandalimit, Strategjia parasheh që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Akademia e Drejtësisë (AD), Policia e Kosovës (PK), organizatat e shoqërisë civile (OShC-të) dhe mediat të sigurojnë "Hetimin me përparësi të rasteve të mundshme të sulmeve ndaj gazetarëve/ve, dhunës në familje, si dhe krimeve të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, përfshirë rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit LGBTI+. Edhe pse PK ka deklaruar se këto raste trajtohen me përparësi, monitorimi i RrGK-së ka evidentuar mangësi në trajtimin e drejtë dhe të shpejtë të tyre. Për shembull, një aktivist i komunitetit LGBTQIA+ ka raportuar:

> Kemi shumë raste brenda komunitetit që lidhen me gjuhën e urrejtjes, por sistemi i drejtësisë pothuajse asnjëherë nuk i klasifikon si të tilla. Po ashtu, nëse raporton një rast

[34] Republika e Kosovës, Qeveria, MD, SKMDHF, f. 47.
[35] Po aty, aktiviteti IV 1.1. 5, f. 103.

dhune në familje, ku babai, nëna apo ndonjë anëtar tjetër të ka rrahur sepse je LGBT, rasti nuk klasifikohet si i motivuar nga orientimi apo identiteti yt.[36]

Ndërsa Policia e Kosovës (PK) ka mundësi të dokumentojë se dhuna ka ndodhur në rrethana rënduese, përfshirë ato që lidhen me identitetin apo orientimin seksual, monitorimi tregon se kjo ndodh shumë rrallë. Në praktikë, PK priret të dokumentojë vetëm veprën penale, si p.sh. ngacmimin, duke e lënë të paqartë dimensionin gjinor të krimit. Personat LGBTQIA+ kanë raportuar hezitim për të kërkuar ndihmë për shkak të frikës nga diskriminimi dhe shkelja e konfidencialitetit.

Në një rast tjetër, disa burra kishin krijuar një grup në rrjetin social "Telegram" të quajtur ALBKINGS, ku kishin shënjestruar gazetare dhe gra të njohura, duke përdorur profilin dhe imazhet e tyre pa pëlqimin e tyre për ngacmime dhe abuzime seksuale. PK e kishte trajtuar rastin vetëm si krim kibernetik, pa e njohur apo adresuar natyrën gjinore të dhunës.

Programi për Barazi Gjinore i Kosovës (2020–2024) kishte paraparë rritjen e përfaqësimit të grave në Policinë e Kosovës.[37] Dëshmitë sugjerojnë se prania e grave në këtë institucion mund të rrisë besimin e qytetarëve/eve, gjë që mund të ndikojë në rritjen e raportimeve dhe, si rrjedhojë, në përmirësimin e qasjes në shërbime.[38] Ndërsa Policia e Kosovës ka synuar të ofrojë orare më fleksibile të punës dhe stacione më afër vendbanimit për gratë, sfidat për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në PK vazhdojnë, për shkak të roleve të socializuara gjinore në shoqërinë kosovare dhe vështirësive të përgjithshme që familjet hasin në sigurimin e kujdesit të përballueshëm për fëmijët. Gratë e komunitetit serb të Kosovës përballen me pengesa shtesë për shkak të pasigurisë, shqetësimeve politike se mund të perceptohen si tradhtare të grupit të tyre etnik dhe/ose frikës nga kërcënimet.[39] Nën-përfaqësimi i grave në Policinë e Kosovës (PK) mund të kontribuojë në nën-raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, si pasojë e mungesës së besimit në këtë institucion — veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, ku sfidat e përmendura më lart janë edhe më të theksuara.

Edhe pse është vërejtur përparim në performancën e Policisë së Kosovës (PK) që nga monitorimi i fundit i RrGK-së, disa probleme vazhdojnë të jenë të pranishme. Disa zyrtarë/e policorë ishin të njohur/a me Programin Kombëtar për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, por jo të gjithë treguan njohuri të thelluara. Zyrtarët/et shpesh e keqkuptonin dhunën me bazë gjinore ose e barazonin atë me dhunën në familje. Termat juridikë kyç si ngacmim, ngacmim seksual dhe sulm seksual shpesh interpretoheshin gabimisht. Policia ishte e painformuar për GJGJF-në (gjymtimin gjenital femëror), duke e ngatërruar shpesh me dhunën në familje në vend që ta njihte si një vepër penale të veçantë. Disa zyrtarë priren të justifikojnë ose arsyetojnë ngacmimin seksual, sidomos kur ndodhte për herë të parë, duke mos

> "Ngacmimi seksual duhet të jetë i përsëritur, jo kur dikush thotë: "Dukesh e bukur." Profesori u dënua vetëm pse dha komplimente.
>
> - Burrë, zyrtar i PK-së

[36] RrGK Intervistë, 2024.
[37] Zyra e Kryeministrit, ABGJ, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore , 2020.
[38] RrGK, *Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqës në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese*, 2021, f. 69.
[39] Balkan Insight, "Tensionet politike vënë në provë unitetin e Policisë së Kosovës", [Në anglisht], 2025, paragrafi 24. RrGK, Peqja dhe Siguria në Kosovë, 2025, f. 19.,

e kuptuar dinamikën e pushtetit. Për shembull, për shkak të kësaj dinamike, një profesor nuk mund të komplimentojë një studente — një veprim i tillë përbën vepër penale. Për më tepër, policët shpesh minimizonin përvojën e viktimave dhe anonin në favor të kryerësve të dhunës. Ata gjithashtu tentonin të arsyetonin veprimet e dhunuesve kur këta i ndiqnin viktimat apo instalonin pajisje teknologjike për t'i monitoruar, duke i përshkruar këto veprime si "sjellje jo të dhunshme". PK shpesh i zvogëlonte përvojat e të mbijetuarave, veçanërisht në mungesë të dëmtimeve fizike të dukshme. Kjo tregon mungesë të kuptimit të dinamikave gjinore të pushtetit, abuzimit psikologjik dhe kontrollit.

> "
>
> Rastet po dalin nga Policia. Madje kemi raste që bëhen publike para se të arrijnë në QPS.
>
> - Burrë, QPS

Edhe pse policia deklaron se ndjek protokollet e dizajnuara për të siguruar një qasje të përqendruar te viktima dhe për të ruajtur konfidencialitetin, nevojiten përmirësime. Për shembull, në një zonë pritjeje të mbushur me njerëz që raportonin raste të ndryshme, një hetues i PK-së bërtiti nga kati i dytë: "kushdo që është këtu për dhunë në familje, të ngjitet lart."[40] Kjo e bëri viktimën të ndihej e pasigurt, e shqetësuar se identiteti i saj mund të zbulohej. Për më tepër, mediat shpesh sigurojnë informacione të ndjeshme për rastet nga policia, duke rrezikuar zbulimin e identitetit të viktimave dhe duke cenuar konfidencialitetin e tyre. Pjesëmarrësit në hulumtim shprehën shqetësime se ndonjëherë nga PK rrjedhin informacione të ndjeshme, gjë që dëmton besimin e viktimave ndaj institucioneve dhe i vë ato në rrezik.

Megjithëse Procedurat Standarde të Veprimitudhëzojnë punën e tyre, zyrtarët e PK-së nuk ndjekin një qasje të unifikuar për trajtimin e rasteve nëpër rajone të ndryshme. Për më tepër, PK përballet me mungesë të burimeve njerëzore dhe teknike. Kur viktimat raportojnë raste në polici, ato mund të intervistohen nga zyrtarë të patrajnuar apo pa arsimim të duhur, çka çon në deklarata të paplota, udhëzime të gabuara dhe potencialisht në ri-traumatizim të viktimave.[41] Raportohet se disa zyrtarë i kanë dekurajuar viktimat nga përdorimi i strehimoreve. Ndër çështjet e tjera të identifikuara përfshiheshin teknologjia e dobët për regjistrimin e intervistave dhe mungesa e fondeve të mjaftueshme. Po ashtu, është raportuar se vonesat në dorëzimin e raporteve forenzike në Prokurori kanë ndikuar në vonimin e procedurave gjyqësore.[42] Policia theksoi gjithashtu se përballet me sfida në zbatimin e ligjit për shkak të "mentalitetit" që ende mbizotëron në Kosovë. Ata thanë se një mënyrë mendimi patriarkale ende e përhapur e justifikon dhunën dhe i shtyn viktimat të vazhdojnë të jetojnë në mjedise abuzive. Nëse viktimat nuk paraqiten vetë, është e vështirë të trajtohen rastet.

> "
>
> Ligji është i mirë, por zbatimi është i vështirë. Nuk mjafton vetëm ta miratojmë standardin evropian, sepse edhe mentaliteti ynë ka ndikim.
>
> - Burrë, PK

Mungesa e mekanizmave të mjaftueshëm për monitorimin e urdhrave mbrojtës dhe mungesa e mbështetjes shtetërore shpesh i detyron të mbijetuarat të qëndrojnë me abuzuesit ose të kthehen në situata të dhunshme për shkak të varësisë financiare. Megjithëse është bërë

[40] Rast i asistuar nga RrGK, 2023.
[41] Intervistë e Rrjetit të Grave të Kosovës me përfaqësues/e të Qendrës për Punë Sociale (QPS), 2024.
[42] Intervista e RrGKS-së me prokurorët/et, 2024.

përparim në lëshimin me kohë të urdhrave mbrojtës, zbatimi i tyre mbetet i paqëndrueshëm, duke i lënë të mbijetuarat në rrezik. Ligji i vitit 2015 për Mbikëqyrjen Elektronike lejon monitorimin elektronik të personave me lëvizje të kufizuar.[43] Megjithatë, MPB e lansoi sistemin e byzylykëve elektronikë vetëm në dhjetor të vitit 2024. Vonesa në zbatimin e këtij sistemi ka penguar Policinë e Kosovës në monitorimin efektiv të urdhrave mbrojtës. Kjo vonesë kontribuoi në një rast të femicidit në vitin 2023: pavarësisht se kishte një urdhër mbrojtës aktiv, viktima u vra në një klinikë të gjinekologjisë, ku ishte gati të lindte. Ajo dhe foshnja e saj humbën jetën, ndërsa kryesi i veprës më pas vrau veten.[44] Përdorimi i byzylykëve elektronikë dhe monitorimi efektiv mund ta kishin parandaluar këtë rast.

Ekzistojnë gjithashtu probleme në zbatimin e aspekteve të ndryshme të urdhrave mbrojtës. Edhe kur urdhrat mbrojtës ndalojnë kontaktin dhe përcaktojnë detyrime për ushqim (alimentacion) për fëmijët dhe/ose bashkëshortët, të mbijetuarat shpesh duhet të paraqesin kërkesa për ekzekutim pranë gjykatave për të marrë pagesat. Dhunuesit shpesh injorojnë vendimet e gjykatës, ndërsa policia ofron ndjekje të kufizuar për zbatimin e detyrimeve për alimentacion. Kjo e vështirëson për të mbijetuarat përballimin e vështirësive ekonomike dhe arritjen e pavarësisë.

Një shqetësim i përsëritur nga pjesëmarrësit/set në intervista ishte fakti se disa oficerë/e policie që punojnë në Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje (NJHDHF) kanë qëndruar në të njëjtën pozitë për një kohë të gjatë, gjë që mund të çojë në ulje të motivimit dhe seriozitetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. "Nëpër departamente të policisë ka oficerë/e që merren me rastet e dhunës në familje, por kam vërejtur që disa janë të lodhur," vuri në dukje një prokuror. "Thonë se janë të rraskapitur nga kjo punë." Kjo mund të sinjalizojë mundësinë e djegies profesionale (burnout). Oficerët/et e Policisë së Kosovës nuk kanë qasje në mbikëqyrje psikologjike apo në shërbime të tjera të mbështetjes emocionale që do të mund ta parandalonin këtë.

Policia e Kosovës, dhe veçanërisht NJHDHF-të, kanë marrë trajnime për dhunën në familje. Megjithatë, ata theksuan nevojën për sesione shtesë dhe më të specializuara. Asnjëri/a prej oficerëve/eve të intervistuar/a nuk kishte marrë trajnim për identifikimin e shenjave të abuzimit seksual në marrëdhënie intime. Kurrikula e Akademisë Policore ende duhet të harmonizohet me Konventën e Stambollit.[45] Trajnimi për sulmet dhe ngacmimet seksuale është përfshirë vetëm në mënyrë të shkurtër brenda sesioneve më të gjera për dhunën në familje dhe nuk është trajtuar mjaftueshëm veçmas, jashtë kontekstit të marrëdhënieve familjare. Po ashtu, nuk është ofruar trajnim i mjaftueshëm për Dhunën me Bazë Gjinore të Lehtësuar nga Teknologjia.

Në përgjithësi, Policia e Kosovës ka praktika të standardizuara të menaxhimit të të dhënave. Ajo konsiderohet si një nga institucionet më efikase në ofrimin e të dhënave për Bazën Kombëtare të të Dhënave për Dhunën në Familje.[46] Megjithatë, baza e të dhënave aktualisht përfshin vetëm rastet e dhunës në familje, gjë që krijon vështirësi në ndjekjen dhe analizimin e të dhënave për format e tjera të dhunës me bazë gjinore.

[43] Republika e Kosovës, Ligji për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës.
[44] *Gazeta Insajderi*, "Hamide Magashi kishte urdhër-mbrojtje deri më 13 mars 2023", 1 dhjetor 2022.
[45] Intervistë e RrGK-së me zyrtar/e.
[46] Deklaruar gjatë takimit të Grupit Ndërministror për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave, të vëzhguar nga Rrjeti i Grave të Kosovës.

Inspektorati i Policisë

Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) është themeluar me Ligjin për Inspektoratin e Policisë së Kosovës si një organ i pavarur mbikëqyrës, i ngarkuar me inspektimin, hetimin dhe rishikimin e veprimeve dhe proceseve policore, si dhe me hetimin e ankesave ose pretendimeve për keqtrajtim apo sjellje të pahijshme të policisë.[47] IPK është përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e ankesave lidhur me mënyrën se si policia trajton rastet e dhunës me bazë gjinore; për inspektimin e njësive policore dhe procedurave të trajtimit të dhunës; për hetimin e sjelljeve të dyshuara të pahijshme ose të moszbatimit të procedurave; për rekomandimin e masave disiplinore, administrative apo njoftimeve penale kur policia dështon të veprojë siç duhet; si dhe për publikimin e gjetjeve dhe rekomandimeve me qëllim përmirësimin e praktikës dhe rritjen e llogaridhënies.

Në përgjithësi, zyrtarët/et e IPK-së tregojnë vetëdije për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe Dhunën me Bazë Gjinore të Lehtësuar nga Teknologjia, duke e njohur nevojën për forcimin e mëtejshëm të kornizës ligjore në këtë drejtim. IPK ka rishikuar trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore nga Policia e Kosovës dhe në vitin 2024 nisi një analizë më të detajuar, të pasuar nga rekomandime për Policinë e Kosovës.[48]

Megjithatë, ekzistojnë mundësi për përmirësim. Në një rast, kur RrGK-i kishte adresuar në IPK mosmarrjen e nënshkrimit të viktimës në deklaratën policore gjatë një rasti të dhunës në familje, IPK nuk ndërmori asnjë veprim. Përkundrazi, IPK e përcolli rastin tek Policia e Kosovës për hetim si shkelje disiplinore të mundshme. Kjo tregon për mungesë qartësie lidhur me ndarjen e kompetencave ndërmjet IPK-së dhe Policisë së Kosovës. Në disa raste, është e vështirë të përcaktohet nëse një rast duhet trajtuar vetëm brenda stacionit policor apo duhet referuar për mbikëqyrje nga IPK-ja. Kjo paqartësi mund të dëmtojë besimin e publikut në efektivitetin e IPK-së dhe të dekurajojë raportimin e rasteve që kërkojnë ndërhyrje.

Instituti i Mjekësisë Ligjore

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML), që vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ofron shërbime mjeko-ligjore, përfshirë kryerjen e autopsive dhe ekzaminimin e viktimave të dhunës fizike dhe seksuale.[49] Raportet e IML-së mund të jenë thelbësore për procedurat gjyqësore, pasi ato ofrojnë prova mbi faktin nëse ka ndodhur dhunë me bazë gjinore. Gjatë tre viteve të fundit, IML ka ekzaminuar nga 120 deri në 130 raste në vit, prej të cilave rreth 100 kanë përfshirë dhunë seksuale. Rreth 85% e viktimave kanë qenë vajza, dhe mbi 70% nën moshën 16 vjeçare, kryesisht nga Prishtina.

Ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, IML ka pranuar një numër të konsiderueshëm raportesh për dhunë në familje. Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e viktimave janë ekzaminuar për shkak të mungesës së stafit dhe mungesës së transportit, veçanërisht në zonat e largëta. Në 72% të rasteve, IML nuk mori mostra sepse personat mbërritën shumë vonë që mostrat të ishin të

> “
>
> Një gërvishtje apo mavijosje mund të duket e vogël, por mbetet provë fizike e kontaktit dhe dëmtimit.
>
> - Mjek/e në IML

[47] Republika e Kosovës, Ligji për inspektoratin policor të kosovës , 2010.
[48] Qeveria e kosovës, MPB, IPK, Raport Inspektimi, 31.10. 2024.
[49] MD, Instituti për Mjekësi Ligjore.

dobishme.[50] Një mjeke i IML-së theksoi: "Raportet mjekësore shpesh janë të paplota… Nganjëherë më duhet të shkruaj që nuk janë gjetur lëndime, megjithëse nuk jam i/e sigurt nëse është bërë një ekzaminim i plotë".[51] Rastet shpesh mbështeten në dokumentacion të paplotë nga institucione të tjera. Edhe pse lëndimet e vogla janë thelbësore për vlerësimet mjeko-ligjore, ato shpesh neglizhohen. "Rastet shpesh mbyllen sepse nuk ka dëmtime fizike… por dëmi emocional nga frika dhe abuzimi mund të zgjasë gjithë jetën," vuri në dukje një mjek/e i/e IML-së.[52] Megjithatë, sipas raporteve, institucionet shpesh kanë anashkaluar dëmet psikologjike në rastet e dhunës seksuale dhe asaj në familje. Mosdokumentimi i plotë i ndikimeve psikologjike mund të çojë në vendime dhe dënime të padrejta ligjore. Për këtë arsye, IML ka rekomanduar që të gjitha ekzaminimet mjekësore të kryhen vetëm nga profesionistët e trajnuar të tij, duke theksuar se institucionet e tjera shpesh nuk kanë ekspertizën e nevojshme.

Në rastet e sulmeve seksuale, IML kryen ekzaminime të plota mjeko-ligjore dhe mbledh të gjitha provat e nevojshme, ndërsa raportet tregojnë se stafi ka bashkëpunim më të mirë me Policinë e Kosovës dhe siguron reagim më të shpejtë. Ata ndjekin procedurat ligjore, sigurojnë pëlqimin e informuar të viktimës dhe i dërgojnë provat në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Raportet u dërgohen prokurorive, ndërsa stafi i IML-së shpesh dëshmon në gjykatë për të sqaruar gjetjet mjeko-ligjore.

Për shembull, gjatë një seance gjyqësore, ekspertët/et e IML-së kanë sqaruar se fakti që himeni është i paprekur nuk përjashton mundësinë e dhunës seksuale, duke theksuar rëndësinë e vlerësimit profesional dhe jo vetëm anatomik në këto raste.

Në vitin 2023, Këshilli i Evropës kritikoi mungesën e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt viktimës në ekzaminimet mjeko-ligjore të IML-së për rastet e dhunës seksuale.[53] Qasja e ndjeshme ndaj traumës, mbështetja psikologjike dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat që zgjedhin të mos paraqesin kallëzim zyrtar vazhdojnë të mungojnë, duke përbërë shkelje të Nenit 25 të Konventës së Stambollit.[54] Raporti i Këshillit të Evropës gjithashtu evidentoi probleme në qëndrimet dhe trajnimet e mjekëve që mbledhin prova, përfshirë sjellje që fajësojnë viktimën. Me vetëm një mjeke grua në staf, mundësitë për ofrimin e kujdesit të përgjegjshëm ndaj gjinisë mbeten të kufizuara.

Prokuroria

Zyra e Prokurorit të Shtetit ka rol qendror në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Prokurorët/et janë përgjegjës/e për shqyrtimin e provave, nisjen e procedimeve dhe sigurimin e kualifikimit të duhur ligjor të veprave penale. Prokurorët/et mbikëqyrin hetimet e Njësive për Hetimin e Dhunës në Familje (NJHDHF), sigurojnë që provat të mblidhen në mënyrë korrekte dhe mund të nisin procedime ex officio (automatikisht), veçanërisht në rastet që përfshijnë shkelje të urdhrave mbrojtës. Sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), prokurorët/et zgjedhin akuzat e përshtatshme bazuar në provat në dispozicion dhe pritet që të trajtojnë me përparësi rastet e dhunës me bazë gjinore. Duhet të shqyrtojnë rastet për indikatorë të rrezikut të menjëhershëm, si kërcënime të mëparshme, shkelje të urdhrave ndalues, qasje në armë, përshkallëzim të dhunës, shenja të mbytjes, rrezik për fëmijët apo sjellje kontrolluese dhe detyruese. Kur këta indikatorë janë të pranishëm, prokurorët/et duhet menjëherë të kërkojnë

[50] KE, Assessment of the alignment of Kosovo's laws, policies and other measures with the standards of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention), [Në anglisht], 2022, f. 51.
[51] Intervistë e RrGK-së me mjekun/e e IML-së, 2024.
[52] Intervistë e RrGK-së me mjekun/e e IML-së, 2024.
[53] KE, Raporti i Vlerësimit për Zbatimin e Konventës së Stambollit në Kosovë, [Në anglisht], 2023, ff. 8-9
[54] Po aty.

masa mbrojtëse urgjente, përfshirë ndalimin ose largimin e përkohshëm të kryesit/es, urdhra mbrojtës dhe masa për ndalim kontakti. Në rastet e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht të dhunës në familje, kur nisin procedura civile, prokurorët/et duhet të sigurojnë që procedurat penale të fillojnë pa vonesë kur ekzistojnë bazat ligjore. Po ashtu, janë ligjërisht të detyruar/a të ndjekin trajnime të specializuara për dhunën me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje.

Në përgjithësi, prokurorët/et treguan vetëdije për përgjegjësitë e tyre ligjore në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.[55] Megjithatë, disa ngatërruan ngacmimin seksual me sulmin seksual dhe nuk e kuptonin plotësisht që dhuna me bazë gjinore mund të prekë edhe burrat. Të tjerë nuk ishin të qartë rreth veprave specifike si gjymtimi gjenital femëror (GJGJF). Edhe pse prokurorët/et raportuan se janë në dijeni të Procedurave Standarde të Operimit (PSV) dhe të Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, shumë prej tyre nuk kishin marrë pjesë në trajnimet përkatëse. Ata e njihnin rëndësinë e konfidencialitetit, por vunë në dukje se rrjedhjet e informacionit në media shpesh e kompromet ojnë atë, duke krijuar sfida shtesë në hetimet e tyre. Prokurorët/et theksuan se infrastruktura e dobët institucionale, përfshirë hapësirën e kufizuar të zyrave, mungesën e dhomave private për intervistimin e viktimave dhe mungesën e qasjes në psikologë dhe staf mbështetës, pengon punën e tyre. Një prokurore theksoi se çrregullimet mendore të kryesve paraqesin një sfidë të madhe:

> Shumicën e rasteve i kemi me persona që kanë çrregullime mendore. Ky është problemi më i madh këtu. Po mundohemi ta menaxhojmë duke përdorur paraburgimin, që të mos lirohen. Të gjitha rastet që kemi me pasoja fatale janë të lidhura me persona të varur nga droga, alkooli ose që kanë probleme të shëndetit mendor.

Megjithatë, lidhja e veprimeve të kryesve të dhunës meshkuj vetëm me probleme mendore apo varësi nga substancat, pa marrë parasysh raportet gjinore të pushtetit, patriarkatin dhe faktorë të tjerë kontribues, mund të dëmtojë sigurimin e drejtësisë efektive për dhunën me bazë gjinore. Për më tepër, deklarata e prokurorit është problematike sepse tregon për mungesë bash-këpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse në trajtimin e rasteve të tilla.
Neni 18 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) e rregullon këtë çështje, duke përcaktuar qartë se "personi është përgjegjës penalisht, por gjykata duhet t'i marrë këto rrethana në konsideratë gjatë vendosjes së kohëzgjatjes dhe llojit të dënimit ose masës së trajtimit të detyrueshëm që e shqipton." Në praktikë, përgjegjësitë e prokurorëve/eve nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Prokurorët/et shpesh neglizhojnë kryerjen e vlerësimeve të rrezikut. Për më tepër, disa palë të interesuara raportuan se prokurorët/et nganjëherë nuk nisin procedura penale edhe kur ekzistojnë prova për veprim të paligjshëm. Edhe pse prokurorët/et janë të vetëdijshëm/me se ndjekja penale duhet të vazhdojë *ex officio* edhe nëse viktimat tërheqin deklaratat e tyre, disa prej tyre tregojnë mungesë ndjeshmërie për arsyet pse viktimat duan të përfundojnë procedurat ligjore ose hezitojnë të raportojnë dhunën — si p.sh. frika, stigmë shoqërore apo presioni dhe detyrimi i vazhdueshëm. Ndërkohë që shumica e prokurorëve/eve theksuan rëndësinë e raportimit të rasteve nga viktimat, disa prej tyre i kanë dekurajuar ato nga raportimi. Një palë e dëmtuar i ka treguar monitoruesve të RrGK-së se gjatë intervistimit, prokurori i kishte thënë: "Pse po e raporton? Mos u ngut se askush s'ka me të marrë seriozisht kur të kuptojnë çka ka ndodhë." Kjo përbën shkelje të Kodit të Etikës së Prokurorëve/eve[56], i cili kërkon që prokurori/ja të respektojë të drejtat ligjore të të gjitha palëve dhe të përmbahet

[55] Kjo pjesë bazohet në intervistat e realizuara nga RrGK në vitin 2024 me pesë prokurorë/e nga rajone të ndryshme, në intervistat me institucione të tjera, si dhe në vëzhgimet e RrGK-së.
[56] Republika e Kosovës, Kodi i Etikës dhe Sjelljes profesionale për Prokurorë, Pika 5 - Profesionalizmi i Kodit.

nga komentet që mund të ndikojnë negativisht në integritetin e institucionit. Fjalë të tilla jo vetëm që minojnë integritetin e prokurorit dhe të sistemit të drejtësisë, por gjithashtu mund të dëmtojnë thellësisht viktimat, të rrënojnë besimin e tyre në institucione, të kontribuojnë në nën-raportim,[57] dhe të dëmtojnë drejtësinë, duke lënë hapësirë për përsëritjen e dhunës.

Shembull i qasjes së pamjaftueshme të një prokurori ndaj viktimës

Gjatë një seance gjyqësore në Departamentin për të Mitur në Prishtinë, që kishte të bënte me akuzat për "Shkelje të Detyrimeve Familjare" dhe "Keqpërdorimi Seksual i Personave Nën Moshën 16 Vjeç", monitoruesi i RrGK-së vërejti se prokurorja dukej e shpërqendruar dhe e painteresuar, duke mos reaguar në momente kyçe apo ndaj deklaratave të palës së dëmtuar. Për më tepër, gjatë seancës, prokurorja i drejtohej nënës së viktimës — e cila gjithashtu kishte përjetuar dhunë në familje — me komente të papërshtatshme si: "Martesa është kompromis, e dashura ime"; "Shpesh edhe burri im më thotë: 'Kam me t'i thy dhëmbët. Kam me të vra."

Këto deklarata pasqyrojnë një normalizim shqetësues të dhunës brenda marrëdhënieve familjare dhe një tendencë për ta justifikuar atë, gjë që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e viktimës dhe të dëmtojë qasjen e saj në drejtësi.

Disa gjyqtarë/e deklaruan se prokurorët/et nuk i përgatisin mirë aktakuzat dhe se hetimet nuk janë mjaftueshëm të thelluara. Përshkrimet në aktakuza raportohen shpesh si të paqarta, duke kombinuar dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike pa sqaruar qartë veprën penale. "Prokurorët/et mbështeten tepër në deklaratën e viktimës dhe dështojnë të mbledhin prova shtesë," theksoi një gjyqtar penal. Një procedurë e plotë hetimore është thelbësore për të përcaktuar fajësinë e të pandehurit/ës. Rastet që mbështeten vetëm në dëshminë e viktimës janë veçanërisht të brishta, pasi viktima mund të tërheqë deklaratën gjatë procesit gjyqësor, duke e lënë aktakuzën pa bazë të fortë provash. Prokurorët/et duhet të veprojnë në mënyrë proaktive për të mbledhur prova shtesë, në mënyrë që rasti të mos varet vetëm nga rrëfimi i viktimës dhe drejtësia të sigurohet për krimin e kryer. Ekzistojnë gjithashtu probleme me cilësimin juridik të veprave penale. Për shembull, në vitin 2019, i pandehuri A.A. ishte akuzuar për ngacmim seksual sipas Nenit 183 të Kodit Penal të Kosovës (KPK). Aktakuza përshkruante se si A.A. kishte prekur në mënyrë të përsëritur pjesët intime të viktimës dhe njëherë e kishte kapur me forcë, e kishte puthur dhe e kishte shtrirë në shtrat, ndërkohë që ajo ishte vetëm dhe e pambrojtur. Këto veprime përputhen më shumë me veprën penale të sulmit seksual (Neni 229 i KPK-së). Për më tepër, paragrafi 3.9 i Nenit 229 parashikon dënime më të rënda kur kryesi ka marrëdhënie familjare me viktimën. Megjithatë, prokurori ngriti akuza për një vepër më të lehtë, duke minimizuar ashpërsinë e krimit duke reduktuar pasojat e mundshme ligjore. Përveç kësaj, gjatë monitorimit të seancave gjyqësore në vitet 2023–2024, RrGK vërejti shtatë raste në të cilat procedurat u shtynë për shkak të mungesës së paarsyeshme të prokurorëve të shtetit.

[57] Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP), "Drejt dhe përtej 'Jo do të thotë Jo': Thirrje për reformë në qasjen e Kosovës ndaj rasteve të përdhunimit", [Në anglisht], 2024.

Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK është organi udhëheqës i sistemit prokurorial.[58] Këshilli është përgjegjës për rekrutimin, emërimin, avancimin, transferimin, trajnimin, vlerësimin dhe llogaridhënien disiplinore të prokurorëve/eve. Mandati i KPK përfshin sigurimin që sistemi të jetë profesional, i pavarur dhe i paanshëm, si dhe të reflektojë barazinë gjinore dhe përbërjen shumetnike. Në lidhje me dhunën me bazë gjinore, KPK ka për detyrë të sigurojë trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve/eve për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Meqë KPK ka autoritet mbi masat disiplinore, një prokuror/e që dështon vazhdimisht të përmbush detyrimet e tij/saj (p.sh., të nis ndjekjen penale kur është e nevojshme ose të mbroj viktimat) mund t'i nënshtrohet shqyrtimit disiplinor nga KPK-ja.

Raportet e publikuara nga KPK tregojnë pak raste të masave disiplinore të marra në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka gjetur se nga 11 masat disiplinore të shqiptuara nga KPK në periudhën 2023–2024 për raste të ndryshme, nëntë (81.8%) kanë qenë vërejtje me shkrim publike ose jo publike.[59] Po ashtu, KPK kishte "vendosur vetëm një ulje page prej 30% për një periudhë njëvjeçare ndaj prokurores Hava Krasniqi", megjithëse ishte konstatuar se ajo kishte dështuar të vlerësonte rrezikun dhe të ndërmerrte veprime të menjëhershme ligjore në një rast dhune në familje. Ky shembull tregon se edhe kur merren masa disiplinore, ato nuk pasqyrojnë mjaftueshëm seriozitetin e shkeljeve, ndikimin e rëndë që këto dështime kanë mbi viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe mesazhin që u përcillet institucioneve dhe shoqërisë.

Mbrojtësit e Viktimave

Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave (ZMNV) funksionon në kuadër të Zyrës së Prokurorisë së Shtetit. Zyra është themeluar për të mbështetur viktimat e dhunës me bazë gjinore, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF).[60] Mbrojtësit e Viktimave (MV) duhet t'u ndihmojnë viktimave të kuptojnë të drejtat e tyre, të kërkojnë urdhra mbrojtjeje, të kryejnë vlerësime të rrezikut, t'i përfaqësojnë gjatë procedurave gjyqësore dhe të menaxhojnë linjën pa pagesë, 24-orëshe, për mbështetje të menjëhershme dhe referime. Ata/ato janë gjithashtu përgjegjës/e për paraqitjen e kërkesave në Fondin e Kompensimit të Viktimave.[61]

Shumica e MV-ve ishin të njohur/a me kuadrin ligjor, si LMDHF, Procedurat Standarde të Veprimit(PSV) dhe Protokollin për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.[62] Megjithatë, ata/ato shpesh përdornin termat "dhunë me bazë gjinore" dhe "dhunë në familje" si sinonime, gjë që tregon konfuzion mbi dallimet ligjore ndërmjet tyre. Pavarësisht viteve të trajnimeve, MV-të theksuan nevojën për ngritje të mëtejshme të kapaciteteve, duke përmendur mentalitetin patriarkal si pengesë të vazhdueshme. Për shembull, një MV burrë deklaroi: "Sfida këtu është që në shumë raste të dhunës seksuale, viktimat mund të mos e thonë të vërtetën... pastaj gjatë ekzaminimeve mjeko-ligjore dalin çështje të tjera." Kjo deklaratë sugjeron se jo të gjithë MV-të i marrin seriozisht deklaratat e viktimave, duke lënë hapësirë për dyshime. Një qasje e tillë mund t'i bëjë viktimat të ndihen të gjykuara, e jo të besuara. Kjo mungesë besimi mund të vështirësojë

[58] Kuvendi i Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
[59] Instituti i Kosovës për Drejtësi, Si duket korporatizimi dhe pandëshkueshmëria në sistemin prokurorial?, 2024.
[60] LMDHF, Neni 16.
[61] ABGJ, PSV-të, 2013; SKMDHF 2022-2025, Kuvendi i Kosovës, Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit; SKMDHF 2022-2025.
[62] Kjo pjesë bazohet në intervistat e realizuara nga RrGK me gjashtë Mbrojtësit e Viktimave nga rajone të ndryshme në vitin 2024, në intervistat me zyrtarë të tjerë, si dhe në vëzhgimet e RrGK-së.

proceset mjeko-ligjore dhe menaxhimin e rasteve, pasi fokusi zhvendoset nga mbrojtja e viktimës tek kërkimi i "mospërputhjeve" në dëshminë e saj. Mosbesimi mund t'i dekurajojë viktimat të flasin hapur ose të kërkojnë ndihmë, duke rritur rrezikun e përsëritjes së dhunës. Për më tepër, sipas një drejtoreje të strehimorës, disa MV e kanë minimizuar dhunën seksuale, duke thënë: "Është normale, është burri i saj'."

MV-të raportuan mungesë të stafit në shumicën e komunave, ngarkesë të madhe pune, mungesë transporti për të marrë pjesë në gjykata dhe hapësira të kufizuara zyre. Në disa raste, viktimat janë detyruar të rrëfejnë përjetimet e tyre në prani të viktimave të tjera, për shkak të hapësirave të përbashkëta, duke cenuar konfidencialitetin. Për shkak të mungesës së resurseve njerëzore, pavarësisht detyrimeve ligjore, MV-të nuk kanë qenë gjithmonë të pranishëm/me në stacionet e policisë kur viktimat japin deklaratat e tyre. Kjo mund të çojë në riviktimizim, pasi viktimat detyrohen të tregojnë historinë e tyre disa herë para institucioneve të ndryshme të drejtësisë. Mungesa e resurseve njerëzore mund të ndikojë gjithashtu që MV-të të mos e informojnë mjaftueshëm viktimën për të drejtat apo procedurat gjyqësore, si dhe të shkaktojë vonesa në sigurimin e mbrojtjes. Për shembull, në një rast të vitit 2024, një grua që kishte kërkuar urdhër mbrojtjeje nuk ishte kontaktuar asnjëherë nga MV-ja. Pas një muaji, kur ajo shkoi vetë në zyrë, MV-ja i tha: "Oh, je me fat që s'të ndodhi gjë, sepse krejt harrova". Kjo neglizhencë përbën shkelje të LMDHF-së, [63] e cila përcakton se MV-të duhet të ndihmojnë viktimat në dorëzimin e kërkesave për urdhër mbrojtjeje dhe mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm. Mungesa e këtij veprimi e kishte vënë në rrezik sigurinë e viktimës.

Për shkak të mungesës së stafit, MV-të shpesh nuk marrin pjesë në seanca gjyqësore, megjithëse janë të detyruar ligjërisht ta bëjnë këtë. Në mënyrë shqetësuese, nga 76 seanca gjyqësore të monitoruara nga RrGK në Departamentin e Përgjithshëm të Prishtinës, vetëm në një seancë ishte i pranishëm një MV. Në mënyrë të ngjashme, monitorimi i 50 rasteve nga Instituti i Drejtësisë i Kosovës zbuloi se vetëm 38% e rasteve kishin përfaqësim dhe vetëm 26% përfaqësoheshin nga MV-të.[64] Mungesa e kohës ndikon edhe në përgatitjen dhe paraqitjen e provave në gjykatë. Në një rast tjetër, të monitoruar nga RrGK, në Pristinë në Departamentin e Përgjithshëm të Divizionit Civil në Mars 2023, MV-ja nuk paraqiti prova për të mbështetur pretendimet e viktimës për dhunë fizike dhe psikologjike. Viktima nuk ishte informuar për të drejtat e saj apo procedurat para seancës. Ajo më pas deklaroi se nuk kishte paraqitur prova fotografike nga frika e hakmarrjes nga familja e ish-bashkëshortit, ndonëse këto prova mund të kishin ndihmuar në sigurimin e drejtësisë dhe mbrojtjes së saj. Monitorimi i RrGK-së, i ilustruar nga këto shembuj, tregon mospërputhje serioze me PSV-të, të cilat kërkojnë që MV-të të informojnë viktimat për ndihmën ligjore, t'i shoqërojnë në gjykatë dhe, kur është e nevojshme, t'i përfaqësojnë në mungesë të një përfaqësuesi tjetër ligjor.

[63] Kuvendi i Kosovës, LMDHF, Neni 16, pikat 1.3 dhe 1.4 (f. 99).
[64] Instituti i Kosovës për Drejtësi, *Kompensimi për Viktimat e Dhunës në Familje*, Prishtinë: 2023.

Rast: Tërheqja e Kërkesës për Urdhër Mbrojtës

Gjatë një seance në mars 2022, pala e mbrojtur e tërhoqi kërkesën e saj për urdhër mbrojtës, pavarësisht se kishte përjetuar dhunë fizike nga partneri i saj, duke deklaruar: "Kjo ka ndodhur vetëm një herë gjatë martesës sonë, prandaj dua ta fal."

Pala përgjegjëse e pranoi se e kishte goditur bashkëshorten, duke e justifikuar veprimin me fjalët se "nuk ndalej duke folur" dhe se "zëri" e kishte shqetësuar. Ai shtoi më tej: "Mund ta pyetni gruan time nëse ndonjëherë kam ushtruar dhunë përsëri ndaj saj." Mbrojtësi Viktimës mbështeti tërheqjen e kërkesës nga pala e mbrojtur, gjë që është shqetësuese në kontekstin e një rasti me dhunë të pranuar, pasi reflekton mungesë mbështetjeje institucionale adekuate. Tërheqja e kërkesës për urdhër mbrojtës mund ta ekspozojë viktimën ndaj rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe të minojë qëllimin parandalues të këtyre masave. Në këtë rast, Mbrojtësi i Viktimës duhej ta këshillonte viktimën, në mënyrë të ndarë dhe individuale, që ta mendonte me kujdes vendimin, nivelin e rrezikut, si dhe mekanizmat institucionalë të mbështetjes që i qëndronin në dispozicion.

MV-të duhet gjithashtu të mbështesin viktimat në dorëzimin e kërkesave për kompensim. Edhe pse në të kaluarën ka pasur vonesa, ky proces është përmirësuar vitet e fundit, dhe më shumë ankesa po adresohen në Komisionin e Kompensimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Disa MV kanë qëndruar në të njëjtin pozicion për më shumë se 20 vjet, pa mbikëqyrje adekuate, mbështetje psikologjike apo mundësi zhvillimi profesional. Ky ekspozim i zgjatur ndaj punës me trauma, pa mbështetje institucionale, ka çuar në lodhje emocionale, stres dhe rënie të mirëqenies. Një Mbrojtëse e Viktimave (MV) nga Prishtina tha: "Dikur i mbaja mend gjërat, isha e qetë. Tash jam bërë nervoze — me kolegët, me familjen, me miqtë… Kam zhvilluar disa zakone të këqija; nuk mbaj mend asgjë si më parë, dhe e gjitha kjo është pasojë e punës që bëj." Këto kushte ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve që ofrojnë MV-të dhe rrisin rrezikun për traumë sekondare. Mbështetja psikologjike për Mbrojtësit e Viktimave vazhdon të mungojë, duke i lënë ato të përballen të vetme me barrën emocionale të rasteve të rënda me të cilat punojnë çdo ditë.

Ndihma Juridike

Në vitin 2022, Kosova ndryshoi Ligjin për Ndihmë Juridike Falas, duke zgjeruar automatikisht qasjen për disa grupe të cenueshme.[65] Këtu përfshihen viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe dëshmitarët që varen nga të tjerët. Aplikueset/it nga këto kategori nuk janë më të detyruar/a të plotësojnë kriteret financiare dhe juridike për t'u kualifikuar për ndihmë juridike falas. Zyrtarët/et e Ndihmës Juridike (ZNJ-të) janë të mandatuar/a të informojnë viktimat për të drejtat e tyre, të ofrojnë këshillim ligjor, të përgatisin dokumentacionin përkatës dhe t'i përfaqësojnë ato në procedura penale, civile dhe administrative. Edhe pse ZNJ-të (Zyrtarët/et e Ndihmës Juridike) mund të paraqesin kërkesa në mënyrë të pavarur, ato duhet të koordinohen me institucione të tjera në çështje si divorci, kujdestaria e fëmijëve dhe alimentacioni, veçanërisht në rastet kur gjykata paraqet kërkesa shtesë. Ata/ato duhet të bashkëpunojnë me institucione të tjera për çështje si divorci, kujdestaria e fëmijëve dhe alimentacioni.

> "
>
> Gratë duhet ta ruajnë institucionin e familjes sepse ai po shkon në drejtim të gabuar. Po degradohet. Gratë e mençura i tejkalojnë gjërat. Nuk po them të mos raportohet kur ka dhunë të tepruar, por për gjëra të vogla, mos e shkatërroni institucionin e familjes sepse është shumë i rëndësishëm.
>
> - Grua, ZNJ
>
> "
>
> Ajo ia la hapësirën [për ngacmim seksual], prandaj ai mund t'i thoshte ato fjalë.
>
> - Grua, ZNJ

ZNJ-të në përgjithësi ishin të njohur me ndryshimet në Ligjin për Ndihmë Juridike Falas dhe me faktin se dhuna në familje, ngacmimi seksual, përndjekja dhe GJGJF-ja përbëjnë vepra penale. [66] Megjithatë, ata/ato kishin njohuri të kufizuara për SKMDHF-në dhe PSV-të, ndonëse shumë nga përgjegjësitë e tyre lidhen drejtpërdrejt me këto korniza. Ndërsa posedonin njohuri mbi dhunën në familje, shpesh mungonte mirëkuptimi për format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Për shembull, një ZNJ e përshkroi gabimisht përndjekjen si një situatë ku një individ ndiqet nga organet e rendit. Disa zyrtarë/e refuzuan të përgjigjen në pyetje që lidhen me dhunën me bazë gjinore për shkak të pasigurisë. Trajnimet për ZNJ-të janë ende në zhvillim dhe të detyrueshme për rastet e dhunës në familje.[67] megjithatë, ata/ato nuk ishin të sigurt/a nëse trajnimet kanë përfshirë format e tjera të dhunës me bazë gjinore, si ngacmimi seksual, apo mënyrat për të identifikuar shenjat e abuzimit.

Disa ZNJ shprehën dyshime mbi legjitimitetin e raportimeve për dhunë me bazë gjinore, duke thënë: "Ka më shumë raportime sesa dhunë reale." Kjo, si dhe deklarata të tjera të ngjashme nga ZNJ-të, ilustron mungesë shqetësuese të besimit ndaj viktimave. Për më tepër, ata/ato shpesh priren të fajësojnë viktimat për dhunën e përjetuar. Kjo jo vetëm që minimizon dëmin e përjetuar nga viktimat, por edhe nxit ndjenja faji e vetë-fajësimi. Si pasojë, qëndrime të tilla krijojnë një mjedis mosbesimi dhe dyshimi që mund t'i dekurajojë viktimat nga raportimi i

[65] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-035 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, 2022.
[66] Kjo pjesë bazohet në intervistat e realizuara nga RrGK me gjashtë ZNJ nëpër Kosovë gjatë vitit 2024.
[67] Ata raportuan se kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga akterë të ndryshëm, përfshirë OShC-të, GIZ-in, USAID-in, Akademinë e Drejtësisë, OSBE-në dhe Këshillin e Evropës.

dhunës. Mungesa e kuptimit të natyrës gjinore të dhunës mund të çojë në mbështetje të pamjaftueshme. Shumica e ndihmës juridike është ofruar në raste civile, veçanërisht në procedura divorci, kujdestarie dhe alimentacioni. Ndërkohë, rastet penale trajtohen nga prokurorët dhe Mbrojtësit e Viktimave (MV-të). Një ZNJ mashkull shpjegoi:

> Procedurat penale trajtohen nga prokurorët/et që përfaqësojnë interesat e viktimës në gjykatë, së bashku me mbrojtësit e viktimave. Meqë tashmë janë dy institucione që e përfaqësojnë viktimën, përfshirja jonë si palë e tretë është e panevojshme. Sipas mendimit tim, këto institucione ofrojnë përfaqësim të mjaftueshëm dhe dinjitoz, ndaj çdo ndërhyrje shtesë do të ishte e tepërt.

ZNJ-të mund të caktojnë një mbrojtës për të përfaqësuar interesat e palës. Megjithatë, për shkak të kufizimeve në burime, ZNJ mund të vendosë të mos caktojë një mbrojtës nëse vlerëson se viktima tashmë ka një përfaqësim tjetër ligjor.[68] Megjithatë, boshllëqet ekzistojnë në koordinimin e mbështetjes për viktimat, veçanërisht në sigurimin e vazhdimësisë së ndihmës ndërmjet procedurave civile dhe penale, ku viktimat shpesh përballen me sfida të mbivendosura ligjore, psikologjike dhe socio-ekonomike. Koordinimi ndërmjet përfaqësuesve ligjorë në rastet që përfshijnë njëkohësisht procedura penale dhe civile është thelbësor. ZNJ-të përballen edhe me sfida praktike, si sigurimi i transportit deri te strehimoret për të marrë dhe dokumentuar deklaratat e viktimave. Përveç kësaj, ato hasin mungesë serioze të stafit. Për shembull, shpesh ndodh që një zyrtar/e të detyrohet të kujdeset për fëmijët e viktimës, ndërsa një tjetër ZNJ zhvillon dëgjimin dhe merr dëshminë e saj. Kjo tregon mungesën e burimeve njerëzore dhe ngarkesën e tepërt që e vështirëson ofrimin e mbështetjes së plotë dhe profesionale për viktimat.

Gjykatat

Shtatë gjykata themelore të shpërndara gjeografikisht në gjithë Kosovën shërbejnë si gjykata të shkallës së parë.[69] Ato duhet t'i japin përparësi trajtimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke i shqyrtuar ato përmes procedurave civile ose penale, varësisht nga rasti.[70] Gjykatat civile janë përgjegjëse për lëshimin e Urdhrave Mbrojtës (UM), Urdhrave të Mbrojtjes Emergjente (UME) dhe për zgjidhjen e çështjeve të lidhura me të drejtën familjare, si divorci, kujdestaria, alimentacioni dhe mosmarrëveshjet pronësore, të cilat shpesh janë të ndërlidhura me dhunën me bazë gjinore. Në rastet penale, gjykatat shqyrtojnë veprat penale, përfshirë shkeljet e urdhrave mbrojtës.[71] Gjykatat duhet t'i trajtojnë të gjitha palët me dinjitet dhe paanshmëri, të sigurojnë mbrojtje për personat e përfshirë dhe të marrin parasysh rrethanat rënduese gjatë përcaktimit të dënimeve. Po ashtu, ato janë të detyruara t'i informojnë palët për të drejtat e tyre dhe për pasojat e moszbatimit të tyre.[72] Kjo pjesë fillimisht shqyrton njohuritë, qëndrimet dhe performancën e gjyqtarëve/eve, duke u fokusuar në zbatimin e Konventës së Stambollit. Më pas, nënseksionet diskutojnë gjykatat penale dhe civile, duke marrë parasysh rolet e tyre të veçanta. Pjesa mbështetet në intervistat e RrGK-së me 13 gjyqtarë/e, si dhe me

[68] Koment nga monitorimi i rasteve.
[69] Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat në Republikën e Kosovës, 2018.
[70] MD, SKMDHF, 2022, f. 28.
[71] Po aty.
[72] Po aty.

përfaqësues/e të institucioneve të tjera, në vëzhgimin e 292 seancave në gjykatat themelore dhe në hulumtime të tjera.[73]

Njohuritë dhe Qëndrimet ndaj Dhunës me Bazë Gjinore

> “
>
> Edhe pse ligji [LMDHF] ka ndryshuar, gjyqtarët/et civilë/e dhe penalë/e nuk janë trajnuar posaçërisht për dispozitat e reja.
>
> - Gjyqtare e gjykatës civile

Gjykatësit në përgjithësi e dinin rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit. Disa prej tyre thanë se i kishin lexuar Procedurat Standarde të Operimit, por nuk i kishin zbatuar në praktikë. Të tjerë ishin plotësisht të vetëdijshëm për përmbajtjen e tyre dhe për detyrimet që u dalin nga to. Gjykatësit civilë dhe penalë në përgjithësi ishin të njohur me veprat penale të dhunës me bazë gjinore të përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës (KPK). Megjithatë, u vunë re mospërputhje në kuptimin e tyre për veprat më të ndërlikuara. Disa gjykatës u hasën në vështirësi në përcaktimin e nocionit “Nxitje për ekspozimin e pjesëve intime të trupit”. Për shembull, një gjykatës civil e përshkroi paqartë si përfshirje të të miturve apo personave të cenueshëm.

Edhe përkufizimet e gjymtimit gjenital femëror (GJGJF) ndryshonin midis gjykatësve, dhe përgjigjet e tyre sugjeronin se kjo vepër ende nuk kuptohet plotësisht.

Njësoj, edhe kuptimi i ngacmimit seksual ishte i paqëndrueshëm — një gjykatës civil tha: “Nuk e kam një përkufizim të saktë se çfarë nënkupton. Por, sigurisht që është një formë e dhunës seksuale, mendoj.”Nuk e di nëse përcaktohet kështu sipas Kodit.” Sulmi seksual përgjithësisht përkufizohej si kontakt pa pëlqim, por disa gjyqtarë/e dhanë përshkrime të paqarta dhe të pasakta si “një veprim pa e ditur pala tjetër”. Edhe pse gjyqtarët/et civilë/e nuk janë ligjërisht të detyruar/a të kenë njohuri të thelluara për këto vepra, ata/ato duhet të jenë të kujdesshëm/me gjatë shqyrtimit të rasteve — nëse vërejnë shenja të një vepre penale, duhet të konsultojnë KPK-në dhe të sigurojnë referimin për ndjekje penale kur është e nevojshme.

Njohuritë e gjyqtarëve/ve për dhunën në familje ishin më të qëndrueshme; ata/ato e përmendnin saktë dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale. Megjithatë, kishte përjashtime. Kur u pyetën nëse është e pranueshme që një bashkëshort xheloz të ndjekë gruan e tij, një gjyqtar penal u pajtua. I njëjti gjyqtar tha se kontrollimi i pajisjeve teknologjike të gruas nuk përbën dhunë në familje — megjithëse e përbën. Edhe pse ai pranoi se sjellja është e papërshtatshme, deklaroi se “do të bënte të njëjtën gjë”. Kur u pyetën si duhet të reagojnë viktimat ndaj dhunës në familje, të gjithë gjyqtarët/et theksuan rëndësinë e raportimit të menjëhershëm, veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijë.

Njohuritë për Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale ndryshonin: disa gjyqtarë/e ishin tërësisht të informuar/a, disa pjesërisht, e disa nuk kishin dijeni fare. Disa gjyqtarë/e, sidomos në gjykatat civile, nuk ishin të vetëdijshëm/e që ekzistonte ky Protokoll, ndërsa të tjerë nuk dinin si ta zbatonin atë. Po ashtu, lidhur me Kurrikulën për Trajtimin e Dhunuesve, disa gjyqtarë/e pranuan se nuk kishin kërkuar masa rehabilituese, meqë këto masa janë ende në fazë pilotimi.

[73] Nga janari 2021 deri në dhjetor 2024, RrGK ka monitoruar gjithsej 257 raste të dhunës me bazë gjinore në Prishtinë, 30 në Ferizaj, 2 në Mitrovicë, 2 në Pejë dhe 1 në Gjilan. Numri më i madh i rasteve të monitoruara në Prishtinë lidhet me faktin se aty raportohen më shumë raste, por edhe me burimet njerëzore të disponueshme dhe lehtësinë e qasjes. Në komunat e tjera janë monitoruar vetëm rastet e profilit të lartë ose ato që kanë kërkuar ndihmë nga RrGK.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se njohuritë — dhe për rrjedhojë edhe zbatimi i kuadrit ligjor — janë të pabarabarta.

Gjyqtarët/et raportuan se kishin marrë pjesë në trajnime për dhunën në familje, të ofruara nga Këshilli i Evropës, Akademia e Drejtësisë dhe OSBE-ja. Megjithatë, një gjyqtar vuri në dukje se Akademia e Drejtësisë ofron "një numër shumë të kufizuar temash për dhunën në familje". Gjyqtarët/et theksuan nevojën për më shumë trajnime të specializuara, veçanërisht mbi ngacmimin seksual, i cili ende nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë.

Reagimi Gjyqësor në Gjykatat Civile

Gjyqtarët/et vërejtën se pengesa sistemike, siç është varësia ekonomike, shpesh i shtyjnë viktimat të tërheqin kërkesat e tyre për urdhra mbrojtës. Disa gjyqtarë/e i paralajmëruan viktimat që të mos i tërheqin kërkesat, pasi një veprim i tillë mund t'i ekspozojë ato ndaj rrezikut. Ndërkohë, të tjerë i toleruan madje edhe i inkurajuan pajtimet. Për shembull, në Prishtinë, një bashkëshorte dhe dy fëmijë kërkuan një urdhër mbrojtës. Jashtë procesverbalit zyrtar të gjykatës, gjyqtari u tha palëve (personit të mbrojtur dhe të padituri): "Ka dhunë, prej të cilës rrjedhë përsëri dhuna. Dhuna ndryshon nga rasti në rast, dhe nuk ka nevojë të nxitoni për të marrë vendime të shpejta. Ligji parasheh se mund të pajtoheni nëse ka hapësirë për këtë." Pozita e fuqisë dhe ndikimit të një gjyqtari mund të bindë viktimën që të tërheqë kërkesën për urdhër mbrojtës, gjë që minon qëllimin e ligjit për të ofruar mbrojtje të menjëhershme nga dhuna në familje dhe mund ta vërë viktimën në rrezik të përsëritjes së dhunës, madje edhe të vdekjes.

> "Kam raste kur kam lëshuar një urdhër mbrojtës, dhe pas një jave viktima vjen dhe kërkon ta heqë, sepse janë pajtuar.
>
> - Gjyqtar/e i/e Gjykatës Civile

Thuhet se nganjëherë urdhrat mbrojtës (UM) nuk lëshohen sepse Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Mbrojtësit e Viktimave (MV) nuk përgatisin dokumentacion të mjaftueshëm për të informuar procedurat gjyqësore. "Në shumicën e rasteve marrim vetëm një deklaratë, pa prova të bashkëngjitura… dhe nuk mund të lëshojmë një urdhër mbrojtës vetëm mbi bazën e deklaratës së një pale," tha një gjyqtar civil. Është thelbësore që akterët që ndihmojnë viktimat në përgatitjen e dokumentacionit të sigurojnë që informacioni dhe provat përkatëse të dorëzohen. Përgatitja e pamjaftueshme mund të vështirësojë mbrojtjen ligjore dhe të ekspozojë viktimat ndaj vazhdimit ose përshkallëzimit të dhunës.

> "Zakonisht raportet e QPS-së janë pak të mangëta, po ashtu edhe kërkesat për urdher mbrojtje, që i parashtorjnë zyra për mbrojtjen e viktimave jane te mangëta.
>
> - Gjyqtar/e i/e Gjykatës Civile

Ndërkohë, deklarata e gjyqtarit nuk është e përqendruar te viktima, pasi e vendos barrën e provës mbi të, çka nuk është në përputhje me Konventën e Stambollit, e cila thekson se autoritetet duhet të prioritizojnë sigurinë e menjëhershme të viktimës dhe të sigurojnë mbrojtje bazuar në vlerësimin e rrezikut, pa vendosur kërkesa të tepruara për prova apo procedura formale. Pjesëmarrësit/et në hulumtim kanë theksuar vazhdimisht mangësitë në zbatimin e Urdhërave Mbrojtës. Për shembull, një pjesëmarrëse theksoi se dështimi i dhunuesve për të përmbushur detyrimet për ushqim (alimentacion) cenon më tej qasjen e viktimave në drejtësi dhe forcon ciklin e varësisë dhe cenueshmërisë ndaj dhunuesit. Gjykatat duhet të sigurojnë

zbatimin e detyrimeve për ushqim kur ato nuk respektohen. Po ashtu, u raportua se shumë dhunues thjesht presin të skadojnë urdhrat mbrojtës për të rifilluar dhunën. Në raste të tilla, disa gjyqtarë/e civilë/e kanë deklaruar se: "nuk ka arsye për ta zgjatur urdhrin; dhuna emocionale nuk mjafton." Kjo tregon një dobësi sistemike në funksionimin e UM-ve: sapo detyrimet ligjore skadojnë, mbikëqyrja ndalet, duke ekspozuar viktimat ndaj dhunës së përsëritur. Refuzimi për të zgjatur urdhrat mbrojtës vetëm sepse nuk ka pasur dhunë të re fizike tregon dështim të gjykatave për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse rrezikun e vazhdueshëm ndaj viktimave, i cili nuk zhduket domosdoshmërisht pas gjashtë muajsh apo një viti. Mungesa e ndjekjes së vazhdueshme për zbatimin e kërkesave ekzistuese të UM-ve, si alimentacioni apo zgjatja e tyre, nënvlerëson përpjekjet për të parandaluar dhunën dhe përsëritjen e saj (recidivizmin).

Reagimi Gjyqësor në gjykatat penale

Gjyqtarët/et penalë/e trajtojnë veprat penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Gjatë intervistave, gjyqtarët/et theksuan urgjencën për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, megjithatë ndryshonin në interpretimin dhe qasjen e tyre ndaj këtyre rasteve. Ata/o identifikuan disa sfida në zbatimin e Kodit Penal të Kosovës (KPK), veçanërisht në rastet e dhunës në familje, përfshirë sfida ligjore, procedurale dhe kulturore. Nënseksionet në vijim trajtojnë disa nga çështjet kyçe të identifikuara lidhur me reagimin gjyqësor ndaj dhunës me bazë gjinore në procedurat penale.

Minimizimi i Dhunës, Argumentet Kulturore dhe Fajësimi i Viktimës

Gjatë intervistave, disa gjyqtarë/e paralajmëruan kundër mbështetjes së tepërt në masa penale, duke thënë: "Procedura penale nuk duhet të jetë mjeti i parë." Kjo sugjeron se disa gjyqtarë/e mund të hezitojnë të aplikojnë ndjekjen penale edhe kur janë kryer vepra të dhunshme. Një tjetër gjyqtar deklaroi: "Dhuna e vërtetë që ushtrohet nëpër disa familje ende nuk raportohet. Raportohen vetëm raste këtu e atje, kur ndodh ndonjë fjalosje apo kapje për flokësh, dhe menjëherë cilësohen si dhunë në familje — që unë e konsideroj më shumë si mosmarrëveshje bashkëshortore. Nuk është njësoj të jetosh në Danimarkë, Suedi apo në Kosovë — duhet pak t'u përshtatim edhe ligjet realitetit tonë." Megjithatë, veprime të tilla përbëjnë vepër penale, dhe shpesh shoqërohen me forma të tjera dhune, si dhuna psikologjike dhe kontrolli, të cilat mund të jenë paralajmërime për dhunë më të rëndë në të ardhmen. Minimizimi i këtyre veprimeve nga gjyqtarët/et mund të lejojë përsëritjen e dhunës (recidivizmin). Prandaj, argumentet kulturore nuk duhet të përdoren asnjëherë si justifikim apo si bazë në vendimmarrje për rastet e dhunës në familje. Gjyqtarët/et duhet të zbatojnë Kodin Penal të Kosovës (KPK) në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të mbijetuarave/ve të dhunës.

I njëjti gjyqtar shprehu bindjen se koncepti i lirisë shpesh keqkuptohet, veçanërisht nga gratë e reja, gjë që mund t'i çojë ato në situata të rrezikshme.

Ai sugjeroi se gratë "hyjnë me dëshirë" në ambiente që mund t'i ekspozojnë ndaj rrezikut, si p.sh. nëpër dhoma hoteli, duke thënë se gratë duhet të "mendojnë mirë" rreziqet që lidhen me veprimet e tyre.

Deklarata të tilla përbëjnë fajësim të viktimës, pasi gjyqtari ia atribuon përgjegjësinë e dhunës vetë gruas, në vend që të mbajë përgjegjës autorin e dhunës.

> "Nuk shkon [në hotel] për të parë televizor. As nuk shkon për të luajtur letra. As për të folur për NASA-n.[74]
>
> - Gjyqtar i gjykatës penale

[74] Administrata Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës.

Fajësimi i viktimës cenon të drejtat e të mbijetuarave/ve, dobëson besimin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe përforcon stereotipe të dëmshme që mund t'i pengojnë viktimat e tjera të kërkojnë drejtësi. Ka prova që tregojnë se disa gjyqtarë/e mund të marrin parasysh në mënyrë të gabuar faktorët kulturorë gjatë vendimmarrjes, veçanërisht në raste që përfshijnë komunitetet etnike pakicë. Për shembull, disa raste kanë përfshirë martesat e hershme, kryesisht në komunitetet Rome, Ashkalie dhe Egjiptiane. Një gjyqtar përmendi një rast ku i pandehuri ishte akuzuar për përdhunim, por marrëdhënia seksuale nuk kishte ndodhur. Ai komentoi: "Kulturalisht, ata martohen të rinj… por ligjërisht, edhe një puthje mund të çojë në dënim me pesë vjet burg. Ligji nuk përputhet gjithmonë me realitetin e jetuar." Kjo deklaratë tregon se gjyqtari nuk e kupton rëndësinë e ndalimit të dhunës ndaj grave, pavarësisht praktikave kulturore, siç kërkohet nga CEDAW dhe Konventa e Stambollit (KS). Kodi Penal i Kosovës (KPK) përcakton qartë se detyrimi, shfrytëzimi seksual dhe bashkëjetesa jashtëmartesore me të mitur janë të ndaluara dhe përbëjnë vepra penale.[75] Gjyqtarët/et që përdorin justifikime të tilla kulturore mund të shqiptojnë dënime më të lehta, duke anashkaluar marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit që ndikojnë tek vajzat që martohen në moshë të re, shpesh edhe kundër vullnetit të tyre. Kjo praktikë jo vetëm që nënvlerëson rëndësinë e mbrojtjes së vajzave dhe grave, por edhe mundëson vazhdimin e pabarazive dhe dhunës ndaj tyre, duke normalizuar sjellje që janë në kundërshtim me parimet e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.

Mungesë e provave për shkak të tërheqjes së dëshmive

Kodi i Procedurës Penale (KPP) i jep bashkëshortit/es apo partnerit/es jashtëmartesore të të pandehurit/es të drejtën për të refuzuar dhënien e dëshmisë, përveç në rastet kur vepra penale dënohet me pesë ose më shumë vite burgim dhe personi është pala e dëmtuar.[76] Një gjyqtar theksoi se kjo dispozitë paraqet një sfidë të madhe, pasi anëtarët e familjes shpesh tërhiqen nga dhënia e dëshmisë në rastet ku dënimi parashikohet nën pesë vite burg, duke i lënë prokurorët/et pa prova të mjaftueshme për të vazhduar procedurën: "E kanë shfrytëzuar këtë të drejtë dhe prokurori/ja ka mbetur pa prova; nuk mund ta përfundojmë rastin e dhunës në familje." Sfida të ngjashme janë vërejtur edhe në rastet e veprave më të rënda, si ngacmimi seksual, ku hezitimi i viktimave për të dëshmuar mund të çojë në mungesë të provave. Në një rast, viktima u tërhoq nga ndjekja penale, duke deklaruar: "Dua të përfundojë kjo punë sepse vëllai im dhe këta njerëz janë marrë vesh." Sjellja e saj tregonte frikë dhe mungesë të kuptimit të pasojave të vendimit apo rrezikut të mundshëm. Në raste të tilla, institucionet duhet të vlerësojnë me kujdes nëse viktima është e aftë të përfaqësojë interesat e saj dhe të sigurojnë mbrojtjen e plotë të të drejtave të saj sipas legjislacionit në fuqi. Një qasje jo e përgjegjshme ndaj këtyre rasteve rrezikon të forcojë dinamikat e dhunës. Institucionet e drejtësisë duhet t'i trajtojnë me seriozitet rastet e tërheqjes së dëshmive, duke siguruar që viktimat të marrin këshillim, mbrojtje dhe mbështetje adekuate, si dhe që ndaj kryesit të dhunës të merren masa ndëshkuese ose rehabilituese të përshtatshme. Në çdo rast, procedurat penale duhet të

[75] Neni 240, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK):
"Një i rritur që bashkëjeton në një marrëdhënie jashtëmartesore me një person të moshës 14–16 vjeç dënohet me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet." KPK-ja nuk e rregullon në mënyrë të qartë martesën e hershme si vepër penale të veçantë, por kriminalizon sjellje të ndërlidhura, si martesën e detyruar (Neni 239) dhe bashkëjetesën jashtëmartesore me të mitur (Neni 240). Ky ligj fokusohet në mbrojtjen e të miturve nga shtrëngimi, shfrytëzimi seksual dhe abuzimi, më shumë sesa në rregullimin e vetë aktit të martesës. Ligji për Familjen ndalon martesën nën moshën 18 vjeç, por lejon autorizim të jashtëzakonshëm nga gjykata për personat 16–17 vjeç. KPK-ja zbatohet vetëm kur ekziston shtrëngim, detyrim ose bashkëjetesë e paligjshme. Në praktikë, kjo ndarje konceptuale krijon sfida në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen efektive të të miturve.

[76] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, 2022, Neni 124 (1.1).

vazhdojnë ex officio, edhe nëse viktima tërhiqet. Megjithatë, kjo bëhet gjithashtu tepër e vështirë nëse provat tërhiqen.

Vonesat për shkak të mungesës së palëve

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore në periudhën 2023–2024, RrGK ka vërejtur 23 raste në të cilat procedurat janë shtyrë për shkak të mungesës së palëve të përfshira. Për shembull, në një rast përdhunimi në Departamentin për të Mitur, një dëshmitar u thirr dy herë por nuk u paraqit, duke shkaktuar dy shtyrje të njëpasnjëshme të seancës. Mungesa e të pandehurve dhe dëshmitarëve gjatë seancave kontribuon në vonesa të mëdha në proceset gjyqësore dhe e shtyn drejtësinë për viktimat. Sipas nenit 305 të Kodit të Procedurës Penale (KPP): "Nëse një dëshmitar/e i/e thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet në gjykatë pa arsye të justifikuar, kryetari/ja i/e trupit gjykues apo gjyqtari/ja kryesues/e i shqipton gjobë deri në 250 euro për çdo mungesë." Po ashtu, gjyqtari/ja kryesues/e duhet të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarit/ës në gjykatë, me shpenzimet e procedurës që mbulohen nga vetë dëshmitari/ja. Kjo nënkupton se gjyqtarët/et kanë detyrimin dhe kompetencën ligjore për të siguruar që dëshmitarët të paraqiten dhe të japin dëshmitë e tyre — megjithatë, kjo dispozitë nuk zbatohet në mënyrë të qëndrueshme në praktikë.

Në disa raste, gjyqtari/ja kryesues/e ka njoftuar në mënyrë joformale prokurorin/en se palët nuk e kishin pranuar ftesën apo se kushtet nuk ishin përmbushur për mbajtjen e seancës. Si rezultat, prokurori/ja nuk është paraqitur, por gjyqtari/ja e ka regjistruar gabimisht praninë e tij/saj në procesverbal — një shkelje serioze procedurale, pasi pjesëmarrja e prokurorit/es të shtetit është thelbësore për zhvillimin e seancës.[77] Në raste të tilla, nëse prokurori/ja i/e shtetit mungon në seancën e caktuar mbi bazën e një aktakuze të ngritur nga vetë ai/ajo, seanca duhet të shtyhet dhe gjyqtari/ja kryesues/e është i/e detyruar të njoftojë kryeprokurorin/en."[78] Megjithatë, gjatë monitorimit, RrGK ka vërejtur se gjykata e ka zbatuar këtë detyrim vetëm në një rast të vetëm.

Pajtim dhe Ndërmjetësim

Edhe pse ndërmjetësimi nuk lejohet ligjërisht në rastet e dhunës në familje dhe shumica e gjyqtarëve/eve deklaruan se nuk e përdorin, disa pranuan se praktika e pajtimit ende vazhdon. Një gjyqtar tha: "Në shumicën e rasteve po, [përdoret], aq sa shohim gjatë seancave." Një gjyqtar tjetër e mbrojti idenë e pajtimit dhe dhënies së një "shansi të dytë", duke sugjeruar se ndërmjetësimi mund të jetë i dobishëm madje edhe për kryesit e veprave të rënda, pasi sjellja kriminale shpesh është rezultat i rrethanave dhe jo prirje e lindur:
"Unë jam gjithmonë për pajtim, mendoj se secilit duhet t'i jepet një mundësi — edhe kriminelit më të madh." Megjithatë, ushtrimi i presionit ndaj viktimave për t'u pajtuar në vend se të kërkojnë mbrojtje ligjore rrezikon qasjen e tyre në drejtësi dhe i ekspozon ndaj recidivizmit. Përpjekjet e institucioneve për të ndërmjetësuar palët bien ndesh me nenin 55 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, i cili ndalon qartë ndërmjetësimin dhe pajtimin në këto raste.

Dënime të Buta

Në vitin 2023, një rishikim sistematik i 218 vendimeve gjyqësore zbuloi se vetëm 11% e kryesve morën dënime me burgim; shumica morën dënime me kusht ose gjoba, çka tregon

[77] KPP, Neni 245, paragrafi 1: "Gjatë shqyrtimit fillestar kërkohet prezenca e prokurorit të shtetit, të pandehurit/ve dhe mbrojtësit."."
[78] Po aty., Neni 301.

mungesë të ndëshkimeve proporcionale për krimet e dhunshme.[79] Për më tepër, 74% e autorëve të krimeve u dënuan me burgim me kusht, 45% u dënuan me gjoba dhe 20% morën gjoba me kusht. Analiza e RrGK-së e 10 aktgjykimeve të publikuara në faqen e internetit të KGJK-së zbuloi se 60% e tyre përfshinin dënime me kusht. Po ashtu, në vitin 2024, RrGK monitoroi pesë shpallje aktgjykimesh në seanca gjyqësore — të gjitha përfunduan me dënime me kusht. Dënimi me kusht është një ndëshkim alternativ, sipas të cilit personi i dënuar caktohet me dënim, por ai nuk zbatohet nëse nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së provës.[80] Edhe pse Kodi Penal i Kosovës (KPK) e lejon këtë masë për rastet e dhunës në familje, ajo nuk duhet të zbatohet automatikisht pa marrë parasysh rrethanat specifike të rastit.

Sipas KPK-së, gjatë vendosjes së një dënimi me kusht, gjykata duhet të vlerësojë faktorë si qëllimi i dënimit, sjellja e mëparshme e kryesit/es, qëndrimi i tij/saj pas kryerjes së veprës, shkalla e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera që lidhen me veprën.[81] Tendenca për të shqiptuar dënime të buta reflekton një qasje toleruese ndaj dhunës, duke e zbehur rëndësinë e ndëshkimit dhe duke nënvlerësuar ndikimin e dhunës në familje ndaj viktimave dhe shoqërisë në tërësi.

Rast: Dënimi me Kusht

Në një rast ngacmimi ndaj ish-bashkëshortes së të akuzuarit, gjykata në qershor 2024 shqiptoi një dënim me kusht, që i akuzuari të mos kryejë të njëjtën vepër brenda një periudhe prove njëvjeçare.

Sipas vlerësimit të RrGK-së, gjyqtari nuk e mori parasysh historinë e mëparshme të dhunës që i akuzuari kishte ushtruar ndaj viktimës, edhe pse kjo u përmend gjatë seancës. Gjykata deklaroi se nuk kishte qasje në regjistrat e Gjykatës së Gjilanit për të provuar dhunën e mëparshme, kështu që kjo informatë nuk u përfshi në procesverbal dhe as në vendimin përfundimtar.

Kjo neglizhencë nënvlerëson historinë e abuzimit dhe rrit rrezikun e përsëritjes së dhunës.

Në mënyrë të ngjashme, procedurat gjyqësore shpesh nuk marrin parasysh dinamikat gjinore të pushtetit, të cilat duhet të konsiderohen si rrethana rënduese që kërkojnë dënime më të larta.[82] Monitorimi i RrGK-së konfirmoi se dënimet për dhunën në familje shpesh janë tepër të buta, duke mos reflektuar rëndësinë e veprës penale dhe duke shkelur parimin e proporcionalitetit të sanksioneve të përcaktuara në KPK. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese nuk vlerësohen gjithmonë siç duhet. Në disa raste, disa faktorë trajtohen gabimisht si rrethana lehtësuese, si për shembull fakti që

> “
>
> Me një gjobë prej 150 eurosh po e legjitimon dhunën në familje... Ligjet tona janë të forta. Po t’i zbatonin siç duhet institucionet, rastet e dhunës do të uleshin menjëherë.
>
> - Burrë, AV

[79] Amnesty International, *Nga letra në praktikë: Kosova duhet t’i mbajë premtimet e saj ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje*, [Në anglisht], 2023.
[80] KPK, nenet 47 dhe 48.
[81] KPK, Neni 496 dhe Neni 49, paragrafi 4
[82] IKD, *Konventa e Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë*, 2022. Raporti po ashtu konstatoi se gjykatat kishin zbuluar publikisht identitetin e viktimave në mbi 13% të rasteve, duke shkelur të drejtën e privatësisë.

përgjegjësi është "babai i X fëmijëve", ndërkohë që kryerja e veprës në prani të fëmijëve duhet, në të vërtetë, të konsiderohet rrethanë rënduese.[83] Kjo tregon mospërputhje në vlerësimin e duhur të rrethanave rënduese dhe lehtësuese nga ana e gjykatave.

Në vitin 2024, RrGK monitoroi dy raste të femicidit, në të cilat gjykatat shqiptuan dënime maksimale ligjore: Gjatë rigjykimit, Dardan Krivaça u dënua me burgim të përjetshëm për vrasjen e Marigonë Osmanit, ndërsa Arbër Sejdiu mori 15 vite burg për ndihmë në kryerjen e krimit. Në rastin e Gjyljeta Ukellës, i akuzuari Edmond Lajçi pranoi fajësinë dhe u dënua gjithashtu me burgim të përjetshëm. Edhe pse këto dënime ishin të përshtatshme, një aspekt shqetësues është se të dy kryesit njiheshin më parë nga organet e rendit për raste të mëparshme të dhunës dhe sjellje kriminale, por kishin marrë dënime të pamjaftueshme. Këto raste dëshmojnë se butësia e dënimeve rrit rrezikun e përsëritjes së krimeve, i lë viktimat të pambrojtura dhe minon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Rast: Dënim i ulët për dhunë në familje

Në shtator 2022, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë ndaj një të pandehuri për veprën penale "Lëndim i rëndë trupor".[84] Sipas aktakuzës, më 17 gusht 2022, rreth orës 21:30, në parkingun e banesës së viktimës, i pandehuri e kishte sulmuar fizikisht viktimën, me të cilën më parë kishte bashkëjetuar për shtatë vjet, para se të ndaheshin shtatë muaj më parë. Ai ia kishte kapur flokët nga pas, e kishte tërhequr me forcë jashtë veturës, dhe më pas e kishte goditur në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, përfshirë thyerje të hundës, çarje të buzës së sipërme, si dhe lëndime në syrin, faqen e majtë dhe të dy duart. Si pasojë e sulmit, viktima kishte humbur vetëdijen.

Gjykata e shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi me tetë muaj burgim. Megjithatë, sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), kjo vepër penale parashikon dënim nga një (1) deri në pesë (5) vjet burgim. Gjykata e konsideroi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit si rrethanë lehtësuese dhe shqiptoi një dënim nën minimumin ligjor. Këto dënime të buta mund të nxisin përsëritjen e dhunës dhe krijojnë një precedent të rrezikshëm, që nuk e dekurajon kryerjen e veprave të ngjashme në të ardhmen.

Sipas LMDHF-së, "viktima të cenueshme" konsiderohen gratë, fëmijët, personat LGBTQIA+, personat me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, gratë shtatzëna, personat e moshuar, si dhe çdo person që për shkak të marrëdhënies familjare apo varësisë me kryesin e veprës është veçanërisht i/e ndjeshëm/e ndaj viktimizimit, frikësimit apo hakmarrjes së përsëritur. Në praktikë, monitorimi i RrGK-së tregon se gjykatat shpesh theksojnë më shumë aspektin familjar të marrëdhënies sesa dimensionet e tjera të cenueshmërisë, përfshirë gjininë. Si rezultat, edhe kur një viktimë përcaktohet ligjërisht si e cenueshme, vendimet gjyqësore shpesh kufizohen Në trajtimin e kontekstit familjar të veprës, duke çuar në dënime standarde dhe në moszbatim të rrethanave rënduese që lidhen me gjininë apo me faktorë të tjerë të cenueshmërisë. Kështu, marrëdhëniet familjare shpesh e errësojnë kuptimin më të gjerë të konceptit të cenueshmërisë, si në procedurat ashtu edhe në vendimmarrjen gjyqësore, duke rritur kështu rrezikun e përsëritjes së dhunës ndaj viktimave.

[83] Koment mbi draft-raportin nga një koleg recensues i angazhuar në monitorimin e rasteve.
[84] Sipas KPK-së, Neni 186, paragrafi 4, pika 4.1, në lidhje me paragrafin 1, pikën 1.3.

Rehabilitimi i kryesve të veprave dhe përgjigjet institucionale

Kjo pjesë shqyrton rolet e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës (ShSK) në trajtimin e dhunës me bazë gjinore përmes rehabilitimit dhe mbikëqyrjes së kryesve të veprave penale.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

ShKK është përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që synojnë riintegrimin shoqëror të personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit.[85] Për ta përmbushur këtë mision, ShKK ofron një gamë programesh rehabilituese për trajtimin e sjelljeve të dhunshme, duke përfshirë trajnime për menaxhimin e zemërimit, "biseda për ndryshim", programe për parandalimin e dhunës në familje, si dhe trajtim për varësi.[86]

Përfaqësuesit e ShKK-së ishin të njohur me konceptin e dhunës me bazë gjinore, por nuk e kuptonin qartë dhunën seksuale dhe cenimin e integritetit seksual.[87] Ata/ato ishin të vetëdijshëm/me për detyrimet e tyre ligjore, përfshirë zbatimin e Kurrikulës për Autorët e Dhunës në Familje, të miratuar në vitin 2022. Pesë zyrtarë/e socialë/e janë certifikuar për të udhëhequr një program gjashtëmujor trajnimi për dhunën në familje nëpër qendrat korrektuese, në kuadër të Strategjisë Kombëtare (2022–2026) me mbështetje nga Këshilli i Evropës (KE) dhe Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë.

Ndërkohë, hulumtimet e ShKK-së kanë treguar se personat e dënuar për dhunë në familje shfaqin pak interesim për programet rehabilituese, shpesh për shkak të turpit, krenarisë apo frikës nga gjykimi i të tjerëve.[88] Edhe pse ata marrin pjesë në programe të tjera, përfshirja e tyre në programe rehabilitimi për dhunë në familje mbetet një sfidë. Aktualisht, pjesëmarrja është vullnetare, por zyrtarët e ShKK-së deklaruan: "Tash jemi në fazën e përpjekjeve për ta ndryshuar ligjin, në mënyrë që programet e rehabilitimit të bëhen të detyrueshme për autorët/et e dhunës në familje."

Në vitin 2024, ShKK nënshkroi shtatë marrëveshje me ofrues shërbimesh, përfshirë OShC-të[89], për ofrimin e programeve për menaxhimin e zemërimit, intervista motivuese, rehabilitim të certifikuar, trajnime profesionale dhe arsimim, me qëllim riintegrimin e suksesshëm të të dënuarve në shoqëri.

Shërbimi Sprovues i Kosovës

Shërbimi Sprovues i Kosovës është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e dënimeve dhe masave alternative, si masa e provës dhe rehabilitimi i detyrueshëm.[90] Shërbimi mbikëqyr personat e liruar me kusht dhe siguron që ata të respektojnë kushtet e përcaktuara nga gjykata, duke vëzhguar sjelljen e tyre, ofruar programe rehabilituese dhe zbatuar trajtimin e detyrueshëm për varësi.[91]

---

[85] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Neni 8.
[86] ShKK, Raporti Vjetor i Punës, 2023.
[87] Intervistat e RrGK-së, 2024.
[88] Hulumtimi i diskutuar gjatë intervistës me zyrtar/e të ShKK-së, 2024.
[89] Këto përfshinin bashkëpunime me OShC-të Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Kërkime (SIT), Monumenta, Mural Fest dhe Islamic Reliefand dhe Kolegjin Universum O.P, Education+, dhe La Belle Beauty Akademinë Shkollore L.L.C *(ShKK, Raporti vjetor i punës, 2024).
[90] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbimin e Provës së Kosovës, Neni 3.
[91] Kuvendi i Republikës së Kosovës , Ligji për Kodin Penal, Neni 59.

Ministria e Drejtësisë miratoi Programin Kombëtar për Kryesit e Dhunës ndaj Grave në vitin 2023. Programi ndjek modelin e pushtetit dhe kontrollit të Duluth dhe zgjat gjashtë muaj, duke u përbërë nga 24 seanca dy-orëshe në grup.[92] Përveç kësaj, u lançua Kurrikula për Trajnimin e Profesionistëve që Ofrojnë Programe për Kryesit e Dhunës në Familje në Republikën e Kosovës, duke përfshirë shembuj nga praktikat ndërkombëtare, duke detajuar strukturën dhe kohëzgjatjen e programeve në Kosovë, dhe duke ofruar dhjetë module trajnimi. [93] Edhe pse kurrikula ofron udhëzime të dobishme, ajo nuk përfshin mjete të standardizuara për vlerësimin e efektivitetit të programit; në vend të kësaj, ajo ofron udhëzime të përgjithshme matjeje bazuar në dy modele.[94]

> “
>
> Jo çdo incident është dhunë e rëndë, për shembull një shuplakë. Sipas mendimit tim, njerëzit sot ndonjëherë e teprojnë. Është më mirë të flasësh fillimisht me partnerin/en, pastaj me familjen e gjerë, sesa menjëherë ta lësh apo ta raportosh në polici, sepse mund të përfundosh duke jetuar sërish me atë person pasi të ndëshkohet.
>
> - Burrë, ShSK

Deri më sot, vetëm 12 burra kanë marrë pjesë në program, duke e bërë të vështirë vlerësimin e ndikimit të tij në uljen e recidivizmit për shkak të madhësisë së vogël të mostrës.[95] SHSK është ligjërisht përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të këtij programi. Ndërkohë, dy nisma të tjera po zbatohen nga streha e Gjakovës dhe Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Kërkime (SIT), të cilat punojnë me autorët e dhunës.[96]

RrGK zbuloi se oficerët e SHSK-së nuk ishin të njohur me Kurrikulën për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës në Familje.[97] Edhe pse në përgjithësi zyrtarët e Shërbimit Sprovues të Kosovës kishin një kuptim të përgjithshëm për dhunën me bazë gjinore, u vërejtën mospërputhje të mëdha në interpretimet e tyre. Për shembull, një drejtor nuk e konsideronte si dhunë me bazë gjinore abuzimin verbal, kufizimin e mundësisë për punë të një anëtari të familjes apo kërcënimet, dhe e shihte marrëdhënien seksuale pa pëlqim si shkelje të integritetit personal, e jo si akt dhune. Njëri madje sugjeroi se një shuplakë duhet duruar dhe jo raportuar, duke shtuar se gratë që përjetojnë dhunë në familje duhet të largohen nga shtëpia, ndërsa dhunuesi të qëndrojë aty: “Ku tjetër me shku burri? Është normale që ai të rrijë në shtëpi,” – tha ai. Këto deklarata tregojnë një kuptim selektiv dhe të pjesshëm të dhunës me bazë gjinore, ku dhuna emocionale apo psikologjike shpesh minimizohet. Si pasojë, ekziston rreziku që zyrtarët e provës të mos e identifikojnë dhunën e ushtruar nga personat nën mbikëqyrje, duke krijuar mundësi për përsëritje të dhunës (recidivizëm).

Zyrtarët e ShSK-së thanë se kishin ndjekur trajnime për dhunën në familje, mirëpo ato nuk ishin të detyrueshme, dhe nuk kishin marrë pjesë në trajnime për format tjera të dhunës me bazë gjinore. Ata theksuan se temat e dhunës me bazë gjinore mund të trajtohen si pjesë e

[92] MD, Brochure on the National Program for Perpetrators of Violence Against Women, [Në anglisht], 2023.
[93] MD, Curriculum for Training Professionals to Provide Programs for Perpetrators of Domestic Violence in the Republic of Kosovo, 2022. , [Në anglisht].
[94] Po aty., f. 31.
[95] MD, Annual Implementation Report of the National Strategy for Protection from Domestic Violence and Violence against Women 2022-2026, 2024, Ika I.4.8. [Në anglisht].
[96] Këshilli i Evropës, Policy Brief: Implementing Perpetrator Programs in Kosovo, [Në anglisht], 2023, pf. 2.
[97] Ky seksion bazohet në intervistat e RrGK-së me pesë zyrtarë të SHPK-së në të gjithë Kosovën në vitin 2024.

trajnimeve për dhunë në familje, por nënvizuan domosdoshmërinë e organizimit të trajnimeve shtesë dhe më të specializuara.

ShSK ofron programe si mbështetje psikosociale, menaxhim të zemërimit, intervista motivuese dhe biseda për ndryshim, të cilat janë të hapura si për autorët e dhunës në familje, ashtu edhe për persona të tjerë që janë nën masën e provës. Pjesëmarrja në këto programe është vullnetare, përveç rasteve kur gjykata e urdhëron detyrimisht, si në rastet e kështillimit të detyrueshëm. Zyrtarët e provës theksuan se roli i tyre kufizohet në mbikëqyrjen e zbatimit të masave të vendosura nga gjykata: "Nëse refuzojnë të marrin pjesë, ne nuk mund t'i detyrojmë," – thanë ata.

Shërbimet Sociale

Ky seksion shqyrton shërbime të ndryshme sociale të ofruara për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë punën e Divizionit për Shërbime Sociale dhe Familjare, QPS-ve dhe strehimoreve.

Divizioni për Shërbime Sociale dhe Familjare

Më 22 mars 2021, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) u shua si pjesë e ristrukturimit të Qeverisë së Kosovës pas zgjedhjeve të shkurtit 2021.

Gjatë vitit 2021, funksionet e saj u transferuan nën Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Më pas, nga janari 2023, këto përgjegjësi u ndarën ndërmjet tri ministrive: MFPT mori përgjegjësitë për punësim, skemat e mbrojtjes sociale dhe pensionet; Ministria e Drejtësisë (MD) mori kompetencat për mbrojtje nga dhuna në familje dhe mbrojtjen e viktimave; Ministria e Shëndetësisë (MSH) mori disa shërbime, si p.sh. ato për shëndetin mendor. Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare u vendos nën Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe përfshin katër divizione: Divizioni për Shërbime Sociale dhe Familjare, Divizioni për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, Divizioni i Inspektimit, dhe Divizioni për Licencim dhe Trajnime.[98] Ky Divizion për Shërbime Sociale dhe Familjare harton politika dhe legjislacion, përfshirë standardet për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe viktimat e dhunës në familje. [99] Divizioni bashkërendon me organet komunale, monitoron shërbimet sociale, bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe sektorin privat, si dhe menaxhon programet kundër dhunës në familje dhe trafikimit me njerëz.

Zyrtarët/et shprehën shqetësim për uljen e nivelit institucional të shërbimeve sociale, nga një ministri në një departament brenda Ministrisë së Drejtësisë (MD). Ata/ato argumentuan se ky ristrukturim ka zvogëluar dukshmërinë institucionale, autonominë buxhetore dhe fokusin politik që dikur i kushtohej mirëqenies sociale nën MPMS-në. Ata/ato kërkuan rikthimin e një Ministrie të veçantë për Mirëqenie Sociale, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sipas Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), në 85% të shteteve anëtare të BE-së ekziston një ministri e dedikuar për punë dhe mirëqenie sociale, e cila shërben

> "Një departament me vetëm 15 persona nuk mund t'i përmbushë nevojat e gjera të mirëqenies sociale. Shumica e vendeve kanë një ministri të veçantë për këtë fushë.
>
> - Zyrtar/e

[98] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Vendimi Nr. 08-V-005 (Kuvendi i Republikës së Kosovës), 2021. Instituti i Kosovës për Drejtësi, Ndikimi i bashkimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Ministrinë e Financave" – Analizë e reformës qeveritare në fushën sociale, 2025.

[99] MD, Departamenti për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, p.d.

si shtyllë e rëndësishme për garantimin e të drejtave sociale. Po ashtu, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor mbajnë ministri të veçanta për këtë fushë, duke trajtuar punësimin, sigurinë në vendin e punës dhe mirëqenien sociale si prioritete të ndara politike. Kjo e thekson rëndësinë strategjike që i kushtohet këtij sektori. [100]

Zyrtarët/et ishin të vetëdijshëm/me për rolin e tyre në zbatimin e SKMDHF-së, por theksuan se ka pasur vonesa për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme ligjore dhe mungesës së akteve nënligjore të finalizuara. Janë zhvilluar gjithsej njëzet e katër (24) module trajnimi nga Këshilli Profesional për Shërbime Sociale. [101] Në vitin 2022, në bashkëpunim me RrGK-në, Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare dhe Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare zhvilluan dy module trajnimi. "Puna me viktimat e dhunës në familje: trajtimi dhe referimi" dhe "Puna me viktimat e krimeve seksuale dhe trafikimit." Më pas, 13 zyrtarë dhe përfaqësues/e të OShC-ve morën pjesë në një trajnim të trajnerëve (ToT) për të dyja modulet dhe u certifikuan. Zhvillimi i mëtejshëm i trajnimeve për punëtorët/e socialë është planifikuar për vitin 2025. Baza e të dhënave për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje, e ndarë me institucione si policia, gjykatat dhe punëtorët/e socialë, funksionon përgjithësisht mirë.

Megjithatë, futja e të dhënave në QPS shpesh është jokonsistente për shkak të ndryshimit të stafit, pensionimeve dhe mungesës së trajnimeve, gjë që mund të ndikojë në saktësinë e të dhënave dhe të vështirësojë planifikimin dhe buxhetimin e saktë. Me mbështetjen e UN Women, në vitin 2024 u mbajtën trajnime për 80 profesionistë/e nga 40 QPS, me fokus në përmirësimin e procesit të futjes së të dhënave.

Megjithëse financimi është rritur, ai vazhdojnë të jetë i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat gjithnjë në rritje të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare — përfshirë punësimin e stafit shtesë, përmirësimin e infrastrukturës, blerjen e pajisjeve e automjeteve, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale.

Qendrat për Punë Sociale

Qendrat për Punë Sociale (QPS) mbështesin viktimat e dhunës me bazë gjinore përmes ofrimit të shërbimeve sociale, mbrojtjes, riintegrimit dhe mbështetjes afatgjatë për rimëkëmbjen e tyre. [102] Për çdo viktimë që referohet, caktohet një menaxher/e rasti, i/e emëruar nga QPS-ja, i/e cili ndihmon në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve të disponueshme dhe në hartimin e një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit të rastit. Ky proces duhet të përfshijë bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Mekanizmit Komunal për Koordinim kundër Dhunës në Familje, në mënyrë që viktima të marrë mbështetje të plotë në strehim, siguri, drejtësi, arsim, trajnim, punësim, ndihmë sociale dhe ndihmë juridike. Në përgjithësi, përfaqësuesit/et e QPS-ve kishin

> "Ndoshta në atë moment mendojnë se veshja e tyre është në trend, por me kalimin e kohës e kuptojnë se ajo vetëm u shkakton probleme.
>
> - Grua, QPS

[100] Instituti i Kosovës për Drejtësi, Ndikimi i bashkimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Ministrinë e Financave" – Analizë e reformës qeveritare në fushën sociale, 2025.
[101] Këto module janë mbështetur nga partnerë si RrGK, Koalicioni i OShC-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Terre des Hommes, Instituti i Psikologjisë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (KRCT), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Fshatrat e Fëmijëve SOS Kosovë.
[102] LMDHF, SKMDHF, PSV-të.

njohuri për LMDHF-në dhe SKMDHF-në.[103] Ndërsa punëtorët/et socialë/e ishin të vetëdijshëm/me për detyrimet e tyre sipas PSV-ve, disa pranuan se nuk dinë si t'i zbatojnë ato siç duhet, duke theksuar se nuk kanë kohë të mjaftueshme për këtë. Kuptimi i tyre për Kodin Penal të Kosovës (KPK) të ndryshuar ishte i paqëndrueshëm. Edhe pse shumica e dinin se dhuna në familje është vepër penale, disa nuk ishin të sigurt për veprat e tjera. Disa madje e mohuan qartë që ngacmimi seksual përbën vepër penale dhe/ose e konsideruan ndjekjen si çështje të vogël, e jo si krim serioz. Punëtorët/et e Qendrave për Punë Sociale (QPS) kishin nivele të ndryshme njohurish lidhur me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore. Shumica kishin njohuri të qarta për dhunën në familje, por shpesh ngatërronin ngacmimin seksual me sulmin seksual. Ndërkohë, intervistat zbuluan qëndrime shqetësuese tek disa punëtorë/e socialë/e, të cilët/at cilat kishin tendencë të fajësonin viktimat dhe të arsyetonin dhunën. Një përfaqësues/e i/e QPS-së deklaroi se normat kulturore dhe papjekuria mund të ndikojnë në mënyrën se si vajzat vishen, duke çuar në dhunë. Kur u pyet nëse është e pranueshme që të ndodhë marrëdhënia seksuale pa pëlqim nëse viktima është veshur në mënyrë provokuese, njëri/ra prej tyre tha: "Edhe ajo e ka pak fajin," duke nënkuptuar se viktimat ndajnë përgjegjësi për dhunën. Një tjetër shtoi: "Kur ato vishen në mënyrë provokuese, kjo nuk është krim." Deklarata të tilla përbëjnë fajësim të viktimës dhe bien ndesh me parimet themelore të mbrojtjes së viktimave dhe të barazisë gjinore.

Këto qëndrime shtriheshin edhe në arsimimin e sjelljes së kryerësve të dhunës. Veçanërisht në raste të dhunës në familje, punëtorët/et e Qendrave për Punë Sociale (QPS) shfaqnin empati ndaj rrethanave të abuzuesve. Për shembull, një përfaqësues/e sugjeroi që gratë duhet të kenë një qasje më mirëkuptuese, duke ofruar ngushëllim për bashkëshortët e irrituar: "A ia ka bërë një kafe dhe e ka pyetur butësisht: 'Dashuri, si e kalove ditën? A pate ndonjë vështirësi?'" Ato thanë se gratë shpesh kontribuojnë në abuzimin emocional dhe psikologjik, duke i përshkruar si më polemizuese dhe më provokuese se burrat. Këto besime të socializuara për rolet gjinore e homogjenizojnë sjelljen e grave dhe burrave, duke neglizhuar strukturat e pabarazisë gjinore që shpesh ekzistojnë midis tyre. Qasje të tilla mund të kontribuojnë në fajësimin e viktimës dhe në mungesën e një qasjeje të mirëfilltë të bazuar te viktima. Sa i përket kujdestarisë së fëmijëve në rastet e dhunës në familje, përfaqësuesit/et e QPS-së në përgjithësi pajtoheshin se fëmijët duhet të qëndrojnë me nënat e tyre, veçanërisht nëse babai është kryesi i dhunës: "Nuk e di… por që fëmijët të jenë me kryesin e dhunës, nuk është kurrë në rregull.".[104] Kjo tregon për një ndryshim të mundshëm të qëndrimeve me kalimin e kohës, pasi punëtorët/et socialë/e më herët kishin prirje t'u rekomandonin gjykatave që fëmijët të qëndronin me kryesit e dhunës, për arsye financiare. Një praktikë e tillë i vendoste fëmijët në rrezik dhe kufizonte qasjen e të mbijeturave tek fëmijët e tyre. Frika se mund të humbasin kujdestarinë e fëmijëve është një nga arsyet pse disa viktima hezitojnë të raportojnë dhunën dhe të kërkojnë ndihmë. Prandaj, ky ndryshim në qasje paraqet një përparim të dukshëm. Punëtorët/et socialë/e shpesh

> "
>
> Në ditët e sotme, gjithçka që dëgjojmë në media është për gratë, gratë, gratë… Por edhe ne gratë ushtrojmë dhunë psikologjike, sidomos ndaj burrave. Burrat, në fakt, janë shumë më të qetë se ne. Ne gratë jemi dukshëm më grindaveçe dhe më provokuese.
>
> - Grua, QPS

[103] Në vitin 2024, RrGK intervistoi stafin e shtatë Qendrave për Punë Sociale (QPS) nëpër Kosovë, përfshirë punëtorë/e socialë/e, psikologë/e dhe drejtorë/e.
[104] Intervistë e RrGK-së me përfaqësues/e të Qendrës për Punë Sociale (QPS), 2024.

deklaruan se rastet e dhunës në familje janë veçanërisht të vështira, duke i përshkruar si emocionalisht dhe profesionalisht rraskapitëse. Ata/ato përballen me mungesë mbështetjeje, mungesë psikoterapie, mungesë stafi dhe shqetësime për sigurinë, gjë që ua vështirëson trajtimin e duhur të rasteve. Janë vërejtur dallime gjinore në mënyrën se si stafi mashkullor dhe ai femëror e trajton dhunën. Disa punonjës ndiheshin të parehatshëm duke punuar me viktima të dhunës në familje dhe hezitonin të hynin në strehimore. Një përfaqësues/e e QPS-së tha: "Burrat dhe gratë [punonjësit/et e QPS-së] dallojnë në mënyrën se si i trajtojnë rastet, veçanërisht ato të divorcit dhe dhunës. Qëndrimet e tyre kanë qenë të ndryshme. Burrat gjithmonë kanë konsideruar se gratë janë fajtore." Disa punonjës të QPS-së fajësuan gratë për situatën e tyre, dhe sipas raportimeve, disa kanë përdorur gjuhë fyese, si p.sh. duke i quajtur viktimat: "Ajo kurva".

Rast: "Pajtim i çifteve"

Gjatë një seance për shqyrtimin e kërkesës për urdhër mbrojtjeje (UM) lidhur me një rast të dhunës në familje ndaj një gruaje dhe dy fëmijëve të saj, një përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale (QPS) i tha viktimës: "Nuk po duket diçka shumë e rrezikshme… ajo që ka ndodhur mes teje [dhe bashkëshortit]. Sepse, sipas përshkrimit tënd, ai nuk duket si tip i dhunshëm." Ajo i tha viktimës se urdhri i mbrojtjes nuk është domosdoshmërisht i nevojshëm, duke sugjeruar se përgjegjësi ndoshta ka më shumë nevojë për trajtim psikiatrik ose terapi sesa për masa mbrojtëse. Përfaqësuesja e QPS-së shtoi: "Ka pasur raste shumë më serioze ku palët janë pajtuar, e lëre më në raste si ky. Këto gjëra tejkalohen." Deklarata të tilla tregojnë një minimizim shqetësues të përvojës së viktimës, duke vënë në prioritet nevojat e perceptuara të abuzuesit mbi sigurinë dhe të drejtat e të mbijetuarës. Është e rëndësishme të theksohet se pajtimi është rreptësisht i ndaluar në rastet e dhunës në familje, për të mbrojtur viktimat nga rreziku i përsëritjes së dhunës (recidivizmit).

Mbështetja e Qendrave për Punë Sociale (QPS) për riintegrimin e viktimave raportohet të jetë minimale, sipas intervistave me akterë të tjerë institucionalë. QPS-të shpesh ia kalojnë përgjegjësinë strehimoreve, për shkak të mungesës së stafit dhe burimeve njerëzore. Pjesëmarrësit/et në hulumtim thanë se shumica e viktimave i gjejnë vetë punën dhe strehimin, me ndihmë shumë të kufizuar nga QPS-të. "Institucionet e trajtojnë si një dosje që duhet mbyllur dhe vazhdojnë me rastin tjetër," – tha një pjesëmarrës. Kjo qasje mund të lidhet më shumë me mungesën e personelit dhe burimeve, sesa me mungesë përkushtimi apo kujdesi. QPS-të nuk kanë mjete të transportit dhe fonde për t'u ofruar viktimave ushqim apo veshmbathje në rastet kur ato paraqiten për të raportuar dhunën. Gjithashtu, QPS-të vuajnë nga mungesa e stafit profesional të kualifikuar. Një pjesëmarrës në hulumtim vërejti: "Kemi njerëz me diplomë gjeografie që punojnë në Qendrat për Punë Sociale. Është sikur këto qendra përdoren vetëm për t'i dhënë dikujt një vend pune. Por mungon serioziteti... Nuk mund të jenë ekspertë për 72 kategori; është i domosdoshëm specializimi." Punëtorët/et socialë/e trajtojnë të gjitha llojet e rasteve, jo vetëm ato që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Aktualisht, nuk ka punëtorë/e socialë/e të specializuar/a për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Ngarkesa e punës për çdo komunë dhe për çdo punëtor/e social/e ndryshon dukshëm nga një komunë në tjetrën. Në komuna si Prizreni, Peja, Ferizaj dhe Therandë, ekzistojnë rreth 2,000–3,000 raste aktive, ndërsa në komuna më të vogla si Hani i Elezit, Sharri dhe Juniku, raportohen më pak se 1,000 raste aktive. Në disa komuna të vogla, si Juniku, një zyrtar/e i/e shërbimeve sociale ka më pak se 10 raste aktive, ndërsa në komuna të mëdha si Prishtina dhe Mitrovica, një zyrtar/e mund të ketë

deri në 150 raste. Këto dallime tregojnë se nuk ekziston asnjë formulë apo standard i unifikuar për shpërndarjen e rasteve ndërmjet punëtorëve/eve socialë/e nëpër komuna.[105] Mungesa e stafit të mjaftueshëm dhe të specializuar përbën qartë një sfidë të përsëritur për Qendrat për Punë Sociale në sigurimin e një qasjeje të plotë dhe të orientuar drejt viktimës, në përputhje me Konventën e Stambollit. Për shembull, në vitin 2023, oficerët e QPS-së ishin të pranishëm vetëm në 3.3 nga çdo 10 raste të dhunës në familje.[106]

Në vitin 2025, Qeveria miratoi një Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Ofrimin e Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave gjatë qëndrimit të tyre në ambientet policore.[107] Ky udhëzim krijon një fond emergjent për të përmbushur nevojat e menjëhershme të viktimave të dhunës me bazë gjinore gjatë qëndrimit të tyre në hapësirat e policisë. Qendrat për Punë Sociale janë përgjegjëse për planifikimin dhe administrimin e këtij fondi, ndërsa menaxherët/et e rasteve janë përgjegjës/e për vlerësimin e nevojave të viktimave dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet përkatëse. Fondi mbulon ushqim, veshmbathje, produkte higjienike, medikamente dhe shërbime të tjera thelbësore, përfshirë trajtim psikosocial.

Strehimoret

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore përcakton se strehimoret e specializuara duhet të ofrojnë mbrojtje, strehim, rehabilitim dhe shërbime riintegrimi për të gjitha viktimat e dhunës.

Kjo është në përputhje me nenin 23 të Konventës së Stambollit, i cili kërkon që shtetet të krijojnë strehimore të përshtatshme dhe lehtësisht të qasshme për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht për gratë dhe fëmijët e tyre. Megjithatë, pavarësisht angazhimeve ligjore, në praktikë sistemi i strehimoreve në Kosovë kryesisht u shërben grave dhe fëmijëve që kanë mbijetuar dhunën në familje. Vetëm një strehimore menaxhohet nga shteti – Objekti i Përkohshëm i Sigurisë për raste me rrezik të lartë të trafikimit seksual, zakonisht të lidhura me gjykime në proces. Të gjitha tetë strehimoret e tjera janë OJQ të kontraktuara nga qeveria.

Këto strehimore u shërbejnë kryesisht grave dhe fëmijëve, duke ofruar mbrojtje të përkohshme dhe mbështetje për riintegrim dhe fuqizim. Strehimoret pranojnë edhe viktima të formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, kur institucionet nuk kanë alternativa të tjera për strehim.

Megjithatë, kërkohet veprim i menjëhershëm për zhvendosjen e tyre në ambiente të veçanta, pasi nuk është e përshtatshme që viktimat e dhunës seksuale të strehohen së bashku me viktimat e formave të tjera të dhunës. Ndërkohë, viktimat me probleme të shëndetit mendor shpesh mbeten në strehimore, pasi institucionet psikiatrike refuzojnë t'i pranojnë. "Jemi të detyruar t'i mbajmë, edhe pse ndikon në rastet e tjera," – tha një drejtore strehimoreje. Strehimoret gjithashtu strehojnë fëmijë pa kujdes prindëror, edhe pse nuk janë të dizajnuara për këtë qëllim, gjë që kërkon burime shtesë njerëzore dhe investime në hapësira fizike për të siguruar një mjedis miqësor për fëmijët. Situata është përkeqësuar pas mbylljes së strehimores për fëmijë, për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm. Përfaqësuesit/et e Qendrave për Punë Sociale (QPS) shprehën shqetësim për përdorimin e

[105] Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Analizë e Qendrave për Punë Sociale, Sfidat në aspektin Ligjor, Institucional dhe Funksional, 2023, f. 31.
[106] Inspektorati Policor i Kosovës, Raport inspektimi mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, 2024, f. 5.
[107] Qeveria, MD, Udhëzim administrativ md - nr. 02/2025 për përcaktimin e procedurës për ofrimin e shërbimeve nga fondi emergjent për nevojat e viktimave gjatë qëndrimit në polici.

familjeve pritëse për fëmijët e abuzuar seksualisht, pasi shumë familje nuk janë të përgatitura të trajtojnë trauma të rënda dhe fëmijët kanë nevojë për institucione të specializuara rehabilitimi.

Që nga shtatori 2024, një strehimore ka filluar të pranojë fëmijë viktima të dhunës në familje, fëmijë pa kujdes prindëror, viktima me rrezik të ulët të trafikimit dhe fëmijë në konflikt me ligjin.

Vendimet për sistemimin e tyre merren në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë (MD), përmes Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare, në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Strehimin Rezidencial.[108] Deri më sot, asnjë komunë nuk ofron mbështetje financiare për këtë strehimore për fëmijë; operimi i saj financohet vetëm nga Ministria e Drejtësisë (MD).

Strehimorja ka strehuar djem mbi moshën 12-vjeçare së bashku me nënat e tyre; megjithatë, një vlerësim i kujdesshëm i rrezikut duhet bërë për secilin rast, veçanërisht në situatat ku janë të pranishme vajza mbi moshën 12-vjeçare. Kërkohen masa të shtuara mbrojtëse, si ndarja sipas moshës dhe gjinisë dhe forcimi i protokolleve të mbikëqyrjes. Mungesa e strehimoreve dhe banesave të specializuara për viktimat LGBTQIA+ e thellon edhe më shumë cenueshmërinë e tyre. Programet e ndihmës financiare dhe sociale janë pothuajse të paqasshme, duke detyruar shumë të mbijetuara/ë të kthehen në mjedise abuzive ose të përballen me vështirësi të rënda ekonomike.[109] Organizatat e shoqërisë civile vazhdojnë të avokojnë për krijimin e një strehimoreje të tillë. Që nga viti 2020, diskutimet me Komunën e Prishtinës janë duke vazhduar, por procesi është vonuar ndjeshëm. Aktualisht, të mbijetuarit/at LGBTQ+ zakonisht referohen në strehimore në Tiranë, por kjo është një zgjidhje e paqëndrueshme për shkak të largësisë, burimeve të kufizuara dhe mungesës së mbështetjes afatgjatë. Pas një avokimi të gjerë nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe anëtarët/et e strehimoreve, si dhe nga OSHC-të e tjera dhe akterë përkatës, qeveria qendrore vendosi në vitin 2019 një linjë buxhetore për "operimin bazë të strehimoreve". Alokimet qeveritare për strehimoret u rritën nga 880,000 € në vitin 2020 në 1 milion € në vitin 2021. I njëjti buxhet u mbajt edhe në 2022, ndërsa në 2023 u rrit në 1.5 milion €. Në vitin 2024, buxheti mbeti në nivelin e 1.5 milion €. Disa strehimore marrin gjithashtu mbështetje nga komunat. Megjithë përmirësimet në financim, strehimoret ende përballen me sfida të shumta, përfshirë mungesën e vazhdueshme të fondeve, mungesën e burimeve njerëzore të mjaftueshme, dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm me institucionet.[110] Disa strehimore nuk kanë automjete, duke u mbështetur në policinë e Kosovës për transport, gjë që vështirëson ofrimin e mbështetjes për viktimat në qasjen e tyre në shërbime të ndryshme. Disa nuk kanë as infrastrukturë të mjaftueshme sigurie. Siguria kibernetike është një tjetër shqetësim – shumica e strehimoreve nuk kanë trajnim apo mjete për të parandaluar rrjedhjen e të dhënave, çka mund të rrezikojë viktimat. Ndërkohë që kanë ndjekur trajnime të gjera, kapacitetet mund të përmirësohen më tej në punën me viktimat e abuzimit seksual. Pjesëmarrës/e të tjera në hulumtim ngritën shqetësimin se viktimat mund të qëndrojnë në strehimore vetëm për tre deri në gjashtë muaj. Si pasojë, shumë viktima detyrohen të kthehen në mjedise abuzive, për shkak të mungesës së strehimit të qëndrueshëm, mbështetjes familjare apo qëndrueshmërisë financiare. Edhe pse disa komuna ofrojnë strehim të përkohshëm, afatet e aplikimit janë të shkurtra dhe zhvillohen vetëm një herë në vit, në vend që të jenë të vazhdueshme, ndaj gratë rrallë mund të aplikojnë kur kanë nevojë reale. Për më tepër, komunat e Kosovës nuk kanë ndarë mjaftueshëm banesa sociale për të përmbushur nivelin e kërkesës, pasi këto banesa përdoren edhe nga kategori të tjera të cenueshme ose të margjinalizuara.

[108] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Udhëzimi Administrativ (MPJ) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, 2025.
[109] OSBE, Anketa mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë, [Në anglisht],2019.
[110] Në vitin 2024, RrGK realizoi intervista me shtatë strehimore nëpër Kosovë.

Historikisht, fondet e alokuara për strehim social kanë qenë kryesisht në dobi të pakicave etnike; vetëm pesë nga 57 përfitues të shtëpive ishin gra në vitin 2023.[111]

Pa qasje në strehim social, viktimat rrezikojnë të kthehen në familje të dhunshme dhe të përjetojnë ri-viktimizim. Avokati i Popullit ka vërejtur se, për shkak të mungesës së programeve të riintegrimit, strehimoret shpesh kthehen në zgjidhje afatgjata për strehim. Edhe pse nuk janë të destinuara për këtë funksion, mungesa e alternativave për strehim bën që ky të jetë opsioni i vetëm për të garantuar një qasje të përqendruar te viktima. Ndërkohë, disa bashki kanë filluar të paguajnë qira për viktimat, gjë që është një praktikë e mirë.[112]

Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Trajnimeve Profesionale

Varësia ekonomike vazhdon të jetë një ndër pengesat kryesore për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore që synojnë të arrijnë autonomi dhe pavarësi. Pa pavarësi financiare, shumë gra detyrohen të kthehen në mjedise abuzive. Institucione si Zyrat e Punësimit (ZP) dhe Qendrat e Trajnimeve Profesionale (QTP) kanë për detyrë të ofrojnë mbështetje për të mbijetuarat/it, duke i ndihmuar në punësim, rritje të aftësive profesionale dhe riintegrim ekonomik. Stafi i Zyrave të Punësimit (ZP) dhe Qendrave të Trajnimeve Profesionale (QTP) në përgjithësi kishte mungesë njohurish lidhur me legjislacionin si Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe me politikat që lidhen me dhunën me bazë gjinore.[113] Stafi ngatërronte termat, keqkuptonte përkufizimet ligjore (p.sh. ndjekja e padëshiruar, nxitja për ekspozim të pjesëve intime të trupit, gjymtimi gjenital femëror – GJGJF, ngacmimi seksual, sulmi seksual) dhe kishin pririe për të fajësuar viktimat. Ata/ato gjithashtu mbronin rolet dhe marrëdhëniet tradicionale gjinore.

> “
>
> Zakonisht, dhuna ndodh sepse gratë duan të jenë të pavarura... Në familjet tona, burrat punojnë, ndërsa gratë duhet të merren me punët e shtëpisë.
>
> - Grua, ZP

Stafi i Zyrave të Punësimit (ZP) dhe Qendrave të Trajnimit Profesional (QTP) shpesh kështillonte pajtim brenda familjes në vend që të raportonte rastet e dhunës. Kjo tregon mungesë të kuptimit për nevojat e sigurisë së viktimave. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe qëndrime të tilla sugjerojnë se ZP-të dhe QTP-të janë të papërgatitura për të mbështetur të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Ndërkohë, UNDP kishte zhvilluar një kurrikulë për stafin e ZP-ve dhe QTP-ve mbi qasjen e orientuar drejt viktimës dhe kishte trajnuar disa punonjës/e, por ky trajnim është mbajtur para disa vitesh. Kalimi i kohës dhe ndryshimet e shpeshta të stafit tregojnë nevojën për institucionalizimin e trajnimeve të vazhdueshme. ZP-të dhe QTP-të nuk mbajnë të dhëna për numrin e mbijetuarave/ve që kanë trajnuar apo punësuar, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit të punës së tyre dhe planifikimin e programeve e buxhetit të ardhshëm.

> “
>
> Ndonjëherë njerëzit veprojnë në një moment zemërimi... Duhet të përpiqemi t’i zgjidhim gjërat me paqe.
>
> - Burrë, ZP

[111] MD, Annual Implementation Report of the National Strategy for Protection from Domestic Violence and Violence against Women 2022-2026, [Në anglisht], 2024, Pika IV.2.5.
[112] Koment nga kolegët mbi draft-raportin.
[113] Në vitin 2024, RrGK intervistoi gjashtë anëtarë/e të stafit nëpër Kosovë. RrGK u përball me vështirësi në kontaktimin e zyrtarëve/eve të Qendrave për Aftësim Profesional, dhe jo të gjitha zyrat e synuara u intervistuan.

Institucionet Shëndetësore

Ministria e Shëndetësisë (MSh), institucionet publike shëndetësore dhe Qendrat e Shëndetit Mendor janë përgjegjëse për të ofruar kujdes mjekësor dhe psikologjik falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, siç përcaktohet në Procedurat Standarde të Veprimit(PSV). Kur personat me lëndime të lidhura me dhunën kërkojnë ndihmë mjekësore, institucionet shëndetësore shërbejnë si reagues të parë në identifikimin dhe parandalimin e mëtejshëm të dhunës në familje. Sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), punonjësit/et shëndetësorë/e janë të detyruar/a ligjërisht të raportojnë rastet e dyshuara të dhunës me bazë gjinore në polici. Mosraportimi i tillë përbën vepër penale. PSV-të e theksojnë këtë detyrim, duke përcaktuar se ofruesit/et e kujdesit shëndetësor duhet të njoftojnë autoritetet. Ndërkohë, GREVIO ka vënë në dukje se: "detyrimet për raportim të përgjithshëm mund të krijojnë pengesa në ofrimin e shërbimeve që janë të orientuara drejt viktimës dhe të përgjegjshme ndaj aspektit gjinor".[114] Kjo ka kontribuar në hutimin e profesionistëve/eve shëndetësorë/e. Në praktikë, punonjësit/et shëndetësorë/e priren të kërkojnë pëlqimin e viktimës para raportimit. Punonjësit/et shëndetësorë të intervistuar/a kishin mungesë njohurish lidhur me Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, LMDHF-në dhe detyrimet e tyre sipas SKMDHF-së, siç janë identifikimi i rasteve të dhunës, trajtimi i tyre dhe referimi tek institucionet përkatëse. Ata/ato vërejtën mungesën e një protokolli trajtimi për GJGJF-në.

Njohuritë e tyre për dhunën me bazë gjinore ishin të kufizuara, shpesh duke e barazuar atë vetëm me dhunën fizike.[115] Ata/ato shpesh nuk arrinin të bëjnë dallimin ndërmjet sulmit seksual dhe përdhunimit, dhe nuk ishin të njohur as me GJGJF-në. Kjo mund të kufizojë aftësinë e tyre për të identifikuar shenjat e abuzimit, për t'i dokumentuar ato siç duhet dhe për t'i referuar viktimat për ndihmë. Disa punonjës/e besonin se dhuna mund të justifikohej nëse gruaja ishte "imorale". Të tjerë justifikonin krime që cenojnë integritetin seksual, duke ia atribuar dhunën "lirive të tepërta të grave". Neni 230 i KPK-së e kriminalizon çdo akt poshtërues me natyrë seksuale, pavarësisht veprimeve, veshjes apo sjelljes së viktimës. Ndërkohë, disa të tjerë sugjeronin që viktimat të kërkonin ndihmë fillimisht brenda familjes, para se të raportonin dhunën. Të gjitha këto qëndrime pasqyrojnë ideologji të rrënjosura patriarkale dhe një prirje për fajësim të viktimës, të cilat cenojnë qasjen e bazuar në viktimë.

Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (LMDHF), Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka obligim të miratojë udhëzime administrative për ofrimin e shërbimeve për përdoruesit e drogave, përdoruesit e alkoolit dhe grupet e tjera të cenueshme.[116] Megjithatë, këto akte ende nuk janë miratuar, dhe Ministria nuk e ka themeluar grupin punues përgjegjës për hartimin e tyre.

Edhe pse nevojat e këtyre grupeve janë identifikuar dhe pranuar vazhdimisht, mungesa e veprimit institucional ka krijuar boshllëqe të mëdha në qasjen dhe trajtimin e personave me

[114] Për diskutim të mëtejmë, shih pjesën I. Raportimi nga profesionistët (Neni 28), Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit, 2022, [Në Anglisht]. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni Kapitullin e Analizës Ligjore.

[115] Në vitin 2024, RrGK intervistoi tetë profesionistë/e shëndetësorë/e nëpër Kosovë, përfshirë mjekë/e, infermierë/e, një përfaqësues/e të Drejtorisë së Shëndetësisë, një Qendre të Shëndetit Mendor dhe Ministrisë së Shëndetësisë.Duke marrë parasysh madhësinë e vogël të mostrës, ekziston mundësia e gabimit, pasi mund të ketë qëndrime të ndryshme. Megjithatë, në këtë hulumtim cilësor, identifikimi i këtij niveli të njohurive dhe qëndrimeve tregon nevojën për institucionalizimin e edukimit të përmirësuar profesional.

[116] LMDHF, Neni 36 mbi Masat Mbrojtëse të trajtimit psiko-social; Neni 37 mbi Masat Mbrojtëse të trajtimit mjekësor për Varësinë nga alkooli dhe substancat psikotrope; Neni Trajtim i detyrueshëm psikiatrik në një institucion shëndetësor.

çrregullime të shëndetit mendor, përdoruesve të substancave dhe grupeve të tjera që kërkojnë shërbime të specializuara.

Edhe pse MSH raportohet se ofron trajnime të rregullta, pjesëmarrësit/et në hulumtim thanë se nuk kanë marrë mjaftueshëm trajnime. Punonjësit/et shëndetësorë theksuan edhe mungesën e hapësirave private për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale, çka vështirëson ruajtjen e konfidencialitetit. Shkeljet e konfidencialitetit mbeten problem: raportet policore shpesh zbulojnë identitetin e viktimave, dhe më pas media raporton nëse ato kanë marrë trajtim mjekësor. Kjo mund të dekurajojë gratë të kërkojnë ndihmë mjekësore apo të raportojnë dhunën, nga frika se identiteti i tyre mund të zbulohet.

Institucionet Arsimore

Shkollat luajnë një rol thelbësor në identifikimin e hershëm dhe mbështetjen e nxënësve që mund të jenë viktima të drejtpërdrejta apo të tërthorta të dhunës me bazë gjinore. Fëmijët janë veçanërisht të cenueshëm ndaj përjetimit të dhunës së tillë. Prandaj, personeli shkollor ka dy përgjegjësi kryesore: të kontribuojë në parandalimin e dhunës përmes edukimit dhe vetëdijesimit, dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme e efektive kur ndodhin raste dhune. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) është përgjegjëse për zhvillimin e politikave që adresojnë dhunën me bazë gjinore në sistemin arsimor. Që nga viti 2013, Kosova ka Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, i cili zbatohet në të gjitha institucionet publike e private parauniversitare, si dhe në institucionet përkatëse lokale e qendrore, përfshirë Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të) dhe Qendrat për Punë Sociale (QPS-të).

Rregullorja përcakton përgjegjësitë, rolet dhe procedurat e institucioneve përkatëse në parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin dhe raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në ambientet e arsimit parauniversitar.[117] Rregullorja thekson bashkëpunimin ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe për të garantuar të drejtat e tyre. Duke u bazuar në këtë kornizë, në vitin 2023, MAShTI zhvilloi Politikën për *Mbrojtjen e Fëmijëve në Institucionet e Arsimit Parauniversitar*, e cila krijon një kornizë të detyrueshme për të gjitha institucionet parauniversitare që të parandalojnë, identifikojnë, reagojnë dhe monitorojnë ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe shfrytëzimit të fëmijëve. [118] Kjo politikë mbështetet në parimet e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes dhe bashkëpunimit ndërsektorial midis institucioneve arsimore, sociale, shëndetësore dhe ligjore. [119] Që nga viti 2024, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës (KE), MAShTI është duke zhvilluar udhëzime për mësimdhënësit dhe profesionistët e arsimit mbi rolin e shkollave në parandalimin dhe identifikimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. [120]

Shkollat parauniversitare nuk kanë politika të brendshme specifike që adresojnë ngacmimin seksual. Megjithatë, Universiteti i Prishtinës[121] dhe Universiteti i Prizrenit[122] kanë miratuar Rregullore për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual, përkatësisht në vitet 2021 dhe 2024. Zbatimi mbetet i kufizuar për shkak të disa mangësive thelbësore: afatit të shkurtër për raportim (vetëm një vit), kërkesës që personat që raportojnë ngacmim seksual të

[117] Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, 2013.
[118] MASHTI, Politika për mbrojtjen e fëmijëve në institucionet arsimore parauniversitare në Kosovë, 2023.
[119] Do të lançohet në vitin 2025. RrGK është pjesë e grupit punues.
[120] Do të publikohet në vitin 2025. RrGk është pjesë e grupit punues.
[121] Universiteti i Prishtinës, Rregullorja për Parandalimin dhe Raportimin e Ngacmimit Seksual, 2021.
[122] Universiteti i Prizrenit, Rregullore për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimet seksuale dhe ngacmimet në universitet , 2024.

nënshkruajnë një deklaratë për përgjegjësi morale dhe penale, mungesës së qartësisë në ndarjen e barrës së provës dhe afateve të gjata institucionale për trajtimin e rasteve.[123] Deri në prill 2023, ishin raportuar pesë raste zyrtare të ngacmimit seksual, shumica e të cilave u mbyllën si "të pabazuara" për shkak se ishin paraqitur në mënyrë anonime. Për më tepër, 59.6% e studentëve ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e rregullores, ndërsa 40.4% nuk ishin. Trajnimet e detyrueshme për studentë dhe staf ende nuk janë vendosur. Vendimet e Këshillit të Etikës mungojnë në transparencë, dhe mungesa e strukturave mbështetëse në nivel fakulteti e pengon zbatimin.

SKMDHF parasheh disa veprime që duhet të zbatohen nga institucionet arsimore. DKA-të janë përgjegjëse për fushata vetëdijësuese për parandalimin e martesave të hershme, sesione informuese për zyrtarët/et shkollorë/e, drejtorët/et dhe psikologët/et, si dhe për promovimin e edukimit ndërmjet bashkëmoshatarëve si mjet për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkolla. Disa aktivitete të tilla janë zbatuar, kryesisht në bashkëpunim me OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe OShC-të, por ato ende nuk janë institucionalizuar plotësisht. Zyrtarët/et e DKA-ve të intervistuar kishin njohuri të kufizuara për dispozitat ligjore përkatëse dhe shpesh kishin keqkuptime rreth dhunës me bazë gjinore.[124] Disa e vlerësonin rëndësinë e LMDHF-së, por pranonin se nuk kanë pasur kohë ta lexojnë apo të trajnohen mbi të. Gjithashtu, zyrtarët/et shpesh barazonin dhunën në familje me dhunën me bazë gjinore, ndërsa terminologjitë si ngacmim, ngacmim seksual dhe sulm seksual kuptoheshin gabimisht. Duket se DKA-të nuk kanë organizuar sesione informuese me stafin arsimor dhe nuk kanë zbatuar programe të edukimit ndërmjet bashkëmoshatarëve për ngacmim seksual, paraqitje të dëmshme gjinore dhe martesa të hershme, siç parashehet në SKMDHF. Asnjë zyrtar/e nuk raportoi për aktivitete konkrete në këto fusha. Përfshirja e prindërve dhe nxënësve në tema si barazia gjinore dhe pasojat e dhunës në familje ishte gjithashtu kryesisht e munguar. Shkollat, veçanërisht në zonat rurale, ende nuk kanë mjaftueshëm psikologë/e, gjë që pengon qasjen e të rinjve në mbështetje kur dhuna me bazë gjinore prek ata ose familjet e tyre. U ngritën gjithashtu shqetësime për konfidencialitetin, pasi disa zyrtarë thanë se të dhënat personale shpesh dalin publike, çka mund të pengojë të rinjtë të kërkojnë ndihmë. Nëse nxënësit dëgjojnë për raste dhune me bazë gjinore në shkolla, ata mund të mos ndihen të sigurt për të kërkuar ndihmë në vetë institucionin arsimor. Zyrtarët/et ndanë shembuj të pezullimeve të mësuesve për sjellje të papërshtatshme seksuale. Në një rast u ndërmor masë disiplinore, ndërsa në një tjetër, reagimi ishte i menjëhershëm pasi një nxënëse raportoi mesazhe të papërshtatshme nga një mësues. Që nga viti 2013, ekziston Sistemi Online për Menaxhimin e Informacioneve në Arsim, përmes të cilit mësimdhënësit/et mund të raportojnë raste të mundshme të dhunës në familje. Ky sistem mund të lehtësojë identifikimin dhe monitorimin e rasteve të mundshme të abuzimit. Megjithatë, historikisht mësimdhënësit/et kanë pasur mungesë vetëdijeje rreth këtij sistemi dhe, për pasojë, ai nuk është përdorur në mënyrë të qëndrueshme.[125]

Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) është përgjegjës për trajtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga shteti, përfshirë edhe rastet që lidhen me dhunën

[123] Artpolis, Analiza mbi njohuritë e studentëve për ekzistencën dhe zbatimin e rregullores së universitetit të prishtinës "Hasan Prishtina" kundër ngacmimit seksual dhe ngacmimit, 2023.
[124] Në vitin 2024, RrGK intervistoi pesë zyrtarë/e nëpër Kosovë.
[125] Shih Endrita Banjska, Besarta Breznica, David JJ Ryan, dhe Nicole Farnsworth për RrGK *Nga Ligjet në Vepra*, 2021.

me bazë gjinore.[126] Nëse një viktimë ndien se është trajtuar padrejtësisht nga ndonjë institucion i Kosovës gjatë trajtimit të rastit të saj/tij, ajo/ai mund ta raportojë çështjen në IAP për hetim dhe mbështetje. IAP ka të drejtë të rekomandojë masa për institucione dhe organe qeveritare me qëllim të përmirësimit të reagimit të tyre ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore.[127] Institucionet janë ligjërisht të obliguara t'i përgjigjen IAP-it dhe të zbatojnë rekomandimet e tij. IAP trajton ankesa që lidhen me të drejtat gjyqësore, neglizhencën administrative, mosmarrëveshjet e punësimit dhe qasjen në shërbime sociale dhe shëndetësore. Ankesat më të shpeshta përfshijnë mosreagimin e autoriteteve publike, punësime të parregullta dhe pengesa në qasjen në shërbime esenciale. IAP pranon rreth 10 deri në 15 ankesa në vit që lidhen me dhunën në familje.

Megjithatë, hetimet e tij kanë treguar mangësi sistematike në vlerësimin e rrezikut, prioritizimin e rasteve dhe koordinimin ndërinstitucional. Sipas IAP-it : "Edhe me rekomandimet tona, nuk ka pasur përgjigje efektive për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve." Pavarësisht përmirësimeve që nga viti 2022, në fund të vitit 2023 vetëm 28% e rekomandimeve të IAP-it ishin zbatuar plotësisht, më shumë se 50% ishin ende në proces, ndërsa 16% ishin injoruara.[128] Edhe pse këto të dhëna i referohen të gjitha rasteve dhe jo vetëm atyre të dhunës me bazë gjinore, ato tregojnë mungesë të vëmendjes institucionale ndaj rekomandimeve të IAP-it, përfshirë ato që lidhen me trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

IAP përballet me sfida të shumta që lidhen me burimet njerëzore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Aktualisht, institucioni ka rreth 50 të punësuar/a në selinë qendrore në Prishtinë dhe vetëm një ose dy zyrtarë/e në secilën zyrë rajonale, gjë që ndikon në efikasitetin dhe mbulueshmërinë e tij. Edhe pse IAP ka miratuar Kod Etik, ende nuk ka një rregullore të brendshme specifike mbi shfrytëzimin dhe ngacmimin seksual, e cila do të forconte mekanizmat e integritetit dhe mbrojtjen e stafit dhe përfituesve. Për më tepër, bashkëpunimi i tij me institucionet publike mbetet i pamjaftueshëm, pasi shumë autoritete dështojnë të zbatojnë rekomandimet e IAP-it në kohë, duke dobësuar rolin dhe ndikimin e këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e drejtësisë gjinore.

Organizatat e Shoqërisë Civile

Organizatat e shoqërisë civile (OShC-të), veçanërisht ato që fokusohen në të drejtat e grave, luajnë një rol kyç në parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Ato ndihmojnë viktimat, mbështesin sigurimin e urdhrave mbrojtës, rrisin vetëdijen, ofrojnë shërbime mbështetëse, realizojnë kërkime dhe monitorim politikash, japin ekspertizë të bazuar në përvojë dhe avokojnë për reforma ligjore e institucionale.

Përfaqësueset/it e OShC-ve theksuan se viktimat e dhunës me bazë gjinore shpesh hezitojnë t'i raportojnë rastet në institucione për shkak të mungesës së besimit.[129] Këtu hyn në lojë roli jetik i OShC-ve, pasi viktimat shpesh kanë më shumë besim tek to dhe kërkojnë ndihmë përmes tyre. Disa OShC ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për të mbijetuarat/it.

Siç është diskutuar më herët, strehimoret e menaxhuara nga OShC ofrojnë shërbime të shumta.[130] Disa OShC ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për të mbijetuarat/it. Siç është diskutuar më herët, strehimoret e menaxhuara nga OShC ofrojnë mbrojtje, kujdes psikosocial dhe mbështetje për riintegrim. Gjithashtu, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra për

[126] Qeveria e Kosovës, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026, 2022, f. 32.
[127] Po aty.
[128] Intervistë e RrGK-së me përfaqësues/e të IAP-ut, 2024.
[129] Në vitin 2024, RrGK intervistoi 15 anëtarë/e të stafit nëpër Kosovë.
[130] Për më shumë informacion, shihni seksionin mbi Strehimoret.

Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal, dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ofrojnë këshillim dhe përfaqësim ligjor, si dhe ndihmë në navigimin e institucioneve. RrGK dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjithashtu kryejnë monitorim ligjor dhe publikojnë raporte që vlerësojnë trajtimin nga gjyqësori të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës seksuale, me fokus në qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore, vonesat në procedura dhe koordinimin institucional. Women 4 Women ofron këshillim psikologjik falas dhe programe fuqizimi socioekonomik për të ndihmuar gratë të fitojnë pavarësi.

Që nga viti 2022, kjo organizatë ka mbajtur seanca individuale dhe në grup, duke mbështetur të mbijetuarat e dhunës, përfshirë edhe ato të dhunës seksuale gjatë luftës, në procesin e tyre të shërimit. Medica Gjakova dhe Medica Kosova ofrojnë trajtim psikosocial për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale. Qendra për Barazi dhe Liri dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore kanë këshilltarë/e ligjorë/e, këshilltarë/e psikologjikë/e dhe psikologë/e që ofrojnë mbështetje për personat LGBTQIA+ që kanë përjetuar dhunë. Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) përmes qendrës së saj drop-in ofron hapësirë të sigurt për komunitetin LGBTQIA+, me qasje në ndihmë juridike, këshillim dhe testim HIV. Përveç ofrimit të shërbimeve, OShC-të luajnë një rol të rëndësishëm në parandalim përmes fushatave të vetëdijesimit mbi dhunën me bazë gjinore dhe mënyrat e raportimit të saj. Edhe pse shumë OShC janë të përfshira, ky studim nuk e mbulon tërësisht veprimtarinë e tyre të gjerë – në vijim përmenden disa shembuj përfaqësuese: RrGK udhëheq rregullisht fushata ndërgjegjësimi, duke përdorur teatrin forum, rrjetet sociale dhe ekspozita rrugore. Artpolis ka zhvilluar trajnime mbi dhunën seksuale në universitete dhe organizon rregullisht forum teatër dhe shfaqje filmash, të shoqëruara me diskutime të moderuara me palë të ndryshme. Qendra për Barazi dhe Drejtësi ka ofruar trajnime mbi ngacmimin seksual në shkolla të mesme. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAEK) punon për ndërgjegjësimin kundër dhunës në familje në këto komunitete, duke bashkëpunuar ngushtë me strehimoret për referime. Medica Kosova gjithashtu organizon sesione me gratë Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane.

Qendra për Arsim dhe Zhvillim të Komunitetit (CEDC) mban sesione informuese për martesat e hershme në shkollat e ulëta dhe të mesme. Handikos Mitrovica mbështet gratë me aftësi të kufizuara, të cilat përballen me diskriminim të dyfishtë dhe rrezik më të lartë për dhunë, duke i informuar për të drejtat dhe mënyrat për të kërkuar ndihmë. QIKA, përmes platformës së saj Qika.org – portali i parë i gazetarisë feministe në Kosovë – raporton rregullisht për dhunën me bazë gjinore. Në mënyrë të ngjashme, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN) hulumton dhe raporton rregullisht për rastet e dhunës me bazë gjinore, reagimet institucionale dhe boshllëqet në llogaridhënie përmes gazetarisë hulumtuese dhe monitorimit të thelluar. Edhe Kosovo 2.0 trajton çështje të ndërlidhura përmes gazetarisë hulumtuese, debateve publike dhe fushatave multimediale, me synim rritjen e vetëdijes për barazinë gjinore, seksualitetin dhe diskriminimin sistemik. OShC-të kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kornizës ligjore të Kosovës, përmes kërkimeve të orientuara drejt politikave, përgatitjes së rekomandimeve, pjesëmarrjes në grupe pune, avokimit për miratimin e politikave dhe monitorimit të zbatimit të tyre – përfshirë edhe në kuadër të këtij raporti. Ndërkohë, përfaqësueset/it e komunitetit LGBTQIA+ thanë se shpesh janë të nën-përfaqësuar në këto procese për shkak të mungesës së ftesave për pjesëmarrje. Në kushtet e shkurtimeve globale të fondeve, OShC-të, shërbimet e tyre për viktimat, ekspertiza dhe aktivitetet ndërgjegjësuese janë nën kërcënim serioz. Sipas anketës së RrGK-së për vitin 2025 mbi situatën e organizatave për të drejtat e 100 grave në Kosovë: 90% e tyre kanë mungesë fondesh për të zhvilluar punën,

gjysma veprojnë pa asnjë fond, dhe 57% nuk kanë siguruar fonde për vitin 2026.[131] Organizata të tjera që ofrojnë ndihmë juridike apo shërbime të tjera gjithashtu kanë raportuar shkurtime të rënda financiare dhe rreziqe për vazhdimësinë e punës së tyre. Kjo situatë rrezikon qasjen e viktimave në ndihmë cilësore, veçanërisht kur ato ngurrojnë t'u drejtohen institucioneve shtetërore.

Akterët Ndërkombëtarë

Akterë të ndryshëm ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, duke kontribuar me ekspertizë, trajnime, mbështetje financiare dhe asistencë teknike për të përmirësuar politikat, infrastrukturën institucionale, performancën dhe koordinimin ndërinstitucional.Për shembull, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka mbështetur trajnime për përdorimin e duhur të dhomave të intervistimit në stacionet e policisë, me qëllim sigurimin e një qasjeje më të përgjegjshme ndaj të mbijetuarave të dhunës. OSBE-ja ka organizuar trajnime për profesionistë/e të drejtësisë dhe zyrtarë/eve policorë/e, si dhe ka mbështetur mekanizmat e koordinimit në nivelet qendrore dhe lokale. Këshilli i Evropës (KE) ka ofruar mbështetje teknike për zbatimin e legjislacionit, përfshirë programet për rehabilitimin e dhunuesve. UN Women ka mbështetur mekanizmat e koordinimit dhe zhvillimin e politikave në nivele komunale dhe kombëtare. UNFPA dhe UNICEF janë angazhuar në zhvillimin e politikave dhe ngritjen e vetëdijes për çështjet që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve. Këto janë vetëm disa prej shumë përpjekjeve të ndërmarra nga akterët ndërkombëtarë. Megjithatë, hartimi i një harte të plotë të mbështetjes ndërkombëtare dhe aktiviteteve përkatëse ishte përtej qëllimit të këtij hulumtimi, i cili është fokusuar në performancën institucionale dhe zbatimin e kornizës ligjore në Kosovë.

Përfundim

Institucionet në Kosovë kanë bërë përparime të dukshme në përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për adresimin e dhunës me bazë gjinore, duke e përputhur atë me standardet ndërkombëtare. Institucionet kanë treguar angazhim më të madh për mbrojtjen e të mbijetuarave, ndërsa stafi i specializuar në disa institucione, mekanizmat e përmirësuar të koordinimit, trajnimi i zgjeruar, dhe rritja e fondeve për strehimoret reflektojnë progres të rëndësishëm.

Ndërkohë, zbatimi mbetet i fragmentuar, veçanërisht në nivelin komunal, ku mungojnë stafi i mjaftueshëm, koordinimi dhe burimet e nevojshme. Qëndrimet patriarkale, stereotipet gjinore të rrënjosura dhe fajësimi i viktimave vazhdojnë të jenë të pranishme në institucione, duke penguar qasjen e bazuar në viktimë dhe reagimin e ndjeshëm gjinor.

Edhe pse gjykatat kanë treguar disa përmirësime, tentativat për pajtim dhe trajtimi i pasaktë i rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët vazhdojnë.

Klasifikimi i pasaktë i rasteve, dënimet e lehta, zbatimi i dobët i urdhrave mbrojtës dhe shkeljet e konfidencialitetit po kontribuojnë në mungesën e besimit ndaj sistemit të drejtësisë, duke dekurajuar raportimin e rasteve dhe, si rrjedhojë, penguar trajtimin e drejtë dhe të plotë të tyre.Koordinimi ndërinstitucional vazhdon të jetë i dobët, sidomos në rastet ku çështjet civile dhe penale ndërthuren. Përfaqësimi i viktimave mbetet i fragmentuar ndërmjet prokurorëve, Mbrojtësve të Viktimave (MV) dhe Zyrtarëve/eve të Ndihmës Juridike (ZNJ), duke kontribuar në vonesa ose ndihmë të pamjaftueshme. Koordinimi ndërinstitucional për hartimin e planeve

[131] Anketa e RrGK-së me 80 organizata për të drejtat e grave në vjeshtë të vitit 2025 (në përgatitje).

të menaxhimit të rasteve të bazuara në viktima dhe sigurimin e shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe riintegrimit mbetet i dobët. Të mbijetuarat e dhunës seksuale, personat LGBTQIA+, gratë me aftësi të kufizuara dhe fëmijët përballen me pengesa sistemike shtesë për të siguruar mbrojtje dhe qasje në shërbime. Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC-të) luajnë një rol thelbësor në mbushjen e boshllëqeve institucionale, por puna e tyre është e rrezikuar për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë financiare. Përgjigjja institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore varet ndjeshëm nga asistenca ndërkombëtare, me pak shembuj të pronësisë së qëndrueshme lokale ose të institucionalizimit të zhvillimit të kapaciteteve brenda vetë institucioneve. Varësia nga iniciativat afatshkurtra të financuara nga donatorët pengon vazhdueshmërinë institucionale dhe konsolidimin e një sistemi kombëtar të qëndrueshëm për reagim. Sfida kryesore mbetet shndërrimi i politikave në praktikë të zotëruara lokalisht, përmes zhvillimit të institucionalizuar të kapaciteteve, zbatimit të qëndrueshëm, llogaridhënies efektive, dhe qasjes gjithëpërfshirëse e të orientuar nga viktima.

REKOMANDIME

Për Zyrën e Kryeministrit

- Të shqyrtohet zhvendosja e grupit ndërministror për dhunën me bazë gjinore nga MD në ZKM, si organ ndërinstitucional më i lartë se MD. Kjo do të mundësonte një qasje më gjithëpërfshirëse në adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, duke e tejkaluar kuadrin e ngushtë të drejtësisë për të përfshirë riintegrimin afatgjatë, rehabilitimin dhe mbështetjen e plotë për viktimat dhe të mbijetuarat. Ky mekanizëm duhet të pajiset me burime njerëzore të specializuara dhe të ketë staf të ekspert/eve.Të ndahet financim shtetëror për një pozitë të re të përhershme të shërbyesit civil — Koordinator/e Kombëtar/e për Dhunën me Bazë Gjinore, person me përvojë të gjerë profesionale, që do të koordinojë bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe draftimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve të ardhshme të veprimit në fushën e adresimit të dhunës me bazë gjinore. Kjo pozitë duhet të mbrohet nga paqëndrueshmëria politike.
- Të rikthehet MPMS si ministri e pavarur dhe të rivendoset Departamenti për Shërbime Sociale brenda saj.
- Të sigurohet që të gjitha institucionet të dorëzojnë të dhëna përmbledhëse lidhur me rastet e dhunës me bazë gjinore në ASK që këto të dhëna të publikohen rregullisht online, në përputhje me standardet minimale të Direktivës së BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje.

Për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

- Të krijohen linja të përhershme buxhetore të dedikuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore brenda buxheteve të institucioneve përgjegjëse dhe të sigurohen fonde të mjaftueshme, përfshirë për trajnime të përshtatshme. Të miratohen kërkesat e prokurorisë, Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave dhe komunave për ndarje të më shumë burimeve, sidomos burimeve njerëzore, për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.
- Të zbatohet obligimi ligjor që organizatat buxhetore të implementojnë buxhet të përgjegjshëm gjinor, duke përfshirë analiza gjinore për të informuar ndarjen e buxhetit.

- Të sigurohen fonde të rregullta vjetore për OShC-të me përvojë, në mënyrë që ato të mund të vazhdojnë ofrimin e shërbimeve për viktimat, zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe monitorimin e pavarur të zbatimit nga institucionet të kuadrit ligjor për dhunën me bazë gjinore nga ana e qeverisë.

Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Koordinatoren Kombëtare

Ndryshimi i KPK-së

Përkufizimet dhe Dispozitat e Përgjithshme

- Të përfshihet një përkufizim i qartë dhe gjithëpërfshirës i termit "gjini", i cili është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me përkufizimin më të gjerë të ofruar nga Konventa e Stambollit.
- Të sigurohet që motivet me bazë gjinore të njihen qartë si rrethana rënduese në të gjitha veprat penale përkatëse sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke reflektuar seriozitetin e krimeve që burojnë nga diskriminimi gjinor. Të përfshihen rastet kur krimet kryhen nga partnerë ose ish-partnerë që nuk bashkëjetojnë me viktimën, si dhe kur krimet kryhen në praninë e një fëmije.
- Të ndyshohet përkufizimi i ngacmimit duke hequr pjesën ku përcaktohet se viktima "vihet në frikë të arsyeshme për vdekje, lëndim të rëndë trupor, dëmtim serioz të pasurisë apo stres të konsiderueshëm emocional" për ta vërtetuar veprën penale. Reformat duhet të fokusohen në kriminalizimin e ndërhyrjes së padëshiruar në hapësirën psikologjike apo privatësinë mendore të një personi, pa kërkuar domosdoshmërisht dëshmi për pasojat tek viktima.
- Të prezantohet një dispozitë e veçantë për dhunën psikologjike, me qëllim që kjo formë e dhunës të trajtohet në mënyrë më adekuate dhe nga një këndvështrim i përgjegjshëm gjinor.

Dispozitat për Dhunën në Familje

- Të përfshihet një formulim i vetëm dhe i thjeshtuar që e përkufizon dhunën në familje si dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual apo ekonomik brenda një "marrëdhënieje familjare", për të siguruar qartësi më të madhe dhe zbatim të qëndrueshëm në praktikë.
- Të përfshihen qartë të gjithë anëtarët e familjes, pa marrë parasysh mënyrën e bashkëjetesës, si dhe çdo person që ndan një hapësirë të përbashkët banimi, pavarësisht nga marrëdhënia mes tyre, për të garantuar mbrojtje të plotë ligjore. Të përfshihen gjithashtu partnerët/et dhe ish-partnerët/et që nuk bashkëjetojnë me viktimën, duke siguruar që dhuna në marrëdhëniet intime jashtë bashkëjetesës të ndëshkohet në mënyrë të përshtatshme.
- Të hiqet dispozita që i referohet "qëllimit për të cenuar dinjitetin dhe për ta mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm apo në pozitë varësie personin ndaj të cilit është ushtruar dhuna", pasi kjo mund të krijojë paqartësi dhe të vendosë një prag të panevojshëm të lartë për vërtetimin e dhunës në familje, duke qenë se është e vështirë të sigurohen prova të mjaftueshme për qëllimet e pretenduara të dhunuesit.

Vepra të tjera të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Seksuale

- Të sigurohet që veprat penale të dhunës me bazë gjinore, përfshirë përdhunimin, sulmin seksual, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar dhe gjymtimin gjenital femëror (përfshirë

nxitjen apo ndihmën në këtë akt), të kenë dënime të rënda kur këto akte rezultojnë me vdekjen e viktimës. Këto ndryshime do të mbyllnin boshllëqet mbrojtëse dhe do të reflektonin realitetet e dhunës me bazë gjinore dhe ashpërsinë e këtyre krimeve.

- Të sigurohet që sterilizimi i detyruar të ndalohet jo vetëm kur mungon pëlqimi, por edhe kur viktima nuk e kupton natyrën dhe pasojat e procedurës.
- Të forcohen mbrojtjet ligjore duke zgjeruar fushëveprimin e veprës penale të vrasjes së rënduar (vrasjes së rëndë).
- Të kriminalizohet gjymtimi gjenital femëror edhe kur kryhet jashtë vendit dhe të kriminalizohet dështimi për të mbrojtur një vajzë nga kryerja e këtij akti, duke siguruar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Të merret parasysh një qasje ku prindërit apo çdo person përgjegjës për një vajzë, që e ekspozon atë ndaj rrezikut për t'iu nënshtruar këtij akti, përfshirë edhe jashtë vendit, mund të ndiqen penalisht. Kjo do të forconte përpjekjet për parandalim dhe do të rriste mbrojtjen e vajzave potencialisht të rrezikuara në Kosovë.

Dhuna e lehtësuar përmes teknologjisë

- Të miratohet një dispozitë penale e synuar brenda Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik, për të adresuar në mënyrë specifike dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia.
- Të harmonizohet KPK me Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje (DHMDHF), duke përfshirë vepra të reja penale që ndalojnë ndarjen pa pëlqim të materialeve intime ose të manipuluara, ndjekjen kibernetike, ngacmimin kibernetik dhe nxitjen e urrejtjes përmes internetit.
- Të aplikohen rrethana rënduese për veprat shtesë që lidhen me dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia, në përputhje me standardet e përcaktuara në Konventën e Stambollit.

Të Ndryshohen Ligjet e Tjera

- Të ndryshohet neni 63.1.15 i KPK-së, duke siguruar që transpozimi i Direktivës për të Drejtat e Viktimave të shoqërohet me një vlerësim të bazuar në nevoja dhe burime, në mënyrë që të drejtat e përcaktuara të mos jenë vetëm formalisht të garantuara, por edhe praktikisht të zbatueshme.
- Të hiqen referencat e papërshtatshme për pajtim nga Ligji për Familjen, pasi ato mund të nxisin presion ndaj viktimave për t'u rikthyer në marrëdhënie të dhunshme.
- Të zhvillohet një kuadër ligjor më i përgjegjshëm gjinor për strehimin social, duke forcuar mbështetjen për të mbijetuarat e dhunës përmes zgjidhjeve afatgjata dhe të qëndrueshme të banimit, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Të ndryshohet Ligji për Ndërmjetësim, duke ndaluar ndërmjetësimin në procedurat civile si kujdestaria e fëmijëve, alimentacioni dhe divorci, në rastet kur ndërmjetësimi mund të rishqetësojë viktimat ose të shfrytëzojë pozitën e tyre të cenueshme.
- Të harmonizohet Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës me Direktivën e BE-së për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje, duke përcaktuar procedura të qarta për mbrojtjen e fëmijëve përpara se prindi ose kujdestari/ja i/e përfshirë në një akt dhune të njoftohet për raportimin e fëmijës.

Të Përmirësohet Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Qeverisja, Koordinimi dhe Llogaridhënia

- Të krijohet një trup i pavarur ndërinstitucional, me përfaqësues/e të shoqërisë civile, për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e Konventës së Stambollit, me qëllim forcimin e sistemit vendor të monitorimit.
- Të realizohet një rishikim pas-zbatimit të Ligjit të ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, me vëmendje të veçantë ndaj trajtimit të dhunës kibernetike dhe qartësimit të aspekteve operative.
- Të shqyrtohet krijimi i një mekanizmi "Vëzhgues i Femicidit", veçanërisht pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2023, e cila konstatoi se institucionet shtetërore kishin dështuar të mbronin një viktimë të dhunës në familje nga femicidi. Ky mekanizëm do të kishte fokus parandalimin, përmes identifikimit dhe adresimit sistematik të mangësive në ligj, politika dhe zbatim që lidhen me dhunën me bazë gjinore.

Menaxhimi i të Dhënave dhe Sistemet e Informimit

- Të zbatohet përdorimi i duhur i bazës së të dhënave për menaxhimin e rasteve, që përfshin të gjitha format e dhunës me bazë gjinore të mbuluara nga Konventa e Stambollit.
- Të garantohet mbrojtja e të dhënave, kufizimi eiqasjes dhe konfidencialitetit, të përdoren zgjidhje softuerike për të lidhur bazën e të dhënave të menaxhimit të rasteve me CMIS, për të mundësuar interoperabilitet dhe përdorim më efikas të kohës nga akterët përkatës gjatë regjistrimit të të dhënave. Kjo mund të bëhet me nivele të përcaktuara mbrojtjeje, në mënyrë që vetëm personat relevantë të kenë qasje në të dhëna, ndërsa numrat dhe tendencat regjistrohen në një sistem të ndërlidhur.
- Të funksionalizohet CMIS duke: (1) siguruar që të dhënat të jenë të ndara sipas gjinisë dhe llojeve të dhunës, për të mundësuar analiza të përgjithshme nga ekspertë të jashtëm; dhe (2) angazhuar ekspertë/e gjinorë/e të specializuar/a në statistika gjinore në finalizimin e sistemit, për të garantuar që ai gjeneron raporte të përditësuara që publiku mund t'i përdorë për monitorimin e trajtimit të përgjithshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore, përfshirë informacion mbi shkallën e dënimeve.
- Të sigurohet që të dhënat përmbledhëse të jenë publikisht të qasshme përmes një faqeje online dhe të dërgohen çdo tremujor në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore.

Trajnimi, Ngritja e Kapaciteteve dhe Standardet Profesionale

- Të institucionalizohet trajnimi i detyrueshëm dhe periodik për Policinë e Kosovës, prokurorët/et, gjyqtarët/et, stafin e gjykatave, mbrojtësit/et, profesionistët/et e shëndetësisë (përfshirë pediatër/e, gjinekologë/e, obstetër/e, mamí, psikologë/e dhe personel tjetër shëndetësor), zyrtarë/e të shërbimeve sociale, staf arsimor dhe persona me funksione mbikëqyrëse, për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore — veçanërisht ato më pak të kuptuara si dhuna seksuale dhe gjymtimi gjenital femëror (GJGJF). Të përfshihen gjithashtu temat mbi stereotipet gjinore, fajësimin e viktimave dhe menaxhimin e rasteve me vlerësim të rrezikut.
- Të koordinohet dhe të finalizohet procesi i hartimit të protokolleve dhe udhëzuesve specifikë për profesionistët që ofrojnë ndihmë për viktimat e të gjitha formave të dhunës me

bazë gjinore të mbuluara nga Konventa e Stambollit, duke u shoqëruar me trajnime të specializuara të vazhdueshme dhe sistematike.

- Të sigurohet që Komisionet Komunale për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje të jenë trajnuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të jenë të afta të zbatojnë rregulloren e re që udhëzon punën e tyre, duke garantuar një reagim të koordinuar institucional që forcon parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe të mbijetuarave.

Ofrimi i Shërbimeve dhe Ndarja e Resurseve

- Të sigurohet zbatimi i plotë i garancive të përcaktuara në Direktivën e BE-së për të Drejtat e Viktimave, duke përfshirë pjesëmarrjen e informuar dhe vullnetare të viktimave, mbrojtjen nga riviktimizimi, si dhe ofrimin profesional dhe cilësor të shërbimeve mbështetëse.
- Të kryhet një analizë gjithëpërfshirëse gjinore përmes buxhetimit me përgjegjshmëri gjinore, me qëllim të vlerësimit të saktë të burimeve të nevojshme për zbatimin efektiv dhe cilësor të shërbimeve sociale. Në bazë të kësaj analize, MFPT-ja të sigurojë ndarje të mjaftueshme buxhetore në buxhetet vjetore për zbatimin e këtyre programeve, duke garantuar gjithashtu burime njerëzore të mjaftueshme, profesionale dhe të kualifikuara në të gjitha shërbimet. Të sigurohen mjete të mjaftueshme buxhetore për kompensimin e viktimave dhe asistencë adekuate për viktimat gjatë paraqitjes së kërkesave për kompensim.
- Të sigurohet shpërndarje e drejtë gjeografike dhe financim i qëndrueshëm për shërbimet e specializuara sipas kërkesave të Konventës së Stambollit, përfshirë strehimoret që operohen nga OShC-të, në bashkëpunim të ngushtë me MFPT-në.
- Të përmirësohen procedurat për referimin dhe dërgimin e rasteve në strehimore duke përdorur metodologjitë[132] ekzistuese të kostimit, me qëllim të sigurimit të strehimit afatgjatë dhe vazhdimësisë së mbështetjes për të mbijetuarat. Të sigurohet që të gjitha strehimoret të kenë financim të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm, si dhe të jenë të pajisura me burime njerëzore profesionale dhe të mjaftueshme, si dhe me infrastrukturën e nevojshme për funksionim të sigurt dhe efektiv.
  Kjo përfshin automjete zyrtare, objekte të sigurta dhe të qasshme, hapësira fizike të përshtatshme, masa të duhura për siguri kibernetike dhe sisteme të qëndrueshme komunikimi.
- Të planifikohet buxheti dhe të sigurohet funksionaliteti i një strehimoreje të dedikuar për viktimat e dhunës seksuale, duke garantuar qasjen në kujdes të specializuar dhe mbrojtje të përshtatshme.
- Të zgjerohet dhe përshtatet kapaciteti i strehimoreve për fëmijët, duke zhvilluar protokolle mbikëqyrjeje që adresojnë nevojat sipas moshës dhe ofrojnë akomodim të ndarë për djemtë mbi moshën 12 vjeçare.
- Të themelohet një strehimore e dedikuar për personat LGBTQIA+, duke siguruar mjedise të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe afirmuese.
- Të krijohet ose të caktohet një strehimore me staf të trajnuar dhe burime të mjaftueshme për të mbështetur personat me gjendje të rënda të shëndetit mendor.

[132] Duke u bazuar në përvojën globale dhe metodologjinë e llogaritjes së kostove të zhvilluar nga ABGJ në vitin 2019 (Buxhetimi operacional i strehimoreve në kosovë dhe udhëzuesi i projektimit), RrGK ka zhvilluar një metodologji gjithëpërfshirëse që mund të adoptohet, potencialisht të përshtatet dhe të përdoret nga MPJ ose ministria përgjegjëse në të ardhmen.

- Të ndahen fonde të dedikuara buxhetore për OShC-të e grave që kontribuojnë në zbatimin e kuadrit ligjor, ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarave, në përputhje me parimet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Të mundësohet që viktimat që aplikojnë për masën e subvencionimit të 70% të pagës bruto (deri në 300 €) të regjistrohen në Zyrat e Punësimit pa u detyruar ta bëjnë publik statusin e tyre si viktima, duke garantuar konfidencialitet të plotë dhe duke minimizuar rrezikun e stigmatizimit apo shkeljes së privatësisë. Të caktohet një menaxher/e i/e dedikuar i/e rastit nga Qendra për Punë Sociale, i/e cili/a do t'i asistojë viktimat gjatë gjithë procesit të aplikimit, regjistrimit dhe integrimit në punësim, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe të koordinuar.

Për Policinë e Kosovës

Të Forcohet Trajnimi, Ngritja e Kapaciteteve dhe Ndërgjegjësimi

- Të standardizohet kurrikula e Akademisë së Policisë dhe të vendosen masa llogaridhënieje për rastet e refuzimit të pjesëmarrjes në trajnim.
- Të bëhet i detyrueshëm trajnimi sistematik dhe periodik — si ai fillestar, ashtu edhe ai në shërbim — për të gjithë zyrtarët/et policorë/e, veçanërisht për reaguesit/et e pare/a, duke përfshirë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, në veçanti: abuzimin psikologjik, kontrollin, dhunën seksuale, ngacmimin seksual, gjymtimin gjenital femëror (GJGJF), martesat e hershme dhe dhunën e lehtësuar përmes teknologjisë. Të përfshihen gjithashtu temat mbi nevojat dhe të drejtat e viktimave, stereotipet gjinore të socializuara, parandalimin e riviktimizimit, marrëdhëniet e pushtetit, fajësimin e viktimës, ruajtjen e konfidencialitetit dhe qasjen e bazuar në traumë.
- Të sigurohet që zyrtarët/et e Policisë së Kosovës t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë në mënyrë të saktë dhe të njëtrajtshme ligjet përkatëse. Në veçanti, të garantohet që ata/ato ta kuptojnë plotësisht rëndësinë e identifikimit dhe dokumentimit të rrethanave rënduese të ndërlidhura me gjininë në rastet e veprave penale, përfshirë dhunën me bazë gjinore, krimet e urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin.
- Të sigurohet që Policia e Kosovës të trajnohet në mënyrë adekuate dhe të vazhdueshme për nxjerrjen dhe zbatimin efektiv të urdhrave për heqjen e përmbajtjeve që lidhen me dhunën me bazë gjinore në internet, duke përfshirë edhe adresimin e këtyre urdhrave te ofruesit e shërbimeve pritëse dhe/ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Të Përmirësohen PSV-të dhe Trajtimi i Rasteve

- Të ristrukturohen njësitë ekzistuese për hetimin e dhunës në familje në Njësi për Hetimin e Dhunës me Bazë Gjinore, në mënyrë që të trajtojnë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Të fuqizohen më tej kapacitetet e zyrtarëve/eve ekzistues/e për trajtimin e këtyre rasteve.
- Të zhvillohen protokolle të qarta dhe të qëndrueshme për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, për të siguruar praktika të unifikuara dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimeve në tërë Kosovën.
- Të sigurohet që vetëm zyrtarët/et e Policisë së Kosovës të trajnuar/a në dhunë me bazë gjinore dhe në qasje të orientuar kah viktima të zhvillojnë intervistat, me qëllim të parandalimit të riviktimizimit.

- Të ndërmerren masa shtesë afirmative për të rekrutuar dhe promovuar më shumë gra të larmishme në Policinë e Kosovës, veçanërisht në njësitë për hetimin e dhunës në familje (dhe në njësitë e ardhshme për dhunë me bazë gjinore), me qëllim të përmirësimit të besimit, qasjes dhe cilësisë së shërbimeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për veriun e Kosovës, ku nevojitet balancë gjinore *dhe* etnike. Të sigurohet qasje në kujdes për fëmijë, orar fleksibil pune dhe vendstacione detyre afër vendbanimit.
- Të sigurohet qasja në mbikëqyrje dhe mbështetje psikologjike për zyrtarët/et që trajtojnë raste të dhunës me bazë gjinore, me qëllim të parandalimit të djegies profesionale (burnout).
- Të sigurohet që të gjitha stacionet policore të kenë dhoma intervistimi të sigurta dhe private, si dhe pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e dinjitetit dhe privatësisë së të mbijetuarave, duke u zgjeruar në të gjitha komunat.
- Të funksionalizohen më tej byzylykët elektronikë për monitorimin e zbatimit të urdhrave mbrojtës.
- Të sigurohet që policia t'u përgjigjet menjëherë të gjitha shkeljeve të urdhrave mbrojtës dhe t'i ndjekë ato përmes sistemit të drejtësisë penale.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet njësive për hetimin e dhunës në familje dhe Njësisë për Krime Kibernetike për adresimin e dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia.
- Të operacionalizohet "Fondi Emergjent" për mbulimin e nevojave urgjente të viktimave gjatë qëndrimit të tyre në stacionet policore, duke siguruar që zyrtarët/et, veçanërisht ata/ato të Qendrave për Punë Sociale, të jenë të informuar/a për ekzistencën e tij dhe mënyrën e qasjes në fonde.
- Të mundësohet transporti i shpejtë i viktimave nga Policia e Kosovës drejt Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) për qasje të menjëhershme në shërbime forenzike.

Për Institutin e Mjekësisë Ligjore

- Të rritet numri i mjekeve forenzikë, për të mundësuar viktimave zgjedhjen e gjinisë së ekzaminuesit/es, duke rritur ndjesinë e sigurisë dhe besimit.
- Të rritet numri i profesionistëve/eve forenzikë të trajnuar/a, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përqendruar te viktima në të gjitha ekzaminimet forenzike të rasteve të dhunës seksuale.
- Të përmirësohet dokumentimi i abuzimit psikologjik dhe emocional, përveç dëmtimeve fizike, në raportet forenzike.
- Të zbatohet trajnimi "fillestar dhe në vazhdim, sistematik dhe i detyrueshëm" për të gjithë profesionistët/et forenzikë/e, siç rekomandohet nga Këshilli i Evropës (KE), mbi parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohen nga Konventa e Stambollit, si dhe mbi procedurat ligjore, nevojat dhe të drejtat e viktimave, sidomos atyre në situata të cenueshme, parandalimin e riviktimizimit dhe eliminimin e stereotipeve gjinore.
- Të i ofrohet stafit të IML-së qasja falas në supervizim profesional dhe psikoterapi, për të mbështetur mirëqenien profesionale dhe për të reduktuar lodhjen emocionale dhe djegien profesionale (burnout).

Për Prokurorinë dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

- Të sigurohet që të gjitha komunat të kenë një prokuror/e të specializuar për rastet e dhunës me bazë gjinore.
- Të sigurohet që prokurorët/et të ndjekin trajnime gjithëpërfshirëse "fillestare dhe në vazhdim, sistematike dhe të detyrueshme", siç rekomandohet nga Këshilli i Evropës (KE). Trajnimi duhet të theksojë marrëdhëniet gjinore të pushtetit, patriarkatin dhe faktorët tjerë strukturorë që kontribuojnë në dhunë. Trajnimi duhet të përfshijë një qasje të përqendruar te viktima, që merr parasysh kontekstet shoqërore dhe të pushtetit që e rrethojnë secilin rast. Prokurorët/et kanë nevojë për trajnim për të dalluar mes **ngacmimit seksual** dhe **sulmit seksual**; **për të kuptuar më mire GJGJF**-në; për klasifikimin e gabuar ligjor, rrethanat rënduese, dhe kombinimin e veprës penale të dhunës në familje sipas KPK-së me akuza përkatëse shtesë; si dhe **për të njohur që dhuna me bazë gjinore mund të prekë edhe burrat**. Të merret parasysh përdorimi i rasteve praktike në trajnim dhe udhëzimet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).
- Të rritet financimi për infrastrukturën institucionale, duke përfshirë punësimin e stafit mbështetës shtesë, zgjerimin e hapësirave të zyrave dhe sigurimin e qasjes në dhoma private për intervistimin e viktimave.
- Të ofrohet qasje në psikoterapi falas për prokurorët/et përmes institucioneve publike, për përmirësimin e mirëqenies së tyre.

Për Mbrojtësit e Viktimave

- Të rekrutohen Mbrojtësit e Viktimave shtesë për të adresuar mungesën e stafit dhe për të reduktuar ngarkesën e lartë të rasteve, duke siguruar burime njerëzore të mjaftueshme për mbështetje të qëndrueshme të viktimave në të gjitha komunat.
- Të sigurohet prezenca e detyrueshme e Mbrojtësve të Viktimave gjatë procedurave kyçe, përfshirë intervistat policore dhe seancat gjyqësore, për të parandaluar riviktimizimin dhe për të respektuar detyrimet ligjore.
- Të forcohen masat për ruajtjen e konfidencialitetit, në bashkëpunim me policinë dhe gjykatat, për të parandaluar rrjedhjen e informacionit në media dhe për të mbrojtur identitetin e viktimave gjatë gjithë procesit ligjor.
- Të ofrohen trajnime fillestare dhe në vazhdim, të detyrueshme, për të ditur dallimin në mes të "dhunës me bazë gjinore" dhe "dhunës në familje", duke adresuar keqkuptimet dhe paqartësitë ligjore. Trajnimi duhet të sfidojë qëndrimet patriarkale, të theksojë rëndësinë e trajtimit serioz të raportimeve të viktimave, dhe të promovojë një qasje të përqendruar te viktima dhe të ndjeshme ndaj traumës.
- Të sigurohet qasja falas në supervizim dhe mbështetje psikologjike për Mbrojtësit e Viktimave përmes institucioneve publike, për të parandaluar lodhjen profesionale.
- Të ndahen fonde për sigurimin e transportit gjatë pjesëmarrjes në seanca gjyqësore dhe për zgjerimin e hapësirave të zyrave, me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit në ndërveprimet me viktimave.

Për Zyrat e Ndihmës Juridike

- Të sigurohen burime njerëzore të mjaftueshme për Zyrat e Ndihmës Juridike.
- Të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë në raport me koordinimin me institucionet e tjera. Të ofrohen udhëzime të qarta se kur Zyrat e Ndihmës Juridike mund dhe duhet të

përfshihen në procedurat penale, veçanërisht në rastet kur mbështetja shtesë ligjore mund të forcojë mbrojtjen e viktimave.

- Të institucionalizohet trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm, i detyrueshëm dhe gjithëpërfshirës, për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, qasjen e përqendruar te viktima, Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) dhe Procedurat Standarde të Veprimit(PSV).
- Të ndahen burime për infrastrukturë, për të mbështetur gratë që kërkojnë ndihmë juridike ndërkohë që kujdesen për fëmijët, duke siguruar sigurinë, privatësinë dhe dinjitetin e tyre gjatë procedurave ligjore.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, AD, dhe Gjyqtarët/et

- Të kërkohet zbatimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Shqyrtimin e Dënimeve, duke përfshirë sqarimet më të qarta mbi *dhunën me bazë gjinore* dhe nevojën për arsyetim të detajuar dhe të qartë për rrethanat rënduese apo lehtësuese në të gjitha aktgjykimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore.
- Të sigurohet që të gjithë gjyqtarët/et penalë/e dhe civilë/e të ndjekin trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm, të detyrueshëm, në nivele bazë dhe të avancuara, mbi dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën psikologjike, ekonomike dhe seksuale, me theks të veçantë në normat e socializuara gjinore. Gjyqtarët/et duhet të trajnohen më tej në kuadrin ligjor, përfshirë LMDHF-në, SKMDHF-në, PSV-të, Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, dhe Kurrikulën për Trajtimin e Dhunuesve. Trajnimet duhet të thellojnë njohuritë për ngacmimin seksual, sulmin seksual, gjymtimin gjenital femëror dhe dhunën me bazë gjinore në teknologji, përfshirë përndjekjen përmes pajisjeve teknologjike. Gjyqësori duhet të trajnohet gjithashtu në nxjerrjen e urdhrave për heqjen e përmbajtjeve TFGBV që adresohen te ofruesit e shërbimeve pritëse dhe/ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve. Trajnimet duhet të adresojnë edhe etikën profesionale, paragjykimet dhe fajësmin e viktimave.
- Të sigurohet që trajnimet për martesat e detyruara të theksojnë se faktorët kulturorë dhe gjinorë duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të asaj që përbën "detyrim", "kërcënim" dhe "shtrëngim" sipas Ligjit për Familjen. Trajnimet duhet të sqarojnë qartë se asnjë kulturë, zakon, religjion, traditë apo i ashtuquajturi "nder" nuk mund të justifikojë martesat e detyruara në asnjë rrethanë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Të zgjerohet dhe diversifikohet përmbajtja e trajnimeve të ofruara nga Akademia e Drejtësisë për të adresuar këto boshllëqe.
- Të shtohen masa disiplinore për gjyqtarët/et që përdorin gjuhë stigmatizuese ose i atribojnë fajin viktimave në rastet civile.
- Të sigurohet që gjyqtarët të pranojnë një gamë më të gjerë të provave të pranueshme në rastet e urdhrave mbrojtës dhe të mos i refuzojnë ato vetëm për mungesë të provave fizike apo dëshmive të plota.
- Të zbatohet ndalesa ligjore për ndërmjetësim dhe pajtim në rastet e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë rastet e dhunës në familje; monitoroni praktikat e gjykatave për t'u siguruar që viktimat të mos ushtrojnë presion për të falur ose për t'u pajtuar me autorët e krimit.
- Të rikujtohen gjyqtarët/et për detyrimin e tyre ligjor që të referojnë viktimat te fondi i kompensimit, kur kompensimi nuk mund të sigurohet nga dhunuesi.
- Të sigurohet që gjyqtarët të zbatojnë të paktën dënimet minimale të përcaktuara me ligj, veçanërisht në rastet e dhunës në familje, përdhunimit dhe përdhunimit brenda martesës, me qëllim të luftimit të pandëshkueshmërisë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të

ndërmarrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve që dështojnë të zbatojnë dënimet minimale të përcaktuara me ligj, pasi veprime të tilla përbëjnë shkelje të ligjit.
- Të përfshihen programe rehabilitimi për dhunën me bazë gjinore si pjesë e dënimeve dhe kushteve të provës të lëshuara nga gjykatat.

Për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin e Provës

- Të ndryshohet kuadri ligjor për të kërkuar pjesëmarrjen e detyrueshme në programe të certifikuara të rehabilitimit për të gjithë personat e dënuar për vepra penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore.
- Të përdoren qasjet motivacionale, modele bashkëmoshatare dhe formate konfidenciale për të adresuar pengesat që lidhen me turpin dhe krenarinë e dhunuesve gjatë pjesëmarrjes së tyre në programe.
- Të sigurohet që zyrtarët/et e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit të Provës të marrin trajnime fillestare dhe në vazhdim, të detyrueshme, mbi dhunën psikologjike, seksuale dhe ekonomike, me theks në format jo fizike të dhunës. Të përfshihet trajnim mbi etikën profesionale dhe përgjegjshmërinë gjinore, për të adresuar fajësimin e viktimës dhe për të zhvendosur fokusin nga ruajtja e familjes drejt mbrojtjes së të mbijetuarës/it. Të sigurohet që të gjithë zyrtarët/et të jenë trajnuar për zbatimin e programeve të rehabilitimit.

Për Shërbimet Sociale

Për Departamentet e Mirëqenies Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale

- Të miratohen standardet minimale për profesionistët e shërbimeve sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, të hartuara nga Ministria e Drejtësisë (MD), duke u siguruar që të gjithë punonjësit/et socialë/e përgjegjës/et të trajnohen në mënyrë të duhur mbi këto standarde.
- Të sigurohet trajnimi fillestar dhe ai i vazhdueshëm i detyrueshëm për të gjithë punonjësit/et socialë/e mbi Kodin Penal të Kosovës (KPK), Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) dhe dhunën me bazë gjinore, duke përdorur trajnimet dhe udhëzuesit e zhvilluar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), me përditësime sipas nevojës. Të vihet theksi në dhunën seksuale, ngacmimin seksual, përndjekjen, etikën profesionale dhe ndjeshmërinë gjinore, me qëllim eliminimin e qëndrimeve diskriminuese, fajësimit të viktimave dhe justifikimit të sjelljeve të dhunuesve, si dhe zhvillimin e një qasjeje të orientuar drejt viktimës në menaxhimin e rasteve. Të forcohen gjithashtu kapacitetet e punonjësve socialë në hartimin e dokumentacionit të mjaftueshëm dhe cilësor për të informuar proceset gjyqësore.
- Të punësohet staf shtesë në bazë të madhësisë së popullsisë dhe të sigurohet që punëtorët/et socialë/e të jenë të specializuar/a për trajtimin e llojeve të caktuara të rasteve, e jo për të gjitha kategoritë. Sipas Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, në secilën komunë të jenë së paku dy punëtorë/e socialë/e të specializuar/a për trajtimin e dhunës seksuale. Të emërohen punëtorë/e socialë/e të specializuar/a dhe të trajnuar/a posaçërisht në menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore me qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe të orientuar kah viktima.
- Të sigurohet qasje në mbikëqyrje dhe psikoterapi falas për punëtorët/et socialë/e, veçanërisht për ata/ato që punojnë me rastet e dhunës me bazë gjinore, me qëllim të parandalimit të djegies profesionale.

- Të monitorohet performanca e punonjësve socialë dhe e ofruesve tjerë të shërbimeve sociale të kontraktuar nga shteti, për të siguruar që ata ndjekin në mënyrë të qëndrueshme standardet dhe protokollet e shkruara të shërbimeve, duke garantuar mbështetje profesionale, të qëndrueshme dhe pa paragjykime për viktimat, përfshirë edhe në procedurat gjyqësore. Të ndërmerren masa për përmirësimin e kapaciteteve profesionale në rastet kur konstatohet performancë e dobët.
- Të planifikohet buxhet për më shumë burime njerëzore, transport dhe mbështetje logjistike, në mënyrë që Qendrat për Punë Sociale (QPS) të mund të reagojnë në mënyrë efikase ndaj rasteve në të gjitha komunat.
- Të përmirësohet futja dhe ndjekja e të dhënave për të informuar politikat, programet dhe buxhetet me të dhëna mbi rastet e trajtuara. Kjo mund të ndihmojë në rishpërndarjen e burimeve njerëzore sipas kërkesës për shërbime dhe në hartimin e buxheteve të përgjegjshme gjinore.

Për Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional

- Të zbatohet trajnimi fillestar dhe në vazhdim, i detyrueshëm, për stafin e Zyrave të Punësimit dhe Qendrave për Aftësim Profesional mbi kuadrin ligjor dhe përkufizimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore, përfshirë dallimet midis ngacmimit seksual, sulmit seksual, gjymtimit gjenital femëror (GJGJF), ndjekjes dhe veprave të tjera përkatëse. Të merret parasysh përditësimi dhe përdorimi i kurrikulës ekzistuese të UNDP-së. Trajnimi duhet të përfshijë temat mbi stereotipet gjinore, fajësimin e viktimës dhe parimet e qasjes së përqendruar te viktima dhe të ndjeshme ndaj traumës, duke theksuar sigurinë, autonominë dhe fuqizimin e të mbijetuarës/it, në vend të pajtimit.
- Të integrohet Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) në planet operacionale të ZP-ve dhe QAP-ve, duke siguruar që i gjithë stafi të jetë i njohur me dispozitat e saj dhe i aftë për t'i zbatuar masat përkatëse në punën e përditshme.
- Të sigurohet staf i mjaftueshëm dhe i kualifikuar në të gjitha ZP-të dhe QAP-të, për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për të mbijetuarat/it, përfshirë pika fokale të specializuara dhe të trajnuara në reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore.
- Të zhvillohen dhe standardizohen protokolle dhe udhëzues të qartë për të mbështetur të mbijetuarat/it në qasjen e tyre të sigurt në aftësim profesional dhe mundësi punësimi, pa diskriminim.
- Të planifikohet buxhet dhe të ofrohen stimuj punësimi për kompanitë që punësojnë të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, përfshirë subvencione pagash ose lehtësime tatimore, për të nxitur punësimin gjithëpërfshirës.
- Të krijohen sisteme të forta për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave, për të ndjekur numrin e të mbijetuarave/ve që marrin trajnime, punësohen dhe e ruajnë punësimin, me qëllim matjen e ndikimit të programeve.
- Të sigurohet qasja e synuar për të mbijetuarat/it në zonat urbane dhe rurale, për të promovuar qasje të barabartë në shërbimet e punësimit dhe aftësimit profesional në të gjitha rajonet.
- Të forcohet bashkëpunimi me OShC-të dhe organizatat e të drejtave të grave, për të bashkë-dizajnuar programe punësimi dhe trajnimi të përqendruara te të mbijetuarat, për të lehtësuar referimet dhe për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse për to.

Për Strehimoret

- Të përmirësohen sistemet e buxhetimit për të kalkuluar saktë koston vjetore të shërbimeve, duke propozuar nevojat buxhetore përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë (MD).
- Të ofrohet trajnim fillestar dhe në vazhdim, i detyrueshëm dhe gjithëpërfshirës për stafin, mbi qasjet feministe, të ndjeshme ndaj traumës dhe ndër-sektoriale, duke përshtatur shërbimet me nevojat specifike të personave të ndryshëm, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, individët LGBTQIA+ dhe pakicat etnike. Të rriten kapacitetet për trajtimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhunës seksuale.
- Të ofrohet supervizim psikologjik dhe këshillim i rregullt për punëtorët/et e strehimoreve, me qëllim parandalimin e djegjes profesionale (burnout), përmirësimin e mirëqenies së stafit dhe rritjen e cilësisë së përgjithshme të kujdesit të ofruar.

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Institucionet Arsimore

- Të ofrohen udhëzime praktike për zbatim dhe burime për të mbështetur Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe institucionet arsimore në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave (SKMDHF) dhe Procedurave Standarde të Operimit (PSV), përfshirë zhvillimin e planeve komunale. Të inkurajohet dhe të monitorohet zbatimi i duhur dhe ndjekja e vazhdueshme e tyre.
- Të krijohen dhe zbatohen politika dhe procedura të qarta për raportimin e ngacmimit seksual dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore në institucionet arsimore parauniversitare, duke siguruar mekanizma të qasshëm, konfidencialë dhe të përqendruar te viktima, si dhe zbatim të plotë e efektiv të tyre.
- Të zgjerohen, harmonizohen, promovohen dhe zbatohen politikat kundër ngacmimit seksual në të gjitha universitetet publike dhe private, duke u bazuar në përvojat dhe mësimet e nxjerra nga Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit.
- Të zhvillohen dhe zbatohen protokolle të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe identitetit të viktimave, dhe të sigurohet që i gjithë stafi të jetë i trajnuar në ruajtjen e konfidencialitetit në të gjitha ndërveprimet me viktimat dhe të mbijetuarat/it.
- Të institucionalizohet trajnimi fillestar dhe i rregullt në vazhdim, i detyrueshëm, për zyrtarët/et e MASHTI-t, DKA-ve, edukatorët/et dhe stafin shkollor, mbi kuadrin ligjor dhe përkufizimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore sipas KPK-së; dallimet midis dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, ngacmimit seksual dhe sulmit seksual; përgjegjësitë institucionale sipas SKMDHF dhe PSV-ve; si dhe parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në përputhje me Konventën e Stambollit. Trajnimi duhet të përfshijë nevojat dhe të drejtat e viktimave, veçanërisht të atyre në situata të cenueshme, dhe të fokusohet në parandalimin e riviktimizimit dhe adresimin e stereotipeve gjinore.
- Të rritet numri i psikologëve/eve në shkolla, me prioritet në zonat rurale dhe të nënpërfaqësuara, për të siguruar mbështetje psikosociale të qasshme dhe reagim të duhur për nxënësit/et.
- Të sigurohen hapësira të sigurta dhe konfidenciale këshillimi brenda të gjitha institucioneve arsimore, ku nxënësit/et e prekur/a nga dhuna me bazë gjinore mund të marrin mbështetje profesionale dhe të menjëhershme, pa frikë nga hakmarrja apo stigmatizimi.

- Të përmirësohet institucionalizimi i përpjekjeve për ngritje të vetëdijes dhe parandalim, të cilat synojnë transformimin e normave gjinore që qëndrojnë në themel të dhunës, me qëllim parandalimin e dhunës në të ardhmen. Të përfshihet në Ligjin për Tekstet Shkollore detyrimi për shqyrtim gjinor të teksteve, për të hequr stereotipet dhe për të promovuar një qasje transformuese gjinore. Të realizohet një shqyrtim i gjithanshëm gjinor i të gjitha kurrikulave në të gjitha nivelet arsimore, për të identifikuar dhe eliminuar stereotipet gjinore dhe përmbajtjet diskriminuese që mund të vazhdojnë dhunën me bazë gjinore. Të integrohet edukimi mbi barazinë gjinore, respektin e ndërsjellë dhe rolet gjinore jo-stereotipe në të gjitha lëndët dhe nivelet shkollore, në përputhje me nenin 14 të Konventës së Stambollit.
- Të zhvillohen fushata të përbashkëta dhe aktivitete ndërgjegjësuese, si forum teatri, ndërmjet DKA-ve, shkollave dhe OShC-ve, mbi temat e barazisë gjinore, marrëdhënieve të respektueshme, pasojave të dhunës me bazë gjinore, parandalimit të martesave të hershme dhe dhunës së lehtësuar përmes teknologjisë.
- Të zhvillohen materiale edukative të përshtatura sipas moshës për mësimdhënësit/et, prindërit dhe nxënësit/et, që promovojnë barazinë gjinore, parandalojnë dhunën dhe sfidojnë normat gjinore të dëmshme.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institucionet Shëndetësore

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të përgatitet korniza ligjore, të ndahen burimet e nevojshme dhe të themelohet një qendër referimi dhe krize për dhunë seksuale, në bashkëpunim me ekspertë/e të organizatave të shoqërisë civile, strehimoret dhe IML-në, siç parashihet nga Konventa e Stambollit. Kjo qendër duhet të ofrojë shërbime të integruara dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë kujdesin shëndetësor emergjent, këshillimin psikologjik, strehimin e përkohshëm dhe të sigurt deri në mundësinë e zhvendosjes, si dhe dokumentimin forenzik nga profesionistë/e të trajnuar/a. Të merret për bazë përvoja dhe mësimet e nxjerra nga Qendra "Lilium" në Tiranë, duke siguruar ndarje të mjaftueshme buxhetore për burimet njerëzore dhe kostot e tjera, përfshirë mbikëqyrjen e stafit për parandalimin e djegies profesionale. Po ashtu, të shqyrtohet mundësia e them limit të një linje telefonike brenda qendrës për këshillim psikologjik, e cila të ketë staf të trajnuar dhe të specializuar për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe të ndjeshme ndaj traumës.
- Të themelohen menjëherë grupet punuese përgjegjëse për hartimin e udhëzimeve administrative mbi Trajtimin e Abuzimit me Alkool dhe Substanca Psikotrope dhe për Trajtimin Psiko-Social, duke prioritizuar finalizimin dhe miratimin e tyre.
- Të zhvillohen dhe forcohen mekanizmat për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik, përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja, protokolleve të qarta dhe sistemeve të monitorimit, në përputhje me Ligjin për Shëndetin Mendor dhe standardet ndërkombëtare.
- Të krijohet një protokoll i veçantë trajtimi për rastet e gjymtimit gjenital femëror.
- Të gjitha institucionet shëndetësore (në të tri nivelet) të marrin trajnim të detyrueshëm dhe të vazhdueshëm mbi mbledhjen, ruajtjen dhe dokumentimin e provave mjekësore në rastet e dhunës me bazë gjinore. Ky trajnim duhet të integrohet si në arsimin para-shërbimit për profesionistët/et e shëndetësisë, ashtu edhe në programet e zhvillimit profesional të vazhdueshëm.
- Të forcohen kapacitetet e punonjësve shëndetësorë për menaxhimin klinik të rasteve të dhunës seksuale dhe përdhunimit, duke siguruar harmonizimin me standardet e OBSH-së

dhe të Konventës së Stambollit, si dhe zbatimin e një qasjeje të orientuar drejt viktimës dhe të ndjeshme ndaj traumës.

- Të institucionalizohet trajnimi fillestar dhe ai i rregullt gjatë punës për punonjësit/et shëndetësorë/e mbi parandalimin, identifikimin dhe reagimin ndaj të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, përfshirë trajnimet mbi KPK-në, LMDHF-në dhe PSV-të. Trajnimi duhet të përfshijë aftësimin e mëtejshëm të stafit shëndetësor për të sfiduar stereotipet gjinore, për të identifikuar shenjat e dhunës, për t'u përgjigjur nevojave të viktimave, për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të komunikuar me ndjeshmëri me viktimat, për të ruajtur konfidencialitetin dhe për të lehtësuar referime të sigurta, duke parandaluar riviktimizimin.
- Të qartësohen procedurat dhe përgjegjësitë për raportim, në mënyrë që profesionistët shëndetësorë të kuptojnë kur raportimi është i detyrueshëm ligjërisht dhe se marrja e pëlqimit të viktimës aktualisht nuk është parakusht për përmbushjen e këtij obligimi. Sipas rekomandimeve të GREVIO-s, mirëqenia e viktimës duhet të jetë kriteri kryesor në vendimmarrjen për raportim, veçanërisht në rastet kur ekziston rrezik i menjëhershëm i dhunës së mëtejshme.
- Të sigurohet disponueshmëria e hapësirave private dhe të sigurta brenda institucioneve shëndetësore për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale, për të mbrojtur dinjitetin, konfidencialitetin dhe sigurinë e tyre.

Për Komunat

- Të ofrohet trajnim bazik, i detyrueshëm dhe ndërsektorial për zyrtarët/e komunalë/e përgjegjës/e për barazi gjinore dhe dhunë me bazë gjinore. Trajnimi duhet të përfshijë mekanizmat e referimit, procedurat e koordinimit dhe detyrimet komunale për ndarjen dhe menaxhimin e buxheteve të mjaftueshme për shërbimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore.
- Të sigurohet ndarje adekuate dhe e qëndrueshme e burimeve, e udhëhequr nga analiza gjinore dhe buxhetimi i ndjeshëm gjinor, për zbatimin e plotë të përgjegjësive komunale në parandalimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Të identifikohen nga komunat burime shtesë të të hyrave lokale për të mbuluar boshllëqet në shërbime që nuk financohen nga qeveria qendrore.
- Të forcohet roli i Zyrtarëve për Barazi Gjinore (ZBGJ), në përputhje me detyrimet e tyre ligjore, përmes mbështetjes politike, ndarjes së kohës së mjaftueshme, burimeve të duhura dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale.
- • Të sigurohen objekte të përshtatshme për strehimoret në ato komuna ku ato aktualisht mungojnë.
- Të ndahen njësi të banesave sociale për të mbështetur viktimat e dhunës me bazë gjinore në kalimin drejt jetesës së pavarur, duke mundësuar qasje në strehim social në baza të vazhdueshme, sipas nevojës.
- • Të sigurohet që të gjithë kryetarët e komunave të jenë të informuar për detyrimet e tyre ligjore, të kuptojnë përgjegjësitë e tyre si kryesues/e të mekanizmave komunal për koordinim, të garantojnë funksionimin e këtyre mekanizmave, të ndajnë buxhet të mjaftueshëm për funksionimin e tyre, dhe të demonstrojnë vullnet të qartë politik për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore.

Për Institucionin e Avokatit të Popullit

- Të krijohet një rregullore e brendshme për parandalimin dhe trajtimin e shfrytëzimit dhe ngacmimit seksual për të gjithë stafin, ekspertët dhe përfituesit e IAP-së.
- Të punësohet më shumë staf në komunat jashtë Prishtinës për të ndihmuar në monitorimin e performancës së dobët institucionale në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të IAP-ut.
- Të përmirësohet koordinimi me institucionet për zbatimin e mëtejshëm të rekomandimeve të IAP-ut.

Për Këshillin e Evropës

- Të vazhdohet monitorimi nga GREVIO në Kosovë, pasi kjo forcon mbikëqyrjen e pavarur dhe mbështet harmonizimin me standardet e Konventës së Stambollit.

Për Koordinimin ndërinstitucional

- Të sigurohet që policia, prokurorët/et dhe gjyqtarët/et të jenë pjesë e trajnimeve ndërsektoriale, në mënyrë që të zhvillojnë një kuptim të përbashkët për dhunën me bazë gjinore me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe të mbështesin më mirë viktimat gjatë procedurave penale.
- Të krijohen mekanizma të strukturuar koordinimi ndërmjet MASHTI-t, MD-së, DKA-ve, OShC-ve, QPS-ve dhe institucioneve të tjera përkatëse, për të siguruar parandalim dhe reagim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial ndaj dhunës në mjediset arsimore.
- Të kërkohen takime të rregullta koordinuese dhe të vendosen protokolle përcjellëse ndërmjet strehimoreve, QPS-ve, policisë, ZP-ve, QAP-ve dhe akterëve të tjerë të Mekanizmave Komunalë të Koordinimit kundër Dhunës në Familje, për të garantuar mbështetje të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar kah viktima për të mbijetuarat/it edhe pas përfundimit të qëndrimit në strehimore.

SHTOJCAT

Shtojca 1. Të dhënat e institucioneve mbi dhunën me bazë gjinore

Kjo shtojcë përmban të dhëna mbi rastet e dhunës me bazë gjinore të raportuara, të siguruara nga institucione të ndryshme në Kosovë, sipas institucionit.

Strehimoret

Strehimoret që fokusohen në ndihmën për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre kanë kapacitet të strehojnë deri në 133 gra dhe fëmijë në mënyrë të përshtatshme, ndërsa disa strehimore mund të ofrojnë shtretër shtesë në raste emergjente. Shumica e strehimoreve kanë gjithashtu dhoma familjare për të akomoduar gratë me fëmijë. Kohëzgjatja e qëndrimit zakonisht varion nga tre deri në gjashtë muaj, në varësi të nevojave individuale dhe progresit në procesin e rehabilitimit. Vlen të theksohet se Kosova nuk ka aq shumë dhoma familjare sa parashihet nga Konventa e Stambollit.

Vendndodhja e strehimorës	Numri i shtretërve për të rritur	Numri i shtretërve për foshnje dhe fëmijë të vegjël	Numri i dhomave familjare	Kohëzgjatja e qëndrimit (në muaj)
Peja	16		3	3-6
Prizren	14		4	3-6
Prishtina	20	2	0	3-6
Gjakova	15	5	5	6
Gjilan	15	5	5	6
Ferizaj	15	0	0	6
Mitrovica	20	4	4	6
Novobërd	15	2	3	24 orë deri 14
Gjithsej	115	18	24	24 orë deri 14

Tabela më poshtë paraqet numrin e grave dhe fëmijëve që janë strehuar, si dhe numrin e atyre që kanë përfituar shërbime nga secila strehimore gjatë viteve. Tabela nuk përfshin të dhëna nga strehimorja për personat e trafikuar apo nga objekti qeveritar "Objekti i përkohshëm i sigurisë", pasi këto institucione nuk kanë ndarë të dhëna. Në disa raste, gratë mund të kenë përfituar të dy llojet e shërbimeve. Strehimorja në Prishtinë zakonisht ka pranuar numrin më të madh të rasteve, ndoshta edhe për shkak të numrit më të madh të popullsisë. Ndërkohë, strehimorja në Gjilan ka ofruar shërbime për dukshëm më shumë raste sesa strehimoret tjera, gjë që mund të tregojë një angazhim më të madh në komunitet për të inkurajuar gratë që të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje.

Strehimorja	2021 Strehime	2021 Shërbime	2022 Strehime	2022 Shërbime	2023 Strehime	2023 Shërbime	2024 Strehime	2024 Shërbime
Gjilan	71	350	66	329	94	332	76	346
Novo Brdo	20	32	38	51	39	52	23	61
Prizren	53	53	55	55	45	45	57	57
Ferizaj	55	32	81	43	75	27	45	18
Peja	66	66	117	117	98	98	64	64
Pristina	132	53	171	46	141	31	149	38

Gjakova	113		172		135		145	
Mitrovica	67		150		97		65	
Gjithsej	**577**	**586**	**850**	**641**	**724**	**585**	**624**	**584**

Policia

Tabela më poshtë paraqet të dhëna nga Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës mbi numrin e personave që kanë qenë viktima të veprave penale, sipas gjinisë. Viktimat paraqiten përgjithësisht në rastet e raportuara si të kryera apo të tentuara. Jo të gjitha veprat penale përfshijnë domosdoshmërisht dhunë me bazë gjinore, pasi Policia e Kosovës ende nuk ka një sistem të veçantë për t'i evidentuar ato si të tilla. Vlen të theksohet se dhuna në familje, e cila në mënyrë të qartë përfshin dhunën me bazë gjinore, është vepra e dytë më e raportuar, menjëherë pas lëndimit të lehtë trupor. Gratë përbënin 80.7% të viktimave të dyshuara. Një tjetër formë e qartë e dhunës me bazë gjinore është ngacmimi seksual, ku gratë përbënin 98% të viktimave të dyshuara. Po ashtu, më shumë gra sesa burra raportuan se kishin përjetuar ngacmim (70.6%), përdhunim (95.4%), sulm seksual (95.4%) dhe incest (100%).

Të dhëna të Policisë së Kosovës mbi Veprat Penale që Potencialisht Përfshijnë Dhunë me Bazë Gjinore 2021-2024

		Numri i viktimave sipas veprës penale dhe gjinisë											
		Gra	Gra	Gra	Gra	Burra	Burra	Burra	Burra	Gjithsej # e grave	%[1] e grave	Gjithsej # e burrave	% burrave
Gjithsej	Krimi	2021	2022	2023	2024	2021	2022	2023	2024				
24	172* Vrasje	1		1	1	6	3	8	2	3	12.5%	21	87.5%
74	173* Vrasje e Rëndë	2	4	5	2	16	10	15	10	13	17.6%	61	82.4%
1	178* Ndërprerje e paligjshme e shtatzënisë	1								1	100.0%		
3,962	181* Kërcënim	255	302	329	245	647	840	706	638	1,131	28.5%	2,831	71.5%
156	183* Ngacmim Seksual	19	51	34	49	1	1	1		153	98.1%	3	1.9%
758	182* Ngacmim	138	152	134	111	56	60	53	54	535	70.6%	223	29.4%
2,789	184* Sulm	220	265	238	181	539	499	422	425	904	32.4%	1,885	67.6%
8,681	185* Lëndim i lehtë trupor	464	444	491	462	1,352	1,245	1,325	1,202	1,861	21.4%	6,820	78.6%
828	186* Lëndim i rëndë trupor	23	25	20	18	214	172	158	130	86	10.4%	742	89.6%
305	227* Përdhunim	89	74	72	56	2	3	5	4	291	95.4%	14	4.6%
185	229* Sulm Seksual	552	40	40	41	1	3	3	24	176	95.1%	9	4.9%
4	230* Degradim i integritetit seksual				1	1			2	1	25.0%	3	75.0%
6	233* Nxitje e akteve seksuale me premtim të rremë për martesë	4	1	1						6	100.0%		
10	234* Lehtësim ose detyrim i prostitucionit	4	1		4				1	9	90.0%	1	10.0%
3	236* Marrëdhënie seksuale brenda familjes		2		1					3	100%		
6,070	248* Dhuna në Familje	1,245	1,414	1,144	1,095	328	296	279	269	4,898	80.7%	1,172	19.3%

[1] Të gjitha përqindjet në tabelë janë rrumbullakësuar në një shifër dhjetore për lehtësi në lexim.

Mbrojtësit e Viktimave

Tabela në vijim paraqet të dhëna të marra nga Zyrat e Mbrojtësve të Viktimave (ZMV), të kombinuara me informacione nga Policia e Kosovës (me shkrim të trashë dhe italik) për qëllime krahasimi. Ajo tregon se Mbrojtësit e Viktimave kanë ofruar vazhdimisht mbështetje në më shumë raste sesa ato të raportuara në Polici. Pavarësisht sfidave me burimet njerëzore të raportuara nga Mbrojtësit e Viktimave, tabela sugjeron se ata/ato kanë ndihmuar një numër gjithnjë në rritje rastesh me kalimin e viteve, ndonëse me një rënie të lehtë në vitin 2024.

Rastet e Dhunës në Familje dhe Kërkesat për Urdhra Mbrojtës	2021	2022	2023	2024
Rastet e dhunës në familje të regjistruara nga Policia e Kosovës	*1,573*	*1,710*	*1,423*	*1,364*
Rastet e dhunës në familje	1,822	2,538	2,636	2,620
Kërkesë për urdhër mbrojtjeje emergjente	32	112	198	434
Kërkesë për urdhër mbrojtjeje të përkohshme emergjente	3	8	16	34
Kërkesë për urdhër mbrojtjeje të rregullt	579	1,012	1,206	653
Kërkesë për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes	9	31	13	7
Kërkesë për urdhër mbrojtjeje të tërhequr nga pala	91	31	81	29
Kërkesë për modifikim të urdhrit të mbrojtjes	2	9	12	18
Kërkesë për ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes	6	257	11	28
Kërkesë për urdhër mbrojtjeje të refuzuar nga gjykata	17	15	8	1
Vendimet e miratuara nga gjykata për urdhrat e mbrojtjes	518	828	1,173	861

Prokuroria

